

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

25-VJETORI I NDËRHYRJES  
SË NATO-S DHE ÇLIRIMIT  
TË KOSOVËS: NJË ÇEREK  
SHEKULL SHTETNDËRTIM,  
ARRITJE DHE SFIDA –  
QASJE MULTIDISIPLINARE

Konferencë shkencore

10 qershor 2024



PRISHTINË  
2024

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SECTION OF SOCIAL SCIENCES

ACADEMY OF SCIENCES OF ALBANIA

THE 25TH ANNIVERSARY OF  
NATO INTERVENTION AND  
THE LIBERATION OF KOSOVA:  
A QUARTER OF A CENTURY OF  
STATE BUILDING,  
ACHIEVEMENTS AND  
CHALLENGES –  
A MULTIDISCIPLINARY  
APPROACH

Scientific Conference

10 June 2024

Prepared for publication by: Arsim Bajrami

Organizing Committee: Gjyljeta Mushkolaj, Frashër Demaj, Arsim Bajrami

Editor: Correspondent member Gjyljeta Mushkolaj, Secretary of the Section of Social Sciences



PRISHTINA  
2024

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

25-VJETORI I NDËRHYRJES  
SË NATO-S DHE ÇLIRIMIT  
TË KOSOVËS: NJË ÇEREK  
SHEKULL SHTETNDËRTIM,  
ARRITJE DHE SFIDA –  
QASJE MULTIDISIPLINARE

Konferencë shkencore

10 qershor 2024

Përgatiti për botim: Arsim Bajrami

Këshilli organizues: Gjyljeta Mushkolaj, Frashër Demaj, Arsim Bajrami

Redaktor: Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore



PRISHTINË  
2024

Copyright © ASHAK



Presidenti Clinton

*“Ne po veprojmë për të mbrojtur mijëra njerëz të pafajshëm në Kosovë nga ofensiva ushtarake në rritje. Duke vepruar tani, ne mbrojmë vlerat tona, mbrojmë interesat tona dhe çojmë përpara çështjen e paqes”*



## PËRMBAJTJA

Arsim Bajrami PARATHËNIE.....	9
----------------------------------	---

Gjyljeta Mushkolaj FJALA E HAPJES .....	13
--	----

### FJALËT PËRSHËNDETËSE

Mehmet Kraja.....	19
-------------------	----

Skënder Gjinushi .....	21
------------------------	----

Albin Kurti.....	25
------------------	----

Fatmir Sejdiu .....	29
---------------------	----

Alfred Moisiu .....	33
---------------------	----

### ARTIKUJ

Muhamedin Kullashi POLARIZIMET NË FRANCË RRETH NDËRHYRJES SË NATO-S NË KOSOVË.....	39
--	----

Arsim Bajrami ARGUMENTE LIGJORE DHE POLITIKE PËR INTERVENIMIN E NATO-S NË KOSOVË .....	51
--	----

Ksenofon Krisafi BOMBARDIMET E NATO-S NË ISH-JUGOSLLAVI NË KËNDVËSHTRIMIN E SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE.....	99
---	----

Paskal Milo

ROLI I DIPLOMACISË SHQIPTARE NË KONFERENCËN E  
RAMBUJESË..... 145

Frashër Demaj

ROLI I POLITIKËS PAQËSORE NË DIMENSIONET E  
NDËRKOMBËTARIZIMIT TË ÇËSHTJES SË KOSOVËS 1990-  
1997 ..... 157

Hajredin Kuçi

REFLEKSIONE POLITIKO-JURIDIKE DHE HISTORIKE PËR  
REAGIMIN NDËRKOMBËTAR NDAJ KRIZËS SË KOSOVËS .... 189

Bekim Baliqi

TRANSFORMIMI I SOVRANITETIT NË MARRËDHËNIET  
NDËRKOMBËTARE PAS NDËRHYRJES SË NATO-S: NGA  
INTERVENIMI HUMANITAR NË ‘PËRGJEGJËSINË PËR TË  
MBROJTUR’ ..... 203

Ibrahim Gashi

LUFTA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS (1998-1999)..... 219

Salihe Salihu

LEGJITIMITETI I INTERVENIMIT TË NATO-S NË KOSOVË  
DHE DOKTRINA CLINTON ..... 227

## PARATHËNIE

*Më 10 qershor 2024 me rastin e 25 vjetorit të intervenimi të NATO-s dhe çlirimit të Kosovës, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Shqipërisë, kanë mbajtur Konferencën shkencore me titull “25-vjetori i ndërhyrjes së Nato-s dhe çlirimit të Kosovës: një çerek shekull shtetndërtim, arritje dhe sfida – qasje multidisiplinare”. Me këtë rast, Seksioni i Shkencave Shoqërore ka emëruar Këshilli Organizativ për organizimin e kësaj konference në përbërje: Gjyljeta Mushkolaj, Arsim Bajrami dhe Frashër Demaj.*

*Në këtë përmbledhje punimesh, botohen fjalimet përshëndetëse të të gjithë folësve, fjalët përshëndetëse nga: Kryetari i ASHAK-ut Mehmet Kraja, Kryetari i ASHASH-së, Skender Gjinushi, Kryeministri Albin Kurti, dhe ish-presidentet prof. dr. Fatmir Sejdiu, Alfred Moisiu dhe kumtesat e të gjithë panelistëve: Muhamedin Kullashi, Arsim Bajrami. Ksenofon Krisafi, Paskal Milo, Gjyljeta Mushkolaj, Sonja Biserko, Frashër Demaj, Hajredin Kuçi, Ibrahim Gashi, Bekim Baliqi dhe Salihe Salihu.*

*Intervenimi i NATO-s në Kosovë, i njohur si Operacioni "Allied Force", ishte një ndërhyrje ushtarake që filloi më 24 mars 1999 dhe zgjati deri më 10 qershor 1999. Ky operacion kishte si qëllim të ndalte dhunën dhe krimet e ndodhura ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës nga forcat serbe, në kontekstin e luftës së Kosovës*

*Pasi negociatat diplomatike në Konferencën e Rambujesë dështuan, NATO-ja vendosi të ndërhyjë ushtarakisht si përgjigje ndaj krizës humanitare. Qëllimi kryesor ishte ndalimi i dhunës, mbrojtja e civilëve dhe rivendosja e paqes në Kosovë. Sulmet e NATO-s kishin një motiv të lartë moral. Ky motiv bazohej në moslejimin e spastrimit etnik në Evropë në prag të shekullit njëzetënjë si dhe ndaljen e një katastrofe të thellë humanitare. NATO-ja u vu në mbrojtje të parimeve të të drejtave të njeriut, të cilat kanë përparësi edhe në raport me sovranitetin e shteteve. Pikërisht kjo e bën të ligjshëm sulmin e saj ndaj Federatës Jugosllave, qoftë edhe pa mandatin e OKB-së.*

NATO-ja e nisi fushatën ajrore me qëllim që të parandalonte një katastrofë humanitare: vrasjen dhe dëbimin e shqiptarëve të Kosovës, si dhe të ruante sigurinë rajonale duke i imponuar Beogradit planin e paqes për Kosovën në Rambuje.

Presidenti amerikan Bill Clinton me rastin e fillimi të bombardimeve të NATO-s kishte deklaruar: **“Është dita e kthesës së madhe për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, është dita e një vendimi dhe sulmi me vlerë historike, jo vetëm për Kosovën që të çlirohet njëherë e përgjithmonë nga sundimi ushtarako-polikor i Serbisë së Millosheviqit, por edhe me peshë shumë e më të gjerë për ndryshimet gjeostrategjike që do të ndodhin më pas në Ballkan dhe në rajon me vendosjen e forcave të NATO-s në Kosovë dhe përreth saj”**. Kurse kryeministri britanik Toni Bler me këtë rast thekson: **“Vendimi për sulmet e NATO-s kundër caqeve ushtarake serbe, "kishte efekte më të gjera sesa vetëm çlirimi i popullit të Kosovës". "Nëse do të kishim lejuar që populli i Kosovës të brutalizohej edhe më tutje, që të drejtat t'i merreshin dhe që e ardhmja t'i vidhej, edhe e ardhmja jonë do të zbehej”**.

Ndërhyrja e NATO-s ka ngjallur debate të shumta lidhur me legjitimitetin dhe pasojat e saj, si dhe në politikën ndërkombëtare të asaj kohe. Intervenimi i NATO-s në Kosovë mbetet një nga momentet më të rëndësishme dhe të diskutueshme në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe në kontekstin e konflikteve etnike në Evropë. Duke u bazuar në vendimin e GJND-së të vitit 2011, me të cilin është konfirmuar legjitimiteti i shpalljes së pavarësisë dhe faktin se Kosova paraqet një rast *sui generis* të shtetndërtimit dhe pavarësisë, rast pa precedent, mund të konstatojmë se edhe intervenimi NATO-s në Kosovë është një rast *sui generis* i ndërhyrjes për të ndalur spastrimin etnik të një populli të tërë.

Doktrina e intervenimit humanitar bazohet në të drejtën ndërkombëtare moderne, të reformuar, që deplason teorinë e sovranitetit absolut shtetëror, parandalon shtetet të kryejnë gjenocid, spastrim etnik dhe krime të tjera makabre dhe i mundëson NATO-s të mbrojë të drejtat universale të popujve kudo që ato shkelen. Legjitimiteti i intervenimit të NATO-s në Kosovë është i pakontestueshëm për faktin se gjenocidi paraqet krimin më të rëndë kundër njerëzimit dhe se ai nuk duhet të tolerohet nga bota demokratike, por duhet të parandalohet në mënyrë që të gjitha shteteve të botës t'u dërgohet një mesazh i qartë se ato do të ballafaqohen me reagime të fuqishme ushtarake, politike dhe gjyqësore, sa herë që ndërmarrin veprime dhe krime gjenocidale. Bazuar në këtë, diskutimet kontraverse për bazën ligjore të bombardimeve janë diskutime që kohë pas kohe shërbejnë për të diskutuar të drejtën e kësaj organizate

*që të intervenojë edhe në kriza të tjera humanitare anë e mbanë botës. Kjo çështje është shtruar edhe në disa raste të tjera, duke përfshirë edhe rastin e agresionit aktual të Rusisë në Ukrainë, dhe duke e marrë shembull rastin e Kosovës si precedent për intervenimin e NATO-s ndaj shteteve të tjera.*

*Me gjithë legjitimitetin e aksionit të NATO-s kundër Serbisë, ky aksion vu përballë kritikave nga drejtimet e ndryshme. Disa thanë se NATO-ja nuk duhej të vepronte si xhandar ndërkombëtar, duke ndërhyrë pa mandatin e qartë të Kombeve të Bashkuara kundër një shteti sovran. Në anën tjetër, një numër i madh i ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare kanë mbrojtur legalitetin e ndërhyrjes, me qëllim të parandalimit të katastrofës humanitare dhe shpëtimit të jetës së njerëzve. Baza juridike sipas këtyre ekspertëve është përcaktuar në Kaptinën VII të Kartës së OKB-së. Pas rënies së komunizmit në Evropë është mjaft i përhapur koncepti se një nga funksionet parësore të shteteve është mbrojtja, dhe jo persekutimi i qytetarëve dhe i çdo njeriu që jeton brenda kufijve të tyre. Kjo doktrinë e re është në pajtim me tendencën e krijimit të rendi të ri ndërkombëtar dhe me teorinë e sovranitetit të kufizuar shtetëror që filloi të promovohet me luftën në Kosovë dhe që mund të jetë një preventivë për luftërat e tjera në baza etnike.*

*Intervenimi u krye kryesisht përmes bombardimeve ajrore mbi objektiva ushtarake dhe infrastrukturën e Serbisë, duke synuar të minimizonte aftësitë e forcave serbe për të kryer operacione ndaj civilëve. Pas ndërhyrjes, forcat e NATO-s, të cilat arritën në Kosovë më 12 qershor 1999, ndihmuan në stabilizimin e situatës dhe mbrojtjen e civilëve. Pas përfundimit të operacionit, Kosova kaloi nën administratën e KFOR-it (Forcat Ndërkombëtare të Sigurisë në Kosovë) dhe më vonë shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008.*

*Pa marrë parasysh debatet dhe polemikat kontraverse rreth legalitetit dhe legjitimitetit të ndërhyrjes së NATO-së në Kosovë, ky intervenim konsiderohet një nga ndërhyrjet më të suksesshme të kësaj aleance, e cila krahas ndaljes së dhunës serbe në Kosovë, rezultoi me paqe dhe me stabilitet, jo vetëm në Ballkanin Perëndimor, por edhe më gjerë.*

*Si rezultat i këtij intervenimi, sot në vitin 2024 Kosovë është e lirë dhe e pavarur dhe e transformuar – një shtet që ka bërë një rrugë të gjatë që nga ato ditë të trazuara. Një shtet i barabartë rajonal, që merr pjesë në iniciativa të shumta, madje kontribuon në sfida globale me eksperiencën e saj modeste, por të sigurtë, është i njohur ndërkombëtarisht dhe ndërvepron me barazi diplomatikisht me shtetet e*

*tjera, përkatësisht me shtetet demokratike që ndihmojnë për të lehtësuar rrugën e zhvillimit të popujve dhe shteteve që u duhet kjo ndihmë. Me këtë ajo po zhvillohet në një partner të rëndësishëm dhe të besueshëm në proceset e rëndësishme jo vetëm rajonale, por edhe me gjerë dhe veçanërisht kjo shprehet në rolin e saj për t'i kontribuar paqes dhe stabilitetit.*

*Në fund, në emër të Këshillit organizativ, shprehim falënderime për të gjithë folësit dhe pjesëmarrësit e Konferencës dhe për shërbimin profesional të ASHAK-ut për përgatitjen e këtij botimi.*

Prishtinë, Nëntor, 2024.

*Arsim Bajrami*

## FJALA E HAPJES

*I nderuar Akademik, Mehmet Kraja, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,*

*I nderuar Akademik Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së shkencave të Shqipërisë,*

*I nderuar SH.T.Z. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës*

*E nderuar Akademike Justina Shiroka Pula, nënkryetare e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës,*

*Të nderuar Presidentë Moisiu dhe Sejdiu,*

*Të nderuar akademikë dhe anëtarë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës*

*Të nderuar profesorë, studiues dhe pjesëmarrës në Konferencë, Zonja dhe zotërinj,*

Jam thellësisht e nderuar që të hapë sot konferencën shkencore të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës të organizuar bashkërisht me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për të shënuar 25 - vjetorin e çlirimit të Kosovës dhe 25-vjetorin e fitores së NATO-s, aleancës më të madhe dhe më të suksesshme ushtarake dhe të vlerave të përbashkëta të anëtarëve të saj, paqes, demokracisë, lirisë dhe sundimit të ligjit.

Në këtë Konferencë shkencore synojmë që të rikujtojmë të kaluarën dhe të analizojmë sfidat dhe mundësitë me të cilat përballet Kosova dhe rajoni, ndërsa festojmë këtë përvjetor historik.

Intervenimi ushtarak i NATO-s nuk është ndërmarrë në vakuum. Intervenimi ishte përgjigje ndaj mizorive masive të shkaktuara nga regjimi i Millosheviqit dhe forcat e tij, për të ndaluar gjakderdhjen e mëtutjeshme në Ballkan dhe për të ndërprerë gjenocidin ndaj shqiptarëve në ish- Jugosllavi.

Tmerri i shkaktuar nga regjimi serb është dokumentuar gjerësisht dhe me këtë rast mjafton t'i referohemi Raportit të përpiluar nga Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën (Kosovo, 2000). Rreth një

milion gjysmë njerëz u dëbuan nga shtëpitë e tyre, prej të cilëve një milion jashtë territorit të Kosovës,, më shumë se 10 mijë u vranë, me mijëra u zhdukën me forcë, një numër alarmant, kryesisht gra, u përdhunuan e shumë të tjerë u torturuan dhe shumica i panë pronat e tyre të shkatërruara e të plaçkitura.

Shikuar në kontekstin e historisë së luftërave të fundit në ish-Jugosllavi, ngjarjet në Kosovë ishin tejet shqetësuese për botën demokratike. Regjimi serb kishte nisur tre luftëra më herët, në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë dhe rrezikonte të destabilizojë jo vetëm rajonin e Evropës Juglindore, por Evropën në tërësi.

Sekretarja Ollbrajt, një vit para intervenimit kishte deklaruar qartë se *“Ne nuk do të qëndrojmë anash dhe të shikojmë autoritetet serbe të bëjnë në Kosovë atë që nuk mund ta bëjnë më në Bosnjë.”* (Erlanger, 1998).

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ishte i përfshirë gjatë gjithë kësaj periudhe, por nuk ishte në gjendje të binte dakord që t’u përgjigjej mizorive në masë të ndërmarra nga regjimi serb.

Me Rezolutën 1199 Këshilli i Sigurimit parashikonte se, "nëse nuk merren masat konkrete të kërkuara [këtu], të shqyrtohen veprime të mëtejshme dhe masa shtesë për të ruajtur ose rivendosur paqen dhe stabilitetin në rajon."

Regjimi serb nuk hezitonte që në mënyrë të përsëritur të shkelte rezolutat e Këshillit të sigurimit dhe të sillej me mospërfillje ndaj të gjitha përpjekjeve diplomatike për të ndaluar mizoritë në masë ndaj popullit shqiptar. Deri në fund, Milosheviqi nuk besonte që qeveritë demokratike, anëtare të NATO-s, do të mund të bashkoheshin për të intervenuar me bombardime. Këtë e kishin kuptuar to gjithë liderët e shteteve të NATO-s. Joshka Fisher, ministri i Jashtëm Gjerman që vinte nga Partia e gjelbër, gjatë takimit të tij me Millosheviqin në prag të bombardimeve, vlerësonte se *“kasapi i Ballkanit”* po llogarit në ndjeshmërinë delikate të publikut perëndimor, shumë më tepër sesa në forcën e ushtrisë së tij, për të minuar ndërhyrjen e NATO-s”. Madje, Fisher, bazuar në publikimin e Qendrës për diplomaci publike të Universitetit të Kalifornisë për Konfliktin e Kosovës (Smith, 2008) kishte deklaruar:

*“Milosheviqi më vështroi gjatë gjithë kohës me një shprehje që në dukje kishte për qëllim të thoshte se ai ishte i përgatitur të ecte mbi kufoma (diçka që ai e kishte provuar shumë shpesh) dhe Perëndimi, por mbi të gjitha Evropa, nuk ishte.”*

Në të njëjtën kohë, Kina dhe Rusia e kishin bërë të qartë se nuk do ta lejonin Këshillin e Sigurimit që të autorizonte përdorimin e forcës kundër Jugosllavisë dhe se ata do të vendosnin veton ndaj çdo përpjekjeje të tillë.

Në fund, pa rrugëdalje tjetër, NATO-ja vendosi të vazhdojë dhe të bënte ndërhyrje ushtarake pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit.

NATO-ja kurrë më parë nuk kishte ndërmarrë sulme të tilla masive ajrore dhe as nuk kishte zëvendësuar autoritetin ndërkombëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Intervenimi ushtarak në Kosovë ishte vërtet unik. Ai ishte jo vetëm përgjigje spektakolare dhe vendimtare ndaj mizorive të regjimit serb, por ishte edhe hyrje e NATO-s në një fazë të re të zhvillimit të pasluftës së ftohtë.

Presidenti Klinton e mbrojti aksionin e NATO-s, pa miratim të Këshillit të Sigurimit, duke theksuar se NATO-ja *"kishte ndjekur një konsensus të qartë të shprehur në disa rezoluta të Këshillit të Sigurimit: se mizoritë e kryera nga forcat serbe ishin të papranueshme, se komuniteti ndërkombëtar kishte një interes bindës për t'i parë ato që të përfundonin"*. Më tutje, Klinton theksoi se *"po të kishte zgjedhur NATO-ja të mos bënte asgjë përballë këtij brutaliteti në Kosovë, "ne do të rrezikonim të diskreditonim gjithçka që përfaqëson Kombet e Bashkuara."* (Nanda).

Forca ushtarake e NATO-s u përdor pas shterimit të të gjitha rrugëve diplomatike. Ishte opsioni i fundit, i DOMOSDOSHËM dhe LEGJITIM.

Pas ndërhyrjes ushtarake, Këshilli i Sigurimit, i autorizoi trupat e NATO-s për të rivendosur sigurinë në Kosovë, mision ky që edhe më tutje, në këtë periudhë tejet të brishtë, me sukses po e kryen.

Konferenca, gjithashtu synon që të reflektojme për përpjekjet heroike të popullit Kosovës për rezistencë, çlirim dhe vetëvendosje dhe për të mbajtur gjallë kujtimin e vuajtjes të popullit të Kosovës nga shtypja, shfarosja, spastrimi etnik dhe gjenocidi.

*Gjyljeta Mushkolaj*



## FJALËT PËRSHËNDETËSE



*Të nderuar miq,*

*Zoti kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti president Sejdiu,  
zoti president Mojsiu*

*Të nderuar akademikë, zoti kryetar i Akademisë së Shkencave të  
Shqipërisë, zoti Gjinushi*

*Të nderuar të pranishëm!*

Në hapje të kësaj konference për 25-vjetorin e çlirimit të Kosovës, më lejoni të bëj një si përkufizim të shpejtë të kësaj ngjarjeje dhe të them se për kombin tonë çlirimi i Kosovës ishte ngjarja e dytë më me rëndësi në historinë shqiptare të shekullin XX, krahas pavarësisë së Shqipërisë.

Por ajo që na bën të mendohemi më gjatë për këtë ngjarje historike, të pangjashme në historinë tonë, është dimensionin kontemporan, botëror, që mori ky zhvillim i pazakonshëm për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe botën demokratike: askush më nuk e konteston se lufta për Kosovën bëri një ndryshim thelbësor në mënyrën e konceptimit të lirisë së popujve, demokracisë dhe vetadministrimit, parime këto që për shumë kohë u shkelën rëndë në vendimmarrjet historike, veçmas në konferencat e paqes. Pra, një ndryshim konceptual, botëkuptimor, në njohjen e së drejtës për liri të kombeve dhe jetë të dinjitetshme të të gjithë njerëzve të mbarë planetit.

Ndërhyrja e NATO-s dhe çlirimi i Kosovës është ndryshim konceptual dhe vlerë botërore edhe për një mori çështjesh të tjera, që lidhen me perceptimin e së drejtës në marrëdhëniet ndërkombëtare, në sovranitetin e shteteve, ndryshime këto që bashkëkohësuan mendimin politik dhe i dhanë dimension human të drejtës së ftoftë dhe ndonjëherë të egër të lirisë dhe vetëvendosjes së popujve.

Për ne, ndërkaq, që mësuam historinë, por nuk ishim aq të sigurt nëse do ta jetonim atë, çlirimi i Kosovës nuk do të pushojë të jetë, përveç se ngjarje me vlerë sipërore, edhe një mësim i jashtëzakonshëm i historisë për aleancat politike, sepse tashmë është e qartë se Shqipërinë dhe Kosovën, me gjithë ankesat tona të hershme dhe të vona, e bëri mendimi politik oksidental dhe nuk e morëm asnjë ndihmë sado të vogël ose mbështetje nga gjysma tjetër e globit.

Unë nuk besoj në koincidenca as profeci, besoj në vullnetin e njeriut, në mendjen dhe pasionet e tij. Por këtë bindje ma luhat një fakt i çuditshëm: çlirimi i Kosovës ndodhi më ditën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Thash, nuk i besoj koincurrencës, por i besoj një fakti tashmë

të ngulitur në vetëdije, se dy shekujt e shkuar bënë kombin dhe shtetet tona: Lidhja e Prizrenit bëri kombin shqiptar, shekulli XX bëri dy shtetet tona.

Shekulli XXI ende nuk e ka thënë për ne fjalën e vet!

Ju faleminderit!

*Mehmet Kraja*

*I nderuar Z. Kryeministër Kurti,  
Të nderuar Presidenti Sejdia e Moisiu,  
I nderuar akad. Kraja, Kryetar,  
Të nderuar pjesëmarrës,*

Kjo konferencë i kushtohet një prej ngjarjeve më të mëdha e më përcaktuese në historinë e shqiptarëve: hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë 25 vjet më parë si forca çlirimtare; ngjarje që çoi në pavarësimin e Kosovës, duke mbyllur kështu ciklin 100-vjeçar të fitimit të pavarësisë së shqiptarëve në Shqipëri e në Kosovë.

E organizuar në kuadër të këtij 25-vjetori, ajo merr edhe vlera festimi, kremtimi e mirënjohjeje; edhe vlera historike, për të parë nga largësia e viteve vërtetësinë e zgjedhjes së shqiptarëve, të rolit e qëndrimit të tyre; të forcave e faktorëve të ndryshëm të vendit e të atyre ndërkombëtare, në këtë periudhë të vështirë e të ndërlikuar.

Sigurisht çlirimi e pavarësia nuk u fituan në një ditë e as në një vit. Periudha nga Rambujeja te ndërhyrja e vendosja e forcave të NATO-s ishte përmbyllja e një procesi historik; përmbyllja e një shekulli luftërash e sakrificash kundër shtypjes e privimit nga të drejtat e liritë themelore të një populli të tërë prej makinerisë e politikave gjenocidale serbe. Prandaj dhe në çdo përvjetor s'mund të mos shprehet mirënjohja e të vihet në pah kontributi i brezave me radhë, i lëvizjeve e politikave për ndërkombëtarizimin e shtrimin për zgjidhje të çështjes së Kosovës; si brezi i vitit 1968, brezi i vitit 1974, brezi i 1981-shit, për të mbërritur te rezistenca e organizuar paqësore e më pas te rezistenca e armatosur në vitet 1990, me dëshmorët e heronjtë e saj, me në krye figurën simbol të Adem Jasharit.

Për rezultatet e tij historike: shpalljen e fitimit e dy pavarësive të arritura tashmë, gjithnjë e më shumë dëshirojmë ta quajmë shekullin e 20-të - shekulli i shqiptarëve.

Të gjithë e kemi jetuar e përjetuar këtë periudhë finale e momentet kyçe të saj. Në mbyllje të bisedimeve të Rambujesë dilema e madhe që pranimi ose jo i projekt marrëveshjes, meqenëse pavarësia nuk garantohej në mënyre eksplicite; ashtu si para saj ishte prezente dilema nëse duhej edhe rezistenca e armatosur e shqiptarëve; dallime të cilat qenë edhe brenda faktorit shqiptar, për motive të ndryshme. Por shqiptarët ditën të bëjnë zgjedhjen e tyre, duke zgjedhur si anën e duhur në Rambuje, ashtu dhe momentin e duhur për marrjen e armëve, duke kuptuar përfundimisht se liria e pavarësia për shqiptarët, bashkimi i tyre de facto

e de jure, s'mund të realizoheshin as nga boshti nazifashist gjatë Luftës së Dytë Botërore, as nga sistemi komunist pas saj, por ai që i mundur vetëm me mbështetjen e forcave demokratike të aleancës euroatlantike, i favorizuar nga procesi i integritit evropian në kushtet e pasluftës së ftohtë.

Pranimi i marrëveshjes së Rambujesë, në largësi të viteve, flet për largpamësinë e kësaj zgjedhjeje historike e rreshtimi të shqiptarëve, proces që vazhdon e do të jetë në vazhdimësi objekt i debatit e i studimeve në konferenca të tilla.

Kjo zgjedhje flet dhe për legjitimitetin e drejtësinë e luftës së popullit të Kosovës, debat që nuk bëhet thjesht për efekte historike, por sepse ai lidhet drejtpërdrejt me legjitimitetin e ndërhyrjes së NATO-s e të vetë pavarësisë së Kosovës. Populli i Kosovës kishte po aq legjitimitet të vetëmbrohej, sa forcat e NATO-s për ta mbrojtur atë nga gjenocidi serb.

Ky debat ka qenë prezent që para ndërhyrjes e deri me sot, në të gjitha nivelet, në tërë organizmat ndërkombëtarë e midis forcave politike të çdo vendi. Për këtë arsye studiuesit tanë, dy akademitë tona, kanë një rol e përgjegjësi të madhe që, me profesionalizëm, fakte e argumente, të mbrohet e vërteta; më saktë, të pastrohet ajo nga balta e përbaltja, të cilat shkojnë deri aty sa UÇK-në ta krahasojnë me grupe terroriste a kriminale dhe ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë me atë të Putinit në Ukrainë, ndërkohë që vetë Putini detyrohet ta krahasojë Kosovën me Krimenë.

25 vjet më parë kjo betejë ishte e fituar para tërë opinionit demokratik në SHBA e Europë, i cili e mbështeti në shumicë mbrojtjen e çlirimit të Kosovës. Më kujtohet atëherë se kur miqtë tanë na pyesnin se si e shikonim të ardhmen e ndërhyrjes, të suksesit të saj, i përgjigjeshim se ka vetëm një pikë të dobët: Serbia bën luftë nën urdhrat e një makinerie e diktatori të përgjakshëm, ndërsa NATO-ja bën luftë me përkrahje demokratike, bazuar në votën e parlamenteve demokratike dhe përkrahjen popullore të shprehur me sondazhe. Kjo është fituar edhe juridikisht, me vendim të gjykatës ndërkombëtare, e cila, duke klasifikuar rastin e Kosovës si rast të veçantë, legjitimon në parim gjithkënd që i shërbeu pavarësimi të saj.

Përbaltja e shtrembërimet kanë ardhur më mbrapa, në tentativë për të zhbërë këtë fitore historike. Aq agresive janë mjetet e strukturat e deformimit, si raporti skandaloz i Dick Marty-t, sa që është i tepërt e i dëmshëm çdo mendim e qëndrim ndryshe brenda nesh në funksion të politikës së ditës a moralit të kohës.

Kjo konferencë do t'i shërbejë më së miri evidentimit e argumentimit të kësaj të vërtete me fakte e dokumente të kohës apo të zbuluara rishtazi.

Ne falënderojmë ASHAK-un për organizimin e kësaj konference dhe shprehim edhe një herë vlerësimin se fitorja e 25 viteve më parë krijoi mundësitë e vendosjes dhe forcimit të bashkëpunimit midis institucioneve reciproke në Kosovë e Shqipëri; krijoi një klimë e situatë të re dhe për dy akademitë tona, që e kanë zgjeruar bashkëpunimin mes tyre, ku kulmon ndërmarrja e përbashkët e hartimit të "Enciklopedisë shqiptare", ashtu si dhe për "Fjalorin e madh të shqipes", ku po punohet me specialistë nga të dy anët e ish-kufirit.

Dhe kjo periudhë me vlera të veçanta historike do të fiksohet në Enciklopedi ashtu siç e meriton, bazuar dhe në kumtesat, kontributin e profesionalizmin e kumtuesve të këtij eventit.

Ju faleminderit për vëmendjen!

*Skënder Gjinushi*



*I nderuari z. Mehmet Kraja, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës,*

*I nderuar z. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë,*

*I nderuari president Fatmir Sejdiu dhe i nderuari president Alfred Moisiu,*

*Të nderuar anëtarë të dy akademive tona të Kosovës dhe të Shqipërisë,*

*Të nderuar anëtarë të Këshillit Drejtues, akademikë të pranishëm,*

*Zonja dhe Zotërinj,*

25 vjet më parë, në mes të muajit qershor të vitit 1999, populli i Kosovës po i përjetonte ditët e fundit të luftës dhe ditët e para të çlirimit. Sikur sot, një çerek shekulli më parë, më 10 qershor 1999, NATO-ja i dha fund fushatës së bombardimeve ndaj Jugosllavisë pas 78 ditësh bombardime. Në New York, Këshilli i Sigurimit i OKB-së e miratoi Rezolutën 1244 me të cilën e autorizonte vendosjen e një force ushtarake dhe civile në Kosovë. Po atë ditë, UNHCR-ja njoftonte se gjatë gjithë luftës në Kosovë, 862,979 refugjatë ishin dëbuar jashtë Kosovës dhe se sfida e radhës ishte organizimi i kthimit të tyre. Ditët në vijim treguan që kjo sfidë nuk ishte siç e kishin menduar zyrtarët e UNHCR-së, sepse më 3 gusht, kjo organizatë njoftonte që 90 % të refugjatëve ishin kthyer në Kosovë, në mënyrë spontane dhe të vetorganizuar pa çka se ata i gjetën 120 mijë shtëpi të tyre të shkatërruara apo të djegura. Me këtë u shuan edhe shpresat e politikës së shtetit të Serbisë, që plani i tyre i gjenocidit përmes Operacionit Patkoi, të kishte të paktën pjesërisht sukses për zbrazjen e Kosovës nga shqiptarët vendas.

Një ditë më herët, më 9 qershor 1999, në Kumanovë, Komandanti i KFOR-it, gjenerali britanik Michael Jakson dhe dy gjeneralë serbë, Svetozar Marjanoviq dhe Obrad Stefanoviq, i kishin vendosur firmat e tyre në dokumentin e Marrëveshjes Ushtarake Teknike duke i dhënë fund ushtarakisht dhe juridikisht luftës së Kosovës. Të gjitha forcat e armatosura serbe dhe jugosllave i kishin 11 ditë afat kohor për t'u tërhequr nga Kosova, deri më 20 qershor. Tutje, ato duhej të vazhdonin thellë në territorin serb, pasi Marrëveshja e Kumanovës parashihte një Zonë Tokësore të Sigurisë prej 5 kilometrash dhe një Zonë Ajrore të Sigurisë prej 25 kilometrash.

Në anën tjetër në terren, ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës po përgatiteshin të hynin në të gjitha qytetet e Kosovës. Ditët e mesit të qershorit 1999, ishin nga ato ditët e pakta dhe rastet e rralla kur të gjithë e dinë se po jetojnë një kohë me peshë historike. Më 11 qershor, trupat ushtarake të NATO-s nisën të hynin në territorin e Kosovës nga toka dhe nga ajri, duke e vendosur kontrollin e tyre në tërë vendin tonë.

Mbi 10,000 viktima civile e kishin humbur jetën nga mbi 13,500 sa do të rezultonte shifra totale e njerëzve të vrarë gjatë gjithë luftës në Kosovë. Mes tyre, 1133 ishin fëmijë, kurse diku mbi 3000 burra dhe gra ishin vrarë me armë në duar, duke rënë dëshmorë të lirisë. Kosova ishte mbushur me varre të të vrarëve nga masakrat dhe ekzekutimet në masë, ndërsa kufomat e shumë shqiptarëve të vrarë, ishin transportuar dhe fshehur nëpër varreza masive në Serbi. 950 shqiptarë gjithsej zbulohen në ato varreza, 744 vetëm nga varreza masive në Batajnicë në periferi të Beogradit, që edhe sot e kësaj dite shërben si poligon për ushtrinë dhe policinë pa asnjë pllakë të vetme përkujtimore se aty dikur kishte një varrezë masive. Disa mijëra gra dhe disa burra gjithashtu, ishin dhunuar dhe torturuar, ndërkaq më shumë se gjysmë milioni njerëz ishin zhvendosur si refugjatë brenda Kosovës. Të gjitha këto kishin ndodhur në më pak se dy vjet luftë. Ndërkaq, vite të tëra do ta prisnin Kosovën përpara kah e ardhmja, si vite të kthimit dhe të rindërtimit, dhe më pas si vite të pavarësimit e të shtetndërtimit.

Gjatë këtyre 25 vjetëve të pasluftës, ka pasur organizime të panumërta, akademi përkujtimore dhe konferenca shkencore për luftën e Kosovës, për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për dëshmorët e rënë për liri; për të vrarët në masakra dhe për viktimat e çdo kategorie; për bombardimet kundër Jugosllavisë dhe për hyrjen e trupave të NATO-s në Kosovë; për refugjatët e shpërndarë gjithandej globit dhe për kthimin e tyre në Kosovë.

Të dominuar nga kujtimet dhe përjetimet e luftës, të rënduar nga vuajtjet dhe nga traumat, akademitë përkujtimore dhe konferencat tona shkencore, deri tani kanë qenë më shumë përkujtimore sesa akademi, më shumë faktografike dhe më pak shkencore. Tani që po bëhen 25 vjet nga lufta e Kosovës, kur një brez i tërë i lindur pas luftës është rritur dhe maturuar, është koha e duhur që diskutimet dhe debatet tona, hulumtimet dhe studimet tona, shkrimet dhe botimet tona, të shkojnë secilën herë e më shumë duke u bërë më akademike dhe më shkencore, më konceptuale dhe më teorizuese.

Andaj më vjen mirë që javën gjatë të cilës do ta shënojmë 25-vjetorin e çlirimit të Kosovës, po e nisim pikërisht me një konferencë

shkencore dhe pikërisht këtu në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Sepse historia dhe trashëgimia e luftës në Kosovë, kanë aq shumë nevojë për t'u studiuar, hulumtuar dhe për t'u shkencëruar. Ngase ne si shoqëri dhe si shtet, kemi nevojë për diskurse të mirëfillta shkencore dhe për narracione sa më të plota dhe të vërteta historike për luftën tonë. Kemi nevojë për shumë studime shkencore dhe gjithashtu për botime akademike për gjithë çfarë ka ndodhur gjatë gjithë luftës në vendin tonë: për viktimat e luftës, për luftëtarët e lirisë, për dëmet e luftës, për kujtesën kolektive të luftës, për gjykimet për krime të luftës, për masakrat dhe për gjenocidin, pastaj për hyrjen e papritur të ushtarëve rusë më 11 qershor 1999 në Aeroportin Ndërkombëtarë të Prishtinës dhe largimin e tyre në vitin 2003, intervenimet ushtarake humanitare dhe për mësimet prej tyre, si në histori, ashtu edhe në ushtri dhe diplomaci.

Duke ju uruar mbarësi në punimet e kësaj konference shkencore, urime të gjithëve për 25-vjetorin e çlirimit të Kosovës. E paçim Kosovën gjithmonë të lirë dhe të pavarur!

Ju faleminderit!

*Albin Kurti*



POLITIKA PROAKTIVE, NDËRTIMI I ALEANCAVE DHE  
HARMONIZIMI I POLITIKËS KOSOVARE ME RENDIN  
BOTËROR QË PO NDRYSHON - FAKTORË TË  
DOMOSDOSHËM PËR PËRMBUSHJEN E ASPIRATAVE DHE  
TË ARDHMEN PROSPERUESE TË KOSOVËS

*(Fjalë e mbajtur Konferencën kushtuar 25 - Vjetorit të Ndërhyrjes së NATO-së dhe Çlirimit të Kosovës, organizuar nga: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë, 10 qershor 2024)*

Njëzet e pesë vjet më parë, pikërisht më 12 qershor 1999, Kosova doli nga rrënojat e konfliktit dhe shtypjes, duke hapur një faqe të re, duke dalë në dritën e lirisë dhe të respektit për dinjitetin e njeriut të saj, të qytetarit të saj.

Ndërsa jemi bashkë këtu në Konferencë kushtuar 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës për të folur dhe përkujtuar këtë ditë, është thelbësore që të reflektojmë mbi udhëtimin që na solli në këtë moment historik.

Përvjetorët, si ky që shënojmë sot, na ofrojnë një mundësi për të reflektuar për proceset dhe vendimet që i dhanë formë shtetit tonë.

Pas një lëvizjeje aktive kundër pushtimit serb në krye me presidentin Ibrahim Rugova, kur Kosova njohu afirmimin ndërkombëtar, në vitet 1998 - 99, qytetarët e Kosovës u përballën me luftën e imponuar nga agresioni serb dhe me sfida të paimagjinueshme.

Shqiptarët nuk u nënshtuan, por rezistuan të prirë nga UÇK-ja.

Politika, ushtria dhe milicia serbe, shkatërroi begatinë dhe ndërtimin tonë material dhe jomaterial, tokën tonë, duke lënë plagë që do të duheshin vite për t'u shëruar.

U vranë nga eskadronët serbë më shumë se 12 mijë shqiptarë, kryesisht civilë dhe ende nuk janë gjetur rreth 1.600 persona, të cilët janë zhdukur në luftën e vitit 1998-99 dhe Serbia edhe sot e kësaj dite mban informatat si armë terrori kundër familjeve, qytetarëve dhe shtetit të Kosovës.

Këto plagë edhe sot i ndiejmë thellë dhe do të ndjehen gjithmonë për të mos u harruar.

Por, ishte gjithashtu një kohë e qëndrueshmërisë, vendosmërisë dhe shpresës së palëkundur për të arritur deri në ditën e lirisë, që ishte ëndërruar breza e breza dhe për të cilën kishin sakrifikuar po kështu breza të tërë.

Mbi të gjitha, patëm dyer për të trokitur jashtë Kosovës, për t'i hapur ato me urtësi dhe kulturë, ku gjetëm mirëkuptim dhe empati, diçka që fatkeqësisht shumë popuj përgjatë historisë nuk e kanë pasur.

Mekanizmat ndërkombëtarë, UNMIK-u, OSBE-ja dhe KFOR-i dhanë një ndihmë të jashtëzakonshme për ngritjen e institucioneve dhe për sigurinë e gjithë qytetarëve të vendit.

Posaçërisht do të theksoja rolin mbështetës të përhershëm të Republikës së Shqipërisë për lirinë e Kosovës.

Shpallja e Pavarësisë më 17 shkurt 2008, solli përgjegjësi të reja për qytetarët e Kosovës dhe institucionet e Kosovës. Pavarësia e Kosovës u rikonfirmua fuqishëm edhe me vendimin e Gjykatës së Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila rikonfirmoi se *“vendimi i përfaqësuesve të popullit më 17 shkurt 2008 nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare”*.

Shteti i Kosovës u njoh nga shtete të fuqishme të botës, që nga SHBA-ja, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, Italia, Turqia, Australia, Kanadaja, Japonia etj, duke dëshmuar se shteti i ri do të kishte përkrahje të sigurtë për t’u bërë edhe pjesë e barabartë e bashkësisë ndërkombëtare dhe i bashkëngjitur me familjen e vendeve të lira.

Peshë të veçantë shënojnë njohjet nga vendet fqinje dhe vendet e rajonit. Sot shteti i Kosovës është i njohur nga 117 vende.

Fatkeqësisht, ende pesë shtete të BE-së nuk e kanë njohur Kosovën, dhe kjo po e vështirëson procesin e integritimit më të shpejtë të Kosovës në institucione politike dhe të sigurisë.

Mbi baza thelbësore të demokracisë u ngritën të gjitha institucionet vitale të shtetit, që nga Gjykata Kushtetuese, Sistemi Gjyqësor dhe Prokurorial në të gjitha nivelet e tyre, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Policia e Kosovës e deri te Forca e Sigurisë.

Sot në vitin 2024 ne e gjejmë veten në një Kosovë të transformuar – një shtet që ka bërë një rrugë të gjatë që nga ato ditë të trazuara. Një shtet i barabartë rajonal, që merr pjesë në iniciativa të shumta, madje kontribuon në sfida globale me eksperiencën e saj modeste po të sigurtë, është i njohur ndërkombëtarisht dhe ndërvepron me barazi diplomatikisht me shtetet e tjera, përkatësisht me shtetet demokratike që ndihmojnë për të lehtësuar rrugën e zhvillimit të popujve dhe shteteve që u duhet kjo ndihmë. Me këtë ajo po zhvillohet në një partner të rëndësishëm dhe të besueshëm në proceset e rëndësishme jo vetëm rajonale, por edhe me gjerë dhe veçanërisht kjo shprehet në rolin e saj për t’i kontribuar paqes dhe stabilitetit.

Fatkeqësisht, Serbia nuk ka ndryshuar politikën e saj provokuese dhe konfliktuoze duke mbajtur tensionet në shkallë të lartë, jo vetëm për të nxitur jostabilitet, por edhe për të paraqitur Kosovën si një vend pa siguri për investime ndërkombëtare. Rasti i Banjskës kur grupe terroristësh të miratuar

nga qeveria e Serbisë vranë policë dhe tentuan pushtimin e Veriut, tregon se nuk ka ndonjë ndryshim në politikën e Serbisë ndaj Kosovës.

### *Të nderuar pjesëmarrës!*

Do pranuar se në këtë rrugë të ngritjes së shtetit tonë, ka pasur edhe probleme, të cilat janë krijuar nga vetë ne. Mostolerancë politike, mbyllje sysh para dukurive negative, mospërfillje lidhur me fenomenin e largimit të të rinjve dhe ekspertëve, brishtësi në luftën kundër korrupsionit dhe proceseve e tjera që morën e po marrin edhe sot e kësaj ditë energji duke ngadalësuar zhvillimin dhe progresin.

Përballë kësaj duhet të vlerësojmë se brenda, Kosova gjithnjë e më shumë ofron mundësi për të kanalizuar talentin e të rinjve tanë jo vetëm për të mirën e Kosovës, por për të mirën e kontinentit tonë në përgjithësi. Të rinjtë tani me vlerën dhe kreativitetin e punës së tyre tashmë i përkasin tregut global të punës dhe dijes. Ata po njihen në të gjitha fushat: në atë të dijes, të artit, kulturës, biznesit e sporteve duke arritur rezultate kulmore.

Pra, të rinjtë, pavarësisht nga prejardhja, kanë mundësi të barabarta për të ndjekur arsimin, karrierën dhe ëndrrat e tyre. Ndër të tjera, Kosova sot është shtet ku ka hulumtim shkencor dhe inovacion. Të gjitha këto nuk kanë qenë të mundura një çerek shekulli më parë.

Infrastruktura jonë është përmirësuar ndjeshëm, duke lidhur qytete, qyteza dhe fshatra. Rrugët, urat dhe rrjetet e komunikimit tani na lidhin së bashku, duke nxitur edhe rritjen ekonomike dhe kohezionin social.

Duke qenë edhe vetë dëshmitarë dhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i proceseve vendimmarrëse në projektin tonë të shtetndërtimit, si në planin e brendshëm, ashtu edhe të jashtëm, dua të potencoj tre reflektime thelbësore, që kanë të bëjnë me politikën.

Këto segmente janë me rëndësi, pavarësisht kohës dhe epokës.

### *1. Politika proaktive*

Në fundin e viteve 1980, Kosova për herë të parë në histori të saj krijoi politikë proaktive, në vend se reaktive. Lëvizja e pavarësisë paraqiti kësaj një organizim nga brenda me drejtim jashtë, në vend se një trup i formuar jashtë për të funksionuar brenda, siç kishte ndodhur deri atëherë. Sidoqoftë, kjo nuk mjaftoi në vetvete. Organizimi proaktiv duhet të ketë vizion, imagjinatë dhe gjykim objektiv. Me largpamësi politike, përkushtim të fortë dhe maturi bëhet e mundur të notohet nëpër ujëra të turbullta dhe të lundrohet në rrymat e politikës ndërkombëtare. Me këtë vizion, Kosova do të kishte

luftuar për të siguruar vendin e saj në skenën botërore. Kosova ka nevojë për politikë të vizionit, që paramendon gjërat që kanë për të ndodhur.

Politikat tona duhet të pasqyrojnë aspiratat tona, duke na shtyrë gjithmonë drejt një të ardhmeje të përhershme prosperuese.

## 2. Ndërtimi i Aleancave

Politika proaktive dhe vizioni nuk janë të plota pa aleancat me Perëndimin, këto e plotësojnë njëra-tjetrën. Si një vend i vogël, Kosova e njeh rëndësinë e aleancave. Partnerët tanë perëndimorë SHBA-ja dhe BE-ja - miqtë që na qëndruan pranë në orët tona më të errëta – mbeten vendimtare. Ne duhet t'i ruajmë këto aleanca, duke i ushqyer me kujdes. Uniteti ka qenë forca jonë – kështu duhet të jetë edhe sot.

## 3. Harmonizimi i politikës kosovare me rendin botëror që po ndryshon

Vitet e fundit, veçanërisht pas shkurtit të vitit 2022 është qartësuar se rendi botëror – i cili gjithashtu mundësoi pavarësimin dhe të arriturat e Kosovës – po ndryshon. Politika proaktive dhe aleancat me Perëndimin kanë si qëllim përshtatjen me ndryshimin e peizazheve të politikës ndërkombëtare. Një gjë duhet kuptuar drejt: Kosovës i duhen dy dialogë: me vetveten dhe me Perëndimin. Çdo gjykim objektiv që na udhëheq është pasojë e këtyre dy bisedave që Kosova duhet t'i ketë. Gjithçka tjetër është në funksion të këtyre dy të parave.

\*\*\*

Si përfundim le të nderojmë sakrificat e atyre që luftuan për çlirimin tonë dhe për të drejtat e njeriut.

Sot kujtojmë dy nga personalitetet e veçanta që janë sinonim i çlirimit dhe shtetndërtimit të Kosovës, presidentin Rugova dhe heroin legjendar Adem Jashari. Kujtojmë të gjithë brezat që kontributin e tyre e vunë në themelet e lirisë.

Ndërsa festojmë këtë jubile, le të riafirmojmë përkushtimin tonë për një Kosovë që lulëzon, një Kosovë që përqafton diversitetin dhe një Kosovë që qëndron lart në skenën botërore dhe i kontribuon sfidave globale të shekullit XXI.

Faleminderit dhe e duam përgjithmonë Kosovën tonë të lirë!

*Fatmir Sejdiu*

President i Republikës së Kosovës në vitet 2006-2010

# ÇFARË DUHET BËRË PËR TË RRRITUR STABILITETIN E RAJONIT DHE ZHVILLIMIN NORMAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

*(Fjala e mbajtur në Prishtinë më 10 Qershor 2024 në kuadrin e 25 -vjetorit të çlirimit të Kosovës, organizuar nga Akademia e Shkencave të Kosovës)*

*I nderuar President Sejdiu*

*I nderuar Kryeministër Kurti*

*Të nderuar Drejtues të Akademisë së Shkencave*

*Të dashur miq dhe të ftuar*

U mbushën 25 vjet që kur bota përparimtare e indinjuar me barbaritë dhe padrejtësitë e regjimit serb të Millosheviçit, vendosi që t'i jepte fund kësaj odiseje të turpshme dhe i dha rrugë ndërhyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë, duke arritur çlirimin e saj nga pushtimi shekullor i Serbisë. Ne shqiptarët u jemi mirënjohës përjetësisht për këtë hap të madh humanitar SHBA-së, Britanisë, NATO-s dhe vendeve të tjera demokratike evropiane.

Gëzuar festën e Çlirimit! Uroj që Kosova të ketë ditë edhe më të bardha në të ardhmen. Uroj që shqiptarët në Ballkanin Perëndimor të kenë një mirëkuptim sa më të mirë midis njëri-tjetrit dhe të mendojnë më shumë për të ardhmen, duke mos harruar asnjëherë se këto ditë u dedikohen sakrificave dhe gjakut shqiptar të derdhur në vite, por njëkohësisht të mos harrojmë ndihmën dhe mbështetjen nga aleatët tanë, për të cilën ne ju jemi mirënjohës në shekuj. Dhe këtë duhet ta kuptojnë mirë, në mënyrë të veçantë brezat e rinj.

Dhe ndërkohë për këtë veprim të drejtë ne duhet të jemi jo vetëm vlerësues, por edhe mirënjohës. Kurrsesi të mos harrojmë se edhe sikur të shuheshim të gjithë ne shqiptarët, si këtu dhe te ne, vetëm nuk do mund të arrinim ta çlironim Kosovën nga thundra serbomadhe. Detyra jonë e tanishme është që të ndërtojmë një shtet real demokratik, duke vepruar me kujdes dhe me konsultime me aleatët tanë, ashtu sikurse e kanë pasur zakon të hershëm shqiptarët, që asnjëherë nuk janë treguar bukëshkalë dhe mosmirënjohës.

Ndaj pa ulur vigjilencën dhe pa proceduar në drejtimet kryesore, me argumente bindëse dhe pa u tërhequr nga interesat koherente elektorale partiake, është e nevojshme të jemi shumë të kujdesshëm në he dhjen e hapave në lidhje me marrëdhëniet me partnerët tanë kryesorë.

Duhet bërë kujdes që veprimet tona të mos sjellin pasoja që mund t'i shërbejnë palës kundërshtare, për të justifikuar veprimet e tyre subversive. Përkundrazi, është shumë e nevojshme që të hedhim hapa të sigurt dhe të matur që të mos çojmë ujë në mullirin e gabuar.

Pra të jemi, **“mat shtatë herë dhe prit një herë”**, sikurse është proverbi i çmuar i popullit tonë filozof.

Tashmë është fakt, se në Evropë janë hapur vatra zjarri që mund të çojnë deri në përplasje globale, me rrezikshmëri të lartë për të ardhmen e njerëzimit. Gjithashtu dihet se Putinit i intereson, që krahas Ukrainës të hapen në Evropë vatra të reja konfliktesh, një ndër të cilat mund të jetë Ballkani Perëndimor dhe konkretisht Kosova ose Bosnja. Ngjarjet e marsit në Banjškë treguan më së miri sesa djallëzore dhe të rrezikshme janë situatat sikurse ajo që u krijua në Manastirin e Banjškës, e cila u mbyll me shumë aftësi dhe profesionalizëm nga forcat e Policisë të Kosovës. Por prapëseprapë nuk kemi asnjë garanci që situata të tilla, më të përgatitura dhe më të mirë organizuara, nuk mund të përsëriten rishtas në veri të Kosovës. Njohja e gjenocidit serb në Srebrenicë nga OKB-ja, e kanë tërbuar së tepërmi Vuçiqin dhe ithtarët e tij. Kjo na detyron që të rrisim edhe më tepër vigjilencën e kujdesin në trajtimin e problemeve që kemi me ta dhe të forcojmë lidhjet dhe mirëkuptimin me aleatët tanë kryesorë.

Situatat e pritshme në veri të Kosovës mund të jenë nga më të ndryshmet dhe më të papriturat. Ndonëse jemi të garantuar nga forcat e KFOR-it, të cilat janë në juridiksionin e NATO-s, ama **“Ta mbajmë macen, por edhe çarkun ta kemi gati”**. Me këtë dua të them se, krahas policisë, duhen marrë masat e duhura mbrojtëse ushtarake. Me kohë kam sugjeruar, që edhe pse kjo republikë ende nuk është e njohur ndërkombëtarisht dhe nuk bën pjesë në OKB, kushtetuta dhe ligji kryesor në fuqi për mbrojtjen, lejojnë që të merren masa përgatitore për forcimin e mbrojtjes ushtarake të shtetit. Për fat të keq nuk mund të shpreh që sugjerimet dhe këshillat e mia janë vlerësuar sa duhet.

Dua të them se ne shqiptarët kemi një defekt të hershëm si komb, i cili po vazhdon. Më shumë jemi mësuar dhe kemi mbështetur bajraktarizmin sesa kemi favorizuar ndërtimin e një shteti solid, që garanton mbrojtjen nga çdo e papritur. Sigurisht që nuk është vendi të merremi me të shkuarën, por tani është koha, në mos jemi me vonesë, të mendojmë se si duhet të mbrohemi. E them këtë me shqetësim, pasi ky mentalitet dominon edhe në Tiranë. Përjashtoj kohën e diktaturës, historikisht ne nuk kemi menduar seriozisht për mbrojtjen e atdheut. Sigurisht sot situata është ndryshe, pasi ne në Tiranë jemi pjesë e NATO-s, ndërsa

ju sikurse e thashë keni këtu një prezencë serioze të saj. Por nuk duhet të harrojmë se sot në fakt, me shpërthimin e agresionit rus në Ukrainë, sistemi i sigurisë i hartuar dhe i kompozuar pas Luftës së Dytë Botërore tashmë mund të quhet i rënë. Rrjedhimisht për këtë çështje duhet menduar seriozisht. Pra u takon qeverive tona t'i lënë mënjane keqkuptimet e panevojshme dhe të merren si duhet me marrjen e masave për mbrojtjen e vendeve tona, duke hartuar një strategji mbrojtëse si komb.

Mendoj se për këtë qëllim duhet të merren të dyja Akademitë e Shkencave, sigurisht me mbështetjen e dy qeverive tona. Të mos harrojmë se kemi të bëjmë me një shtet si Serbia, e cila kundër nesh ka një strategji të përpunuar që herët në mesjetë dhe të avancuar më vonë nga Çubrilloviçi e tjerë, të përpunuar edhe nga Akademia e tyre e Shkencave, sesi të mposhten dhe të largohen shqiptarët nga trojet e tyre, të pushtuara prej sllavëve, duke filluar që nga Kongresi i Berlinit dhe më vonë, sipas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913.

E them këtë jo vetëm se e kërkon situata, por se te shtetarët tanë, si këtu edhe në Tiranë, mbretëron mentaliteti që kemi NATO-n. Ajo sigurisht është, dhe sipas artikullit 5 ajo do përgjigjet, por do edhe një farë kohe të ndërhyjë, ndaj kërkohet nga ne që të jemi në gjendje t'i rezistojmë fillimisht çdo lloj agresioni të mundshëm. E kjo kërkon pikërisht atë që thashë më lart.

Shohim që Serbia vazhdon të armatohet me ritme jo të zakonshme, si në drejtim të modernizimit, ashtu edhe duke shtuar arsenalin ushtarak. Takimet e drejtuesve të shtetit serb me Putinin dhe presidentin e Kinës janë të vazhdueshme dhe mjaft kërcënuese. Ata nuk takohen kaq shpesh se i merr malli për njëri-tjetrin, por në çdo takim thellojnë dhe detajojnë planet dhe masat për bashkëpunimin e tyre, në përputhje me situatat që po kalon bota.

Ende nuk kemi dëgjuar që drejtuesit e mbrojtjes dhe të ushtrisë të dy vendeve tona të takohen dhe të bisedojnë se si duhet të veprojmë dhe të koordinojnë në rast agresioni, si do ta mbështesim njëri-tjetrin, si dhe çfarë masash të përbashkëta duhet të merren, si gjatë kohës përgatitore ashtu edhe në rast se do të përballemi me një agresion të mundshëm. Se çfarë dhe si duhet të bisedojnë këta njëri me tjetrin, sigurisht që ata duhet ta dinë më mirë, por edhe pse dëgjojnë mendimet dhe këshillat tona nuk bëjnë keq. Nuk duam të ndërhyjmë në punët dhe përgjegjësitë e tyre, por e ndiejmë për detyrë patriotike t'u themi që duhet të merren seriozisht me këto probleme. Nuk mund ta them se sa të menduara dhe të llogaritura po bëhen porositë në armatime dhe mjete ushtarake, dhe

sigurisht këto gjëra nuk mund të bëhen publike, por kur brigadat serbe po iu afrohen kufijve të Kosovës, kur ata zhvillojnë stërvitje dhe dislokime luftarake, kur politikanët e tyre kryesorë bëjnë deklarata provokuese si p.sh. Kosova është Serbi, ose ende flasin me të madhe për Kosovë e Metohi, nuk duhet të harrojmë se asgjë nuk ndodh dhe nuk bëhet kot. Të gjitha këto kërkojnë që vlerësimi i situatës të jetë më serioz dhe i shoqëruar me veprime të përbashkëta të mirëmenduara.

Në këtë aspekt merr rëndësi të madhe edhe edukimi patriotik i rinisë, që ata asnjëherë të mos harrojnë se këto ditë të paqes dhe të mirëqenies, janë rezultat i sakrificave dhe gjakut të derdhur nga paraardhësit e tyre. Dihet që liria nuk dhurohet por fitohet, dhe jo vetëm kaq, por edhe duhet mbrojtur. Sigurisht që për këtë qëllim përgatitet ushtria dhe forcat e sigurisë, që në rast nevojë duhet të gjithë të jemi të gatshëm për t'u përballur. Pra të jemi të gatshëm të mbrojmë lirinë dhe pavarësinë tonë me të gjitha mjetet dhe mundësitë tona. E ndërkohë mendoj dhe sugjeroj se për këto probleme nuk duhet të ketë ndarje partiake. Kjo kërkon që të gjithë të jemi të një mendje dhe të veprimje të bashkuar dhe të koordinuar.

Kujtoj me këtë rast shprehjen popullore të popullit tonë filozof -  
**“UJËT FLE, POR ARMIKU NUK FLE”**.

Ju faleminderit për vëmendjen

*Alfred Moisiu*

## ARTIKUJ



Muhamedin Kullashi

## POLARIZIMET NË FRANCË RRETH NDËRHJRJES SË NATO-S NË KOSOVË

Njëri nga tubimet më të mëdha kushtuar Kosovës në Francë u mbajt më 7 mars 1998, në Sheshin e Trokaderos, që quhet ndryshe edhe « Sheshi i të drejtave të njeriut » në Paris. Tubimin e organizoi Komiteti i Kosovës në Paris bashkë me disa shoqata të tjera për të drejtat e njeriut. Shkas i drejtpërdrejtë për këtë tubim ishte sulmi i trupave serbe në Prekaz më 5 mars. Përveç shoqatave parisiane, morën pjesë edhe shoqata të shqiptarëve në Francë, e nga Gjermania e Belgjika erdhi një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve nga Kosova që jetonin atje. Tubimi u hap me leximin e kumtesës së Komitetit të Kosovës, e cila iu shpërnda medieeve, qeverisë franceze dhe grupeve parlamentare. Kjo kumtesë ishte, në fakt, një apel dhe kërkesë drejtuar opinionit dhe qeveritarëve që të ndërmarrin veprime, bashkë me qeveritë e tjera perëndimore për t'iu kundërvënë krimeve gjenocidale të regjimit serb. Ishte njëherësh solidarizim me shqiptarët; afirmohej ideja për legjitimitetin e rezistencës së armatosur, krahas rezistencës politike.

Ky apel u nënshkrua nga më se 300 intelektualë, filozofë, shkrimtarë, artistë e shkencëtarë francezë. Toni i kumtesës i përgjigjej ndryshimit dramatik të situatës: tani u bë e qartë se Serbia e Milosheviqit nuk do të kënaqej vetëm me terrorin e përditshëm dhe me mbajtjen e sistemit të aparteidit, ngase kishte hyrë në një fazë më radikale të politikës së vet ndaj Kosovës: ishte fjala për kalimin prej spastrimit etnik të institucioneve në fazën e spastrimit etnik të territorit, me masakra të civilëve dhe me dëbimin e tyre.

Kjo kumtesë kërkonte shprehimisht, për herë të parë, **ndërhyrjen ushtarake të NATO-s e njëherësh afirmonte të drejtën e Kosovës për pavarësi**. Manifestimi dhe kumtesa patën jehonë të fuqishme në opinionin publik francez; kumtesa u botua nga mediet më të rëndësishme. Kumtesa ishte nënshkruar nga një numër shumë i madh i krijuesve të shquar francezë: nga filozofët Paul Ricoeur, Claude Lefort, Edgar Morin, Olivier Mongin, Pierre Hassner, Antoine Garapon, André Glucksmann, Alain Finkielkraut, Bernrad Henri Lévy, Pascal Bruckner, Véronique Nahoum-Grappe, Gisèle Donard etj; nga shkrimtarët Jean d'Ormesson, Annie Lebrun, Hélène Cixous, Olivier Rolin etj; nga

artistët Bertrand Tavernier, Jane Birkin, Romain Goupil, Claude Lelouch, Marcel Ophuls, Peter Brook, Ariane Mnouchkine etj., nga Michèle Gendrau Massalou, rektorja e Universiteteve të Parisit etj.

Kjo ishte njëra nga ngjarjet dramatike ku thurej miqësia dhe solidariteti midis shqiptarëve dhe francezëve, prej qytetarëve të rëndomtë deri tek intelektualët e rangut më të lartë.

Krimet e trupave serbe në pranverë të vitit 1998 në Kosovë ndaj shqiptarëve dhe reagimet e protestat e fuqishme të shoqatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare, si edhe medieve të mëdha me ndikim në Francë dhe në disa vende të tjera perëndimore, do të ndikojnë gradualisht në ndryshimin e qëndrimeve të qeverive të këtyre vendeve. Ky ndryshim u shpërfaq me *kristalizimin* e propozimit për t'ia imponuar Milosheviqit një plan të një statusi të përkohshëm të Kosovës, realizimi i të cilit do të duhej të sigurohej nga një forcë ndërkombëtare paqësore. Rezultat i kësaj ishte Konferenca në Rambouillet (Rambuqe) të Francës, ku u zhvilluan negociatat gjatë 18 ditëve, presionet që ministri e *Grupit të Kontaktit* ushtronin ndaj « palëve në konflikt ». Kësisoj u arrit një *ndërkombëtarizim* në nivel të lartë i çështjes së Kosovës

Nga komunikimet tona me disa zyrtarë të lartë të OKB-së që vinin në Paris, si dhe me zyrtarë të lartë të Francës dhe të BE-së, diktuam se rezistenca e armatosur e shqiptarëve, me konstituimin e UÇK-së kishte ndikuar në një perceptim të ri të çështjes së Kosovës. Një numër më i madh i politikanëve dhe diplomatëve perëndimorë do të fillojnë ta shikojnë Kosovën jo më si një *problem i brendshëm* i Serbisë, në suaza të kufijve të saj, jo më si « provincë e pandashme e Serbisë ». Disa nga politikanët, qeveritarët e diplomatët francezë do të jenë më të hapur ndaj analizave që vinin në pah *veçantinë* e çështjes së Kosovës. Ata nisën të kuptojnë se çështja e Kosovës ishte çështje fillestare dhe hapësirë ku ishte eksperimentuar ridefinimi i Jugosllavisë nëpërmjet kritikës dhe terrorit kundër « nacionalizmit shqiptar » i stigmatizuar si rreziku kryesor i Serbisë. Politikanët francezë filluan t'u kushtojnë më shumë vëmendje analizave që i kishim botuar që nga fillimi i viteve 1990 në Francë lidhur me projektin e elitave politike e intelektuale serbe për Serbinë si një shtet për të gjithë serbët dhe për pasojat që prodhoi ai në Ballkan.

## Evoluimi i qëndrimeve në Francë

Kosova sërisht depërtoi brenda opinionit të gjerë në Francë, me thellimin dhe zgjerimin e krimeve që i bënte ushtria e policia serbe.

Lufta në Prekaz në shkurt të vitit 1998 zgjoi interesim të shtuar sa të medieeve po ashtu edhe të strukturave politike e shtetërore franceze. U riaktivizuan edhe shoqatat kundër « spastrimit etnik », jo vetëm në Paris, por edhe në qytete të tjera të Francës.<sup>1</sup>

Në kumtesat e mëparshme të shoqatave parisienne evitohet rëndom çështja e statusit të Kosovës, nga bindja se kjo mund t'i shërbejë si alibi qarqeve proserbe në Francë që ta mjegullojnë politikën e terrorit të Beogradit, duke e paraqitur këtë si pasojë të domosdoshme të mbrojtjes së « sovranitetit e integritetit » të një shteti të pranuar, Jugosllavisë apo Serbisë. Mu për këtë arsye theksi në reagime vihej më shumë te karakteri ekstrem i masave represive të Serbisë dhe te kërkesa që ato të ndalen me një ndërhyrje. Ndërkaq çështja e statusit do të shtrohej doemos pas intervenimit ushtarak dhe pas largimit të strukturave të pushtetit serb nga Kosova. Ky qëndrim lucid anticipoi atë që ndodhi në fakt më vitin 1999, me intervenimin e NATO-s dhe çlirimin e Kosovës, e pas disa viteve, më 2008 shpallja e pavarësisë.

Ashpërsimi i krimeve në Kosovë do të ndikojë që opinionin publik në Francë të bëhet më i mobilizuar; reagimet drejtuar opinionit dhe qeverisë do të bëhen më të shpeshta e më të forta. Po të bëhet një paralele midis nismës së luftës në Bosnjë dhe asaj në Kosovë, si dhe reagimeve të opinionit francez dhe autoriteteve politike të vendit, mund të thuhet se tani reagimet në Francë ishin *më të shpejta e më të vendosura* ndaj ngjarjeve që zhvilloheshin në Kosovë. *Ndërveprimet* midis aktiviteteve të shoqërisë civile për ta sensibilizuar opinionin me ngjarjet dramatike, jehona që këto aktivitete kishin në gazetatat me tirazh të madh dhe në mediet elektronike dhe komunikimet me qarqet qeveritare e parlamentare do të bëhen më intensive nga gjysma e vitit 1998.

Kjo mund të shpjegohet sidomos me *akumulimin e efekteve* që kishin prodhuar agresionet e njëpasnjëshme të Serbisë kundër Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnjës. Agresione këto të shoqëruara me krime masive ndaj civilëve në Kroaci dhe Bosnjë, agresione që kishin për qëllim ta realizojnë projektin e një shteti për të gjithë serbët e ish-Jugosllavisë, projekt që shtetet euroatlantike iu kundërvunë edhe politikisht edhe ushtarakisht duke penguar realizimin e tij.

---

<sup>1</sup> Po aty, f.285-287.

## Ftesa për takim nga ministri i P.J. Hubert Vedrine

Rifillimi i një agresioni të ri të Serbisë në Kosovë, në pranverën e vitit 1998, me operacione të mëdha ushtarake-policore, me gjithë premtimet e Milosheviqit në Konferencën e Daytonit se nuk do të përsërisë më aksione të tilla (fusnotë Chirac-u na tha këtë në takimin e dytë me të në Elysée, në qershor 1999). Gjithçka zhvillohej tani më shpejt. Shumica e medieve këtë herë e kapërcyen atë fazë të *mosbesimit* ndaj informatave që vinin nga terreni, në emër të një « objektiviteti » të rremë dhe në mënyrë më të qartë iu qasen informimit dhe komentimit të ngjarjeve. Në anën tjetër, në këto rrethana u hetua se qarqet politike vendim-marrëse në Francë u bënë më të hapura për komunikim dhe këmbim të pikëpamjeve me shoqatat që merreshin me çështjen e Kosovës.

Ministri i Punëve të Jashtme të Francës, Hubert Vedrin, në fillim të muajit prill 1998 mori iniciativën të na ftojë në një takim në zyrat e tij lidhur me zhvillimet më të reja në Kosovë. Më parë ne kërkonim takime me të sikurse edhe me ministra të tjerë ose me grupet e deputetëve në Parlament dhe në Senat. Disa shoqata kundër « spastrimit etnik », si dhe disa medie franceze e kritikonin shpesh Vedrinin për qëndrimin e tij proserb dhe kundërvënien ndaj iniciativave që të luftohet regjimi i Beogradit. Në delegacion ishin edhe Antoine Garapon, Olivier Mongin, Alain Joxe, Alain Finkielkraut, Pascal Bruckner dhe Ismail Kadare. Ministri ishte i shoqëruar me këshilltarët e vet, me në krye me Michel Foucher, më parë profesor i gjeografisë në Universitetin e Lyonit. Me dinakërinë e tij të rëndomtë, Vedrini njëherësh tregoi mirëkuptim për qëndrimet dhe kërkesat e bashkëbiseduesve të vet, por më vonë shfaqti mendimin se nuk sheh zgjidhje tjetër për Kosovën veç një « autonomie substanciale ». Në fjalën time theksova se Kosova ka pasur që nga fundi i viteve '60 statusin, e cila me Kushtetutën e vitit 1974 u ngrit në një nivel më të lartë, ngase mori edhe atributin e *njesisë federative*, dhe si e tillë kishte delegacionin e vet parlamentar në Kuvendin federativ, i cili kishte jo vetëm të drejtë vote, por edhe të drejtën e *vetos* për një numër të caktuar të ligjeve të rëndësishme në nivelin federativ.

Saktësova po kështu se regjimi serb në vitet '80 e kishte suprimuar statusin kushtetues të autonomisë së Kosovës me një vendim të dhunshëm e arbitrar dhe në kundërshtim me Kushtetutën e ish-Jugosllavisë. Shtova se nëse statusi i Kosovës ishte suprimuar brenda ish-Jugosllavisë, me praninë edhe të shtatë njësive të Federatës (Sllovenia, Kroacia, Bosnja, Maqedonia e Mali i Zi), çfarë sigurie mund t'u ofrojë

shqiptarëve të Kosovës një autonomi e kontrolluar dhe e dominuar nga Serbia? Theksova se Kosova, pas gjithë asaj që ka ndodhur, ka të drejtë që realizimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve të vet t'i kërkojë në suaza të një shteti të pavarur, sikurse edhe njësitë e tjera të Federatës. Edhe anëtarët e tjerë të delegacionit tonë (Alain Joxe, Finkielkraute etj.) insistuan se pavarësia është *e vetmja zgjidhje adekuate* për Kosovën, pavarësisht nga refuzimi i Serbisë. Këshilltari i Vedrinit me një propozim për një marrëveshje me Serbinë, në të cilën ajo do të garantonte statusin e pavarësisë së Kosovës pas 20 vjetësh. Me atë rast ai rikujtoi se Franca kishte bërë një marrëveshje të tillë me Kaledoninë<sup>2</sup>. Mirëpo, ne insistuam që të mos ngatërrohen kontekstet dhe situatat historikopolitike të ndryshme dhe se kësodore Kosova ka si kërkesë pavarësinë e saj. Në një ndërhyrje timen vijuese ceka se në Beograd ka kohë që janë bërë publike kritika të argumentuara nga disa qarqe intelektuale (si fjala vjen «Qarku i Beogradit») të regjimit të Milosheviqit; shtova se në analizat e politikës ndërkombëtare lidhur me Serbinë do të ishte e rëndësishme të merren parasysh edhe pikëpamjet e atyre qarqeve, si opsione alternative, veç të tjerash, edhe rreth çështjes së Kosovës. Vedrine u tregua skeptik sa i përket ndikimit të qëndrimeve të qarqeve intelektuale të regjimit serb. Mbylltësia e optikës së Vedrinit nuk ia bënte të mundur të shohë ndryshimet që u bënë në shtator të vitit 2000: dështimin e Milosheviqit në zgjedhje dhe protestat masive opozitare.

Në bisedën e mëtutjeshme ministri Vedrine shfaqti shqetësimin për rolin gjithnjë e më të madh që SHBA-ja po e merr në çështjet e Ballkanit duke theksuar se « asnjëherë në histori nuk ka ndodhur që një fuqi të dominojë aq shumë mbi të tjerat dhe mbi botën ». Ai fliste nga pozitat e një fuqie (Francës) që nuk e kishte më rolin që pati në shekullin e 18-të e 19-të. Disa pjesëmarrës të këtij takimi theksuan se do të ishte mirë sikur diplomatët dhe zyrtarët e lartë francezë të gjenin sot mënyra për një bashkëpunim të mirë me administratën amerikane, duke evituar rivalitetet e moçme, në ballafaqimin me situatën e rëndë në Kosovë. Dihej se asokohe amerikanët dhe britanikët diskutonin për mundësinë e intervenimit ushtarak kundër Serbisë dhe se zhvillonin bisedime me vende të tjera evropërendimore lidhur me këtë mundësi.

Në anën tjetër, iniciativa e Vedrinit tregonte se ai kishte hetuar se gjërat do të zhvillohen me *shpejtësi të madhe*, si në Kosovë ashtu edhe në skenën politike ndërkombëtare. Në fakt, në Paris pati mjaft jehonë deklarata e Madeleine Allbright-it pas masakrës në Drenicë se «

---

<sup>2</sup> Siç dihet, edhe pas tridhjetë vjetësh statusi i Kaledonisë nuk është zgjidhur.

Milosheviqi do ta paguajë shtrenjtë këtë ». Edhe deklaratat e Kryeministrit të ri britanik ishin kërcënuese e të ashpra.

Një ndryshim i rëndësishëm i politikës së Francës karshi luftërave në Ballkan u hetua me ardhjen e Jacques Chirac-ut në postin e presidentit në vitin 1995. Që në fillim, në analizat e veta të luftës në Bosnjë ai e bëri dallimin midis « agresorëve » dhe « të agresuarve », duke evituar qasjen e mëparshme, e cila i barazonte mekanikisht *përgjegjësitë* e « palëve ndërluftuese ». Asokohe u hetua një *polarizim brenda strukturave politike e shtetërore franceze*: rrymat politike, të cilat e mbështetnin politikën e Serbisë, do të bëhen më pak të zëshme në opinion. Disa personalitete politike ndërkaq filluan t'i kritikojnë aksionet ushtarake të regjimit të Milosheviqit si të rrezikshme për Ballkanin.

Ndërhyrja e NATO-s, në fund të marsit 1999 u prit si ngjarje e rëndësishme dhe shpresëdhënëse nga një pjesë e madhe e opinionit francez, e veçmas nga gjithë ata që vepruan gjatë dhjetë vjetëve që të bëhet i ditur realiteti i rëndë në Kroaci, Bosnjë apo në Kosovë. Një pjesë tjetër e opinionit ishte kundër intervenimit. Por kundërvënia ndaj intervenimit bëhej nga pozita të ndryshme etike dhe politike. Disa, si bie fjala, pacifistët, e kundërshtonin parimisht intervenimin si një dhunë që nuk mund të sjellë zgjidhjen politike të problemit, sado që shumica e tyre dëshmoi deri simpati dhe mbështetje për Kosovën dhe shqiptarët si viktima të regjimit serb. Disa të tjerë, republikanët e sovrenistët, nga spektri politik i majtë apo i djathtë (Chevenement-i, ministri i Punëve të Brendshme) dhe Pasuqa (ish-ministër i Punëve të Brendshme), e kritikonin intervenimin si « përzierje jolegjitime në punët e brendshme të një shteti sovran ». Disa të tjerë kritikonin këtë ndërhyrje në emër të interesave gjeopolitike të Francës në Ballkan, kurse një pjesë e mirë e së majtës ekstreme në saje të bindjeve të tyre antiamerikane e « anti-imperialiste ». Kësodore u hap një debat më i dendur e më dinamik ku ndesheshin argumente e pikëpamje nga më të ndryshmet, të cilat fillonin me problemet e Kosovës e pastaj dilnin te çështje të politikës së jashtme të Francës, të BE-së, te interesat gjeopolitike e ekonomike të këtyre vendeve. Pyetje këto që duke u nisur nga problemi i Kosovës problematizonin ambiciet dhe parimet e BE-së, vlerat dhe orientimet politike të intelektualëve apo të politikanëve. Mund të thuhet se çështja e Kosovës shërbeu si *një katalizator për një debat polemik* e përplot pasione rreth këtyre çështjeve gjatë këtyre muajve. Numri i artikujve i botuar në gazetatat e përditshme dhe në revista ishte tejet i madh. Krahas analizave të holla e lucide historiko-politike botoheshin edhe artikuj të sipërfaqshëm, të ngarkuar me emocione e indinjim. Disa dëshmonin se

këto çështje dhe polemika shkaktonin ndarje që shfaqeshin nga strukturat politike dhe qarqet intelektuale e shkonin deri te familjet.

Mendoj se produktioni i shkrimeve për Kosovën nga këta muaj mars-dhjetor 1999 ofron një spektër tejet të begatshëm të analizave dhe problemeve të Kosovës nga intelektualë, gazetarë, historianë e politikanë francezë, nga pikëvrojtime të ndryshme e të kundërta. Ky produktion përbën një material të çmuar për studime historike e politike që sillen rreth pyetjes se si shikohej e si trajtohej çështja e Kosovës në Francë në përgjithësi.

## Bisedat me Presidentin Chirac

Në fillim të muajit prill na priti, si anëtarë të Komitetit të Kosovës në një takim Presidenti Jacques Chirac në pallatin e Elisesë. Ishin të pranishëm Antoine Garaponi, Olivier Mongeni, Alain Finkielkraut, Pierre Hassner, Pascal Bruckner, Alain Joxi dhe autori i këtij shkrimi. Kisha përshtypjen se dukej i tronditur dhe i preokupuar me atë që po ndodhte në Kosovë: filluan të arrijnë lajmet e para për masakrat masive të shqiptarëve pas ndërhyrjes së NATO-s. Chirac-u dha mendimin e vet pse e mbështeti ndërhyrjen e pastaj deshi të dëgjonte mendimet e mysafirëve lidhur me atë se në çfarë drejtimi mund të shkojnë ngjarjet në Kosovë dhe çfarë reperkusione ato mund të kenë në raportet midis aleatëve perëndimorë. Ai kritikoi qasjet e disa gazetarëve në kanalet televizive, paraqitjet e tyre të sipërfaqshme, imazhet e shumta për krimet që nuk i përcjellin me shpjegime politiko-historike dhe mbesin kësisoj në rrafshin e përshkrimit të emocioneve.

Në rastin e Kosovës, shtoi Chirac-u, jemi pajtuar në fund se ndërhyrja ishte e paevitueshme. Ai foli pastaj se çfarë masa parashihen për mbrojtjen e refugjatëve kosovarë në Shqipëri, Maqedoni e Mal të Zi. E pyetëm se a parashihet një intervenim tokësor në mënyrë që të pengohet gjenocidi, na tha se tani për tani do të vazhdojë ndërhyrja ajrore dhe se pret që ajo do të çojë te zgjidhja e problemit. Në ndërhyrjen time shkurtazi rikujtova disa fakte historike me problemin e Kosovës, që më pak zihen në gojë në medie, e në anën tjetër, bindjen se regjimi i Beogradit do të orvatet të shkojë deri në fund të realizimit të projektit të vet, zbrazjes së Kosovës nga shqiptarët. Këtë e thashë, ngase disa propozonin mundësinë e një kompromisi me Milosheviqin, edhe tani, për « ta shpëtuar si Kosovën ashtu edhe Serbinë ».

Ndryshe nga Vedrini, ish-ministër i Punëve të Jashtme, që pas intervenimit ra në heshtje, Chirac-u dilte një herë në javë, i drejtohej publikut francez përmes kanaleve televizive për ta sqaruar *domosdonë e ndërhyrjes* dhe qëllimet e saj. Në ndërhyrjen e parë, ai e cilësoi politikën e Milosheviqit në Kosovë si një « barbari të organizuar »: ky ishte vlerësimi më i rëndë që një politikan francez kishte bërë në llogari të regjimit të Beogradit.

Një rezyme të qëndrimeve të presidentit francez e gjejmë në disa fjalime të tij, me të cilat ai i drejtohej opinionit francez, sikurse edhe në vëllimin e dytë të *Memorareve* të tij me titull *Le temps présidentiel. Mémoires 2*.<sup>3</sup> Botuar nga NiL éditions, Paris 2011, f.236-250.

Chirac-u rikujton këtu se acarimi i situatës së rëndë në Kosovë u arrit më 1989 kur Serbia e Milosheviqit e suprimoi në mënyrë të njëanshme statusin e autonomisë që Kosova kishte në Kushtetutën e Jugosllavisë. Ai cek se karshi kësaj politike, në Kosovë u organizua një rezistencë së pari paqësore e pastaj edhe një rezistencë e armatosur, e cila « u transformua duke filluar nga viti 1996, në luftë për pavarësi ».<sup>4</sup> Ai shton se Milosheviqi dërgoi pastaj atje trupa për ta shuar kryengritjen me një represion të përgjakshëm. « Pas dështimit të tij në Bosnjë e Hercegovinë, humbja e Kosovës do të shënonte për të mbarimin e projektit të tij për një « Serbi të Madhe ». Ai saktëson në vijim se si rrjedhojë e operacioneve të ushtrisë serbe « qindra mijëra kosovarë u eliminuan apo u deportuan me qëllim që të ndryshohet rrënjësisht drejtpeshimi demografik i territorit në dobi të pakicës serbe. Pasi i hyri një aventure të tmerrshme për t'i imponuar planet e tij dhe të mbahet në pushtet, Milosheviqi vendos të tregohet radikalisht i ashpër duke llogaritur sërish se bashkësia ndërkombëtare do të tregohet pasive dhe e përçarë ».<sup>5</sup> Është kjo një mënyrë shumë e thukët për ta rezymuar orientimin dhe synimin e Milosheviqit në Bosnjë dhe Kosovë, në njërën anë dhe dobësitë e bashkësisë ndërkombëtare karshi politikës së tij.

Chirac-u rikujton se në nëntor të vitit 1997 Franca dhe Gjermania kishin bërë propozimin e parë për zgjidhjen e konfliktit, por ky propozim nuk u pranua. Ndërkaq më 1998, Britania e Madhe, shton Chirac-u, mori vendimin « ta sensibilizojë SHBA-në për këtë dramë të re humanitare ». Ai cek pastaj se kishte kërkuar nga Rusia t'i bëjë presion aleatit të saj për ta gjetur një marrëveshje politike « para se të bëhet vonë ».

<sup>3</sup> Nga libri i memoareve të tij *Le temps présidentiel. Mémoires 2*. NiL éditions, Paris 2011, f.236.

<sup>4</sup> Po aty, f.236-237.

<sup>5</sup> Po aty

Kurse në mars të vitit 1998, pra pas sulmit të trupave serbe në Prekaz, Chirac-u rikujton se u riaktivizua *Grupi i Kontaktit*, i përbërë nga Franca, Britania e Madhe, Gjermani, Rusia dhe SHBA-ja<sup>6</sup>, i cili u drejtoi një ultimatum udhëheqësve të Serbisë. Ky Grup ishte formuar me qëllim që të ballafaqohet me sfidat e luftës në Bosnjë.

Ai shtoi njëherësh se Këshilli i Sigurimit i OKB-së nxori një rezolutë përmes së cilës u vu një embargo në shitjen e armëve për Serbinë.<sup>7</sup>

Mund të hetohet se Chirac-u në fillim të kësaj analize të qëndrimit francez ndaj çështjes së Kosovës kishte theksuar se bashkë me Kryeministrin britanik, Tony Blair, pas diskutimeve që kishin pasur në disa takime në Francë, arritën tek ideja se duhet vepruar më në fund karshi acarimit të gjendjes në Kosovë. Blair-i kishte cekur, sikurse edhe buri me të tjera madje amerikane, se ia kishin konfirmuar *hezitimet* e disa zyrtarëve amerikanë lidhur me ndonjë ndërmarrje apo aksion të vendosur karshi Serbisë për shkak të krimeve në Kosovë.

Edhe filmi i njohur britaniko-amerikan *The special relationship* (2010) lidhur me intervenimin në Kosovë vë në pah gjithë aktivitetin politik që kryeministri britanik kishte zhvilluar për ta bindur presidentin amerikan Klinton se duhet vepruar më në fund. Po kështu, studiues të shquar amerikanë kishin vënë në pah më parë se Klintoni hezitonte dhe evitonte të ndërmarrë aksione karshi praktikave gjenocidale në Bosnjë. Sa i takon Kroacisë, amerikanët i kishin ofruar një ndihmë logjistike nga mbarimi i luftës; e kjo ndihmë logjistike u tregua efikase dhe trupat serbe në Kroaci u mposhtën me sukses.

Njëherazi, kur është fjala për pozicionin e Chirac-ut ndaj Kosovës duhet cekur se ai shënoi një ndryshim e madje një kthesë të rëndësishme në krahasim jo vetëm me qëndrimet e Mitterrand-it, por edhe të një pjese të konsiderueshme të klasës politike të Francës dhe diplomacisë së saj karshi Serbisë, si aleate shumëvjeçare e Francës.

## Vendimi i Presidentit Chirac

Më 24 mars 1999 Presidenti i Francës, Jacques Chirac, në një paraqitje televizive e njoftoi opinionin francez se kishte marrë vendim

---

<sup>6</sup> Po aty, f.237

<sup>7</sup> Po aty, f.238.

për pjesëmarrjen e aviacionit francez, me më se 100 aeroplanë në bombardimet e Serbisë, përkatësisht të caqeve ushtarake e strategjike të saj. Asokohe Franca nuk bënte pjesë në NATO.

Në këtë fjalim Chirac-u shpjegon arsyet dhe qëllimet e këtij intervenimi: « Kemi marrë vendim t'u japim fund praktikave barbare të regjimit serb, spastrimeve etnike, masakrave dhe dëbimeve masive të shqiptarëve nga Kosova ». Ai thekson se kanë marrë vendim t'i kundërvihen « vullnetit metodik » të regjimit serb « për ta zhdukur tërë një popull ». Këto praktika, saktëson Chirac-u, rikujtojnë orët më të errëta të barbarisë. Sikur t'i pranohet këto praktika dëshmitarë të të cilave jemi, kjo do të thoshte të humbasim shpirtin tonë, të lejojmë që gangrena e të pathënshmes (*l'innomable*) të vendoset sërish në kontinentin tonë [...]. Brezave të cilët nuk e kanë njohur luftën, lufta e sotme është shembullore, ajo nuk bazohet në konsiderata ekonomike apo strategjike, por në një ide të caktuar të « moralit » dhe « të drejtës së kombeve ».

Dimensioni etiko-politik i qëndrimit të Presidentit Chirac ndaj çështjes së Kosovës shpërfaqet qartazi edhe në këto formulime.

Presidenti Chirac do t'i drejtohet opinionit francez rregullisht (së paku një herë në javë) për t'ia sqaruar hollësisht qëllimet e intervenimit të NATO-s kundër Serbisë. Ai e dinte se një pjesë e opinionit ishte e ndikuar nga qarqet politike, shoqatat e mediet proserbe, të cilat sistematikisht i mjegullonin dhe deformimin faktet dhe realitetin e ngjarjeve, sidomos në dy vitet e fundit.

Nga më të zëshmit kundërshtarë të intervenimit në Francë ishin rrymat majtiste « antiimperialiste ». Kundërvënien ndaj intervenimit të NATO-s, në vitin 1999, këto qarqe e mbështetnin në dy « arsye-time-argumente » kryesore: ata e cilësonin intervenimin e NATO-s si intervenim i « fuqive imperialiste » për ta realizuar « sundimin e tyre imperialist » në Ballkan e kundër « Serbisë si shtet sovran ». « Argumenti » i dytë shpalosej me mohimin e plotë të krimeve të shtetit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës: ato qarqe i cilësonin pohimet për krimet masive serbe si « gënjeshtër e shpifje »: negacionizëm ky si ai që mohonte dikur krimet kundër hebrenjve, kurse intervenimin e NATO-s, të udhëhequr nga SHBA-ja, e cilësuan si « agresion ». Ndërkaq, ky operacion, në të vërtetë, ndërpreu masakrat e shqiptarëve nga serbët e njëherësh e bëri të mundur kthimin e afro 1 milion shqiptarëve në vendin e tyre, në Kosovë. Kështu kundërshtimi i intervenimit të NATO-s ishte faktikisht mbështetje e vazhdimit të krimeve masive ndaj shqiptarëve.

Në fjalimin e pestë që nga fillimi i bombardimeve të NATO-s Chirac-u, sipas « Libération », më 4 maj 1999, në kanalin televiziv TF1,

përsëriti sërish se qëllimi i bombardimeve është që të ndalet « gangrena e të pathënshmes “l’innommable », term ky që emërton krimin më të ndyrë, shprehje kjo që ishte sajuar në analizat për Shoa-n. Ndaj vlerësimeve mediatike për lirim të tre pilotëve amerikanë nga pushteti serb Chirac-u tha: « Kurrfarë besimi nuk mund të kemi sot tek autoritetet e Beogradit. Pikërisht në momentit kur ata lironin tre të burgosurit, forcat e tyre përndiqnin dhjetëra mijëra kosovarë nga qyteti i tyre i Prizrenit ». Ai thekson se bombardimet do të vazhdojnë dhe do të jenë më intensive. Në këtë fjalim ai cek po kështu se « do të zhvillohet përforcimi i kapaciteteve ajrore të Aleancës për t’i arritur caqet e veta pa ndërprerje. Kemi arritur, shton ai, t’i ndërprejmë linjat e furnizimit, kështu regjimi i Beogradit ka mbetur i privuar pashmangshëm nga mjetet e pushtetit të vet. Në këtë fjalim Chirac-u ka qenë shumë i ashpër, në veçanti, ndaj Milosheviqit dhe « vullnetit të tij metodik për ta zhdukur tërë një popull dhe praktikën që rikujtojnë orët më të errëta të barbarisë”.

Dimensioni etiko-politik i qëndrimit të Presidentit Chirac ndaj çështjes së Kosovës shpërfaqet fuqishëm edhe në këto formulime.

Në takimin e dytë me Presidentin Chirac, në pallatin e Elysesë, në fund të muajit qershor (1999), ai na falënderoi që ia kishim dërguar librin *Le Kosovo, un drame anoncé (Kosova, një dramë e paralajmëruar*, Michalon, Paris, 1999). Ai shprehu respektin për analizat e ngjarjeve, për pikëpamjet dhe vlerat me të cilin orientohet kjo vepër e përbashkët e autorëve.

Veç disa anëtarëve të Komitetit të Kosovës, në takimin me Chirac-un ishin edhe Ismail Kadare, Jean d’Ormesson, e njëherësh edhe drejtori i të përditshmes *Le Monde* Edwy Plenel dhe editorialisti i të përditshmes *Le Figaro*, Gérard Slamma.

Chirac-u dukej i shtendosur, i kënaqur me përfundimin e sukseshëm të operacionit ushtarak ndërkombëtar.

Ai rikujtoi, megjithatë, se paralajmërimi i një ndërhyrjeje tokësore të NATO-s kishte shkaktuar kriza në koalicionet e majta të qeverive në Francë, Itali e Gjermani. Komunistët dhe të gjelbërit ishin kërcënuar se do ta braktisin qeverinë nëse lufta në Kosovë thellohet dhe zgjatet. Ai tha se Milosheviqi kishte kalkuluar me këto përçarje, mirëpo, paralajmërimi i një ndërhyrjeje tokësore megjithatë e kishte detyruar të tërhiqet, me qëllim të ruajtjes së pushtetit.

Biseda u soll në këtë takim sa rreth ardhmërisë së Kosovës, aq edhe asaj të Serbisë dhe Milosheviqit. Chirac-u shprehu rezervë ndaj

opsionit të pavarësisë së Kosovës, duke theksuar se “duhet evituar të hapet kutia e Pandorës në Ballkan”. Në fjalën time, pasi e falënderova për mbështetjen që i dha ndërhyrjes së NATO-s, e cila solli çlirimin e Kosovës, ia rikujtova se kutia e Pandorës ishte çelur më herët, me shpërbërjen e Jugosllavisë në entitete të Federatës. Shtova se pasi popujt jugosllavë që e kishin krijuar Jugosllavinë, vendosën të ndahen, shqiptarët nuk mund të mbeteshin në një strukturë të vdekur, në të cilën më parë u detyruan, kundër vullnetit të tyre, të jetojnë. Bëra krahasimin edhe midis kërkesës së Malit të Zi për pavarësi, megjithëse atje nuk është shënuar ndonjë terror serb, me kërkesën për pavarësi të Kosovës. Kadareja e Bernard-Henri Lévy mbështetën kërkesën për pavarësi të Kosovës, si dhe nevojën që UÇK-ja të transformohet në ushtri të rregullt.

Me intensifikimin e debateve në skenën publike franceze lidhur me statusin e Kosovës, Chirac-u do ta mbështesë pavarësinë e Kosovës. Mirëpo, meqë mandati i tij merrte fund në vitin 2007, ai e realizoi këtë mbështetje *brenda* qarqeve diplomatike e politike të Francës, si dhe me komunikimin që kishte me shefat e shteteve perëndimore.

Arsim Bajrami

## ARGUMENTE LIGJORE DHE POLITIKE PËR INTERVENIMIN E NATO-S NË KOSOVË

### Abstrakt

Edhe sot e kësaj dite, 25 vjet pas fushatës së bombardimeve të NATO-s në Kosovë, në qarqe ndërkombëtare, sidomos në debate publike ka diskutime kontraverse për bazën ligjore të bombardimeve të NATO-s në Kosovë. Legjitimiteti i fushatës së bombardimeve të NATO-s në Kosovë ka qenë objekt i shumë debateve politike e diplomatike në mbarë globin. NATO-ja për fillimin e bombardimeve ajrore nuk e kishte mbështetjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për shkak të kundërshtimit nga anëtarët e përhershëm të saj që ishin shumë të lidhur me Jugosllavinë, në veçanti, Rusia, e cila kundërshtonte fuqishëm çdo intervenim të NATO-s në konfliktin në fjalë. Kritika ruse dhe e shume aleatëve të Jugosllavisë ishte projektuar në faktin se karta e NATO-s përcakton se NATO-ja është një organizatë e krijuar për mbrojtjen e anëtarëve të saj, dhe në këtë rast ajo po përdorej për të sulmuar një vend jo të NATO-s, i cili nuk kërcënonte drejtpërdrejt ndonjë anëtar të NATO-s. NATO-ja deklaronte se jostabiliteti në Ballkan ka qenë një kërcënim i drejtpërdrejtë për interesat e sigurisë së anëtarëve të NATO-s, dhe në këtë formë ajo justifikonte veprimin ushtarak, ndërsa i vetmi vend anëtar i NATO-s, për të cilin veprimet jugosllave nuk paraqitnin kërcënim të drejtpërdrejtë për jostabilitet në Ballkan ishte Greqia, e cila i kundërshtoi bombardimet edhe pse mori vetë pjesë në to.

Aksioni i NATO-s ndodhi pas shumë paralajmërimeve të NATO-s dhe pasi Beogradi kishte injoruar thirrjet e OKB-së, angazhimet e Grupit të Kontaktit, të OSBE-së dhe të emisarëve të tjerë ndërkombëtarë. Milosheviqi tregoi konfrontues dhe arrogant me Perëndimin dhe krejt hapur deklaronte se ishte i gatshëm të shkelte mbi trupat e shqiptarëve të Kosovës, duke u thirrur në eksperiencën e komunistëve jugosllavë në fund të Luftës së Dytë Botërore. Me një fjalë, Beogradi nuk mori në konsideratë mjetet joushtarake të Perëndimit. Prandaj, NATO-ja nga pranvera e vitit 1998, e deri në fillim të vitit 1999, shteroi të gjitha instrumentet joushtarake efektive.

Rendi ndërkombëtar i viteve nëntëdhjetë bazohet në teorinë e sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve dhe kishte vendosur disa kufizime sa u përket intervenimeve ndërkombëtare të NATO-s në shtete sovraane të cilat ishin anëtare fuqiplote të OKB-së. Por ky rend ndërkombëtar, filloi të shembej pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe ndarjes bipolare të botës, kur filloi procesi i globalizimit dhe krijimit të sistemit të sigurisë kolektive dhe kur NATO-ja fitoi të drejtën e intervenimit humanitar kurdo dhe kudo që shkelen të drejtat e njeriut, zbatohen politikat e spastrimit etnik dhe veprimet e tjera gjenocidale.

Doktrina e intervenimit humanitar bazohet në të drejtën ndërkombëtare moderne, të reformuar, që deplason teorinë e sovranitetit absolut shtetëror, parandalon shtetet të kryejnë gjenocid, spastrim etnik dhe krime të tjera makabre dhe i mundëson NATO-s të mbrojë të drejtat universale të popujve kudo që ato shkelen. Legjitimiteti i intervenimit të NATO-s në Kosovë është i pakontestueshëm për faktin se gjenocidi paraqet krimin më të rëndë kundër njerëzimit dhe se ai nuk duhet të tolerohet nga bota demokratike, por duhet të parandalohet në mënyrë që të gjitha shteteve të botës t'u dërgohet një mesazh i qartë se ato do të ballafaqohen me reagime të fuqishme ushtarake, politike dhe gjyqësore, sa herë që

ndërmarrin veprime dhe krime gjenocidale. Bazuar në këtë, diskutimet kontraverse për bazën ligjore të bombardimeve janë diskutime që kohë pas kohe shërbejnë për të diskutuar të drejtën e kësaj organizate që të ndërhyjë edhe në kriza të tjera humanitare anë e mbanë botës. Kjo çështje është shtruar edhe në disa raste të tjera, duke përfshirë edhe rastin e agresionit aktual të Rusisë në Ukrainë, dhe duke e marrë shembull rastin e Kosovës si precedent për intervenimin e NATO-s ndaj shteteve të tjera.

Qasja klasike e sovranitetit territorial të shteteve që bazohet në parimet e së drejtës ndërkombëtare klasike të modelit sovjetik, sipas së cilës NATO-ja nuk mund të bombardojë apo ndërhyjë në sovranitetin e asnjë shteti anëtar të OKB-së pa marrjen paraprake të pëlqimit të Këshillit të Sigurimit, me të cilin autorizohet ky intervenim. Kjo doktrinë e ka origjinën në periudhën e Luftës së Ftohtë dhe bazohet në parimin e mosndërhyrjes në punët e brendshme, integritetin dhe sovranitetin territorial dhe të drejtën e secilit shtet që të zgjidhë konfliktet e brendshme. Ihtarët e kësaj teorie bazoheshin në faktin se gjoja Kosova ishte një çështje e brendshme, nuk ishte një shtet i pavarur dhe sovran, ishte çështje e brendshme e Serbisë dhe se çfarëdo intervenimi i NATO-s do të cenonte integritetin territorial të këtij shteti. Fatkeqësisht këto opinione kanë qenë të përhapura në një pjesë të komunitetit juridik ndërkombëtar dhe janë shprehur në shumë konferenca kushtuar legalitetit të intervenimit të NATO-s në Kosovë, madje edhe nga ekspertët juridikë të shteteve që kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

*Fjalët çelës:* NATO-ja, legjitimiteti, legaliteti

## Okupimi i Kosovës dhe eskalimi i luftës së armatosur<sup>1</sup>

Pas shpalljes së Republikës së Kosovës, Serbia intensifikoi dhunën shtetërore ndaj shqiptarëve, duke zbatuar politikën e saj të shtypjes, keqtrajtimit, të shkeljes së të drejtave elementare (përfshirë këtu edhe të drejtën për jetë) dhe një arsenal të tërë të dhunës shtetërore që synonte spastrimin etnik dhe vënien e plotë të Kosovës nën juridiksionin serb. Pas vitit 1990, Serbia përmes metodës së puçit kushtetues shkatërroi të gjitha institucionet legjitime të Kosovës dhe me ndihmën e dhunës policore, okupoi të gjitha institucionet publike në Kosovë, që nga ato politike, arsimore, kulturore, informative, shëndetësore, sportive etj<sup>2</sup>.

Praktikisht, shqiptarët dhe Kosova, përmes një varg ligjesh diskriminuese, vendosën në gjendje jashtëligjore dhe Serbia zbatoi një segregacion etnik në shkallë apartheidi, duke kufizuar dhe shkelur të gjitha liritë individuale dhe politike, duke siguruar sundimin e pakicës serbe

<sup>1</sup> Shih më shumë edhe: Dusan Janjić, with Anna Lalaj and Besnik Pula “Kosovo under the Milošević Regime”, fq.272-301. Publikuar në kuadër të: “Confronting the Yugoslav Controversies” United States Institute of Peace Press Washington, D.C., 2009, Purdue University.

<sup>2</sup> Peter Hilpold, “The International Court of Justice’s Advisory Opinion on Kosovo: Perspectives of a Delicate Question”, Austrian Review of International and European Law, fq.264-266.

ndaj shumicës shqiptare. Si përgjigje ndaj dhunës serbe, shqiptarët zgjodhën rrugën e jodhunës dhe përmes mjeteve politike shprehën kundërshtimin e okupimit serb dhe padëgjueshmërinë qytetare ndaj këtij okupimi. Ata, nuk morën pjesë në zgjedhjet serbe dhe jugosllave dhe nuk participuan në asnjë proces politik të cilin Serbia dhunshëm e imponoi në Kosovë. Në anën tjetër, shqiptarët në Kosovë bënë përpjekje për organizim paralel të institucioneve politike, arsimore, kulturore, informative, etj. Në periudhën deri në eskalimin e plotë të luftës në Kosovë, siç u tha u mbajtën dy cikle të zgjedhjeve parlamentare, por mungoi funksionalizimi i organeve të Kosovës. Këtë, e pengoi regjimi serb i cili ndëshkonte dhe pamundësonte çdo përpjekje të shqiptarëve për organizim shtetëror, por edhe mungesa e një strategjie të qartë politike të subjekteve të atëhershme politike, për realizimin e përcaktimit politik të popullit të Kosovës për pavarësi, me referendumin e vitit 1991<sup>3</sup>.

## Paraqitja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Duke mos u pajtuar me okupimin serb të Kosovës dhe duke parë paaftësinë e zgjidhjes politike të krizës në Kosovë, pas vitit 1990, filluan përgatitjet për formimin e UÇK-së, si formacion i rregullt ushtarak dhe si kryengritje e armatosur për çlirimin e Kosovës. Këto përgatitje u kurorëzuan në vitin 1997, kur UÇK-ja doli publikisht në skenë dhe filloi luftën çlirimtare në Kosovë. Formimi i UÇK-së paraqet një ngjarje historike për popullin e saj, në luftën e tij historike për pavarësi. Formimi i UÇK-së<sup>4</sup>, bazohej në vetë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të 7 shtatorit të vitit 1990, e cila në nenin 77 shprehimisht përcaktonte se: “mbrojtja e vendit, është e drejtë e pacenueshme dhe e patjetërsueshme, obligim dhe nder i madh i çdo qytetari”.

Themelimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bëri që të krijohen raporte të reja në Kosovë dhe rajon, që problemi i Kosovës të dalë në skenë me tërë kompleksitetin e tij. Kundërvënja e armatosur e shqiptarëve, përmes UÇK-së, ishte një dëshmi e fuqishme e gatishmërisë së popullit të Kosovës, që me vetëflijmë dhe sakrificë, të dëshmojë përcaktimin e tij të fuqishëm për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ky fakt bëri që problemi i

---

<sup>3</sup> Stefan Troebst, “*Conflict in Kosovo: Failure of Prevention? An Analytical Documentation, 1992-1998*”, European Centre for Minority Issues (ECMI) Flensburg, 1998, fq.31.

<sup>4</sup> Peter Hilpold, “*The International Court of Justice’s Advisory Opinion on Kosovo: Perspectives of a Delicate Question*”, Austrian Review of International and European Law, fq.264.

Kosovës të arrijë kulminacionin e ndërkombëtarizimit dhe të marrë një trajtim më adekuat. Më të vërtetë, fillimi i luftës çlirimtare nga UÇK-ja, nxori në shesh faktin se çështja e Kosovës nuk paraqet çështje të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të shqiptarëve (siç trajtohej deri atëherë ky problem), por një problem politik në thelbin e së cilës është e drejta e vetëvendosjes së shqiptarëve, përkatësisht pavarësia e Kosovës.

E formuar nga motivi çlirimtar, UÇK-ja arriti shumë shpejt, të fitojë mbështetjen e popullit të Kosovës dhe të paraqitet si faktor kryesor në komunikimet me faktorin ndërkombëtar, rreth zgjidhjes së krizës në Kosovë. Në doktrinat ushtarake ndërkombëtare, UÇK-ja paraqet formacionin ushtarak i cili gëzoi njohje shumë të shpejtë ndërkombëtare<sup>5</sup>.

Që nga ditët e para të paraqitjes publike, filluan kontaktet diplomatike të UÇK-së, me diplomatët e huaj, sidomos të atyre amerikanë, rreth zgjidhjes së krizës. Në këto kontakte, u bë njohja *de facto* e UÇK-së, kurse njohja *de jure* e saj, pasoi në Konferencën e Rambujesë, ku përfaqësuesit e saj u legjitimuan si negociatorë kryesorë, kurse ish-udhëheqësi i Drejtorisë Politike të UÇK-së, njëkohësisht kryeson delegacionin kosovar në këtë Konferencë.

E formuar fillimisht përmes njësive të vogla guerile, UÇK-ja shumë shpejt mori formën e një ushtrie të rregullt me një strategji të qartë politike, me një komandim unik dhe me strukturë tipike ushtarake. Ajo arriti të çlirojë shumë territore të Kosovës dhe të përfitojë simpatinë ndërkombëtare për luftën e saj të drejtë. Në anën tjetër, policia dhe ushtria serbe, si dhe formacionet e saj paramilitare, duke mos qenë në gjendje të mposhtin UÇK-në, vazhduan vrasjet joselektive të civilëve shqiptarë, masakrimin e tyre kolektiv, djegien e shtëpive dhe pasurisë së tyre, si dhe deportimin e tyre të dhunshëm jashtë Kosovës. Ky deportim, pas dështimit të Konferencës së Rambujesë, mori trajtën e një eksodi masiv, me synim të spastrimit etnik dhe gjenocidit të shqiptarëve. Më tepër se 1 milion shqiptarë të Kosovës u dëbuan dhunshëm nga policia serbe në Maqedoni, Shqipëri dhe anembanë Evropës. Ky eksod masiv, dhuna dhe gjenocidi, të cilën Serbia e ushtroi në Kosovë, si dhe lufta e drejtë e UÇK-së, zgjoi ndërgjegjen e komunitetit ndërkombëtar dhe nevojën e ndërhyrjes ushtarake kundër Serbisë. Kjo edhe ndodhi, më dt. 24.03.1999, kur NATO-ja filloi luftën kundër Serbisë, luftë kjo që zgjati 78 ditë dhe që përfundoi me kapitullimin e Serbisë dhe tërheqjen e saj të plotë nga territori i Kosovës. Pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së Kosovës nën prezencën civile dhe ushtarake ndërkombëtare dhe marrjes përsipër

<sup>5</sup> Greg Campbell, "The road to Kosovo", 2000, fq. 159-181.

të sigurisë së Kosovës nga forcat e KFOR-it, erdhi deri te demilitarizimi i UÇK-së, dhe formimi i Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

## Masakra e Reçakut

Në orët e hershme të mëngjesit të datës 15 janar 1999, ashtu siç ishte planifikuar në Beograd, fshati Reçak u zgjua i rrethuar nga formacionet e policisë speciale, ushtarake dhe paraushtarake serbe të shoqëruara edhe me mjete të shumta të motorizuara. Sipas dëshmitarëve që i kanë mbijetuar krimit, aty rreth orës 6:30, forcat serbe me artileri të rëndë kanë filluar ta granatojnë fshatin, prej vendeve të quajtura „Pishat“, „Gështenjat“, „Rrasa e Çallakut“ dhe nga „Çesta“ përmbi Reçak. Pas ndërprerjes së granatimeve forcat kriminale serbe janë futur në fshat dhe kanë filluar bastisjet shtëpi për shtëpi. Në këto momente mjaft të rënda, fshatarët janë përpjekur të largohen nga fshati apo të gjejnë një vendstrehim më të sigurt, por rrethimi i hekurt e ka bërë të pamundur një gjë të tillë<sup>6</sup>.

Më 16 janar ish-shëfi i Misionit Verifikues të Organizatës për Siguri e Bashkëpunim në Evropë, ambasadori William Walker e cilësoi masakrën serbe krim kundër njerëzimit. "Nga ajo që unë personalisht kam parë, nuk hezitoj ta përshkruaj ngjarjen si një masakër, padyshim një krim kundër njerëzimit. Bota duhet ta dënojë këtë mizori", tha atë kohë ambasadori Walker.

## Lufta e UÇK-së dhe ndalja e gjenocidit serb

Kosova u kthye në temën numër një në botë, sepse komplet vëmendja ndërkombëtare ishte përqendruar në luftën e Kosovës, në përpjekjet e popullit shqiptar për mbijetesë dhe në dënimin global të

---

<sup>6</sup> Më 15 janar 1999, në këtë ditë të kobshme, në Reçak u vranë e u masakruan barbarisht 45 shqiptarë të paarmatosur, në mesin e të cilëve ishte edhe një grua; Lute Asllani, Banush Kamberi, Ragip Bajrami, Halim Beqiri, Rizah Beqiri, Zenel Beqiri, Lutfi Bilalli, Ajet Emini, Bujar Hajrizi, Myfail Hajrizi, Skënder Halili, Haqif Hysenaj, Hajriz Ibrahim, Hakip Imeri, Murtez Imeri, Nazmi Imeri, Mehë Ismajli, Muhamet Ismajli, Ahmet Jakupi, Eshref Jakupi, Hajriz Jakupi, Mehmet Jakupi, Xhelal Jakupi, Jashar Jashari, Raif Jashari, Shukri Jashari, Fatmir Limani, Nexhat Limani, Salif Limani, Bajram Mehmeti, Hanumshah Mehmeti, Arif Metushi, Haki Metushi, Ahmet Mustafa, Asllan Mustafa, Muhamet Mustafa, Sadik Osmani, Jashar Salihu, Shukri Salihu, Bajrush Shabani, Ahmet Smajlaj, Sheremet Sylja, Shyqëri Sylja, Bajram Xheladini, Njazi Zymeri.

fushatës gjenocidale të spastrimit etnik. Angazhimit medial për të krijuar një diskurs publik për nevojën e ndërhyrjes urgjente për të ndaluar një gjenocid në ardhje në Kosovë pati sukses. Pamjet të cilat mediet ndërkombëtare i transmetonin për masakrat, dhunën, terrorin serb dhe keqtrajtimet ndaj popullit shqiptar, ndikuan në një solidaritet të paparë ndërkombëtar me popullin shqiptar të Kosovës, në luftën e tij për mbijetesë dhe në gjykimin absolut të politikës gjenocidale të Serbisë. Në këtë rast u arrit të thyhet edhe paragjykimi ndërkombëtar për luftën që bënte Ushtria Çlirimtare e Kosovës si një guerilë patriotike e formuar nga idealistët dhe patriotët për të mbrojtur popullin e Kosovës dhe për të luftuar për liri dhe pavarësi të Kosovës. Fillimisht një pjesë e madhe e medieeve ndërkombëtare, por edhe qeverive të shteteve të ndryshme ishin skeptike ndaj luftës së UÇK-së dhe karakterit të saj, duke i quajtur madje edhe me terma ofendues si “organizatë terroriste”. Profilizimi i qartë politik i UÇK-së dhe përcaktimi i qëllimeve të luftës, që ishin lufta mbrojtëse, çlirimtare dhe lufta kundër ushtrisë dhe policisë serbe, bëri që të ndërrojë percepticioni i opinionit ndërkombëtar për UÇK-në dhe ajo gjithnjë e më shumë të pranohet si një formacion i rregullt, si një ushtri që zhvillon luftë mbrojtëse ndaj agresionit dhe gjenocidit serb.

Masovizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sidomos pas rezistencës heroike të familjes Jashari dhe vrasjes së Komandantit të UÇK-së, heroit kombëtar Adem Jashari, ndikoi në një mobilizim të paparë të qytetarëve të Kosovës për t’u rreshtuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, në luftën ndaj agresionit dhe gjenocidit serb. Pikërisht ky profilizim i qartë i qëllimeve të UÇK-së, ndikoi që ajo të pranohej nga faktori ndërkombëtar si faktor kryesor për një zgjidhje politike dhe të fillojnë kontaktet e para me bashkësinë ndërkombëtare, në radhë të parë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me përfaqësuesit e UÇK-së, për të gjetur një zgjidhje politike që do t’i jepte fund luftës dhe do të mundësonte një zgjidhje të qëndrueshme paqësore.

### Sensibilizimi ndërkombëtar për nevojën e ndaljes së gjenocidit serb në Kosovë

Në situatën në të cilën bashkësia ndërkombëtare u ballafaqua me gjenocidin e dytë në ish-Jugosllavi pas atij në Bosnjë, kishte një gatishmëri dhe sensibilizim ndërkombëtar për nevojën e intervenimit preventiv, për të ndaluar fushatën gjenocidale të spastrimit etnik dhe për të mos i lejuar Serbisë që në mes të Evropës të implementonte një gjenocid klasik ndaj

popullit shqiptar të Kosovës. Aktet e para gjenocidale dhe masakrat që Serbia kreu ndaj popullsisë së pambrojtur civile, dhjetëra masakra që ishin një përsëritje e masakrave në Bosnjë, ku u vranë qindra shqiptarë të pafajshëm, rezistenca heroike e familjes Jashari dhe vrasja e më shumë se 40 anëtarëve të kësaj familjeje në mbrojtje të shtëpisë, e në veçanti masakra e Reçakut, ishin momente vendimtare të sensibilizimit ndërkombëtar dhe të nevojës së intervenimit preventiv të NATO-s për të ndaluar një gjenocid në ardhje. Në këtë situatë bashkësia ndërkombëtare, mediet dhe televizionet ndërkombëtare, organizata për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, krijuan një opinion ndërkombëtar për nevojën e ndërhyrjes së menjëhershme të NATO-s në Kosovë. Ishte evidente se gjenocidi serb në Kosovë do të kalonte përmasat e asaj që bota kishte parë në Bosnjë<sup>7</sup>. Kjo për faktin se armiqësia e serbëve ndaj shqiptarëve është trefish më e madhe sesa ndaj popujve të tjerë të ish-Jugosllavisë. Historikisht serbët kanë udhëhequr një politikë gjenocidale ndaj shqiptarëve, me qëllim të shfarosjes së tyre, dekompozimit si komb, shkatërrimit të çfarëdo organizimi politik të shqiptarëve për t'i zmbarsur ata nga kërkesat e tyre për liri, për barazi, për shtet dhe pavarësi. Mediet ndërkombëtare dhe gazetarët të cilët u dërguan në Kosovë për të raportuar për fushatën e gjenocidit serb, njoftuan opinionin ndërkombëtar se në Kosovë po përgatitej një gjenocid i përmasave më të mëdha sesa në Bosnjë dhe krijuan një opinion shumë pozitiv ndërkombëtar për nevojën imediate për ndërhyrje sa më të shpejtë për të ndaluar një gjenocid shkatërrimtar të Serbisë.

## Kërcënimi për ndërhyrje ushtarake

Më 11 qershor, ministrat e mbrojtjes së NATO-s autorizuan autoritetet ushtarake të NATO-s të zhvillojnë një varg opsionesh për “ndalimin dhe ndërprerjen e një fushate sistematike të represionit e dëbimit të dhunshëm në Kosovë”<sup>8</sup>. Për një demonstrim të fuqisë ushtarake, NATO-ja ra dakord të zhvillojë disa ushtrime ajrore mbi Shqipërinë e Maqedoninë fqinje. Stërviçja “fajkoi i vendosur”, e zhvilluar më

---

<sup>7</sup> Presidenti Clinton aso kohe deklaroi; “Krenar që ndalëm spastrimin etnik në Kosovë”, “Unë gjithmonë do të jam krenar me faktin se unë isha president i SHBA-së në kohën kur ju patët nevojë që dikush të ngrihet dhe ta thotë se nuk ka më spastrim etnik, nuk ka më përndjekje të njerëzve nga shtëpitë e tyre, jo më vrasje të civilëve të pafajshëm” <https://www.vizionplus.tv/clinton-takon-thacin-krenar-qe-ndalem-spastrimin-etnik-ne-kosove/>

<sup>8</sup> Deklaratë për Kosovën të bërë në takimim e Këshillit të ministrave të Mbrojtjes të Alencës së Atlantikut të Veriut, Bruksel, 11 qershor 1998

15 qershor, u prezantua si një demonstrim “i aftësisë së NATO-s për të projektuar shpejt e shpejt forcë vepruese në rajon”. 56 aeroplanët fluturonin mbi Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë, por jo mbi Shqipërinë Veriore, ku ata mund të shiheshin nga forcat serbe dhe UÇK-ja.

Grupi i Kontaktit i përkrahur nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, bashkë me NATO-n tanimë ishin pjesë e lojës. Qeveria amerikane në veçanti kishte filluar të bënte trysni për aksion të mundshëm ushtarak për ta ndalur represionin në Kosovë. Kërcënimi i përdorimit të forcës në raport me Kosovën nga ShBA-ja ishte bërë që nga viti 1992. “Në rast të konfliktit në Kosovë, i cili do të shkaktohej nga veprimi i Serbisë, SHBA-ja do të ishte e gatshme të përdorte forcën ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe në vetë Serbinë”, i kishte shkruar kryetari i atëhershëm, George Bush, Slllobodan Millosheviqit, kërcënim ky që u përsërit nga administrata e Bill Clinton-it. Kurse Javier Solana, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s kishte deklaruar se Aleanca, në përpjekjet e veta për ta përkrahur bashkësinë ndërkombëtare që të arrihej një marrëveshje e negociuar, kishte “...rishikuar planifikimin ushtarak për një vistër mundësish që të ndalej dhuna dhe të krijoheshin kushtet për negociata. Këto e përfshijnë edhe përdorimin e forcave tokësore e ajrore, e posaçërisht një vistër të gjerë opsionesh për përdorimin vetëm të forcës ajrore. Këto sigurojnë që NATO-ja të mund të vepronte me shpejtësi dhe në formë efikase po të shfaqej nevoja”. Këshilli i Sigurimit i OKB-së, kishte miratuar edhe rezolutat 1160 (1998), sipas së cilës Beogradi duhej të ndërpriste të gjitha veprimet luftarake, si dhe 1199 (1998), që ishin të bazuar në kapitullin VII të Kartës së OKB-së. Një rezolutë e cila merret duke u mbështetur në Kapitullin VII të Kartës së OKB-së, çmohet si hap i parë drejt masave më të ashpra të ndërmarra nga KS-ja, të cilat mund të shkojnë deri tek intervenimi ushtarak. Në bazë të kapitullit VII të Kartës së OKB-së, keqësimi i gjendjes në Kosovë u cilësua si “rrezik për paqe dhe siguri në rajon. Edhe ministri i Jashtëm rus Ivanov, votoi pro Rezolutës 1199, çka nënkupton një tërheqje nga pozicioni i saj i fortë në mbështetje të Beogradit. Para opinionit publik, si justifikim rusët do të theksojnë se kjo rezolutë do të shërbejë si impuls për dialog të drejtpërdrejtë midis Beogradit dhe Kosovës.

Ambasadori William Walker në një dëshmi të tij për Slllobodan Millosheviqin së bashku me Gjeneralin Wesley Clark, atëherë komandant supreme i forcave aleate në Evropë, Naumann ka vizituar Millosheviqin më 24 dhe 25 Tetor, 1998 për t'i dhënë atij një ultimatum të NATO-s. Nëse presidenti nuk tërhiqte 6,000 policë nga Kosova dhe nuk kthente forcat e ushtrisë në kazerma, do të nisnin sulmet ajrore.

Pas arritjes së një marrëveshjeje dhe nënshkrimit të saj nga presidenti, Naumann kujton se si gjatë një bisede të qetë me nga një gotë raki kumbulle përpara, biseda ka prekur edhe çështjen e numrit të shqiptarëve në Kosovë. Ai ka thënë para gjykatës se i akuzuari dhe zëvendëskryeministri i tij, Nikola Shainoviq, kanë thënë se çdo zgjidhje e krizës në Kosovë duhe të përfshijë “një balancim ndërmjet dy grupeve etnike”<sup>9</sup>. Nauman tha se më pas Millosheviqi ka njoftuar se ai do të “përpiqej të gjente një zgjidhje për problemin” pranverën e ardhshme. Kur dy gjeneralët e kishin pyetur se çfarë kishte në mend, me sa duket presidenti është përgjigjur: “Do të bëjmë atë që kemi bërë në Drenicë më 1945-46... I rreshtuam njerëzit dhe i pushkatuam”<sup>10</sup>.

Më 30 janar 1999 NATO-ja lëshoi një deklaratë ku Këshilli i Atlantikut të Veriut kishte pranuar që "Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s mund të autorizojë sulme ajrore kundër shënjestrave në territorin e RFJ-së" në mënyrë që të arrihej një marrëveshje politike". Ky ishte më shumë një kërcënim për qeverinë e Millosheviqit, ajo po ashtu ishte një sprovë për të gjithë faktorin politik shqiptar.

Po ashtu më 30 janar 1999 Grupi i Kontaktit lëshoi një set "principesh të panegociueshme", e cila krijoi një paketë të njohur si "Status Quo Plus", efektivisht rikthimin e autonomisë së Kosovës si para vitit 1990 brenda Serbisë, plus futjen e demokracisë dhe vëzhgimin nga organizatat ndërkombëtare. Po ashtu kërkohet një konferencë paqej e cila pritej të mbahej në shkurt të vitit 1999 në kështjellën Château de Rambouillet, jashtë Parisit, në Francë.

## Kërcënimi i Kërshëndellave i Presidentit Bush, 22 dhjetor 1992 dhe kërcënimi i Presidentit Clinton 1993 (vija e kuqe amerikane)

Shtetet perëndimore në fillim përpiqeshin që në Kosovë të mos shpërthente konflikti i armatosur dhe të zbutet represioni serb, i cili kishte për qëllim ndryshimin e strukturës së popullsisë në Kosovë me anë të spastrimit etnik. Me qëllim që ky konflikt latent të evitohet deri në zgjidhjen definitive të çështjes së Kosovës, kryetari i Republikës së Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, parashtrroi një plan veprimi prej 10 pikash, ndër të tjera, kërkoi që Kosova të vihej nën protektoratin e

---

<sup>9</sup> Millosheviqi krijon realitetin e tij, <https://iwpr.net/sq/global-voices/millosheviqi-krijon-realitetin-e-tij>

<sup>10</sup> Po aty.

OKB-së dhe të ndërmerren masat e duhura në pajtim me këtë akt. Këtë plan të Rugovës e mbështeti edhe Republika e Shqipërisë.

Pikërisht në momentet kur çështja e Kosovës u bë shqetësim për nivelet e veçanta e të përbashkëta ndërkombëtare, kur një konfiguracion i ri etnik e politik u krijua në territorin e ish-Jugosllavisë, sekretari i NATO-s, gjenerali Manfred Vërner, paralajmëronte Serbinë kundër përpjekjeve për spastrim etnik të shqiptarëve nga Kosova dhe nënvizonte se “një zgjerim i luftërave drejt Kosovës dhe një luftë ballkanike duhet të ndalet me çdo çmim”. Kurse ish-presidenti Xhorxh Bush paralajmëroi udhëheqjen serbe në dhjetor të vitit 1992 që ShBA-ja mund ta përdorën forcën në qoftë se Serbia shtrin luftën në Kosovë. Mesazhi i Bushit indirekt thoshte që “në rast të konfliktit në Kosovë të shkaktuar nga serbët, ShBA-ja do të përgatitet t’i përdorë forcat ushtarake në Kosovë dhe Serbi kundër serbëve”<sup>11</sup>. Jo rastësishtë 16 vjet më voni, i biri i Presidentit Bush, Presidenti George W. BUSH (Republikan) do të deklaronte: “Mjaft është mjaft... Kosova do të jetë e pavarur”<sup>12</sup>, Kështu kishte deklaruar Bush gjatë vizitës së tij historike në Tiranë, duke përcaktuar qartë si kristali statusin final të Kosovës dhe duke i dhënë përfundimin efektiv të duhur negociatave të Vjenës (Tiranë, 10 qershor 2007). Deklarata e Presidentit Bush në Tiranë më 10 qershor 2007,<sup>13</sup> përfundimisht, nuk lanë asnjë dilemë se Kosova me ose pa mbështetjen e OKB-së do të shpallte pavarësinë<sup>14</sup>.

Presidenti 41 i ShBA-së, George H. W. Bush, nëpërmjet një letre drejtuar Millosheviqit, më 25 dhjetor 1992, do të paralajmëronte regjimin serb se SHBA-ja do të intervenojë ushtarakisht në Kosovë nëse Serbia nis luftën. Kështu thuhej në letrën që njihet si “Kërcënimi i Kërshëndellave”. Pra, porosia ishte e qartë për të gjithë, veçanërisht për Millosheviqin. “ShBA-ja, në kuadër të konfliktit në Kosovë, shkaktuar nga aksionet e Serbisë, do jenë të gatshme të përdorin forcë ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe Serbi”, thuhej në letrën e presidentit Bush drejtuar Millosheviqit, i cili kishte shpallur zgjedhjet, pasuar nga

<sup>11</sup> Faton Bislimi, gjashtë presidentë amerikanë e mbi tri dekada përkushtim për Kosovën, <https://www.ekonomia.info/sq/opinion/gjashte-presidente-amerikane-e-mbi-tri-dekada-perkushtim-per-kosoven>

<sup>12</sup> Po aty.

<sup>13</sup> *Bush is greeted warmly in Albania - The New York Times*. (n.d.). Retrieved December 8, 2021, from <https://www.nytimes.com/2007/06/10/world/europe/10cnd-prexy.html>.

<sup>14</sup> *Bush is greeted warmly in Albania - The New York Times*. (n.d.). Retrieved December 8, 2021, from <https://www.nytimes.com/2007/06/10/world/europe/10cnd-prexy.html>.

paralajmërimi i dytë i Shtëpisë së Bardhë, menjëherë pas një viti, në shkurt të vitit 1993.



Një muaj më vonë, përkatësisht më 21 janar 1993, edhe Bill Clintoni në fjalimin e tij të përirimit për president të ShBA-së, në mënyrë indirekte ia dërgon këtë mesazh Millosheviqit: “Çdo herë që interesat tona kërcënohen, ose kurdoherë që vullneti dhe ndërgjegjja e bashkësisë ndërkombëtare përbuzet, ne do të veprojmë me diplomaci paqësore kur është e mundur, me forcë kur është e nevojshme”.

Kështu, për herë të parë që nga Lufta e Dytë Botërore, në vitet '90 koncepti humanitar fitoi epërsinë mbi konceptin e “interesave të shtetit”, të “integritetit tokësor”, “të sovranitetit absolut”, të mbrojtur nga e drejta ndërkombëtare. Kjo ishte një risi shumë pozitive me rrjedhime të paparashikuara, por pa dyshim përparimtare dhe e mirëseardhur.

Bota e re filloi kështu një epokë, në të cilën gjykimi dhe ndërgjegjja e opinionit ndërkombëtar po konkretizohen me një të drejtë ligjore ndërkombëtare, që inkurajon “veprime të përbashkëta” në “kuadër të OKB-së”, kundër “shteteve sovrane” që sfidojnë këtë gjykim dhe ofendojnë këtë ndërgjegje, kundër luftërave civile e eksodit dhe urisë masive, kundër gjenocidit etj. Këto ndodhën kur u shua “bota dypolare” apo e “dy superfuqive”, kur ShBA-ja mbeti e vetmja superfuqi e aftë për të formuar dhe drejtuar koalicionet për përballimin e situatave ekstreme. Si rrjedhim, me gjithë dëshirën e shumë qeverive të Evropës

Perëndimore që ShBA-ja ta luajë rolin e “policit ndërkombëtar”, këtë superfuqi koha e “dënoi” që ta marrë përsipër rolin udhëheqës në krijimin e një rendi të ri botëror.

Dy deklaratat e dy presidentëve të ShBA-së, Xhorxh Bush dhe Bill Klinton, dëshmojnë se koncepti i “sovrانيتit” do të kalojë në një fazë transitore për arsye të përparësisë që fiton respekti për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos garancia e jetës së lirë. Ky qëndrim inkurajoi popujt e pushtuar-robëruar, pra edhe popullin shqiptar, ta kërkojë me këmbëngulje të drejtën e vetëvendosjes, duke përfshirë edhe pavarësinë e plotë, si mjet i fundit për ndalimin e shkeljes së të drejtave individuale dhe kolektive.

Nga pikëpamja e sigurimit të paqes ndërkombëtare edhe koncepti i mosndërhyrjes në punët e brendshme pësoi ndryshim me rastin e Kosovës, sepse përvoja tregoi se lufta në Kosovë paraqet kërcënim për paqen botërore dhe se imperativi i ruajtjes së paqes imponon si zgjidhje të fundit mundësinë e intervenimit. Rendi i ri botëror imponoi përdorimin e forcës për probleme të reja, siç janë: mbrojtja e një shteti demokratik, mbrojtja e të drejtave të njeriut për grupe të gjera popullsive nga shkeljet e rënda, katastrofat njerëzore: si uria masive, anarkia, eksodi i pafund, pastrimi etnik me anë të dhunës, katastrofat humanitare etj. dhe ndalimi i luftës vëllavrasëse shkatërrimtare.

ShBA-ja, por edhe Britania e Madhe dhe ato shtete që kanë qenë të interesuara për ta nxjerrë Kosovën pa kaluar nëpër përvojën e Bosnjës, janë munduar vazhdimisht të krijojnë parakushte për këtë. Janë munduar që problemin e Kosovës ta zgjidhin shkallë-shkallë, duke i amortizuar pengesat e shteteve, si: Rusia, Kina etj.

Pas të gjitha këtyre zhvillimeve, është e kuptueshme edhe prania e kontingjentit të forcave të huaja në Maqedoni qysh në vitin 1992. Fillimisht i njohur me emrin “Forcat e UNPROFOR-it”. Në përbërje të këtyre forcave ishin dy batalione, të njohura shkurt US-bat (Batalioni amerikan) dhe Nord-bat (Batalioni nordik). Me fillimin e luftës në Kosovë më 1998 institucionet ndërkombëtare dhe shtetet aleate të Paktit të NATO-s e përforcuan praninë e tyre ushtarake në Maqedoni. Në të njëjtën kohë edhe qeveria shqiptare, zyrtarisht kërkonte asistencë ushtarake të huaj, së pari të NATO-s në kuadër të formulës “partneriteti për paqe” (partnership for peace).

Presidenti i 41-të i ShBA-së, George H. W. Bush, nëpërmjet një letre drejtuar Millosheviçit, më 25 dhjetor 1992, do të paralajmëronte regjimin serb se ShBA-ja do të ndërhyjë ushtarakisht në Kosovë nëse

Serbia nis luftën. Presidenti George H. W. Bush: “Në rast të një konflikti në Kosovë të shkaktuar nga veprimet serbe, Shtetet e Bashkuara janë të gatshme të përdorin forcën ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe në Serbi,” thuhej në letrën e Presidentit Bush dërguar Millosheviqit më 25 dhjetor 1992, ndryshe e njohur botërisht si “Kërcënimi i Kërshëndellave.”<sup>15</sup> Ky është momenti kur Serbisë i vendoset vija e kuqe amerikane në Kosovë. Kështu thuhej në letrën që njihet si “Kërcënimi i Kërshëndellave”. Pra, porosia ishte e qartë për të gjithë, veçanërisht për Millosheviçin. “ShBA-ja, në kuadër të konfliktit në Kosovë, shkaktuar nga aksionet e Serbisë, do jetë e gatshme ta përdorë forcën ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe Serbi”, thuhej në letrën e presidentit Bush drejtuar Millosheviqit, i cili kishte shpallur zgjedhjet, pasuar nga paralajmërimi i dytë i Shtëpisë së Bardhë, menjëherë pas një viti, në shkurt të vitit 1993. “Ne jemi të përgatitur për t’iu përgjigjur serbëve në rast të një konflikti në Kosovë të shkaktuar nga aksionet e Serbisë”, deklaronte kryediplomati amerikan, Warren Christopher, saktësisht më 13 shkurt 1993 – rifuqizim i porosisë së presidentit Bush dhe për më shumë, një deklaratë me peshë historike për rolin amerikan në çlirimin e Kosovës nga Serbia<sup>16</sup>.

Në artikullimin e “Kërcënimit të Kërshëndellave” kontribuoi edhe ambasadori amerikan, Robert Gelbard, i cili shërbeu si përfaqësues special i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor. Në mars të vitit 1998, në pyetjen nëse porosia e presidentit Bush vlente akoma pas rikonfigurimit të administratës amerikane, ai ishte përgjigjur: “Politika e ShBA-së nuk ka ndryshuar<sup>17</sup>”.

Gjashtë vjet më vonë, në vitin 1999, presidenti i 42-të i ShBA-ve, Bill Clinton, do ta realizonte porosinë. Në fakt, Sekretarja e Shtetit, Madeleine Albright, në përpjekje për të arritur një qëndrim të unifikuar të administratës amerikane rreth Kosovës, shpesh do t’ia rikujtonte presidentit Clinton zotimin e presidentit Bush në dhjetor të vitit 1992.

“Koha për t’i ndaluar vrasjet është tani, para se të përhapen. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është të ndërmerren veprime të menjëhershme kundër regjimit në Beograd”, deklaronte Albright më 8

---

<sup>15</sup> Faton Bislimi, gjashtë presidentë amerikanë e më shumë se tri dekada përkushtim për Kosovën, <https://www.ekonomia.info/sq/opinion/gjashte-presidente-amerikane-e-mbi-tri-dekada-perkushtim-per-kosoven>

<sup>16</sup> Kërcënimi i Kërshëndellave”: 31 vjet nga porosia e bushit që betonizoi angazhimin amerikan ndaj Kosovës, <https://albanianpost.com/kercenimi-i-kershendellave-plot-31-vjet-nga-porosia-e-presidentit-bushit/>

<sup>17</sup> Ibid.

mars 1998. Për shfeten e diplomacisë amerikane, bombardimi i Serbisë ishte kthyer në një mision shumë personal, përtej angazhimit diplomatik në zgjidhjen e konfliktit.

Ky zotim, krahas premtimit të presidentit Clinton, dhënë delegacionit kosovar, nën drejtimin e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe presidentit historik, Ibrahim Rugova, në maj të vitit 1998, që ShBA-ja nuk do të lejonte që në Kosovë të përsëritet Bosnja e Hercegovina, vlerësohen të kenë peshën e dy vendimeve kapitale për angazhimin amerikan në Kosovë<sup>18</sup>. Për fatin e madh të gjithë shqiptarëve, Kosova ishte “vija e kuqe” e durimit amerikan. Ndryshe do të kishte luftë! Presidenti i përmbyesjes së komunizmit, Xhorxh Bush, i ati, kushtëzonte me përdorimin e forcës çdo aventurë të Millosheviqit me paralajmërimin e famshëm të Krishtlindjeve të vitit 1992. “Shkelni në Kosovë dhe do të keni luftë”! E drejta morale, forca dhe fati bënë që një dekadë e gjysmë më pas, një tjetër president amerikan, Xhorxh Bushi, i biri, të paralajmëronte dhe të jetësonte pavarësinë e Republikës së Kosovës<sup>19</sup>.



*William Walker, pas Masakrës së Reçakut, tha “kjo është masakër dhe është krim kundër njerëzimit”.*

---

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> Lorenc Vangjeli: vija e kuqe për shqiptarët, <https://shqiptarja.com/lajm/lorenc-vangjeli-vija-e-kuqe-per-shqiptare>

Mendoj se sakrificat e bëra në Reçak nga njerëzit atje, ajo çfarë u ka ndodhur atyre, thellësisht e ka ndryshuar çështjen e Kosovës, nga të qenit një provincë e neglizhuar në atë që është sot; një shtet i pavarur”, pohoi Walker-i.

“Besoj sinqerisht, se masakra serbe e Reçakut, për arsye të ndryshme ka çuar në ndërhyrjen e NATO-s, në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ka pasur faktorë të ndryshëm në atë që ka ndodhur, por pas disa viteve të informatave dhe dëshmisë që Sllobodan Millosheviqi po e trajtonte popullatën shqiptare në mënyrë barbare, është mundësuar ndërhyrja e NATO-s”. Walker-i ka treguar se komuniteti ndërkombëtar nuk ishte i një mendjeje për ndërhyrjen në Kosovë, por ai pas ardhjes në Kosovë dhe pasi kishte parë gjendjen e rëndë këtu, kishte njoftuar komunitetin ndërkombëtar për krimin masiv që kryente ushtria serbe. “Ndërkombëtarët nuk kanë qenë të unifikuar”.

Pas kësaj deklaratë, Beogradi e shpalli ambasadorin Walker person të padëshirueshëm, ndërsa nuk lejoi hyrjen në Kosovë të ish- prokurores së Gjykatës Ndërkombëtare për Krime Lufte në hapësirat e ish-Jugosllavisë, Louise Arbour. Masakra e Reçakut shënoi fillimin e një fushate të re diplomatike në përpjekje për t'i dhënë fund luftës dhe më 6 shkurt përfaqësuesit e Kosovës dhe të Serbisë u takuan në Rambouillet të Francës, në bisedimet e ndërmjetësuar nga bashkësia ndërkombëtare.

Serbia edhe sot e kësaj dite mohon masakrën e Reçakut dhe dhjetëra masakra të tjera duke i quajtur ato si inskenime dhe si “të pavërteta”, si konstruksione politike dhe si një alibi për intervenimin e NATO-s në Kosovë.<sup>20</sup> Sipas “The Washington Post”, e cila, artikullin e bazonte në përgjime telefonike të shteteve perëndimore, sulmi në Reçak ishte kryer me urdhër nga Beogradi, nga Nikolla Shainoviq, njeriu më i besuar i Sllobodan Millosheviqit. “Në telefonatat gjatë ditëve në vijim, Shainoviqi dhe Llukiqi shprehën shqetësimin për reagimin ndërkombëtar dhe diskutuan se si t'i bënin vrasjet të dukeshin si rezultat i një beteje të ashpër. Përpjekjet e tyre për të mbuluar atë që ndodhi vazhduan...Një masë për të cilën Shainoviqi avokoi në bisedat e tij ishte mbyllja e kufirit të Kosovës me Maqedoninë për të parandaluar hyrjen e Louise Arbour, një hetuese e lartë e OKB-së për krimet e luftës. Arbour u kthye mbrapsht. Një tjetër kërkesë ishte që trupat e Ministrisë

---

<sup>20</sup> Shih më gjerë, për mohimin e Masakrës së Reçakut ^"Masakra e Reçakut, ngjarja që bëri botën të kthejë kokën nga Kosova". Radio Televizioni Shqiptar. 15 janar 2019. Arkivuar nga origjinali më 15 janar 2019. ^"Masakra e Reçakut e 15 janarit, turpi i madh i Serbisë". Kultplus.com. 12 janar 2019..^"Serbia mohon masakrën e Reçakut-MPJ publikon fotografitë e kryesve të krimit". Insajderi.com. 7 dhjetor 2019.

së Brendshme të luftonin për të rimarrë kontrollin e vendit të vrasjeve për të rimarrë trupat” shkruante gazeta<sup>21</sup>. “Ishte një mision kërkimi dhe shkatërrimi” me miratim të qartë në Beograd, tha burimi. Ndërsa zjarri i tankeve dhe i artilerisë dhe muhabeti i mitralozave jehon në kodrat përreth Raçakut, sipas burimeve perëndimore, Shainoviqi e thirri Llukiqin nga Beogradi. Shainoviqi ishte i vetëdijshëm se sulmi ishte duke u zhvilluar dhe ai donte që gjenerali t’i tregonte atij se sa njerëz ishin vrarë. Llukiq u përgjigj se në atë moment numri ishte 22, thanë burimet. Në telefonatat gjatë ditëve në vijim, Shainoviqi dhe Lukiqi shprehën shqetësimin për reagimin ndërkombëtar dhe diskutuan se si t’i bënin vrasjet të dukeshin si rezultat i një beteje të ashpër. Përpyekjet e tyre për të mbuluar atë që ndodhi vazhduan, thanë burimet perëndimore.<sup>22</sup>

Masakra e Raçakut si një prej krimeve më monstruoze ndaj popullsisë civile<sup>23</sup>, ku u vranë më shumë se katërdhjetë civilë të pafajshëm, ishte një moment për alarmimin e botës demokratike për nevojën e pashtyeshme të intervenimit në Kosovë për të parandaluar një gjenocid, ndër më të mëdhenj në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Thirrja që ambasadorit amerikan William Woker i bëri botës për të intervenuar urgjent në Kosovë, sipas Serbisë, është një inskenim, një komplot për ta gjunjësuar Serbinë në fushatën gjenocidale që ajo zhvillonte në Kosovë. Jo rastësisht Serbia e shpalli “*Person Non Grata*” ambasadorin William Woker duke e akuzuar atë për një konstruksion ndaj shtetit serb dhe duke e depërtuar dhunshëm nga territori i Kosovës<sup>24</sup>.

## Konferenca e Rambujesë

Gjenocidi serb në Kosovë, i cili manifestohej në forma të ndryshme të dhunës dhe masakrimit të shqiptarëve, riktheu interesimin e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë dhe nevojën e pashlyeshme për një zgjidhje të shpejtë politike të luftës. Në këtë kontekst, masakra e Raçakut dhe gjykimi i drejtë i saj, nga ambasadori i OSBE-së në Kosovë, Uoker, ishte ngjarje kyçe, e cila ndikoi në thirrjen e një Konference Paqësore Ndërkombëtare për Kosovën, në Rambuje të Francës.

<sup>21</sup> R. Jeffrey Smith 28 Janar 1999, The Washington Post, 28 janar 1999

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Masakra e Raçakut-krim kundër njerëzimit, bot.Fondi i Kompleksit Përkujtimor Masakra e Raçakut, Shtime 2004

<sup>24</sup> Me 19 janar 1999-Ministri i jashtëm i RFJ,. Zivadine Jovanovic shpalli Ambasadorin William Walker, "persona non grata", <https://www.osce.org/cio/52376>

Konferenca ndërkombëtare paqësore për Kosovën u mbajt në Rambuje dhe Paris prej 6 deri me 23 shkurt dhe prej 15 deri më 18 mars 1999, në kohën kur kriza në Kosovë kishte përshkallëzuar në një luftë të përgjakshme me rrezik për t'u shtrirë edhe jashtë kufijve të Kosovës. Konferenca paraqiste përpjekjen e fundit politike për ndaljen e luftës dhe gjenocidit serb kundër shqiptarëve, vendosjen e Kosovës nën protektoratin e NATO-s, krijimin e një statusi kalimtar për Kosovën dhe evitimin e rrezikut potencial që kërcënonte paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Konferenca ishte organizuar nga i ashtuquajtimi Grup i Kontaktit dhe në Konferencë mori pjesë delegacioni shqiptar, ai serbo-jugosllav dhe pala ndërkombëtare, ku bënë pjesë anëtarët e Grupit të Kontaktit dhe shumë shtete evropiane. Delegacioni shqiptar përfaqësohej nga subjektet e atëhershme politike dhe përfaqësuesit e UÇK-së, si dhe nga ekspertët e pavarur. Delegacioni serbo-jugosllav përfaqësohej nga zyrtarët e lartë serbë dhe nga anëtarët lojalë të politikës së regjimit serb. Konferenca kryesohej nga tre bashkëkryesues Kristofer Hill nga ShBA-ja, Volfang Petriç nga Këshilli i Evropës dhe Boris Majorski nga Federata Ruse<sup>25</sup>.

Procesi negociator në Rambuje zhvillohej mbi bazën e Projekt-marrëveshjes së Rambujesë, përkatësisht Projektmarrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë, të cilën e kishte përgatitur Grupi i Kontaktit.



---

<sup>25</sup> Stephen T. Hosmer, "Why Milosevic Decided to Settle when He Did", Prepared for the United States Air Force, 2001, pp.8-16.

Konferenca e Rambujesë krijoi një partneritet historik midis Perëndimit dhe Kosovës, midis NATO-s dhe UÇK-së, midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Bashkimit Evropian dhe Kosovës në rrugën e lirisë dhe në rrugën drejt pavarësisë. Shikuar nga prizmi i sotëm, Konferenca e Rambujesë, në fakt, ka qenë krijimi i një partneriteti strategjik me bashkësisnë ndërkombëtare, i cili ka bërë një revolucion në të drejtën ndërkombëtare, duke afirmuar të drejtën e vetëvendosjes përkundrejt teorisë sovjetike të integritetit territorial.

Konferenca e Rambujesë synonte arritjen e një marrëveshjeje juridike dhe politike për zgjidhjen e krizës në Kosovë, duke përcaktuar një zgjidhje kalimtare që parashihte vendosjen e Kosovës nën mbrojtjen e NATO-s, të mundësonte një vetadministrim të përkohshëm për Kosovën në periudhën trevjeçare dhe të hapte mundësinë e zhvillimit të një procesi politik për përcaktimin e statusit final për Kosovën. Konferenca parashihte një proces negociues të palës shqiptare dhe serbe për marrëveshjen politike, të cilën e propozonin ndërmjetësuesit ndërkombëtarë. Me gjithë përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar, në këtë Konferencë nuk kishte kontakte të drejtpërdrejta shqiptaro-serbe, për shkak të refuzimit të delegacionit shqiptar për t'u takuar me palën serbe. Në Konferencë dominonin dy qasje dhe koncepte. Qasja e delegacionit shqiptar, që ishte konstruktive dhe kooperative me faktorin ndërkombëtar dhe qasja e dytë serbe destruktive dhe joserioze, e cila bënte obstrukcion në arritjen e kësaj marrëveshjeje dhe përjashtonte çdo opsion të ndarjes së Kosovës nga Serbia dhe të vendosjes së saj nën administrimin ndërkombëtar. Konferenca, krahas negociatorëve politikë ndërkombëtarë udhëhiqej dhe përgatitej nga ekspertët amerikanë, të cilët ishin hartues të të gjitha drafteve që diskutoheshin në Konferencë. Në fund të pjesës së parë të Konferencës në Rambuje, në punimet e saj u inkuadrua në mënyrë aktive edhe zonja Madeleine Albright (Medlin Olbrajt), Sekretare e Jashtme e shtetit amerikan, e cila i ofroi ndihmë të konsiderueshme delegacionit kosovar.

Pas dështimit të Konferencës në Rambuje filluan përgatitjet intensive të NATO-s për fillimin e aksioneve ushtarake kundër Serbisë, në bazë të planit të përgatitur më herët dhe të aprovuar nga NATO-ja. Këto bombardime ajrore filluan më 24.03.1999 dhe zgjatën plot 78 ditë, për të rezultuar me fitoren e plotë të NATO-s dhe kapitullimin e Serbisë. Krahas fillimit të bombardimeve të caqeve serbe nga ana e NATO-s, Millosheviqi dha urdhër që forcat e veta në Kosovë të fillonin një fushatë terrori, e cila kaloi për nga përmasat, ashtu edhe për nga shpejtësia

më të cilën u krye, edhe vetë spastrimin etnik që ai kreu në Bosnjën Lindore dhe Veriore gjatë vitit 1992.<sup>26</sup>

Fushata e bombardimeve ajrore të NATO-s zgjati nga 22 mars deri 11 qershor 1999, ku u përfshinë diku rreth 1,000 avionë që kanë operuar kryesisht nga bazat në Itali dhe nga anijet detare luftarake dhe transportuse avionësh të vendosur në detin Adriatik. Të gjithë anëtarët e NATO-s kanë qenë të përfshirë në një farë mase në këtë intervenim të NATO-s, edhe Greqia, pavarësisht nga kundërshtimi i saj publik ndaj këtyre sulmeve. Gjatë dhjetë javëve të konfliktit, aeroplanët e NATO-s fluturuan dhe realizuan më shumë se 38.000 misione luftarake. Për Forcat Ajrore Gjermane (Luftwaffe)<sup>47</sup>, kjo ishte hera e parë që kishin marrë pjesë në një konflikt që prej Luftës së Dytë Botërore.

Lufta e përbashkët e UÇK-së dhe e NATO-s rezultoi me çlirimin e territorit të Kosovës dhe largimin e plotë të forcave policore militare dhe paramilitare dhe atyre ushtarake, si dhe me largimin nga Kosova të administratës së dhunshme civile të Serbisë. Intervenimi i NATO-s në Kosovë, para së gjithash, ishte i një natyre humanitare, por i njëjti duhet shikuar edhe në kontekstin gjeopolitik. Në historikun e NATO-s rasti i intervenimit të Kosovës është i një relevance të jashtëzakonshme si në aspektin dinamik, po ashtu edhe në kuptim të pozicionimeve të reja të sigurisë ndërkombëtare. Ishte intervenim historik për NATO-n edhe për nga forma, natyra dhe gjeografia, si dhe aspekti kohor, meqë ndodhi për herë në parë që nga ekzistimi i Aleancës duke qenë kështu intervenimi i parë ushtarak i saj. Ky intervenim ndodhi vetëm disa javë para shënimit të 50 -vjetorit të themelimit të Aleancës Veri-Atlantike. Ndërkohë që duke ndodhur në kapërcyell mes dy shekujve shërbeu si rast unik në konceptualizimin e politikave të shekullit XXI të NATO-s<sup>27</sup>. Me intervenimin në Kosovë NATO-s shkoi përtej misionit të vet të Luftës së Ftohtë. Kështu që intervenimi në fjalë mund të konsiderohet se ka krijuar një profil të ri për NATO-n në kuptim të rolit, kapaciteteve dhe misionit të vet të ardhshëm evolues. Njëpërmjet intervenimit në Kosovë në 50-vjetorin e vet Aleanca ia arriti që të japë një mesazh të fuqishëm në kuptim të natyrës së intervenimit humanitar përballë pengesave të së drejtës ndërkombëtare. Me këtë u dha mesazhi për

---

<sup>26</sup> Neol Molcolm, "Të drejtat e Kosovës", botuar në librin Lufta kundër luftës, Tiranë, 2001, fq, 96.

<sup>27</sup> Ky është një fragment nga libri i Prof. dr. Veton Latifit, me titull "Ballkani në Marrëdhëniet Ndërkombëtare bashkëkohore". Titulli i origjinalit "The Balkans in Contemporary International Relations" botuar nga Universiteti i Varshavës, 2021

potencialin e NATO-s në shekullin XXI në kuptim të rreshtimit të forcave në sistemin e sigurisë globale.<sup>28</sup>

Fillimi i fushatës së bombardimeve të NATO-s ndaj Serbisë hapi debatet në lidhje me legalitetin, shkaqet dhe qëllimet e luftës, efektivitëtin e fushatës së NATO-s, si dhe çështjet e tjera që lidheshin me promovimin e një doktrine të re ushtarake dhe me krijimin e rendit të ri ndërkombëtar. Këto debate dhe polemika buronin në faktin se ky ishte aksioni i parë ushtarak që ndërmoi NATO-ja në historinë e saj pesëdhjetëvjeçare pa mandatin formal të Këshillit të Sigurimit të OKB-së kundër një shteti sovran dhe përmasat e tij ishin shumë më të mëdha se ato të ndërmarra në Bosnjë, e cila çoi në përfundimin e luftës dhe arritjen e Marrëveshjes së Dejtonit më 1995<sup>29</sup>.

NATO-ja e nisi fushatën ajrore me qëllim që të parandalonte një katastrofë humanitare: vrasjen dhe dëbimin e shqiptarëve të Kosovës, si dhe të ruante sigurinë rajonale duke i imponuar Beogradit planin e paqes për Kosovën në Rambuje. Megjithatë, efekti imediat i sulmeve ajrore ishte i kundërt; ato përshpejtuan operacionet e spastrimit etnik nga forcat serbe, rezultati i të cilave ishte largimi dhe deportimi i rreth 1 milion shqiptarëve të Kosovës për në Shqipëri, në ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në Mal të Zi dhe në shumë shtete evropiane. Depërtimi i refugjatëve dhe dyndja e tyre shtoi nga ana e saj edhe rrezikun e mundshëm të destabilizimit social të vendeve pritëse, fakt ky që e shtyu NATO-n të angazhonte burimet e veta për operacionet humanitare<sup>30</sup>.

Fillimi i bombardimeve të NATO-s, si dhe lufta çlirimtare që bënte UÇK-ja, ndikuan që Serbia, e përballur me humbjen e luftës, të fillojë aksione ndëshkuese ndaj popullsisë civile duke masakruar dhe me qindra civilë, fëmijë, gra dhe pleq dhe duke ushtruar një gjenocid të paparë që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Më të filluar bombardimet nga NATO-ja, Serbia filloi implementimin e planit të përgatitur më parë në qarqet e saja kuazishkencore për spastrimin etnik në Kosovë, një prej krimeve më të lemerishme kundër njerëzimit që janë kryer gjatë këtij shekulli, i krahasueshëm për nga natyra, edhe pse jo për nga numri, me Holokaustin e hebrenjve të realizuar nga Hitleri.

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Shih më shumë: Gordon N. Bardos, “*Balkan History, Madeleine’s War, and NATO’s Kosovo*”, *Journal of the North American Society for Serbian Studies* 15(1): 77–102, 200, pp. 96-100.

<sup>30</sup> Gabriel Partos, “*Kosova-mënyra të reja për të ndalur në konflikt të vjetër*”, botuar në librin, *Lufta kundër luftës*, Tiranë, 2001, fq.102.

Në anën tjetër, udhëheqja e komanduar nga Millosheviçi e nisi luftën me shpresën se uniteti i 19 vendeve anëtare të NATO-s do të cenohej seriozisht po të zmadhoheshin humbjet e NATO-s dhe bombardimi të shkaktonte një numër të madh të viktimave civile. Megjithëse uniteti i NATO-s kaloi një provë të vështirë dhe nuk pati për pasojë ndalimin e as uljen e intensitetit të goditjeve ajrore. Përkundrazi, NATO-ja filloi dislokimin e forcave tokësore në rajon para se Beogradi të pranonte një marrëveshje, dhe kjo bëri që lufta të zgjatë 11 javë, duke shkatërruar një pjesë të caqeve ushtarake dhe civile të Serbisë në Kosovë dhe Serbi dhe duke pasur për pasojë një numër të madh të viktimave civile.

Sulmet e NATO-s kishin një motiv të lartë moral. Ky motiv bazohej në moslejimin e spastrimit etnik në Evropë në prag të shekullit XXI, si dhe ndaljen e një katastrofe të thellë humanitare. NATO-ja u vu në mbrojtje të parimeve të të drejtave të njeriut, të cilat kanë përparësi edhe në raport me sovranitetin e shteteve. Pikërisht kjo, e bëri të ligjshëm sulmin e saj ndaj Federatës Jugosllave, qoftë edhe pa mandatin e OKB-së<sup>31</sup>.

Me gjithë legjitimitetin e aksionit të NATO-s kundër Serbisë, ky aksion vu përballë kritikave nga drejtimet e ndryshme. Disa thanë se NATO-ja nuk duhej të vepronte si xhandar ndërkombëtar, duke ndërhyrë pa mandatin e qartë të Kombeve të Bashkuara kundër një shteti sovran. Në anën tjetër, një numër i madh i ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare kanë mbrojtur legalitetin e ndërhyrjes, me qëllim të parandalimit të katastrofës humanitare dhe shpëtimit të jetës së njerëzve. Baza juridike sipas këtyre ekspertëve është përcaktuar në Kaptinën VII të Kartës së OKB-së. Pas rënies së komunizmit në Evropë është mjaft i përhapur koncepti se një nga funksionet parësore të shteteve është mbrojtja, dhe jo persekutimi i qytetarëve dhe i çdo njeriu që jeton brenda kufijve të tyre. Kjo doktrinë e re është në pajtim me tendencën e krijimit të rendi të ri ndërkombëtar dhe me teorinë e sovranitetit të kufizuar shtetëror që filloi të promovohet me luftën në Kosovë dhe që mund të jetë një preventivë për luftërat e tjera në baza etnike.

Krahas bombardimeve të NATO-s, UÇK-ja arriti t'u kundërvihet sulmeve serbe dhe sadopak të mbrojë popullsinë civile që kishte ngelur në Kosovë. Për më tepër, UÇK-ja i shkaktoi mjaft humbje armikut dhe,

---

<sup>31</sup> Shih gjerë: Gordon N. Bardos, "Balkan History, Madeleine's War, and NATO's Kosovo", *Journal of the North American Society for Serbian Studies* 15(1): 77–102, 200, fq.96-100.

e ndihmuar nga sulmet ajrore të NATO-s, fitoi shumë beteja dhe çliroi disa territore. Megjithatë, forcat serbe vranë dhe masakruan më shumë se 10.000 civilë shqiptarë, dogjën më tepër se 100.000 shtëpi, shkatërruan dhe plaçkitën pasurinë e shqiptarëve dhe morën si pengje dhe robër të luftës një numër të madh të shqiptarëve, për fatin e të cilëve as sot e kësaj dite nuk dihet asgjë. E ballafaquar me sulmet ajrore të NATO-s dhe luftën çlirimtare të UÇK-së, Serbia ndërmori represaliet më brutale ndaj popullatës civile shqiptare me ç'rast shkeli në mënyrë flagrante Konventat e Gjenevës, të cilat përcaktojnë të drejtën e luftës.

E ballafaquar me humbjen e sigurt të luftës, Serbia pranoi kapitullimin e saj dhe nënshkroi Marrëveshjen Tekniko-ushtarake, të ashtuquajturën Marrëveshje e Kumanovës, e cila përcaktonte detajet teknike dhe ushtarake të tërheqjes së forcave policore dhe ushtarake të Serbisë nga Kosova dhe vendosjen e forcës së sigurimit ndërkombëtar (KFOR) në Kosovë.

## Ndërhyrja e NATO-s dhe çlirimi i territorit të Kosovës

Pas dështimit të Konferencës në Rambuje, filluan përgatitjet intensive të NATO-s, për fillimin e aksioneve ushtarake kundër Serbisë, në bazë të planit të përgatitur më herët dhe të aprovuar nga NATO-ja. Këto bombardime ajrore nisën me dt. 24.03.1999 dhe zgjatën plot 78 ditë, për të rezultuar me fitoren e plotë të NATO-s dhe kapitullimin e Serbisë. Krahas fillimit të bombardimit të caqeve serbe nga ana e NATO-s, Millosheviqi dha urdhër që forcat e veta në Kosovë të fillonin një fushatë terrori, e cila kaloi për nga përmasat, ashtu edhe për nga shpejtësia më të cilën u krye, edhe vetë spastrimin etnik që ai kreu në Bosnjën Lindore dhe Veriore gjatë vitit 1992<sup>32</sup>.

Lufta e përbashkët e UÇK-së dhe NATO-s, rezultoi me çlirimin e territorit të Kosovës dhe largimin e plotë të forcave policore militare dhe paramilitare dhe atyre ushtarake, si dhe me largimin nga Kosova të administratës së dhunshme civile të Serbisë.

Fillimi i fushatës së bombardimeve të NATO-s ndaj Serbisë, hapi debatet në lidhje me legalitetin, shkaqet dhe qëllimet e luftës, efektivitetin e fushatës së NATO-s, si dhe çështjet e tjera që lidheshin me promovimin e një doktrine të re ushtarake dhe me krijimin e rendit të ri ndërkombëtar. Këto debate dhe polemika buronin në faktin, se ky ishte

---

<sup>32</sup> Neol Molcolm, "Të drejtat e Kosovës", botuar në librin Lufta kundër luftës, Tiranë, 2001, fq.96.

aksioni i parë ushtarak që ndërmori NATO-ja në historinë e saj pesëdhjetëvjeçare pa mandatin formal të Këshillit të Sigurimit të OKB-së kundër një shteti sovran; dhe përmasat e tij ishin shumë më të mëdha se ato të ndërmarra në Bosnjë, e cila çoi në përfundimin e luftës dhe arritjen e Marrëveshjes së Dejtonit më 1995<sup>33</sup>.

NATO-ja e nisi fushatën ajrore me qëllim që të parandalonte një katastrofë humanitare, vrasjen dhe dëbimin e shqiptarëve të Kosovës, si dhe të ruante sigurinë rajonale duke i imponuar Beogradit planin e paqes për Kosovën në Rambuje. Megjithatë, efekti imediat i sulmeve ajrore ishte i kundërt; ato përshpejtuan operacionet e spastrimit etnik nga forcat serbe, rezultati i të cilave ishte largimi dhe deportimi i rreth 1 milion shqiptarëve të Kosovës për në Shqipëri, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në Malin e Zi dhe në shumë shtete evropiane. Depërtimi i refugjatëve dhe dyndja e tyre shtoi nga ana e saj edhe rrezikun e mundshëm të destabilizimit social të vendeve pritëse, fakt ky që e shtyu NATO-n të angazhonte burimet e saja për operacionet humanitare<sup>34</sup>.

Fillimi i bombardimeve të NATO-s, si dhe lufta çlirimtare që bënte UÇK-ja, ndikuan që Serbia e përballur me humbjen e luftës, të fillojë aksione ndëshkuese ndaj popullsisë civile, duke masakruar dhe me qindra civilë, fëmijë, gra dhe pleq dhe duke ushtruar një gjenocid të paparë që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Më të filluar të bombardimeve të NATO-s, Serbia filloi implementimin e planit të përgatitur më parë në qarqet e saja kuazishkencore për spastrimin etnik në Kosovë, një prej krimeve më të lemerishme kundër njerëzimit që janë kryer gjatë këtij shekulli, i krahasueshëm për nga natyra, edhe pse jo nga numri, me Holokaustin e hebrenjve të realizuar nga Hitleri.

Në anën tjetër, udhëheqja e komanduar nga Millosheviqi e nisi luftën me shpresën se uniteti i 19 vendeve anëtare të NATO-s do të cenohej seriozisht po të zmadhoheshin humbjet e NATO-s dhe bombardimi të shkaktonte një numër të madh të viktimave civile. Megjithëse uniteti i NATO-s kaloi një provë të vështirë, dhe nuk pati për pasojë ndalimin e as uljen e intensitetit të goditjeve ajrore. Përkundrazi, NATO-ja filloi dislokimin e forcave tokësore në rajon para se Beogradi të pranonte një marrëveshje; dhe kjo bëri që konflikti të zgjatë 11 javë,

---

<sup>33</sup> Shih më shumë: Gordon N. Bardos, “*Balkan History, Madeleine’s War, and NATO’s Kosovo*”, *Journal of the North American Society for Serbian Studies* 15(1): 77–102, 200, fq.96-100.

<sup>34</sup> Gabriel Partos, “*Kosova-mënyra të reja për të ndalur në konflikt tëvjetër*”, botuar në librin *Lufta kundër luftës*, Tiranë, 2001, fq.102.

duke shkatërruar një pjesë të caqeve ushtarake dhe civile të Serbisë në Kosovë dhe Serbi dhe duke pasur për pasojë një numër të madh të viktimave civile.

Sulmet e NATO-s kishin një motiv të lartë moral. Ky motiv bazohej në moslejimin e spastrimit etnik në Evropë në prag të shekullit njëzetënjë, si dhe ndaljen e një katastrofe të thellë humanitare. NATO-ja u vu në mbrojtje të parimeve të drejtave të njeriut, të cilat kanë përparësi edhe në raport me sovranitetin e shteteve. Pikërisht kjo e bën të ligjshëm sulmin e saj ndaj Federatës Jugosllave, qoftë edhe pa mandatin e OKB-së<sup>35</sup>.

Me gjithë legjitimitetin e aksionit të NATO-s kundër Serbisë, ky aksion vu përballë kritikave nga drejtimet e ndryshme. Disa thanë se NATO-ja nuk duhej të vepronte si xhandar ndërkombëtar, duke ndërhyrë pa mandatin e qartë të Kombeve të Bashkuara kundër një shteti sovran. Në anën tjetër, një numër i madh i ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare kanë mbrojtur legalitetin e ndërhyrjes, me qëllim të parandalimi të katastrofës humanitare dhe shpëtimit të jetës së njerëzve. Baza juridike sipas këtyre ekspertëve është përcaktuar në Kaptinën VII të Kartës së OKB-së. Pas rënies së komunizmit në Evropë është mjaft i përhapur koncepti se një nga funksionet parësore të shteteve është mbrojtja dhe jo persekutimi i qytetarëve dhe i çdo njeriu që jeton brenda kufijve të tyre. Kjo doktrinë e re është në pajtim me tendencën e krijimit të rendit të ri ndërkombëtar dhe me teorinë e sovranitetit të kufizuar shtetëror që filloi të promovohet me konfliktin në Kosovë dhe që mund të jetë një preventivë për konfliktet e tjera në baza etnike.

Krahas bombardimeve të NATO-s, UÇK-ja arriti t'u kundërvihet sulmeve serbe dhe sado pak të mbrojë popullsinë civile që kishte ngelur në Kosovë. Për më tepër, UÇK-ja i shkaktoi mjaft humbje armikut dhe e ndihmuar nga sulmet ajrore të NATO-s fitoi shumë beteja dhe çliroi disa teritore. Megjithatë, forcat serbe vranë dhe masakruan më shumë se 10.000 civilë shqiptarë, dogjën më shumë se 100.000 shtëpi, shkatërruan dhe plaçkitën pasurinë e shqiptarëve dhe morën si pengje dhe robër të luftës një numër të madh të shqiptarëve, për fatin e të cilëve as sot e kësaj dite nuk dihet asgjë. E ballafaquar me sulmet ajrore të NATO-s dhe luftën çlirimtare të UÇK-së, Serbia ndërmori represaliet

<sup>35</sup> Shih më shumë: Gordon N. Bardos, "Balkan History, Madeleine's War, and NATO's Kosovo", *Journal of the North American Society for Serbian Studies* 15(1): 77–102, 200, fq.96-100.

më brutale ndaj popullatës civile shqiptare me ç'rast shkeli në mënyrë flagrante Konventat e Gjenevës, të cilat përcaktojnë të drejtën e luftës.

E ballafaquar me humbjen e sigurt të luftës, Serbia pranoi kapitullimin e saj dhe nënshkroi Marrëveshjen Tekniko-ushtarake të ashtuquajturën Marrëveshje e Kumanovës, e cila përcaktonte detajet teknike dhe ushtarake të tërheqjes së forcave policore dhe ushtarake të Serbisë nga Kosova dhe vendosjen e forcës së sigurimit ndërkombëtar (KFOR) në Kosovë.

## Diskutimet kontraverse për bazën ligjore të bombardimeve

Prej vitit 1999 e deri në ditët e sotme vazhdon debati lidhur me sulmet ajrore kundër Jugosllavisë (Serbisë) për çlirimin e Kosovës. Ndërsa para 15 vjetësh diskutimi kontravers u soll rreth legjitimitetit të ndërhyrjes ushtarake për zgjidhjen e krizës në Kosovë; sot ky debat nxitet më së shumti në rastin e krizave të ndryshme në botë. Dilema lidhet me dy çështje, nëse NATO-ja veprimi në Kosovë në përshtatje me ligjet ndërkombëtare të së drejtës ose jo. Dhe çështja e dytë, nëse Kosova po përdoret ose keqpërdoret si precedent nga kundërshtarët e ndërhyrjes së NATO-s për çlirimin e saj. Kundërshtarët e NATO-s dhe të sulmeve ajrore kanë arsyetuar se më 24 mars të vitit 1999 Aleanca e Atlantikut nuk respektoi të drejtën ndërkombëtare. Sipas tyre, kjo ndodhi për shkak të mungesës së një vendimi të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, vendim që mungoi pasi Kremlini vuri veton e tij kundër këtyre sulmeve. Sigurisht që mungesa e vendimit të Këshillit të Sigurimit krijoi një vakuum ligjor, e dobësoi legjitimitetin e ndërhyrjes ushtarake në këtë vend. Por kundërshtarët e ndërhyrjes në Kosovë e shfrytëzuan këtë fakt për t'u konfrontuar me gjithë procesin e vendosjes së paqes në Kosovë dhe në rajonin e Evropës Juglindore. Ata synuan në radhë të parë të kundërshtojnë politikën paqebërëse të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nëse reagimet kritike i vështrojmë nga pikëpamja politike, atëherë vëmë re se kundërshtarët e luftës së NATO-s në Kosovë ishin të gjithë ekstremistët e majtë e të djathtë, të cilët gjithnjë kundërshtojnë praninë amerikane në Evropë. Nisur nga kjo, pati jo pak studiues, të cilët këto sulme i quajtën si "Luftë imperialiste për vendosjen e një rregulli të ri në botë". Pati nga ata që sulmet e NATO-s kundër makinerisë ushtarake serbe i konsideruan "të parin agresion të NATO-s kundër një vendi sovran". Disa të tjerë angazhimin ushtarak në Kosovë e konsideruan si konkretizim të doktrinës Clinton të shpallur në vitin 1993, sipas së cilës "Interesat dhe ideali ynë na detyron jo vetëm të veprojmë, por edhe të udhëheqim.

Kritikët e quajtën atë shkelje të së drejtës ndërkombëtare civile, sepse nuk pati një mandat të posaçëm të Këshillit të Sigurimit dhe se NATO-ja po vepronte jashtë territorit të vendeve të Aleancës, duke cenuar integritetin territorial të Jugosllavisë.<sup>36</sup>

Përkrahësit e sulmit mendonin, se ato legjitimoheshin prej një së-rë rezolutash të Këshillit të Sigurimit, si dhe paaftësisë së tij për të kërkuar me forcë zbatimin e tyre. Edhe pse OKB-ja kishte kërkuar prej Beogradit tërheqjen e trupave dhe përfundimin e luftimeve, regjimi Millosheviqit nuk iu përgjigj atij.

Edhe sot e kësaj dite, 23 vjet pas fushatës së bombardimeve të NATO-s në Kosovë, në qarqe ndërkombëtare, sidomos në debate publike ka diskutime kontraverse për bazën ligjore të bombardimeve të NATO-s në Kosovë. Legjitimiteti i fushatës së bombardimeve të NATO-s në Kosovë ka qenë objekt i shumë debateve politike e diplomatike në mbarë globin. NATO-ja për fillimin e bombardimeve ajrore nuk kishte mbështetjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për shkak të kundërshtimit nga anëtarët e përhershëm të saj qe

<sup>36</sup> Intervenimi i NATO-s në Kosovë në vitin 1999 ka qenë temë e diskutuar dhe e analizuar nga shumë autorë, dhe disa libra ofrojnë kritika ndaj këtij operacioni ushtarak. Ja disa tituj të njohur që mund të përfshijnë kritika ndaj intervenimit të NATO-s: 1. "The Kosovo War: A Military History" - James D. C. S. Houghton\*\*: Ky libër analizon aspektet ushtarake të luftës në Kosovë dhe ofron një vështrim kritik për arsyetimin dhe strategjitë pas sulmit të NATO-s.. 2. "NATO's Secret Warfare: Operation Gladio and the "Stay-behind" Armies" - Daniele Ganser\*\*: Ky libër heton operacionet sekrete të NATO-s dhe ofron një kontekst më të gjerë lidhur me intervenimet e saj, duke përfshirë Kosovën, dhe kritikon praktikën e saj..3. "The Kosovo Crisis: The Lasting Effects of NATO's Intervention" - David Campbell\*\*: Autori analizon pasojat e intervenimit të NATO-s, duke e trajtuar atë si një akt të diskutueshëm që ka pasur efekte të thella në stabilitetin dhe politikën e rajonit.4. "The New Military Humanism: Lessons from Kosovo" - David Rieff\*\*: Ky libër kritikon përdorimin e konceptit të "humanitarizmit" si justifikim për ndërhyrje dhe ofron një analizë të thellë të pasojave të intervenimit të NATO-s në Kosovë.5. "War and Revolution in Yugoslavia, 1941-1992" - V. D. Kostić\*\*: Edhe pse fokusi kryesor është te periudha e Luftës së Dytë Botërore dhe pasardhësit e saj, libri diskuton ndikimin e ndërhyrjeve të jashtme, përfshirë ato të NATO-s në Kosovë.6. "Humanitarian Intervention: Legal and Political Dimensions" - Aidan Hehir\*\*: Ky libër ofron një analizë të hollësishme të aspekteve ligjore dhe politike të ndërhyrjeve humanitare, duke përfshirë atë në Kosovë, dhe argumenton përballë rezultateve të tilla. Këta libra ofrojnë perspektiva të ndryshme dhe kritike ndaj intervenimit të NATO-s në Kosovë, duke eksploruar implikimet e tij ushtarake, politike dhe sociale. Përveç këtyre titujve, është gjithashtu e dobishme të shikoni artikuj akademikë, ese dhe analiza nga studiues të ndryshëm për të pasuruar kuptimin tuaj mbi këtë temë komplekse.

ishin shumë të lidhur me Jugosllavinë, në veçanti Rusia, e cila kundërshtonte fuqishëm çdo interevnim të NATO-s në konfliktin në fjalë. Kritika ruse dhe e shumë aleatëve të Jugosllavisë ishte projektuar në faktin se karta e NATO-s përcakton se NATO-ja është një organizatë e krijuar për mbrojtjen e anëtarëve të saj, dhe në këtë rast ajo po përdorej për të sulmuar një vend jo të NATO-s, i cili nuk kërcënonte drejtpërdrejt ndonjë anëtar të NATO-s. NATO-ja deklaronte se jostabiliteti në Ballkan ka qenë një kërcënim i drejtpërdrejtë për interesat e sigurisë së anëtarëve të NATO-s, dhe në këtë formë ajo justifikonte veprimin ushtarak, ndërsa i vetmi vend anëtar i NATO-s, për të cilin veprimet jugosllave nuk paraqitnin kërcënim të drejtpërdrejtë për jostabilitet në Ballkan ishte Greqia, e cila i kundërshtoi bombardimet edhe pse mori vetë pjesë në to. Aksioni i NATO-s ndodhi pas shumë paralajmërimeve të NATO-s dhe pasi Beogradi kishte injoruar thirrjet e OKB-së, angazhimet e Grupit të Kontaktit, të OSBE-së dhe të emisarëve të tjerë ndërkombëtarë. Millosheviqi tregojë konfrontues dhe arrogant me Perëndimin dhe krejt hapur deklaronte se ishte i gatshëm të shkelte mbi trupat e shqiptarëve të Kosovës, duke iu referuar eksperiencës së komunistëve jugosllavë në fund të Luftës së Dytë Botërore. Me një fjalë, Beogradi nuk mori në konsideratë mjetet joushtarake të Perëndimit. Prandaj, NATO-ja nga pranvera e vitit 1998, e deri në fillim të vitit 1999, shteroi të gjitha instrumentet joushtarake efektive. Përfaqësuesit kryesorë të NATO-s imagjinuan se, si përpara Marrëveshjes së Dejtonit, ashtu edhe tani vetëm disa goditje ajrore do të ishin të mjaftueshme për të arritur këtë qëllim. Kjo pritje shkoi paralelisht me dëshirën që problemi i Kosovës të përfundojë me sukses përpara takimit jubilar të NATO-s në Washington më 24 prill 1999. Prandaj, mendohet se ka pasur një presion shtesë kohor për fillimin e fushatës para këtij samiti.

E theksuam edhe më herët se rendi ndërkombëtar i viteve nëntëdhjetë bazohet në teorinë e sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve dhe kishte vendosur disa kufizime sa u përket intervenimeve ndërkombëtare të NATO-s në shtete sovrane të cilat ishin anëtare fuqiplote të OKB-së. Por ky rend ndërkombëtar, filloi të shembej pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe ndarjes bipolare të botës, kur filloi procesi i globalizimit dhe krijimit të sistemit të sigurisë kolektive dhe kur NATO-ja fitoi të drejtën e intervenimit humanitar kurdo dhe kudo që shkelen të drejtat e njeriut, zbatohen politikat e spastrimit etnik dhe veprimet e tjera gjenocidale.

## Koncepti humanitar për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë

E drejta humanitare ndërkombëtare ushtron një sërë kufizimesh, rreth mënyrës së bërjes së një luftime, të cilat, njihen ndryshe edhe si ligjet e luftës.

Me fillimin e bombardimeve të NATO-s më 24 mars 1999, konflikti në Kosovë dhe në të gjithë Republikën Federale të Jugosllavisë, në atë shkallë që përfshinte forcat serbe dhe ato jugosllave, u shndërrua në një konflikt të armatosur ndërkombëtar, i cili lypte aplikimin e të gjithë korpusit të së drejtës zakonore humanitare. Protokollin I shtesë i Konventave të Gjenevës të vitit 1949, ofron bazat për të bërë vlerësimin e bombardimit të NATO-s. Ky protokoll është ratifikuar nga pjesa më e madhe e vendeve anëtare të NATO-s, si dhe qeveria e Shteteve të Bashkuara, teksa as edhe një vend palë, nuk ka deklaruar se s'pranon të gjithë standardet e rëndësishme të tij. Parimi themelor i Protokollit I, si dhe të ligjeve të luftës në përgjithësi, është *se popullsia civile, ashtu si dhe çdo civil individ duhet të gëzojnë mbrojtjen e të gjitha palëve të angazhuara në konflikt, kundrejt rreziqeve që paraqesin operacionet ushtarake*. Kjo ka të bëjë në një pjesë të konsiderueshme me kërkesën se, pala që ndërmerr sulmin duhet të bëjë dallimin midis civilëve dhe trupave të armatosura, si dhe midis objektivave ushtarake dhe atyre civile. Pala sulmuese, pra, duhet të marrë të gjitha masat mbrojtëse të mundshme në mënyrë që të shmangë ose të minimizojë viktimat dhe dëmet kundrejt civilëve, ndaj dhe duke pasur këtë gjë parasysh, nuk mund të sulmojë popullsinë civile drejtpërdrejt, ose trupat ushtarake dhe popullsinë civile pa bërë një dallim të qartë midis tyre.

Dëmet ndaj objektivave civile dhe viktimat e shaktuara në radhët e civilëve që janë rastësore përgjatë sulmeve të përligjura kundrejt objektivave ushtarake, njihen në terminologjinë ushtarake si “dëme anësore”. Ligjshmëria e një sulmi lypset të marrë parasysh një sërë faktorësh. E para, pala sulmuese duhet të bëjë gjithçka të mundur për të verifikuar që ata synojnë diçka specifike – kësisoj, ata s'mund të godasin qorrazi. E dyta, pala sulmuese duhet të përcaktojë qartë se, objektivi që do të sulmohet është një objektivi i ligjshëm ushtarak. Dhe e treta, pala sulmuese duhet të përcaktojë qartë nëse, sulmi që ajo do të ndër-marrë vë në rrezik popullsinë civile dhe objekte civile, si dhe të peshojë gjithë rreziqet e mundshme kundrejt përfitimit ushtarak që mund të ketë. Sulmet që mendohet se mund të shkaktojnë humbje aksidentale jetësh ose lëndime të ndryshme në radhët e popullsisë civile, apo mund

të shkaktojnë dëmtime të objekteve civile, konsiderohen si sulme të kryera pa bërë dallim, në qoftë se dëmet e shkaktuara kundrejt civilëve janë “të tejskajshme në raport me përfitimet konkrete dhe të drejt-përdrejta ushtarake të parashikuara” (Protokolli I, neni 572 ). Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC), autoriteti kryesor për të bërë interpretimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare, ka paralajmëruar se argumenti i proporcionalitetit nuk mund të përligjë kurrsesi numrin e lartë të viktimave në radhët e popullsisë civile ose të dëmtimit të objekteve civile, cilido qoftë përfitimi i parashikuar ushtarak.

Në hulumtimin e çdonjërit prej incidenteve me pasojë vdekjen e civilëve gjatë luftës në Kosovë, Human Rights Watch u rrek të mbledhë fakte që u mundësojnë analistëve të kryejnë vlerësimin e legjitimitetit të goditjeve mbi objektivat ushtarake reale ose të perceptuara si të tilla; kujdesi i treguar si dhe procedurat dhe kriteret e ndjekura për të vërtetuar natyrën ushtarake të objektivave; proporcionalitetin e vdekjes së civilëve dhe mjetet e përdorura në sulmet kundrejt objektivave ushtarake, të njohura si të tilla; korrelacioni midis vdekjes së civilëve në vendngjarje dhe natyrës së objektivit të përzgjedhur; kohëmatja në përzgjedhjen e objektivit, si faktor të domosdoshëm për minimizimin e viktimave dhe dëmeve kundrejt popullsisë civile; metodat dhe kushtet në të cilat është vënë në përdorim çdo sistem i caktuar armësh; dhe, potencialisht, natyra e përzgjedhjes pa bërë kurrfarë dallimi të disa sisteme të caktuara të armëve në përgjithësi, si dhe në disa kushte të caktuara.

Në vlerësimin e sulmeve të veçanta sipas Human Rights Watch, duke i hedhur një sy vëzhgimeve, humbjet më dramatike të jetës së civilëve nga ofensiva e NATO-s në Kosovë, erdhën prej sulmeve ndaj karvanëve të refugjatëve ose personave në ikje e sipër, të marrë gabimisht për trupa ushtarake të NATO-s. Një rëndësi të dorës së parë është se, a iu kushtua vëmendja e duhur mbrojtjes së civilëve. A u mor sa e si duhet parasysh mundësia e vdekjes së civilëve në përcaktimin e objektivave, armëve të vëna në përdorim, si dhe mjetet dhe kushtet në të cilat këto armë shkuan e u përdorën? Kjo do të thotë që lypset hedhur një sy përzgjedhjes së objektivave dhe procedurave përmes të cilave kaloi përcaktimi i tyre, gjë që i tejkalon kompetencat e këtij raporti. Kësisoj, gjithçka shkon e përmblihet në një pyetjeje të madhe, a ishin brenda për brenda asaj çka konsiderohet e lejueshme në kuadër të ligjeve humanitare, objektivat ushtarake të identifikuar dhe të goditur nga trupat e NATO-s? Analiza që do të vijojë, trajton aspektet e luftës ajrore në Kosovë, e parë kjo vetëm në këndin e kostos në jetë civilësh,

si një faktor bazë në vlerësimin e kuadrit të madh në përputhje me të drejtën humanitare ndërkombëtare.

## Debatet pro dhe kundër intervenimit të NATO-s në Kosovë

Në shumë konferenca ndërkombëtare anë e mbanë botës, në të cilat është debatuar për bazën juridike të intervenimit të NATO-s në Kosovë, janë shprehur opinione kontraverse rreth legalitetit të këtij intervenimi. Kryesisht kemi dy qasje në raport me këtë çështje:

**Qasja klasike e sovranitetit territorial** të shteteve që bazohen në parimet e së drejtës ndërkombëtare klasike të modelit sovjetik, sipas së cilës NATO-ja nuk mund të bombardojë apo ndërhyjë në sovranitetin e asnjë shteti anëtar të OKB-së pa marrjen paraprake të pëlqimit të Këshillit të Sigurimit, me të cilin autorizohet ky intervenim. Kjo doktrinë e ka origjinën në periudhën e Luftës së Ftohtë dhe bazohet në parimin e mosndërhyrjes në punët e brendshme, integritetin dhe sovranitetin territorial dhe të drejtën e secilit shtet që të zgjidhë konfliktet e brendshme. Ithtarët e kësaj teorie bazoheshin në faktin se gjoja Kosova ishte një çështje e brendshme, nuk ishte një shtet i pavarur dhe sovran, ishte çështje e brendshme e Serbisë dhe se çfarëdo intervenimi i NATO-s do të cenonte integritetin territorial të këtij shteti. Fatkeqësisht këto opinione kanë qenë të përhapura në një pjesë të komunitetit juridik ndërkombëtar dhe janë shprehur në shumë konferenca kushtuar legalitetit të intervenimit të NATO-s në Kosovë, madje edhe nga ekspertët juridikë të shteteve që kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Akoma edhe sot e kësaj dite shkruhen punime, libra dhe artikuj të ndryshëm, në të cilat mendohet që me intervenimin e NATO-s në Kosovë është cenuar rendi juridik ndërkombëtar dhe është cenuar sovraniteti dhe integriteti territorial i një shteti sovran. Serbia ka zhvilluar një fushatë politike dhe mediale, duke kontestuar ligjshmërinë e intervenimit të NATO-s në Kosovë dhe duke trajtuar atë si një agresion në sovranitetin territorial të këtij shteti.<sup>37</sup> Edhe sot e kësaj dite, pushteti aktual serb ka homogjenizuar opinionin publik serb me teorinë se bombardimet e NATO-s

---

<sup>37</sup> Intervenimi i NATO-s në Kosovë ka qenë subjekt i kritikave të shumta, si nga ekspertët e politikës ndërkombëtare, ashtu edhe nga politikanë dhe organizata të ndryshme. Disa nga kritikant kryesorë përfshijnë: 1. Legjitimiteti Ndërkombëtar: Një nga kritikant kryesorë ishte mungesa e një mandati të qartë nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për ndërhyrjen. Disa analistë argumentuan se intervenimi në Kosovë shkelte normat e tanishme ndërkombëtare, duke i hapur rrugë një precedenti të rrezikshëm për ndërhyrjet e ardhshme. 2. Pasojat humanitare: Edhe

kanë shkelur ligjin ndërkombëtar, sovranitetin e saj dhe mbi bazën e kësaj qasjeje Serbia çdo vit, në datën e fillimit të bombardimeve mban manifestime të ndryshme me të cilat shënon këtë ditë, si ditë të agresionit të NATO-s ndaj saj. Kontestimet e tilla të intervenimit të NATO-s në Kosovë vijnë edhe nga Rusia, Kina dhe disa shtete të tjera që mbajnë qëndrim refuzues ndaj pavarësisë së Kosovës dhe paraqesin kritika ndaj NATO-s, duke e quajtur këtë fushatë bombardimesh si shkelje të ligjit ndërkombëtar.

Në përgjithësi kjo kategori shpreh mendimin se “demokracia dhe të drejtat e njeriut nuk mund të rrënojnë të drejtën shtetërore dhe sovranitetin e shteteve”. Në të gjitha këto raste kemi të bëjmë me shumë me një reagim antiamerikan dhe kundër NATO-s, ndërkohë në kritikën përkatëse shohim pak arsyetim nëse u respektua ose jo Karta e OKB-së. Madje antiamerikanizmi i disa ekspertëve shkon deri te instrumentalizimi i qëllimeve të ShBA-së, duke e lidhur veprimin në Kosovë me përpjekjet për të zotëruar e kontrolluar burimet e gazit e të naftës në Kaspik. Dhe në të gjithë këtë diskurs bie në sy fakti se në kritikën kundër NATO-s për sulmet ajrore kundër Jugosllavisë (Serbisë), nuk gjen në asnjë rast një qëndrim kritik sa i përket dhunës e terrorit serb në

---

pse intervenimi kishte për qëllim të ndihmonte në mbrojtjen e civilëve nga krimet e luftës, disa kritikë argumentuan se bombardimet e NATO-s patën pasoja të rënda humane. Civilët u vranë si pasojë e sulmeve ajrore dhe dëmet në infrastrukturë, duke përfshirë objekte të rëndësishme për jetën civile, si spitale dhe shkolla.<sup>3</sup> Dëmet Materiale dhe Ambientale: Intervenimi solli dëme të konsiderueshme materiale, duke përfshirë shkatërrimin e shumë shtëpive dhe infrastrukturave të tjera. Po ashtu, përdorimi i armëve me uran të pasuruar shkaktoi shqetësime për ndotjen mjedisore dhe mundësinë e rrezikut për shëndetin e popullsisë.<sup>4</sup> Mungesa e një Plani për Pasluftën: Kritikët argumentuan se NATO-ja dhe komuniteti ndërkombëtar nuk patën një plan të qartë për pasluftën, çka rezultoi në probleme të mëdha në menaxhimin e pasojave, ndihmën humanitare dhe krijimin e institucioneve të qëndrueshme. 5. Sfidat e Stabilitetit Rajonal: Disa analistë e panë intervenimin si një faktor që kontribuoi në destabilizimin e disa vendeve të tjera në rajon, duke rritur tensionet etnike dhe politike. Kritikat sugjerojnë se intervenimi mund të ketë nxitur nacionalizmin dhe ndarje të mëtejshme në Ballkan.<sup>6</sup> Përjashtimi i Diplomacisë: Disa kritikë nënvizuan se NATO-ja zgjodhi të intervenonte ushtarakisht në vend që të vazhdonte negociatat diplomatike, duke e parë intervenimin si një dështim të politikës së jashtme në zgjidhjen e konfliktit përmes mjeteve paqësore.<sup>7</sup> Perceptimi i Barazisë së Standardeve: Të tjerët e kritikuan intervenimin si një shembull të dy standardeve në politikat ndërkombëtare, duke theksuar se ndërhyrjet ushtarake janë shpesh të drejtuara nga interesa strategjike, dhe nuk janë gjithmonë të afërta me ndihmën humanitare. Këto kritika paraqesin vetëm disa nga shqetësimet e ngritura lidhur me intervenimin e NATO-s në Kosovë, i cili mbetet një temë e diskutueshme në historinë e politikës ndërkombëtare dhe marrëdhënieve përgjithëse.

Kosovë. Përkundrazi, kritikët e luftës në Kosovë e shohin atë si manipulim propagandistik me qëllim justifikimin e ndërhyrjes ushtarake për zgjidhjen e konfliktit. Për këtë kategori kritikësh masakra e Reçakut dhe terrori e dhuna serbe në Kosovë ishin një sajese për të justifikuar ndërhyrjen ushtarake. Gjithashtu vihet re se kritikët e ndërhyrjes së Aleançës së Atlantikut në Kosovë përdorën si arsyetim të kritikës së tyre disa tregues që nuk kanë lidhje me të drejtën ndërkombëtare, si p.sh. llogaritë e shpenzimeve të luftës, dëmet në shëndetin e njerëzve e të mjedisit e deri te konstatimet e paprovuara për përdorimin e armëve të ndaluara. Të tjerë kritikë përdorën si argument “dobësimin e opozitës serbe përballë Milosheviqit”. Dhe shumica prej tyre thanë se ndërhyrja ushtarake në Kosovë do të ishte shkak i zgjerimit të konfliktit në rajon, madje pati prej tyre që valën e refugjatëve shqiptarë e shpjeguan me bombardimet e NATO-s. Ndërkaq, thujse të gjithë iu referuan faktit që mungoi një mandat nga ana e Këshillit të Sigurimit për të autorizuar veprimin ushtarak. Në të vërtetë, mungesa e mandatit nga ana e Këshillit të Sigurimit e dobësoi nga pikëpamja e argumentit të së drejtës ndërkombëtare ndërhyrjen ushtarake në Kosovë. Por unë mendoj se ky fakt nuk e delegjitimoi atë. Sipas nenit 51 e 52 të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit është organi kompetent, i cili autorizon ndërhyrjen ushtarake kundër një vendi sovran. Karta e OKB-së, e ratifikuar në vitin 1945 në Konferencën e San Franciskos, ia dha këtë të drejtë Këshillit të Sigurimit, duke u garantuar anëtarëve të përhershëm të këtij Këshilli të drejtën e vetos.

Derisa shtetet ishin unike për angazhimin e tyre me karakter humanitar, mbizotëronte dilema për bazën ligjore. Që në fillim, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe e vlerësuan të lejueshëm përdorimin e forcës, për shkak të rrezikut të një “katastrofe humanitare” dhe mundësisë e ndikimit të saj në stabilitetin e rajonit të Ballkanit. Presidenti amerikan Bill Clinton në fjalimin e tij mbajtur gjatë vizitës së trupave amerikane në Shkup, më 21 qershor 1999, deklaroi: “Ne, mund t’u themi njerëzve në botë, kudo që jetoni, në Afrikë, në Evropën Qendrore, apo kudo tjetër, në rast se dikush përndjek qytetarë të pafajshëm dhe përpiqet t’i vrasë në masë, për shkak të racës, përkatësisë etnike, apo besimit të tyre, e nëse kjo është në fuqinë tonë për ta ndaluar, ne do ta ndalojmë.”<sup>38</sup>

---

<sup>38</sup> Presidenti Bill Clinton, fjalim për forcat e KFOR-it, Shkup, 22 qershor 1999



*“Është dita e kthesës së madhe për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, është dita e një vendimi dhe sulmi me vlerë historike, jo vetëm për Kosovën që të çlirohej njëherë e përgjithmonë nga sundimi ushtarako-politor i Serbisë së Millosheviqit, por edhe me peshë shumë e më të gjerë për ndryshimet gjeostrategjike që do të ndodhnin më pas në Ballkanin dhe rajonin me vendosjen e forcave të NATO-s në Kosovë dhe përreth saj”.*

Afirmimi i doktrinës së ndërhyrjes humanitare shprehet qartë sidomos në suksesin e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në luftën e Kosovës. Menjëherë pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s, më 10 qershor 1999, Kryeministri i atëhershëm britanik, Toni Bler, shpalli misionin e Kosovës si një fitore “progresive” në politikën e jashtme, duke zëvendësuar konceptet e vjetruara tradicionale: “Kjo luftë u zhvillua për një parim themelor të nevojshëm për përparim të njerëzimit: që çdo qenie njerëzore, pavarësisht nga raca, feja apo lindja gëzon një të drejtë të patjetërsueshme për të jetuar i lirë nga persekutimi.”<sup>39</sup>

---

<sup>39</sup> Kryeministri Toni Bler, fjalim pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s kundër Jugosllavisë, Londër, 10 qershor 1999.



*“Vendimi për sulmet e NATO-s kundër caqeve ushtarake serbe, "kishte efekte më të gjera sesa vetëm çlirimi i popullit të Kosovës". "Nëse do të kishim lejuar që populli i Kosovës të brutalizohej edhe më tutje, që të drejtat t'i merreshin dhe që e ardhmja t'i vidhej, edhe e ardhmja jonë do të zbehej", tha Blair.*

Ndërhyrjen ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur e kishte parë si të domosdoshme edhe kancelari i atëhershëm i Gjermanisë, Gerhard Schröder, i cili përgjegjësinë për këtë konfrontim të Perëndimit me qeverinë e Milosheviqit e adreson te politika e tij agresive, tek ideja për vazhdimin e brutalitetit dhe terrorit sistematik kundër popullsisë shqiptare në Kosovë dhe synimit për cenimin e sigurisë rajonale. Në deklaratën e qeverisë federale gjermane, kancelari Schröder deklaronte se NATO-ja dhe vendet anëtare po luftojnë në Kosovë për të drejtat e njeriut, për liri dhe për demokraci, duke shtuar se qëllim i këtij angazhimi mbetet se si duhet të duket Evropa në shek. XXI, pas dy përvojave tragjike që përjetoi bota në shek. XX. “Ne dëshirojmë që sa më shpejt t’i japim fund katastrofës humanitare dhe shkeljes sistematike të të drejtave të njeriut. Ne dëshirojmë të arrijmë një zgjidhje politike për Kosovën”, theksonte 29 Presidenti Bill Clinton, fjalim për forcat e KFOR-it, Shkup, 22 qershor 1999. 30 Kryeministri Toni Bler, fjalim pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s kundër Jugosllavisë, Londër, 10 qershor 1999. Ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë: rast precedent... 209 Schröder.<sup>40</sup>

<sup>40</sup> Erklärung Bundeskanzler Gerhard Schröder zur Lage im Kosovo, Bonn, 24.04.1999. Burimi: Pressemitteilung Nr. 111/99 vom 24. März 1999

Duke folur për zgjedhjet jugosllave, Klinton tha se, -"ata (populli serb) do të duhet të shohin se çka ka bërë dhe po vazhdon të bëjë z. Millosheviq në Kosovë... ata do të duhet të vendosin nëse mbështesin udhëheqjen e tij apo jo, nëse ata mendojnë se është në rregull që të gjithë ata dhjetëra e mijëra njerëz që u vranë...". Klinton gjithashtu shtoi, po në të njëjtën konferencë për shtyp, se - "NATO-ja, me intervenimin e saj donte të ndalte përpjekjet sistematike për spastrim etnik dhe gjenocid."

Klintoni krahasonte ngjarjet në Kosovë me ato të Holokaustit. CNN kishte njoftuar duke e akuzuar Serbinë për 'spastrimit etnik' në Kosovë, të ngjashme me gjenocidin ndaj hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore. Presidenti Klinton kërkoi mbështetje publike për vendimin e tij për të dërguar forcat amerikane në luftë kundër Jugosllavisë, një perspektivë që dukej gjithnjë e më e mundshme me ndarjen e një përpjekje diplomatike të paqes.<sup>41</sup>



### **Ish-Sekretarja amerikane e Shtetit, Madalene Albright,**

*“Presidenti Clinton donte të sigurohej që Kosova do jetë e sigurt. Në natën kur nisën bombardimet më thirri në mes të natës dhe më tha Medllin avionët u nisën, ne po e bëjmë veprimin e duhur. Unë ia ktheva po zotëri President pajtohem plotësisht me ju”.*

---

<sup>41</sup> Lufta dhe Inter ufta dhe Intervenimi i Nat enimi i Nato-s në K o-s në Kosovë Edona Bislimi University for Business and Technology – UB, 2010, fq.30

## Doktrina e intervenimit humanitar

Doktrina e dytë juridike dhe politike arsyeton fushatën e bombardimeve të NATO-s, duke e konsideruar atë si legjitime dhe të domosdoshme për të ndaluar gjenocidin, spastrimin etnik dhe veprimet e tjera të shkeljes së të drejtave individuale dhe kolektive, mbi bazën e Kapitullit VII të Kartës së OKB-së që i mundëson NATO-s intervenime humanitare në tërë globin.<sup>42</sup> Ndërkaq, ish- kryeministri italian, Masimo D'Alema, theksonte motivin etik dhe idealin për një rend ndërkombëtar të themeluar mbi të drejtat e njeriut, që si vlerë tejkalonte edhe sovranitetin kombëtar. “Ishte një luftë e re, që nuk kishte shpërthyer nga qëllimet territoriale ose nga vullneti i forcës. Ne nuk donim që të push-tonim Ballkanin, por që të afirmonim një ideal të një rendi ndërkombëtar të themeluar mbi të drejtat e njeriut, mbi lirinë dhe tolerancën. Një vlerë kaq e fortë sa kapërcente madje edhe sovranitetin kombëtar.”<sup>43</sup>

Doktrina e intervenimit humanitar bazohet në të drejtën ndërkombëtare moderne, të reformuar, që deplason teorinë e sovranitetit absolut shtetëror, parandalon shtetet të kryejnë gjenocid, spastrim etnik dhe krime të tjera makabre dhe i mundëson NATO-s të mbrojë të drejtat universale të popujve kudo që ato shkelen. Legjitimiteti i intervenimit të NATO-s në Kosovë është i pakontestueshëm për faktin se gjenocidi paraqet krimin më të rëndë kundër njerëzimit dhe se ai nuk duhet të tolerohet nga bota demokratike, por duhet të parandalohet në mënyrë që të gjitha shteteve të botës t’u dërgohet një mesazh i qartë se ato do të ballafaqohen me reagime të fuqishme ushtarake, politike dhe gjyqësore, sa herë që ndërmarrin veprime dhe krime gjenocidale. Bazuar në këtë, diskutimet kontraverse për bazën ligjore të bombardimeve janë diskutime që kohë pas kohe shërbejnë për të diskutuar të drejtën e kësaj organizate që të intervenojë edhe në kriza të tjera humanitare anë e mbanë botës. Kjo çështje është shtruar edhe në disa raste të tjera, duke përfshirë edhe rastin e agresionit aktual të Rusisë në Ukrainë, dhe duke e marrë shembull rastin e Kosovës si precedent për intervenimin e NATO-s ndaj shteteve të tjera. Eksperti i së drejtës ndërkombëtare, Aigul Taskushina, i cili në librin e tij “Die humanitäre Intervention am Beispiel des NATO-Einsatzes im Kosovo” merret ekskluzivisht me

---

<sup>42</sup> Shih më gjerë për intervenimin humanitar të NATO-s në Kosovë “Joachim Krause (Hrsg), Kosovo Humanitare Intervention und Kooperative Sicherheit in Europa, Opladen, 2000.

<sup>43</sup> M. D'Alema, Kosova: Italianët dhe lufta..., f. 98

përligjien e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, nocionin e “intervenimit humanitar” e përkufizon si vijon: “Një intervenim humanitar – pavarësisht nga ligjshmëria e tij, nëse bëhet me përdorimin e forcës, nga ana e një apo më shumë shtetesh, apo nga ana e një organizate ndërkombëtare e cila është e pajisur me kompetencat përkatëse për përdorimin e forcës - është një ndërhyrje ndërshtetërore për të vendosur lirinë në një shtet tjetër, me qëllim që të ndikojë mbi këtë të fundit për të respektuar standardet minimale humanitare ndaj qytetarëve të vet.”<sup>44</sup>

Pra, situata në Kosovë kërkoi me çdo kusht ndërhyrjen me forcë, sepse bota e qytetëruar nuk mund të pranonte aneksimin e territoreve në formën e spastrimit etnik të tyre, si në kohët primitive, sipas parimit gebelsian që Millosheviqi e pati shpallur në Fushë-Kosovë më 28 qershor 1989, „Serbia ose do të jetë e madhe ose nuk do të ekzistojë fare“. Sipas zëdhënësit të Departamentit të Shtetit, James Rubin, se në Kosovë kishte një situatë dramatike humanitare dhe se Millosheviqi synonte zgjerimin e konfliktit, për këtë realitet ishin të vetëdijshëm edhe udhëheqësit e Moskës. Sekretarja e Shtetit Amerikan, Ollbright, para fillimit të Konferencës së Rambujesë ishte pajtuar me ministrin e Jashtëm rus, Ivanov, se “Millosheviqi nuk njeh tjetër, veçse gjuhën e forcës, për t’u tërhequr nga kursi i dhunës në Kosovë”. Por se situata në Kosovë kërcënonte paqen e sigurinë, si dhe do të shkaktonte një katastrofë humanitare, kjo është pranuar zyrtarisht në Rezolutën 1190 të 30 shtatorit 1998. Aty thuhet se konflikti në Kosovë rrezikon të përhapet në vendet e rajonit dhe më gjerë, si dhe theksohet gjendja e rëndë e refugjatëve, e cila do të vështirësohej edhe më shumë në kushtet e motit të ftohtë gjatë dimrit që po vinte. Kështu, Rusia vetë pranoi në këtë rezolutë se situata në Kosovë ishte dramatike dhe ajo u pajtua që të vihej gishti te fajtori, te Millosheviqi. Megjithatë, Kremli në marsin e vitit 1999 nuk pranoi të përdorej forca për ta ndalur këtë situatë katastrofike. Kjo do të thotë se në përmbajtje veprimi i NATO-s ishte i justifikuar, derisa vetë Këshilli i Sigurimit kishte pranuar faktin se kishte arsye objektive për veprim<sup>45</sup>. “Intervenimi humanitar” ka funksionin e dënimit të shtetit që ushtron dhunë dhe kryen vrasje masive ndaj popujve apo pakicave kombëtare, gjë që i jep të drejtë shteteve të

---

<sup>44</sup> Aigul Taskushina, Die humanitäre Intervention am Beispiel des NATO-Einsatzes im Kosovo, Tectum Verlag Marburg: 2000, f.17

<sup>45</sup> Legjitimiteti dhe diskutimet kundërthënëse rreth ndërhyrjes së nato-s për çlirimin e kosovës, <https://www.standard.al/2014/03/24/legjitimiteti-dhe-diskusimet-kunderthenese-rreth-nderhyrjes-se-nato-s-per-clirimin-e-kosoves/>

tjera të bashkohen për ta ndëshkuar dhe për ta pamundësuar realizimin e një qëllimi të tillë të dhunshëm<sup>46</sup>.

Prof. Marc Weler me të drejtë pohon se rasti i Kosovës është një rast i mirë në arenën ndërkombëtare dhe paraqet fillimin e një rendi të ri kushtetues ndërkombëtar dhe paraqet një burim të rendit të ri ndërkombëtar, e jo të shuarjes së tij. Në vend se të mbështetej në burime të tejkaluara, siç ishin mosndërhyrja dhe çështjet njëdimensionale të sovranitetit, Kosova paralajmëron një sistem kushtetues ndërkombëtar postmodern që është ende në proces të themelimit të vet<sup>47</sup>. Kosova tregoi se shtetet nuk mund të thirren në të drejta dhe privilegje të tij dhe popullit të vet dhe nuk mund të thirren në doktrinën mosndërhyrjes në sovranitetin shtetëror nëse kemi të bëjmë me raste të rënda kur krijesa shtetërore që ishte artificiale, sillet në mënyrë agresive ndaj përbërësit të vet, në këtë rast Serbia ndaj Kosovës, deri në spastrimin etnik dhe në shkallë gjenocidi. Edhe pse çështja e Kosovës u komplikua për shkak të çështjes së shkëputjes së njëanshme, prapëseprapë paraqet një rast të mirë që tregon se ekzistimi i parimit së paku juridikisht që ekziston se shtetet nuk mund të shkëputen njëanshëm nga struktura, rasti i Kosovës ka tendenca që të bëjë përjashtim nga ky parim ndërkombëtar gjë që po dëshmohej me pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës e cila ishte në dëm të Serbisë<sup>48</sup>.

Autori i njohur i librit “Përse kombet shkojnë në luftë?” (Why Nations Go to War), Johan G. Stoessinger, mendon se “katalizatori që përshpejtoi fillimin e fushatës së bombardimeve ajrore nga NATO-ja, ishte i dyfishtë. Së pari, zbulimi i një numri masakrash të forcave serbe kundër shqiptarëve, duke përfshirë gratë dhe fëmijët, e shtynë NATO-n të merrte vendim. Së dyti, fuqitë perëndimore zbuluan planin e përgjithshëm strategjik të Millosheviqit për të “zgjidhur” problemin shqiptar, i njohur si operacioni “Patkoi”. Në përputhje me emrin e koduar të tij, Millosheviqi planifikonte t’i mbyllte shqiptarët brenda një patkoi gjigant dhe pastaj t’i detyronte ata të iknin nga Kosova. Shkatërrimi i pasurisë së tyre dhe të gjitha dokumenteve të identifikimit do të garantonin që ata të mos ktheheshin dot kurrë. Me një fjalë, Kosova do të “spastrohej” nga myslimanët me qëllim që të sigurohej “lebensraum” për ardhacakët serbë<sup>49</sup>”

<sup>46</sup> Z. Gruda, E drejta ndërkombëtare publike..., f. 99.

<sup>47</sup> Weller, Mark, Shtetësia e Kontestuar, Koha, Prishtinë (2009),

<sup>48</sup> Po aty.

<sup>49</sup> John G. Stoessinger, Përse kombet shkojnë në luftë, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë: 2015, f. 176-184.

Joseph Marko, specialist i së drejtës ndërkombëtare civile në Universitetin e Gracit në Austri, beson se ndërhyrja në Kosovë vërtet nxori në pah dobësitë e së drejtës ndërkombëtare civile, por nga ana tjetër dha impluse të rëndësishme për zhvillimin e saj: "Kosova ishte sigurisht një pikë kthese, e cila e çoi më tej të drejtën ndërkombëtare civile. Është e qartë se për shkak të së drejtës së vetos të anëtarëve të përhershëm, Këshilli i Sigurimit nuk është vërtet i aftë për të vepruar në raste krizash të tilla. Ndërhyrja humanitare e NATO-s, dha sigurisht një implus të ri vendimtar për ta diskutuar sërish doktrinën e sovranitetit dhe për të diskutuar në lidhje me të"<sup>50</sup> “

Duke e argumentuar vendimin e NATO-s për sulm kundër Jugosllavisë së mbetur, ministri i atëhershëm i Jashtëm gjerman, Joshka Fischer, në një intervistë për gazetën berlinase “Tageszeitung” konstaton: “Çfarë është dashur të bëjmë në mars të vitit 1999, kur Millosheviqi po e spastronte etnikisht Kosovën?! T’i vënim duart në gjoks dhe t’u thoshim shqiptarëve të Kosovës: na vjen keq, mirëpo ne nuk kemi vendim të Këshillit të Sigurimit. Në çfarë bote ne po jetojmë.”<sup>51</sup> Në këtë kontekst, ai, metodat brutale të politikës së Millosheviqit kundër shqiptarëve të Kosovës i krahasonte me doktrinën antishqiptare të Çubriloviqit<sup>52</sup>

Autori i njohur latino-amerikan Mario Vargas Losa, në një shkrim të tij për luftën e Kosovës, vlerëson se ndërhyrja e NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur ishte e vonuar për dhjetë vjet, prandaj ajo duhej qortuar jo për ndërhyrjen, por për vonesën e saj, e cila pati pasoja të rënda për Kosovën, ndodhën krimet më të rënda kundër njerëzimit. Kjo vonesë ndezi “dritën e gjelbër të diktaturës së Beogradit për të vënë në jetë planin për spastrimin etnik të Kosovës, një prej krimeve më të lemerishme kundër njerëzimit që janë kryer përgjatë këtij shekulli, i krahasuar për nga natyra, edhe pse jo për nga numri, me Holokaustin e hebrenjve të

---

<sup>50</sup> Ndërhyrje humanitare apo mosprekje e kufijve territorialë, <https://www.dw.com/sq/nd%2c3%abrhyrje-humanitare-apo-mosprekje-e-kufijve-territorial-%2c3%ab/a-4121638>

<sup>51</sup> “Nuk ndihem fitimtar” (Tageszeitung: Intervistë me ministrin e Jashtëm gjerman, Joshka Fisher), botuar në Rilindja, botim në Perëndim, Zürich. 16.08.1999

<sup>52</sup> A ka doktrinë antishqiptare të fqinjët e përmendur më lart? Për fat të keq po, sidomos te serbët. Ajo s’është fantazi, është e shkruar, e formuluar qartë, e botuar, dhe kryesorja, e padënuar. Është doktrina e Çubriloviqit, versioni i fundit, i një sërë programesh të ngjashme, e titulluar nga vetë autori “Dëbimi i shqiptarëve”. E ngjizur gati në të njëjtën kohë me projektin nazist për hebrenjtë dhe, për nga thelbi, jo larg atij. Ky draft famëkeq, i rënë tani në koma pret orët e saj. Bombat e NATO-s ndëshkuan Serbinë më 1999, por jo doktrinën.

realizuar nga Hitleri ose me depërtimin e popujve prej 37 Deklaratë e Presidentit të Republikës lidhur me ndërhyrjen ushtarake në Jugosllavi, Pragë, 24 mars 1999, cituar sipas Michael Zantovsky, Haveli, AIIIS, Tiranë: 2018, f. 459. 38 Po aty, f. 507-508. 39 Po aty, f. 459. Ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë: rast precedent... 213 Stalinit, i cili ishte i vendosur në synimin e vet për të rusifikuar Bashkimin Sovjetik<sup>53</sup>.”

Legjitimitetin e veprimeve të NATO-s në Kosovë e përforcon gjithashtu vendimmarrja me konsensus të plotë e Aleancës së Atlantikut. Ndonëse kishte segmente politike të Francës, Italisë dhe Greqisë, të cilat punuan për të sabotuar unitetin e vendeve anëtare për marrjen e vendimit të sulmeve ajrore, në fund të fundit të 19-të vendet qenë në një mendje: u thanë po aksioneve ushtarake kundër Jugosllavisë (Serbisë). Por kjo nuk ndodhi më vonë në luftën e Irakut. Nuk ndodhi as në vendimmarrjen e fundit të presidentit Obama në rastin e Sirisë. Kështu që realizimi i aksioneve ushtarake në Kosovë me konsensus të plotë të vendeve anëtare të NATO-s e përforcon idenë e legjitimitetit të këtyre aksioneve.<sup>54</sup>

Duke u bazuar në vendimin e GJND-së të vitit 2011, me të cilin është konfirmuar legjitimiteti i shpalljes së pavarësisë dhe faktin se Kosova paraqet një rast *sui generis* të shtetndërtimit dhe pavarësisë, rast të paprecedent, mund të konstatojmë se edhe intervenimi NATO-s në Kosovë është një rast *sui generis* i ndërhyrjes për të ndalur spastrimin etnik të një populli të tërë. Rezoluta 1244 u krijua si akt kompromisi pas ndërhyrjes ushtarake dhe pas vendosjes së administratës civile dhe ushtarake në Kosovë. Rezoluta kishte një qëllim të qartë - ndërprerjen e luftës, vendosjen e administratës ndërkombëtare në Kosovë dhe përgatitjet për zgjidhjen e statusit përfundimtar. Pikërisht në pikën 11 të këtij dokumenti thuhet se, synimi i Rezolutës është krijimi i kornizës politike për gjetjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Në momentin kur ajo Rezolutë u bllokua për shkak të pamundësisë së Këshillit të Sigurimit për të marrë vendim për statusin e Kosovës, Këshilli i Sigurimit ka emëruar Marti Ahtisaarin si ndërmjetës për të udhëhequr procesin negociator në Vjenë. Ai proces ishte plotësisht nën patronatin e Kombeve të Bashkuara dhe në fund të tij kishim propozimin e Ahtisaarit që Kosovës t'i jepet pavarësia. Përse Këshilli i Sigurimit nuk ishte në gjendje të bëjë një rezolutë të përbashkët përmes së cilës përfundon administrimin e tij në Kosovë dhe jep mendimin për statusin përfundimtar të Kosovës për shkak të bllokadës në Këshillin e Sigurimit.

<sup>53</sup> Mario Vargas Llosa, “Një luftë e vonuar”, në Lufta kundër luftës, Botim i Institutit Shqiptar të Medias, Tiranë: 1999, f. 13.

<sup>54</sup> Po aty.

Sidoqoftë, kur u soll vendimi për bombardimin e Serbisë, edhe atëherë kishte diskutime nëse ai vendim është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Por ka mbizotëruar opinioni se një ndërhyrje e tillë është legjitime, kur është çështja e katastrofës humanitare dhe kur bëhet fjalë për të drejtat e një populli. Duke pasur parasysh se logjika e bllokimit të procesit për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës nuk ishte më e pranueshme, përfundim logjik i gjithë procesit ishte Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, e cila ishte në pajtim me aktorët kryesorë të bashkësisë ndërkombëtare, që janë të pranishëm në Kosovë<sup>55</sup>.

Ashtu siç nuk ekziston një unitet ndërkombëtar rreth legalitetit të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, ka edhe mendime kontraverse rreth asaj që ka ndodhur në Kosovë, luftës së Kosovës dhe brutalitetit dhe ashpërsisë së krimeve që Serbia i ka kryer në Kosovë. Dilema kryesore që shtrohet jo vetëm në qarqe politike dhe mediave, por edhe në ato profesionale dhe juridike, ka të bëjë me atë se çfarë, në të vërtetë, ka ndodhur në Kosovë. Në këtë segment janë tri dilema kryesore: e para, çfarë karakteri kishte lufta e Kosovës, ka qenë një luftë e brendshme apo një luftë ndërshtetërore? Dilema e dytë është se a kemi të bëjmë në Kosovë me krime lufte dhe krime kundër njerëzimit apo gjenocid.

Në këto rrethana bëhet ende më e qartë se cili është rezultati i sulmeve ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë (Serbisë) për çlirimin e Kosovës, rezultat i cili çliroi njëkohësisht rajonin nga konfliktet disa-shekullore dhe vendosi bazat e pajtimit dhe integritetit rajonal e evropian. E vështruar edhe nga ky këndvështrim, këto sulme mund të konsiderohen si legjitime. Në fund të fundit, kritikët e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, patën parashikuar se veprimet ushtarake nga jashtë do ta destabilizonin rajonin dhe do të shkaktonin viktima të panumërta. Në fakt, ndodhi e kundërta. Sipas vlerësimeve të ekspertëve aksionet ushtarake të Aleancës në ish-Jugosllavi shkaktuan gjithsej 556 viktima dhe 878 të plagosur, një numër ky minimal në një luftë të armatosur.

Përfundimisht mund të konkludojmë se aksionet ushtarake të NATO-s në Kosovë, të cilat ne i përkujtojmë sot në 25 -vjetorin e tyre,

---

<sup>55</sup> Kush fitoi në Hagë? Debate e polemika profesionale ndërmjet Arsim Bajramit, profesor i së drejtës kushtetuese në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe Radosllav Stanojeviçit, profesor i së drejtës ndërkombëtare në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit, Radio Evropa e Lirë. Kjo polemikë u transmentua direkt në emisioni 'Ura' në linjën në distanca Prishtinë-Pragë-Beograd. Konstatimet e Bajramit dolën të sakta, sepse vetëm disa ditë me vonë në Aktgjykimin e GJND-së këto konstatime u gjetën në arsyetimin e aktgjykimit të GJND-së në favor të pavarësisë së Kosovës.

ishin e vetmja mënyrë e zgjidhjes së konfliktit në Kosovë midis shqiptarëve shumicë dërmuese dhe shtetit të Serbisë e serbëve në përgjithësi. Ato aksione sollën ndryshimin epokal të Kosovës e të gjithë rajonit, madje mund të konsiderohen edhe si ilaçi i vetëm për çlirimin e vetë Serbisë nga ëndrrat shekullore të miteve dhe obsesioneve të saj për epërsi ndaj popujve të tjerë të rajonit. Këto aksione nuk i dhanë lirinë vetëm shqiptarëve në Kosovë, por çliruan nga ndjenja e padrejtësisë të gjithë shqiptarët në rajon. Çliruan gjithashtu nga ndjenja e supozuar e viktimizimit vetë serbët, si dhe lehtësuan plagët e vjetra e të reja që Serbia shkaktoi në luftërat e fundit të shekullit XX në Kroaci, Bosnjë, Kosovë e Slloveni.

## Shkaqet kryesore të intervenimit të NATO-s në Kosovë

Krahas doktrinës së intervenimit humanitar, bombardimi i NATO-s., kishte edhe qëllime të tjera strategjike, të cilat ishin një provë e verifikimit të kësaj aleance ushtarake si një mekanizëm i sigurisë globale. Për këtë arsye intervenimi në Kosovë ishte shumë kompleks dhe kishte këto qëllime kryesore:

- Ndalja e spastrimit etnik, shkeljes së të drejtave të njeriut në nivel gjenocidi
- Parandalimi i përshkallëzimit të luftës në vendet e tjera në Ballkan, Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi dhe tendencës së Serbisë dhe Rusisë për dalje në Adriatik dhe Mesdhe
- Provimi i doktrinës së intervenimit preventiv dhe relativizimit të sovranitetit territorial
- Ndëshkimi i politikave serbe të spastrimit etnik të udhëhequra nga Millosheviqi në Kroaci, Bosnjë dhe Kosovë
- Ruajtja e kredibilitetit të NATO-s në 50 -vjetorin e themelimit të saj.
- Çlirimi i Kosovës, administrimi ndërkombëtar, shtetndërtimi dhe pavarësia e Kosovës.

## Marrëveshja e Kumanovës dhe tërheqja e forcave serbe nga Kosova

Faza e parë e administrimit ndërkombëtar të Kosovës ka filluar me miratimin e rezolutës 1244 dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së

ashtuquajtur të Kumanovës, si Marrëveshje Tekniko-Ushtarake. Nënshkrimi i Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake midis ushtrisë jugosllave dhe NATO-s, të cilën e përfaqësonte gjenerali Mike Jackson shënoi fundin e bombardimeve ajrore të NATO-s dhe pranimin e kushteve që ajo i parashtrroi Serbisë për njohje të kapitullimit dhe për tërheqjen e forcave të saja nga territori i Kosovës. Kjo Marrëveshje përcakton modalitete tekniko-ushtarake të tërheqjes së forcave serbe nga territori i Kosovës, dinamikën e tërheqjes dhe hyrjen e forcës ndërkombëtare të sigurisë. Marrëveshja përmban gjithsej 6 nene dhe dy shtesa. Në nenin e parë përcaktohen obligimet kryesore, në të cilat pala serbe pajtohet për vendosjen e prezencës civile të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe pranimin nga ana e saj të vendosjes së Forcës së Sigurimit Ndërkombëtar (KFOR). Më tutje në këtë nen, Serbia pranon tërheqjen e të gjitha forcave të sigurimit të saj, duke përfshirë këtu të gjithë personelin dhe organizatat me aftësi militare të RFJ-së dhe Republikës së Serbisë nga territori i Kosovës. Në vazhdim të këtij neni, përcaktohet Zona e Sigurisë Ajrore (ASZ), e cila përfshin një zonë 25 kilometërshe që zgjerohet përtej kufirit rajonal të Kosovës. Zona e Sigurisë Tokësore (GSZ) definohet si zonë 5 -kilometërshe që zgjerohet përtej kufirit rajonal të Kosovës<sup>56</sup>.

Në këtë pjesë të marrëveshjes përcaktohen dy obligime kryesore, që rrjedhin nga Marrëveshja:

1. Që të vendosen ndalimet e veprimeve ushtarake të qëndrueshme; nën asnjë rrethanë nuk duhet çfarëdo force federative dhe e Republikës së Serbisë të hyjë brenda, rihyjë apo të mbetet brenda territorit të Kosovës apo në Zonën e Sigurisë Tokësore (GSZ) dhe në Zonën e Sigurisë Ajrore (ASZ), pa pëlqimin prioritar të Komandës së Forcës së Sigurisë Ndërkombëtare (KFOR);

2. Të sigurohet përkrahja dhe autorizimi i Forcës së Sigurisë Ndërkombëtare (KFOR) dhe në veçanti të autorizojë KFOR-in të ndërmarrë aksione të tilla siç janë kërkuar, duke përfshirë edhe përdorimin e forcës së domosdoshme, për të siguruar përkrahjen e kësaj marrëveshjeje dhe mbrojtjen e Forcës së Sigurisë ndërkombëtare (KFOR) dhe të kontribuojë në ambientin e sigurt të prezencës civile ndërkombëtare<sup>57</sup>.

---

<sup>56</sup> Marrëveshja e Kumanovës, 9 Qershor 1999. E qashme në <http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>, qasur së fundmi me 10.07.2017.

<sup>57</sup> Ibid.

Në nenin 2 të Marrëveshjes përcaktohen detyrimet e ndaljes së menjëhershme të veprimeve ushtarake dhe kushtet, rrugët dhe dinamika e tërheqjes së forcave serbe dhe jugosllave nga territori i Kosovës dhe në distancë të zonës tokësore dhe ajrore të sigurisë. Krahas tërheqjes nga Kosova, forcat serbe dhe jugosllave detyrohen të shënojnë dhe pas-trojnë të gjitha fushat e minuara në të gjitha linjat e komunikacionit. Më tutje në këtë nen specifikohen saktësisht afatet e tërheqjes së forcave serbe nga Kosova. Dispozitat e nenit 3, 4, 5 dhe 6 kanë karakter teknik dhe u referohen mekanizmave të implementimit të marrëveshjes<sup>58</sup>.

Nënshkrimi i Marrëveshjes mundësoi fillimin e aksionit të vendosjes së Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë në Kosovë (KFOR) dhe largimin e forcave serbe nga Kosova. Ky fakt, krijon kushtet për rikthimin e refugjatëve kosovarë në Kosovë, kthim ky që u bë me një shpejtësi të madhe, që habiti komunitetin ndërkombëtar.

Pas hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë, Këshilli i Sigurimit më 10 qershor, 1999 miratoi Rezolutën 1244, me të cilën edhe formalisht e vendosi Kosovën nën administrimin e Kombeve të bashkuara dhe hapi rrugën për vendosjen e prezencës ndërkombëtare civile dhe ushtarake në territorin e Kosovës.

## Resume

Even today, 25 years after the NATO bombing campaign in Kosovo, in international circles, especially in public debates, there are controversial discussions about the legal basis of the NATO bombings in Kosovo. The legitimacy of NATO's bombing campaign in Kosovo has been the subject of many political and diplomatic debates around the globe. NATO did not have the support of the United Nations Security Council for the beginning of the aerial bombardment due to the opposition of its permanent members who were closely related to Yugoslavia, in particular Russia, which strongly opposed any NATO intervention in the conflict in question. Russian and many allies' criticism of Yugoslavia was based on the fact that NATO's charter states that NATO is an organization created to protect its members, and in this case it was being used to attack a non-NATO country., which did not directly threaten any NATO member. NATO stated that the instability in the Balkans was a direct threat to the security interests of NATO

---

<sup>58</sup> Marrëveshja e Kumanovës, 9 Qershor 1999, neni 2. E qashme në <http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>, qasur së fundmi me 10.07.2017.

members, and in this form it justified military action, while the only NATO member country, for which the Yugoslav actions did not present a direct threat to instability in the Balkans was Greece, which opposed the bombings even though it took part in them.

The NATO action came after many warnings from NATO and after Belgrade had ignored the calls of the UN, the commitments of the Contact Group, the OSCE and other international emissaries. Milosevic was confrontational and arrogant with the West and quite openly declared that he was ready to step on the bodies of the Kosovo Albanians, referring to the experience of the Yugoslav communists at the end of World War II. In a word, Belgrade did not consider the means non-military of the West. Therefore, from the spring of 1998 until the beginning of 1999, NATO exhausted all effective non-military instruments.

The international order of the nineties is based on the theory of the sovereignty and territorial integrity of the states and had set some limitations regarding NATO's international interventions in sovereign states that were full members of the UN. But this international order began to collapse after the end of the Cold War and the bipolar division of the world, when the process of globalization and the creation of the collective security system began and when NATO gained the right of humanitarian intervention whenever and wherever rights are violated of man, policies of ethnic cleansing and other genocidal actions are implemented.

The doctrine of humanitarian intervention is based on modern, reformed international law, which displaces the theory of absolute state sovereignty, prevents states from committing genocide, ethnic cleansing and other macabre crimes and enables NATO to protect the universal rights of peoples wherever they are violated. The legitimacy of NATO's intervention in Kosovo is indisputable due to the fact that genocide represents the most serious crime against humanity and that it should not be tolerated by the democratic world, but it should be prevented so that all the countries of the world are sent a clear message that they will face strong military, political and judicial responses whenever they undertake genocidal actions and crimes. Based on this, the controversial discussions about the legal basis of the bombings are discussions that from time to time serve to discuss the right of this organization to intervene in other humanitarian crises around the world. This issue has been raised in several other cases, including the case of

Russia's current aggression in Ukraine, and taking the case of Kosovo as a precedent for NATO's intervention against other countries.

The classical approach of the territorial sovereignty of states which is based on the principles of classical international law of the Soviet model, according to which NATO cannot bomb or interfere with the sovereignty of any UN member state without first obtaining the consent of the Security Council Insurance, which authorizes this intervention. This doctrine has its origins in the Cold War period and is based on the principle of non-interference in internal affairs, territorial integrity and sovereignty, and the right of each state to resolve internal conflicts. Proponents of this theory were based on the fact that supposedly Kosovo was an internal matter, it was not an independent and sovereign state, it was an internal matter of Serbia and that any NATO intervention would violate the territorial integrity of this state. Unfortunately, these opinions have been widespread in a part of the international legal community and have been expressed in many conferences dedicated to the legality of NATO's intervention in Kosovo, even by legal experts of countries that have recognized Kosovo's independence.

## Literatura

- Akademik Gazmend Zajmi, “Çështja e Kosovës në kuadër të çështjes shqiptare si sfidë e madhe dhe madhore e kohës dhe ndaj kohës”, Prishtinë, revista “E drejta” 1/96,
- Akademik Pajazit Nushi, *Determinantet psikosociale të gjenocidit të pushtetit serb ndaj shqiptarëve dhe struktura kognitive e tyre*, ASHAK, 1995,
- Albert J. Schmidt, “*Toward the Rule of Law: Kosovo 2000. Elections*”, [Vol. 20:467-2001],
- Albert J. Schmidt, “*Toward the Rule of Law: Kosovo 2000 Elections*”, [Vol. 20:467-2001],
- Alexander Orakhelashvili, “*Statehood, Recognition and the United Nations System: A Unilateral Declaration of Independence in Kosovo*” Max Planck Yearbook of United Nations Law, Volume 12, 2008.
- Alexandros Yannis “*Kosovo Under International Administration an Unfinished Conflict*”, 1999-2000.
- Anton Vukpalaj, *Gjenocidi, Kosova dhe padia kundër Serbisë*, Koha ditore, 21, Gusht, 2021.
- Arsim Bajrami, *Shtetndërtimi i Kosovës 1990-2020, fq.250-258, botimi ASHAK, Prishtinë, 2021.*
- Arsim Bajrami, *Measures be undertaken with the aim of state and constittional institutionalizing of the Republic of Kosova*, Kosova Law Review, nr. 1-97, Stamboll, 1997;
- Arsim Bajrami. *Concrete remarks about letter of so-called FRY to Comission for Human Rights of UN*, projekt i dërguar OKB-së për gjendjen e arsimit në Kosovë në periudhën e okupimit, New York, 19.06.199;
- Bill Clinton: *Pse dhe si e bëra luftën e Kosovës*, DOSIERprill, 15, 2018 81 <https://api.parliament.uk/historic-nsard/commons/1999/mar/23/kosovo>
- Christiane Amanpour: *Gjenocidi në Srebrenicë-një moment përcaktues! A defining moment* By Christiane Amanpour, Anchor, CNN <https://edition.cnn.com/2017/11/22/opinions/amanpour-srebrenica->
- Çirkovic, Sima (1990): *Kosovska bitka kao istorijski problem*; Istorijski
- Gordon N. Bardos, “*Balkan History, Madeleine’s War, and NATO’s Kosovo*”, *Journal of the North American Society for Serbian Studies* 15(1): 77–102, 200,
- <sup>1</sup>Gabriel Partos, “*Kosova-mënyra të reja për të ndalur në konflikt tëvjetër*”, botuar në librin *Lufta kundër luftës*, Tiranë, 2001
- David L. Phillips “*Clirimi i Kosovës*”, *diplomacia kemngules dhe nderhyrja e SHBA-ve*, Tetove, 2015, fq.14. 220

- Dejan Marolov, “*The Reasons for the Collapse of Yugoslavia*”, Goce Paskal Milo, *Ditari i një ministri të Jashtëm, konflikti i Kosovës: 1997-2001*, Toena, Tiranë, 2009, f. 146.
- Bush is greeted warmly in Albania - The New York Times*. (n.d.). Retrieved December 8, 2021, from <https://www.nytimes.com/2007/06/10/world/europe/10cnd-prexy.html>. Retrieved December 8, 2021, from <https://www.nytimes.com/2007/06/10/world/europe/10cnd-prexy.html>
- Bill Clinton, *Ne luftën, ju paqen: mesazhe, artikuj, konferencë shtypi, intervista dhe fjalime për Kosovën*, gazeta Albania, 2000. Përgatiti për botim Lutfi Dervishi, f. 13.
- Wolfgang Petritsch, Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë, Kosova dhe Bashkësia Ndërkombëtare: 1989-1999...*, f. 185.
- Blerim Shala, *Vitet e Kosovës 1998-1999*, botimi i dytë, Gama, Prishtinë, 2001, f. 257.
- Rexhep Qosja, *Paqja e përgjakshme, Konferenca Ndërkombëtare për Kosovën*, Rambuje, 6-23.2.1999; Paris 14-19.3.1999; New York, 1999, f. 202.
- Tim Judah, *Kosova, luftë dhe hakmarrje*, Koha, Prishtinë, ShLK, Tiranë, 2000, f. 261.
- Paskal Milo, *Ditari i një ministri të Jashtëm, konflikti i Kosovës...*, f. 157.
- Wolfgang Petritsch, Robert Pihler, *Rruga e gjatë në luftë: Kosova dhe Bashkësia Ndërkombëtare...*, f. 203.
- Marc Weller, “Shtetësia e kontestuar”, KOHA, Prishtinë, mars 2009.
- Noel Molcolm, “Të drejtat e Kosovës”, botuar në librin “Lufta kundër luftës”, Tiranë, 2001.
- Noel Molcolm, “Kosovo - a Short History”, Macmillan, London 1998
- Stipe Mesic, “Si u shkatërrua Jugosllavia”, Prishtinë 2011.
- Madelein Olbright: “Zonja sekretare”, f. 446
- Noam Chomsky “Failed States”, Pinguin Books, London, England, 2006,
- Mario Vargas Llosa, “Një luftë e vonuar”, në Lufta kundër luftës, Botim i Institutit Shqiptar të Medias, Tiranë: 1999

Ksenofon Krisafi

## BOMBARDIMET E NATO-S NË ISH-JUGOSLLAVI NË KËNDVËSHTRIMIN E SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE

### Abstrakt

Mizoritë serbe të kryera në Kosovë, veçanërisht gjatë luftës së viteve 1998-99, zgjuan nga kujtesa e së shkuarës, skenat e tmerrshme të masakrave çnjerëzore që ata kishin kryer ndaj shqiptarëve në një hapësirë kohore prej rreth një shekulli e gjysmë. I pasuruan edhe me përvojat më ekstreme, më mizore, të nazizmit hitlerian, - kampet e përqendrimit, dëbimet, ekzekutimet, varret masive, zhdukjen e kufomave në furnallat e shkritoreve serbe në Smederevo etj.

Ata, sikurse edhe disa fqinjë të tjerë, nuk i kanë reshtur për asnjë çast veprimet kriminale antishqiptare dhe ato nuk kanë qenë asnjëherë aksidentale. Pavarësisht nga emërtimi dhe cilësimi juridik që kanë marrë apo duhej të merrnin, ishin pjesë e platformave strategjike afatgjate për dëbimin, asimilimin, asgjësimin fizik të shqiptarëve dhe spastrimin e tyre etnik, për krijimin e *spazio-s vitale* për veten e tyre. Ngjarjet e viteve '80-'90 të shekullit të kaluar rikonfirmuan se krimi i gjenocidit në Kosovë është zbatuar si aspekt esencial i politikës shtetërore të Beogradit për të përzënë ose gjunjëzuar shqiptarët, "pronarët" e saj të ligjshëm dhe për ta mbajtur atë nën sundim. Kjo shpjegon edhe vazhdimin e qëndrimeve mizore, provokacionet, kërcënimet, presionet e drejtuesve të shtetit serb, veçanërisht skenarët e rrezikshëm të përsëritur në veri të Kosovës.

Ndikojnë për keq edhe llastimet e qarqeve të ndryshme në shtete të botës perëndimore. Beogradi ndjehet i inkurajuar ngaqë nuk është ndëshkuar asnjëherë siç e meriton. Mosndëshkimi inkurajon autorët e krimeve kundër njerëzimit dhe përsëritjen e të njëjtëve skenarë të kobshëm, siç ka ndodhur në Kosovë, ku sipas Ismail Kadaresë, Milosheviqi dhe përkrahësit e tij, urrejtjen e lashtë kundër shqiptarëve, e kanë shpallur "obligim kombëtar", simbol dhe bazë të politikës serbe.

Bashkësia ndërkombëtare u ndodh në atë kohë përpara dy alternativash ekstreme, të qëndronte spektatore përballë një tragjedie me përmasa apokaliptike të shfarosjes së një populli të tërë, siç ishte rasti i Kosovës, ose të ndërhynte për të ndaluar zhdukjen e shqiptarëve të Kosovës, duke u mbështetur në një interpretim të zgjeruar juridik të dispozitave të Kartës së OKB-së dhe parimeve e normave themelore të së drejtës ndërkombëtare. Ajo zgjodhi të dytën dhe bëri shumë mirë. Në vijim, do të parashtrihen argumentet juridiko-ndërkombëtare në mbështetje të bombardimeve të forcave të NATO-s, për shpëtimin e popullit shqiptar të Kosovës.

*Fjalët çelës:* Serbi, Kosovë, NATO, SHBA, BE, OKB, bombardime, ndërhyrje, qëllime humanitare, sovranitet shtetëror etj.

## BOMBARDIMET E NATO-S NË ISH-JUGOSLLAVI NË KËNDVËSHTRIMIN E SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE

Lajmet e mbrëmjes të datës 24 mars 1999, pothuajse të të gjitha kanaleve televizive dhe mjeteve të tjera të informimit publik, njoftuan se, pak para orës 20.00, qielli i ish-Jugosllavisë ishte mbuluar nga avionët e NATO-s, të cilët sapo kishin nisur bombardimin e disa pjesëve të territorit të saj.<sup>1</sup> Ndjesi të shumëfishta përftoheshin nga kjo ndodhi e pazakontë. Për një grup njerëzish dhe politikanësh dhe pothuajse për gjithë botën demokratike, të rreshtuar moralisht përkrah popullit të Kosovës, ishte ndërmarrë një hap i rëndësishëm edhe pse ekstrem, por i domosdoshëm. Bashkësia ndërkombëtare nuk mund të qëndronte spektatore përballë përsëritjes së një tragjedie me përmasa apokaliptike të shfarosjes së një populli, akti i parë i së cilës ishte luajtur kohë më parë në Bosnjë e Hercegovinë.

Gjithkush nga vendimmarrësit ishte i ndërgjegjshëm se bombardimet ishin pjesë e një zgjidhjeje të dhimbshme, nëpërmjet dhunës së organizuar, që mund të shoqërohej gjithashtu me viktima dhe dëme materiale. Por, mendohej se gjithçka do të kryhej në kushtet e një kujdesi maksimal që mundësisht dëmet ndaj popullsisë civile të ishin zero ose afër zeros. Prandaj bombardimet drejtoheshin ndaj atyre që ishin në krye të Serbisë ose ish-Jugosllavisë, për t'i detyruar të hiqnin dorë nga strategjia e zhdukjes së shqiptarëve, e huajtur nga *Naçertania* e Garashaninit, *Zhdukja e shqiptarëve* e Vasa Çubrilloviqit dhe nga edicione të shumta platformash antishqiptare me autorë të një skote mizorësh të strehuar në Beograd.

Pra, ndërhyrja u zgjodh nisur nga mendimi se edhe lufta mund t'i shërbejë paqes kur zhvillohet në përputhje me parimet themelore të përcaktuara nga e drejta ndërkombëtare. Shpresohet që pas saj të vinin ditë më të mira për Kosovën, se ajo do të shpëtonte nga zgjedha serbe, do të fitonte lirinë. Bashkë me të do të vinin ditë të mira edhe për Ballkanin edhe për Evropën, mbi qiellin e të cilave vërtiteshin prej kohësh re të errëta lufte, që mund të tërhiqnin dhe të përfshinin në vorbullën e tyre edhe vetë Evropën.

---

<sup>1</sup> Bombardimi i fabrikës së aeroplanëve *Lola Utva*, në Pançevë, në periferi të Beogradit, rreth orës 21:00, të 24 marsit 1999, shënoi fillimin e një fushate 78-ditore të ndërhyrjes së armataosur në ish-Jugosllavi.

## Fundi i “diplomacisë së navetës”, bombat në veprim (Mars 99)

Ishte përmendur edhe më parë alternativa e bombardimeve të NATO-s ndaj ish-Jugosllavisë për krimet e rënda që ajo po kryente në Kosovë. Drejtuesit e NATO-s, kur konstatuan se kishin dështuar të gjitha orvatjet për zgjidhje paqësore, veçanërisht takimet e shpeshta të emisarëve të Uashingtonit me Milosheviqin, për ta detyruar të hiqte dorë nga lufta, në emër të jetës, u detyruan të shqyrtonin opsionin e sulmeve ajrore, të cilat, një ndër politikanët e asaj kohe, Lionel Zhospen, i cilësonte si betejë për qytetërimin.<sup>2</sup> Më 13 tetor 1998, NATO-ja, vendosi zyrtarisht përdorimin e forcës. Beogradit iu lanë katër ditë afat për të pranuar kushtet.<sup>3</sup> Nuk u zbatua vendimi, nuk filloi sulmi, sepse Milosheviqi, të cilin Ollbrajt, e cilësonte “një gënjeshtar të lindur”, ia mbushi mendjen Hollbrukut se do të pranonte zgjidhjen e propozuar. Mashtroi sërish. Në këtë mënyrë e shmangu përkohësisht përdorimin e forcës, por jo për gjithmonë. Sepse ai nuk hoqi dorë realisht nga gjenocidi dhe pastrimi etnik. Se ç’ndodhi në vazhdim e përshkruan Toni Bler në *Një rrugëtim*. Në dhjetor 1998 - shkruan ai, Padi Ashdaun (Paddy Ashdown) më dërgoi një shënim lidhur me vizitën e tij në rajon. Rezultonte se Milosheviqi, ndryshe nga sa premtonte, në fund të vitit 1998, ishte duke autorizuar një goditje të madhe serbe.<sup>4</sup> Bleri përmend edhe masakrën e Reçakut, të 15 janarit të vitit 1999, ku serbët ekzekutuan dyzetepesë fshatarë shqiptarë, shkruan për vazhdimin e dënimeve të shqiptarëve dhe zgjerimin e pastrimit etnik. Me mijëra njerëz vdisnin, thotë ai.<sup>5</sup>

Gjashtë muaj më pas, ajo që u nis në tetorin e 1998, do të vihej në jetë, NATO-ja e sulmoi ish-Jugosllavinë. Veprimet që u ndërmoren dhe shkaqet imediate të fillimit të sulmeve ajrore i shpjegon me qartësi ish-presidenti i SHBA-së, Bill Klinton. Ai thotë: “Në janar të vitit 1999, serbët filluan të vrisnin sërish kosovarë të pafajshëm dhe kështu sulmet ajrore dukeshin të pashmangshme. Ne vendosëm të provonim diplomacinë edhe një herë, por nuk kishim shumë optimizëm. Objektivat e palëve ishin shumë larg njëra-tjetrës. Shtetet e Bashkuara dhe NATO-

---

<sup>2</sup> *Le Monde*, 22 mai 1999.

<sup>3</sup> Albright, Madeleine, - *Zonja Sekretare: autobiografi*. Tiranë: Dudaj, 2004. f. 454.

<sup>4</sup> Blair, Tony, - *Një rrugëtim*, Shtëpia botuese “55”, Tiranë 2011, f. 274.

<sup>5</sup> Po aty, f. 274.

ja donin që Kosova të gëzonte autonominë politike që kishte pasur nën kushtetutën jugosllave ndërmjet viteve 1974 dhe 1989, derisa ua hoqi Milosheviqi, si dhe dëshironim një forcë paqeruajtëse të drejtuar nga NATO-ja që të garantonte paqen dhe sigurinë e civilëve kosovarë, duke përfshirë këtu edhe minoritetin serb. Milosheviqi dëshironte ta mbante Kosovën nën kontroll dhe ishte kundër vendosjes të trupave të huaja ushtarake. Shqiptarët kosovarë kërkonin pavarësi.”<sup>6</sup> Sekretari amerikan i Mbrojtjes William Cohen, konstatonte se “vrasjet e tmerrshme masive në Kosovë dhe fotot e refugjatëve që i largoheshin shtypjes serbe e bënë të qartë se kishim të bënim me një krim kundër njerëzimit dhe gjenocid”.<sup>7</sup> Presidenti francez Shirak shprehet se “para bindjes së pajustificuar dhe të pakuptueshme të Presidentit Milosheviç, aleatët ranë dakord unanimisht se nuk kishte zgjidhje tjetër përveçse të intervenonin ushtarakisht, kundër objektivave të synuara serbe, me qëllim që të ndalohej një tragjedi që rrezikon gjithnjë e më shumë stabilitetin e Ballkanit”.<sup>8</sup>

Ato çka politika nuk arriti t’i shmangte në rrugë paqësore nuk do të vononin të provoheshin. Më 20 mars 1999, forcat e Beogradit ndërmorën sulmin e armatosur final, shoqëruar si gjithmonë me politikën e pastrimit etnik të shqiptarëve nga Kosova.

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan, duke rikujtuar agresionin e Serbisë ndaj Kosovës, shprehet se qysh në vitet 1980, ishin një varg aktesh represive që po kryheshin në kuadrin e gjenocidit të heshtur ndaj shqiptarëve të Kosovës. “Fushata e urryer e “pastrimit etnik”, vazhdon ai, e zhvilluar në mënyrë metodike nga autoritetet serbe në Kosovë, duket se ka si objektiv të vetëm, të përzërë ose të vrasë shqiptarë të Kosovës sa më shumë që të jetë e mundur, duke e privuar kështu një popull nga të drejtat më themelore të jetës... Megjithatë indinjata e thellë, e ringritur kudo në botë, përbën një shenjë që mban shpresën”,<sup>9</sup> shpresë që nuk mund të shpresohej, për sa kohë që në krye

<sup>6</sup> Klinton, Bill, - “*Ne luftën, ju paqen*”, “Albania”, Tiranë 2000. Klinton, Bill, *Jeta Ime*, Dudaj, Tiranë, 2005; f. 714.

<sup>7</sup> William Cohen, - *War in Europe, NATO’s war against Serbia over Kosovo*, në *FRONTLINE*, November, 2015.

<sup>8</sup> *AFP, AP* 13.4.1999.

<sup>9</sup> Annan, Kofi, - “*Interventions: A Life in War and Peace*”, Penguin Books, 2012. Pasojat e luftërave pushtuese serbe në Kosovë, gjatë shekujve kanë qenë të shumta dhe mizoritë të papërshkrueshme. Vetëm në vitet 1990-1995, sipas deklarimeve të palës kosovare në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, në Hagë, më shumë se 133 mijë shqiptarë u dëbuan nga vendet e tyre të punës, 25 mijë vetë u dëbuan nga shtëpitë, bizneset u plaçkitën, u vodhën ose u dogjën, 20 mijë u keqtrajtuat, u burgosën ose u bënë objekt i keqtrajtimit, rreth 2 mijë u vranë dhe mbi 250 mijë të

të ish-Jugosllavisë ishte Milosheviqi, për të cilin Toni Bler thoshte se vizionin e tij mesjetar e bëri ferr real në Evropën moderne.<sup>10</sup> Është një karakteristikë që ndeshet pothuajse gjithmonë pranë emrit të tij.<sup>11</sup> Edhe miku i serbëve, ministri i Jashtëm rus, e quajti një idiot të gatshëm për të filluar luftën.<sup>12</sup> Ish-ndihmëssekretari i shtetit, Morton Abramowitz, më 12 qershor 1998, deklaroi se “Perëndimi do të bëjë gjithçka që është e mundur për ta rrëzuar atë nga pushteti, duke përfshirë, nëse është e

---

tjerë emigruan në shtetet e Evropës Perëndimore. U mbyllën shkollat, gazetat, radio-televizionet kombëtare, u synua të shkatërrohej çdo dëshmi dhe prani e monumenteve kulturore, të shkatërroheshin xhamitë, kishat katolike, bibliotekat, shkollat, si dhe objektet e trashëgimisë kombëtare shqiptare. Por lista e humbjeve njerëzore dhe e dëmeve të luftës në Kosovë, nuk mbyllet me kaq. Ato vazhduan edhe gjatë viteve 1998-1999, periudhë që njihet si “Lufta në Kosovë”, e cila ka një inventar të përgjakshëm. Shifrat, për shkak të prejardhjes nga burime të ndryshme, nuk përkojnë gjithmonë. Flitet për 186 masakra, rreth 500 varreza masive në Kosovë dhe 5 varreza masive në Serbi, më tepër se 13 mijë të vrarë ose të djegur të gjallë, 1 595 persona të zhdukur, 20, 000 raste të dhunës seksuale, një pjesë e shoqëruar edhe me vrasje nga ushtarët jugosllavë, policia serbe ose forcat paramilitare. Vetëm në janar-qershor 1999 u dëbuan afro një milion shqiptarë ose 80 për qind e popullsisë, një dëbim masiv dhe i shpejtë i shumicës dërrmuese të popullatës të një vendi, i cili nuk kishte ndodhur as nga nazistët në Luftën e Dytë Botërore. Pothuajse 40 për qind e të gjitha shtëpive u dëmtuan ose u shkatërruan. Dëmet materiale arrijnë në së paku rreth 4 miliardë dollarë. (Të dhënat vijnë nga: *Çështja e reparacioneve për krimet e luftës të kryera në Kosovë në kontekstin e 'finales së madhe' eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë*, Nëntor 2019, Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA); Amnesty International, *Plagët që na djegin shpirtrat tanë: Kompensimi për të mbijetuarit e përdhunimit të luftës në Kosovë, por ende nuk ka drejtësi*. [https://www.amnesty.org/download/Documents/EUR7075582017\\_ENGLISH.PDF](https://www.amnesty.org/download/Documents/EUR7075582017_ENGLISH.PDF); Paul B. Spiegel & Peter Salama, *War and mortality in Kosovo, 1998-99: an epidemiological testimony*, *The Lancet*, 355(9222) (2000), 2204-2209; Central and East European Law Initiative of the American Bar Association and the American Association for the Advancement of Science, *Political Killings in Kosova/Kosovo*, Washington D.C., tetor 2000. Human Rights watch; *Nën urdhërat: Krimet e luftës në Kosovë* (2001), f. 121, gjëndet edhe në: [https://www.hrw.org/sites/default/files/reports/Under Orders En Combined.pdf](https://www.hrw.org/sites/default/files/reports/Under%20Orders%20En%20Combined.pdf). Amnesty International, *Një studim i Qendrës për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në Atlanta*, botuar në vitin 2000 në revistën mjekësore *Lancet*; *Studimi Vrasjet politike në Kosovë*, botuar në tetor 2000, nga Iniciativa Ligjore e Evropës Qendrore dhe Lindore (CEELI), e Shoqatës Amerikane të Avokatëve dhe Shoqatës Amerikane për Avancimin e Shkencës (AAAS), Human Rights Watch; Aktgjykim, Prokuroria e Tribunalit të Hagës, Vëllimi 1, prej 4, [https://www.icty.org/cases/tjug/090226 vol 1, PDF](https://www.icty.org/cases/tjug/090226_vol_1.pdf).

<sup>10</sup> Blair,Toni,- *Për Shqiptarët*, “ALBPAPER”, Tiranë, 2005,f. 66.

<sup>11</sup> Po aty, f. 121.

<sup>12</sup> Gecaj, Bajram,- *Konferenca e Rambujesë*, AIKD, Prishtinë, 2009, f. 57.

nevojshme, mbështetjen dhe armatosjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.<sup>13</sup>

Toni Bleri dhe Joshka Fischer tregojnë lojën e Milosheviqit me ndërkombëtarët. Sipas tyre ai nënshkroi 18 marrëveshje për armëpushim dhe nuk respektoi asnjërën prej tyre.<sup>14</sup> Nuk respektoi as edhe 73 rezolutat e miratuara nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së.<sup>15</sup> Ishin një seri veprimesh simetrike me strategjinë dhe taktikat mashtruese që ndjek sot Vuçiçi, pasardhësi i denjë i Milosheviqit në marrëdhënie me Kosovën dhe faktorin ndërkombëtar. Edhe ky ka nënshkruar një numër marrëveshjesh me Kosovën dhe faktorin ndërkombëtar, të cilat nuk i përfill.

Në këto rrethana, bashkësia ndërkombëtare e asaj kohe, veçanërisht elementët realistë dhe objektivë, duke mbajtur parasysh edhe përvojën më shumë se njëshekullore, nuk e patën të vështirë të kuptonin që strategjia e Beogradit ishte qartësisht e orientuar drejt shfarosjes së një bashkësie kombëtare, racore ose fetare, nëpërmjet vrasjeve në masë, dëbimit dhe ndryshimit të përbërjes demografike. Përballë kësaj tabloje të zymtë zhvillimesh, dolën në konkluzionin se tolerimi i krimeve serbe mund të shoqërohej me pasoja të paparashikuara, prandaj, siç u shpreh Komisionerja e Lartë për të drejtat e njeriut, Mary Robinson, lufta ishte bërë mjeti i vendosjes së paqes.<sup>16</sup>

Toni Bler ishte ndër ata që e kishte kuptuar herët qëllimin dhe strategjinë e Milosheviqit. Këtë e tregon edhe historiani gjerman Holm Sundhaussen, i cili shkruan se një ndër mbështetësit më të vendosur të ndërhyrjes ushtarake në Jugosllavi ishte Toni Bler. Ai, qysh në maj 1997, kishte nisur një kthesë në politikën britanike ndaj Ballkanit, sepse mendonte që politika e nënshtrimit ndaj Milosheviqit kishte dështuar, se nuk duhej lejuar përsëritja e një “Bosnje të dytë” dhe se bashkësia botërore, në emër të përgjegjësisë ndërkombëtare për mbrojtje, e ka për detyrim të mbrojë popullsinë civile në ato shtete, ku nuk mund apo nuk duan ta garantojnë.<sup>17</sup> Ai thotë gjithashtu se NATO-ja vendosi të

<sup>13</sup> FELTONI Rambuje - ultimatum për bombardim (1): 12. shkurt 2024. Burim: Kosovo Online; (7): Sekretarja e Shtetit imponon bombardimin, Shkruan për Kosovo online: Biseniq, Dragan,- Telegraf

<sup>14</sup> Blair, Toni,- *Për Shqiptarët*, ‘ALBPAPER’, Tiranë, 2005, f. 37.

<sup>15</sup> Fischer, Joschka,- *Vitet kuq-gjelbër*, Koha, Prishtinë, 2008, f. 221.

<sup>16</sup> Nations Unies, E, Conseil Économique et Social, Distribution Générale, E/CN.4/1999/SR.62, 18 juin 1999, Commission des Droits de l’Homme, Cinquante-cinquième session, *Compte rendu analytique de la 62ème séance*, tenue au Palais des Nations, à Genève, le vendredi 30 avril 1999.

<sup>17</sup> Holm Sundhaussen, - *Jugoslawien und seine Nachfolgestaaten 1943-2011*, Böhlau Verlag Wien · Köln · Weimar, 2012.

ndërhynte nën presionin e Blerit, madje edhe pa mandatin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke “shkelur” të drejtën ndërkombëtare. Por, po ai pohon se një Komision i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, në raportin e vitit 2000, kishte arritur në përfundim se ndërhyrja ushtarake e NATO-s ishte “legjitime”.<sup>18</sup>

Megjithëse kanë kaluar më shumë se 25 vjet nga përfundimi i luftës në Kosovë, duket se Beogradi ende nuk ka nxjerrë mësim nga e kaluara e tij. Veprimet e tij agresive të llojit të sulmit të Banjskës në veriun e Kosovës (shtator 2023), si dhe grumbullimet dhe afrimi i reparteve ushtarake serbe në rajonin e Kamenicës, në shtator-tetorin e vitit 2024, tregojnë se Serbia është mjaft e distancuar nga vlerat demokratike dhe njerëzore dhe vazhdon të jetë e lidhur shumë ngushtë me politikën e saj tradicionale të gjenocidit.<sup>19</sup>

Presidenti Klinton dhe drejtuesit e NATO-s, në emër të shpëtimit të jetës, vendosën të bombardonin ish-Jugosllavinë.<sup>20</sup>

Atmosferën e atyre ditëve e përshkruan në mënyrë koncize Ismail Kadare. Në shënimin e datës 23 mars 1999, të *Ditarit* të tij, ai shkruan: “Ka diçka prej vdekjeje, prej kishe, prej kambane mortore në skenën që shohim në televizion. Vëzhguesit e fundit të OSBE-së po ikin nga Kosova. Po largohen ata që e mbrojtën, që e deshën, William Wallker. Qindra të tjerë, midis të cilëve mikeshja jonë franceze, Miriam Gaume. Përpiqem të marr me mend atë që po ndodh. Pas çdo makine që largohet, Kosova duhet të ngjajë edhe më e shurdhër. E braktisur në mëshirë të fatit. Pa dëshmitarë... Ata ikin sepse atje s’mund të pritet veçse një gjëmë. Veç qoftë e shkurtër. Kosovarët e ndiejnë me siguri. E kanë ditur gjithmonë qyshse i kanë hyrë kësaj rruge. Kjo e bën flijimin e tyre edhe më të madhërishtëm. Midis heshtjes, një popull i tërë po pranon të vërë kokën në satër. Për të paguar çmimin e lirisë. Nuk i ndodh çdokujt një gjë e tillë.”<sup>21</sup>

Pak minuta pas fillimit të sulmit ajror, presidenti Klinton, në një dalje në Shtëpinë e Bardhë, iu drejtua amerikanëve duke iu thënë se “sot Forcat e Armatosura i janë bashkuar aleatëve tanë të NATO-s në sulme ajrore kundër forcave serbe, të cilat janë përgjegjëse për brutalitetin në

---

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> Albin Kurti, - *Vuçiq në koordinim me Rusinë, mbi varrezat masive, po përgatit kërcënime dhe ultimatumet të reja ndaj Kosovës*, Agjencia Telegrafike Shqiptare, 13 shtator 2024.

<sup>20</sup> Klinton, Bill, - “*Ne luftën, ju paqen*”, “Albania”, Tiranë 2000. Clinton Bill, *Jeta Ime*, Dudaj, Tiranë, 2005; f. 714.

<sup>21</sup> Kadare, Ismail, - *Ditari për Kosovën*, 23-24 mars 1999.

Kosovë. Ne kemi vepruar me vendosmëri për disa arsye. Kemi vepruar për të mbrojtur mijëra njerëz të pafajshëm në Kosovë nga ofensiva ushtarake që vazhdon të rritet. Kemi vepruar për të ndaluar një luftë më të gjerë, shpërthimin e një fuçie baruti në zemër të Evropës që ka plasur dy herë në këtë shekull me rezultate katastrofike. Dhe ne kemi vepruar për të qëndruar të bashkuar me aleatët tanë për paqen. Duke vepruar tani, po mbështesim vlerat tona, mbrojmë interesat tona dhe avancojmë kauzën e paqes. Sot, dua t'ju flas ju për tragjedinë në Kosovë dhe përse i intereson Amerikës të punojë me aleatët për dhënien fund të saj. Fillimisht, me lejoni të shpjegoj se kujt po i përgjigjemi... Në 1989, lideri serb Slobodan Milosheviqi, i njëjti lider që nisi luftërat në Bosnjë dhe Kroaci dhe lëvizti kundër Sllovenisë në dekadën e fundit, i hoqi Kosovës autonominë kushtetuese që populli i saj gëzonte, duke u mohuar atyre të flasin gjuhën e tyre dhe të shkojnë në shkollat e tyre. Për vite me radhë, kosovarët kanë luftuar paqësisht për të rikthyer të drejtat e veta...”.<sup>22</sup> Sqaroi se liderët serbë kanë refuzuar të diskutojnë madje edhe elemente kyçe të marrëveshjes së paqes. Kur kosovarët i thanë “po” paqes, Serbia stacionoi 40, 000 trupa në Kosovë, për t’u përgatitur për një ofensivë të madhe në shkelje të qartë të angazhimeve që ata kishin marrë.<sup>23</sup>

Shtypi amerikan dha hollësi të tjera rreth zhvillimeve të asaj dite. Midis tyre bëhej me dije se “sulmi i NATO-s vjen një ditë pasi i dërguari i lartë i SHBA-së, Richard Holbrooke dështoi në një përpjekje të minutës së fundit për të bindur presidentin jugosllav Slobodan Milosheviqi të bjerë dakord për planin e Kosovës, i cili do të jepte një autonomi paksa më të gjerë lokale për shqiptarët etnikë, por jo pavarësinë, shkëputjen nga Serbia”.<sup>24</sup>

Ishte me sa duket akti i fundit i asaj që me të drejtë u quajt “diplomaci ndëshkuese”.<sup>25</sup> Të nesërmen Hollbruk-u shkoi në Bruksel, në selinë e NATO-s, ku informoi se bisedimet nuk patën rezultat. Situata nuk kishte qenë ndonjëherë kaq e errët sa kësaj radhe.<sup>26</sup>

<sup>22</sup> *Sulmi i SHBA-së dhe i NATO-së kundër Jugosllavisë filloi me shpërthimin e bombave mbi Beograd*, 24 Mars 2019.

<sup>23</sup> Citohet nga *Newsbomb*, 24 Mars 2024, 25 vjet nga sulmi i NATO-s ndaj ish-Jugosllavisë, si dhe Klinton, Bill, - *Jeta Ime*, Dudaj, Tiranë, 2005, f. 714.

<sup>24</sup> *Sulmi i SHBA-ve dhe NATO-së mbi Jugosllavi filloi me shpërthimin e bombave mbi Beograd*, 24 Mars 2019.

<sup>25</sup> Leurdiq, Dick A., - *Kosovo: A case of 'coercive diplomacy*, Helsinki Monitor, 10 (2), 1999, pp.8-18.

<sup>26</sup> *ATS, AFP*, 22.3.1999, 23.3.1999, 24.3.1999.

Klintoni shpjegoi qëllimet kryesore të fushatës së bombardimeve, e cila synonte “t’i tregonte Milosheviç-it se ne e kishim seriozisht se donim të ndalonim një valë tjetër të spastrimit etnik, se donim të shmangnim një sulm akoma më të përgjakshëm kundër civilëve të pafajshëm në Kosovë dhe që, nëse Milosheviç-i nuk do të dorëzohej së shpejti, ne do ta dëmtonim seriozisht kapacitetin ushtarak të Serbisë.”<sup>27</sup>

Arsyetimeve dhe sqarimeve të veta për synimin e NATO-s dhe aleatëve perëndimorë gjatë ndërhyrjes në Jugosllavi për konfliktin në Kosovë, presidenti Klinton, iu është rikthyer shumë herë më pas. Në prillin e vitit 1999, duke shprehur shqetësimin e përhapjes së konfliktit përtej ish-Jugosllavisë, ai thoshte se “ne duam ta mbytim që në vezë këtë konflikt përpara se ai të destabilizojë gjithë Evropën.”<sup>28</sup> Njoftimet e AFP-së, të datës 27 mars 1999, bënë të ditur se Presidenti Klinton kishte deklaruar disa orë më parë që operacionet ajrore të NATO-s në Jugosllavi do të vazhdonin “derisa drejtuesi serb Slobodan Milosheviqi, të pranojë paqen ose deri kur ne të kemi zvogëluar seriozisht aftësinë e saj për të bërë luftë”. Ai shtonte se SHBA-ja dhe aleatët e vet ishin shtrënguar të vepronin për “t’i hequr fitilin një fuçie baruti në zemër të Evropës dhe për të shmangur një zgjerim të luftës”.<sup>29</sup> Këto fjalë që dolën nga goja e liderit të SHBA-së, që ishin në pajtim me mendimin e liderëve të tjerë evropianë, përbëjnë në vetvete arsyetimin më të plotë dhe më bindës të legjitimitetit të ndërhyrjes së NATO-s në ish-Jugosllavi.

Një tjetër personalitet i asaj kohe, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, duke deklaruar se aleanca veriatlantike kishte ndërmarrë sulmin ajror ushtarak kundër Jugosllavisë e mbetur (Serbi, Mali i Zi, Vojvodinë dhe Kosovë) dhe se kishin filluar zyrtarisht bombardimet, u shpreh se kishte ardhur koha për veprim. Ato u udhëhoqën nga gjenerali amerikan Clarck.<sup>30</sup>

Presidenti francez Zhak Shiraku (Jacques Chirac), shpjegoi qëndrimin e vendit të vet duke thënë se Franca po merrte pjesë në sulmet ajrore të NATO-s, sepse Serbia kishte demonstruar “sjellje të paprueshme për shumë kohë në lidhje me shqiptarët e Kosovës”. “Unë e

---

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> AFP, AP 13.4.1999.

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> *1st April 1999 Joint Press Conference with NATO Secretary General, Dr. Javier Solana and General Wesley Clark, SACEUR concerning the crisis in Kosovo. Transcript of Press Conference, Washington, 23 Apr. 1999.*

di, vazhdonte ai, se populli francez do të kuptojë që duhet të veprojmë”.<sup>31</sup>

Nuk ishte e lehtë të bëheshin bashkë të gjithë këta faktorë, që në fund të fundit, të prodhonin zgjidhjen e dëshiruar, që agresori jo vetëm të ndëshkohej për veprimet ose mosveprimet ndërkombëtarisht të paligjshme, por edhe të frenohej dhe ndalohej, për të mos shkaktuar pasoja të tjera ndaj njerëzve të pafajshëm.

## Ndërhyrja - reagim *in extremis* në ish-Jugosllavi

Reagimi violent i bashkësisë ndërkombëtare ndaj ish-Jugosllavisë u ndërмор dhe u realizua në rrethana ekstreme. U imponua nga fushata e pastrimit etnik e ndërmarrë nga Milosheviqi, e cila kishte shuar çdo shpresë për zgjidhje të arsyeshme. U imponua kur kishin dështuar qindra demarshe me karakter paqësor për ta ndaluar atë dhe kur bashkësia ndërkombëtare nuk mund të qëndronte spektatore përballë përsëritjes së një tragjedie me përmasa apokaliptike të shfarosjes së një populli, akti i parë i së cilës ishte luajtur kohë më parë në Bosnjë e Hercegovinë. Prandaj, kishte një numër të pambarimtë politikanësh, përfaqësues të shoqërisë civile, studiues etj. që u rreshtuan përnjëherësh, pa rezerva, për zgjidhjen që kishte gjetur NATO-ja. Sipas tyre bëhej fjalë për një reagim *in extremis*, një ndërhyrje për të ndaluar zhdukjen e shqiptarëve të Kosovës.

Në bazë të përcaktimeve themelore në të drejtën ndërkombëtare dhe praktikës së deriatëhershme, ndërhyrja duhet të autorizohet nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Mirëpo kjo, për shkak të kompozimit politik tepër heterogjen të tij, kishte zero shanse të realizohej. Prandaj ideatorët dhe ata që morën vendimin e rëndësishëm për nisjen e bombardimeve mbi territorin e ish-Jugosllavisë, iu drejtuan alternativave të tjera, instrumenteve juridike të ofruar nga e drejta ndërkombëtare në këto raste, për ta anashkaluar KS të OKB-së.

Kjo e fundit ka përcaktuar se, kur një shtet e shkel atë mund të përballlet jo vetëm me kundërpërgjigje individuale nga shteti i cenuar, por edhe me kundërpërgjigjen e një grupi shtetesh të bashkuar nëpër-

<sup>31</sup> Hoxha, Mentor, - *Zhak Shirak, Presidenti më proshqiptar në historinë e Francës. Meriton një shtatore gjigande në Tiranë dhe Prishtinë. Ja 7 arsyt.* Gazeta Fjala, 05/04/2022.

mjet në traktati ose një organizate ndërkombëtare. Në rastin e bombardimeve në ish-Jugosllavi, ato ishin produkt i reagimit kolektiv që erdhi si domosdoshmëri vështirë e kontestueshme.

## Ndërhyrja e NATO-s, legjitime apo cenim sovraniteti?

Që në orët e para të inkursioneve bombarduese të avionëve të NATO-s kundër ish-Jugosllavisë, do të shpërthente një fushatë tjetër, tashmë në terrenin teoriko-juridik në forumet diplomatike dhe ato mediatike. Thelbi kishte të bënte me legjitimitetin ose me kualifikimin juridiko-ndërkombëtar të tyre si cenim i sovranitetit të ish-Jugosllavisë.

Trajtimi duhet të fillonte nga përgjigjja për pyetjen nëse në vitin 1998-1999, në Kosovë kishte shkelje masive, sistematike, të rënda të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, nëse kishte politika të pastrimit etnik, të gjenocidit, krime kundër njerëzimit etj. që të përlligjej ndërhyrja e armatosur në punët e brendshme të ish-Jugosllavisë për qëllime humanitare. Me të lidhet ngushtë aspekti procedural, që nëse po, kush e kishte kompetencën juridiko-institucionale të autorizonte ndërhyrjen, kur, ku dhe si duhej të vepronte?

Përgjigjja mund të ishte në dy alternativa, pohuese dhe mohuese dhe mund të mbështetej në shkollë, teori, rryma shkencore etj. që, përgjithësisht, shprehin interesa të caktuara politike të shteteve, aleancave, organizatave ndërkombëtare etj.

## Justifikimet e agresorit dhe aleatëve të vet

Njëra përgjigje vinte nga autorët dhe aktorët e krimeve të viteve 1998/1999 në territorin e Kosovës, të cilët kanë punuar për kultivimin e një ndjenje vetëviktimizeuese, me qëllim fshehjen e krimeve dhe mohimin e përgjegjësisë juridiko-ndërkombëtare.

Për këtë janë përpjekur të krijojnë një simetri artificiale duke deklaruar se të gjithë popujt që kanë luftuar në hapësirën e ish-Jugosllavisë kanë bërë krime. Sipas tyre, bombardimet e NATO-s kundër regjimit të Millosheviqit ishin të paligjshme dhe i krahasonin me agresionin fashist të Luftës së Dytë Botërore, ndërsa mijëra civilët e ekzekutuar në Reçak, Krushë të Madhe, Krushë të Vogël, Likoshan, Qirez, Prekaz, Volljak, Suharekë, Kosovë, Pusto Selo, Rezallë, Gjakovë, Vushtrri, Korishë etj., i konsiderojnë si “viktima të ngjarjeve ushtarake”.

Shfajësoheshin duke interpretuar abuzivisht parimet e respektimit të sovranitetit, tërësisë territoriale, mosndërhyrjes në punët e brendshme etj. I ekspozonin të shkëputura nga konteksti i realiteteve konkrete politike e juridike dhe abstraktonin nga parimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e jetës njerëzore, integritetit fizik e moral të njeriut, respektimin e dinjitetit dhe të personalitetit të tij etj. Pikëpamjet e tyre gjejnë mbështetje edhe te disa studiues të së drejtës aktuale ndërkombëtare.

Në krye të listës së shteteve që iu referua me zell shkeljes së tërësisë territoriale dhe të sovranitetit shtetëror nga NATO-ja, gjendej protektorja tradicionale e Serbisë, Rusia. Ajo paraqiti në Këshillin e Sigurimit të OKB-së një projekt-rezolutë në të cilën, thuhej “se përdorimi i tillë i njëanshëm i forcës përbën shkelje flagrante të Kartës së Kombeve të Bashkuara”. Kundërshtimi i disa anëtarëve të përhershëm të Këshillit, bëri që rezoluta të mos miratohej.

Përçapja do të përsëritej sërish më 29 prill 1999. Kësaj here nga ish-Jugosllavia, e cila paraqiti ankesë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ) në Hagë, ndaj dhjetë vendeve anëtare të NATO-s (Belgjika, Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Italia, Kanada, Holandë, Portugali, Spanjë, dhe SHBA). Gjykata nuk vendosi, sepse ish-Jugosllavia nuk ishte anëtare e OKB-së gjatë luftës.

Kundërshtarë të bombardimeve të NATO-s pati edhe në disa vende të tjera, një prej të cilave ishte Britania e Madhe. Ish-Sekretari i Jashtëm, Malkolm Rifkind, ish-Kancelari i Thesarit, Norman Lamont, gazetarët Peter Hitchens dhe Simon Heffer e të tjerë, dolën hapur pro ish-Jugosllavisë.

Serbët nuk ngurronin t'i shpalosën qëndrimet e veta edhe në institucionet përkatëse ndërkombëtare. Midis tyre ishte Komisioni i të drejtave të njeriut të OKB (KDNj), aktualisht i quajtur Këshilli i të drejtave të njeriut. Në seancën e 26, të datës 30 mars 2001, të sesionit të 57, përfaqësuesja e Jugosllavisë, Boskoviç-Prodanoviç, u përpoq të përlligjte qëndrimet e vendit të vet, duke thënë, se “dhuna e vazhdueshme e ekstremistëve shqiptarë në Serbinë Jugore përbënte një kërcënim të madh për procesin e konsolidimit të demokracisë dhe po pengonte qeverinë nga trajtimi i nevojës për reforma ekonomike dhe vendosja e sundimit të ligjit.”<sup>32</sup> Duke iu drejtuar KDNj-së, kërkoi llogari se

<sup>32</sup> Nations Unies, E, Conseil Économique et Social, Distribution Générale, E/CN.4/1999/SR.62, 18 juin 1999, Commission des Droits de l'Homme, Cinquante-cinquième session, *Compte rendu analytique de la 62ème séance*, tenue au Palais des Nations, à Genève, le vendredi 30 avril 1999.

përse “nuk duket se ka shumë shqetësime për fatin e 1300 serbëve të zhdukur ose atyre të rrëmbyer *çdo ditë* në Kosovë.”<sup>33</sup> Presidenti i Serbisë, Vojslav Koshtunica do të shkonte në ekstrem. Anashkaloi krimet e serbëve ndaj kroatëve, boshnjakëve dhe shqiptarëve. Mori në mbrojtje vendin e tij, duke deklaruar se “populli jugosllav... u përball me sfidën e ndërtimit të një shoqërie të re dhe të lirë, duke luftuar *terrorizmin shqiptar*, gjë që nuk ishte detyrë e lehtë.”<sup>34</sup>

Fryma primitive antishqiptare, e ardhur nga skutat e *Naçertanies*, e përcjellë vit pas viti, për rreth një shekull e gjysmë, vazhdon të përsëritet edhe në ditët tona, tashmë në gojën e Vuçiçit, pasardhësit të denjë të Milosheviqit. Ky i fundit (Milosheviqi), në një takim me Wesley Clark-un<sup>35</sup>, në nëntor të vitit 1998, i tha ndër të tjera: “E di unë se si të merrem vesh me këta shqiptarët. E kemi bërë dhe më parë”. Në përgjigje të pyetjes së Clark-ut se si kishin vepruar, u shpreh lehtësisht, “i vrasim të gjithë”.<sup>36</sup> Është kjo fryma gjithë duf e antishqiptarizmit edhe e drejtuesve aktualë të Serbisë, midis të cilëve shquhet presidenti Vuçiç, zëvendëskryeministri Vulin, ministri i Brendshëm Daçiç etj.

Në mbrojtje të Milosheviqit në KDNJ dolën përfaqësues të disa shteteve, madje edhe vetë raportuesi i posaçëm për situatën e të drejtave të njeriut në Bosnjë e Hercegovinë, Republikën e Kroacisë dhe në Republikën Federale të Jugosllavisë, çeku Jiri Dienstbier, njëlloj Lajçaku (sllovaku) i asaj kohe. Për të zhvleftësuar rëndësinë e ndërhyrjes së NATO-s, arsyetoi se “Bombardimi ... dobësoi forcat demokratike dhe ndëshkoi popullin. Komuniteti ndërkombëtar kishte nevojë për një politikë gjithëpërfshirëse për nxitjen e shoqërisë civile dhe ndërtimin e demokracisë, në vend që të merrte veprim të precipituar.”<sup>37</sup> Në sintoni të plotë me të, përfaqësuesi i Rosisë, i bëri Jugosllavisë mbrojtjen më të kualifikuar dhe më të vendosur, duke i cilësuar veprimet e NATO-s kundër shtetit sovran të Jugosllavisë si agresion dhe dhunim flagrant të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të marrëveshjes ndërmjet NATO-s dhe Federatës së Rosisë...<sup>38</sup> Qëndrim të njëjtë adoptoi edhe Kina, e cila e quajti fushatën e NATO-s precedent të rrezikshëm, formë të re të

---

<sup>33</sup> Po aty.

<sup>34</sup> Po aty.

<sup>35</sup> Me të po firmoste marrëveshjen për tërheqjen e forcave të tepërta serbe nga Kosova, në zbatim të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që kërkonte largimin e tyre.

<sup>36</sup> “Me shqiptarët e kemi bërë edhe më parë. I vrasim të gjithë”, gjenerali Wesley Clark tregon çka i tha Millosheviqi në vitin 1998, gazeta *Telegrafi*, 24.03.24.

<sup>37</sup> Po aty.

<sup>38</sup> E/CN.4/1999/SR.14, p. 18.E/CN.4/1999/SR.13, page 3.

“kolonializmit”, luftë agresive të pambështetur në moral apo në ligj, pjesë të një komploti amerikan për të shkatërruar Jugosllavinë etj.<sup>39</sup>

E tillë ishte edhe fryma e fjalës së përfaqësueses së Indisë, të cilën e “preokuptonte” ruajtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të ku-fijve ndërkombëtarë të RFJ-së...<sup>40</sup> Këta dhe të tjerë që i dolën në krah ish-Jugosllavisë, për të mbrojtur agresionin dhe dhunimin e të drejtave të njeriut, operonin me arsyetime sofiste.

## Luftë për paqen jo për humanizmin

Në të drejtën ndërkombëtare është përvijuar bashkëjetesa dhe për-plasja e dy instituteve, bashkekzistencës paqësore, që duhet të ndikojë në të mirë të stabilitetit dhe sigurisë ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut. Aty takohen dhe ballafaqohen parimet e mosndërhyrjes, ndalimit të përdorimit të forcës dhe respektimit të sovranitetit, tërësisë territoriale nga njëra anë dhe të drejtave të njeriut nga ana tjetër. Insistohet se nuk mund të ketë mbrojtje të të drejtave të njeriut me anë të luftës, sepse ajo sjell vdekje, fatkeqësi, tragjedi dhe dështim për njerëzimin. Profesori spanjoll Jaime Oraa thekson se situata e të drejtave të njeriut në botën bashkëkohore po përjeton një paradoks të madh. Në një kohë kur në gjysmëshekullin e fundit jemi dëshmitarë të progresit të pamohueshëm, teorik, juridik dhe institucional të legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, jemi dëshmitarë edhe të shkeljeve të rënda të këtij të fundit. “Nuk bëhet fjalë vetëm për faktin se shekulli i 20-të mund të dëshmojë masakrat më të mëdha në historinë e njerëzimit, shpjegon ai, por më shumë për faktin se ekziston një situatë strukturore e shkeljes së këtyre të drejtave nga shumicat e mëdha.”<sup>41</sup> Por, sepse, siç shprehet José María Mendiluce, çdo “luftë është mizore në vetvete, është skenari ideal për akte veçanërisht mizore. Lufta nuk

<sup>39</sup> Po aty, si edhe në Frederking, Brian, - *The United States and the Security Council: Collective Security since the Cold War*, Routledge, 2007.

<sup>40</sup> E/CN.4/1999/SR.14 p. 16, Fjala e saj është botuar edhe nën kodin E/CN.4/1999/L.3.

<sup>41</sup> Oraa J., *La gran paradoja de los derechos humanos en el mundo contemporáneo*, në Marzal A. (ed.), *Los derechos humanos en el mundo*, Barcelona, J.M. Bosch/ESA-DE. Citohet nga David Sánchez Rubio, *Interventions humanitaires: principes, concepts et réalités*, në Alternatives Sud, VOLUME Vol.XI 2004/3, DATE 08/2004. CETRI. Interventions humanitaires? LA COLLECTION

është kurrë e pastër apo e pafajshme...”<sup>42</sup> Të njëjtin arsytim ndan edhe Tzvetan Todorov, i cili thotë se asnjë veprim që përfshin përdorimin e forcës së armatosur dhe merr pjesë në një situatë lufte, nuk është gjest humanitar, pavarësisht nga akrobacitë verbale që përdoren për ta paraqitur atë.<sup>43</sup>

Duket sikur me këtë pikëpamje bashkohet edhe Ian Brownlie, profesori i së drejtës ndërkombëtare në *London School of Economics*, një nga ndërkombëtaristët më të mëdhenj të kohës sonë. Ai arsyeton se “të pari më i spikatur i gjysmës së shekullit të kaluar është ndryshimi vendimtar i ndodhur nga një regjim juridik indiferent ndaj arsyeve për luftë, në të cilin ajo shihej kryesisht si një duel, një mjet për të sheshuar një mospajtim privat, në një regjim juridik që ka vendosur kufizime thelbësore ndaj kompetencave të shteteve për t’iu drejtuar e përdorur forcën. Pas vitit 1928 efekti i akumuluar i Paktit Kellogg-Briand, i Paktit të Saavedra Lamas, i doktrinës Stimson, i praktikave shtetërore gjatë periudhës 1928-1942, i luftës së sanksioneve të zhvilluar kundër fuqive të Aksit, i Kartës së Nurembergut, parimet e së cilës u afirmuan më pas nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe i Kartës së Kombeve të Bashkuara, ishte të themelohej ndalimi i shprehur i përdorimit të forcës për qëllime vetjake.”<sup>44</sup> Brownlie, me këtë mentalitet, nëpërmjet interpretimesh të sforcuara, zhgënjeu shumë ithtarë të tij, sepse arriti deri aty sa, në emër të respektimit të procedurave formale, nuk e quajti gjenocid krimin makabër serb në Bosnjë e Hercegovinë dhe u rreshtua në anën e Serbisë.

Me këtë mendim janë bashkuar gjithashtu studiuesit gjermanë, Wolff Heintschel von Heinegg dhe Michael N. Schmitt, të cilët shkruajnë që, nëse pyetet për opinionin mbizotërues, bombardimi i NATO-s ishte shkelje e së drejtës ndërkombëtare, sepse paraprakisht ishte thënë se masat ushtarake kundër Serbisë do të ndërmerren vetëm me miratimin e Këshillit të Sigurimit.<sup>45</sup>

---

<sup>42</sup> Mendiluce, José María,- *La nueva política. Por una globalización democrática*, Barcelona, 2002, Planeta.

<sup>43</sup> Todorov, Tzvetan,- *Imperfect Garden: The Legacy of Humanism*, 2002, Published by: Princeton University Press, p. 316.

<sup>44</sup> Brownlie, Ian, - *International Law and the Use of Force by States*, 1st edition, Clarendon Press (1991).

<sup>45</sup> Von Heinegg, Wolff Heintschel & N. Schmitt, Michael,- *Detention and Occupation in International Humanitarian Law*, Published June 10, 2019 by Routledge.

Ndërkohë, Charles R. Beitz dhe Ernesto Garzón Valdés, deklarojnë se problemi i vërtetë etik i të ashtuquajturave veprime luftarake humanitare nuk qëndron në konfliktin midis parimit të mosndërhyrjes dhe atij të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por më tepër në faktin se këto janë operacione të armatosura të cilat, si të tilla, mund të çojnë në vdekje dhe viktima si në popullatën e vendit në të cilin kryhet ndërhyrja, ashtu edhe tek ushtarët e vetë aktorëve. Kjo rezulton në keqinterpretimin se për të mbrojtur të drejtat e një grupi, bëhet e nevojshme që të shkelen ato të një grupi tjetër.<sup>46</sup>

Ky grup “argumentesh”, ishin shkëputur nga konteksti i realiteve konkrete politike e juridike dhe trajtoheshin në mënyrë metafizike. Abstraktohet nga realitetet konkrete, më interpretive abuzive çohet deri në ekstrem vlera e parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe shpërfilleshin krejt ose minimizoheshin një pjesë tjetër, pikërisht atë që kanë të bëjnë me mbrojtjen e jetës njerëzore, integritetit fizik e moral të njeriut, respektimin e dinjitetit dhe personalitetit të tij etj. të cilat janë edhe një ndër misionet kryesore të së drejtës në tërësi.

Qartësisht dallohet përpjekja për të marrë në mbrojtje interesa politike të shteteve, aleancave, organizatave ndërkombëtare etj. në radhë të parë, ato të Serbisë. Ata përsërisin pak a shumë njëri-tjetrin. Siç ndodh rëndom në politikën dhe doktrinën ndërkombëtare, kërkojnë ta thjeshtësojnë deri në tejskaj ngjarjen duke u zhytur në “baltën e pozitivizmit juridik”, siç shprehet shumë saktë Martin Wight.<sup>47</sup>

## Perëndimi në krah të Serbisë

Sulmi i NATO-s në ish-Jugosllavi që, së bashku me faktorë të tjerë, solli lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, për çka janë të pafundme mirënjohja dhe veneracioni i shqiptarëve kudo ku jetojnë, bëri që në të ardhmen të ndodhte një ndryshim i paimagjinueshëm. Miqësia me SHBA-në, BE-në dhe shtetet që iu ndodhën në krah për fitoren e lirisë, ishin bërë pikë reference për çdo hap të saj. Mirëpo, kohët e fundit,

<sup>46</sup> *Dictatorship and Punishment: a Reply to Scanlon and Teitel*, në Harold Hongju Koh and Ronald C. Slye (eds.), *Deliberative Democracy and Human Rights*, New Haven/London 1999, p. 291-300. Ernesto Garzón Valdés, “Guerra e diritti umani”, *Región Practica*, n° 13, 1999, p. 47.

<sup>47</sup> Wight, Martin, - *Power politics: the definitive study of international relations*, Publisher West Drayton: Penguin, 1986.

duket sikur nga ana e atyre që kontribuuan për lirinë, ka një ftohje politike. Në mjediset politike e sociale serbe ky qëndrim ka inkurajuar zërat anti NATO, si dhe ka zgjuar prirjet aneksioniste ndaj Kosovës etj. Është përsëritur akuza ndaj koalicionit aleat që ndërmori bombardimet në Kosovë, është përgënjeshtuar numri i të vrarëve, të plagosurve, shkatërrimet, shifrat e krimeve të gjenocidit, pastrimit etnik, krimeve të luftës etj, të deklaruara nga ndërkombëtarët.<sup>48</sup> Beogradi, që shihej si faktori dhe përgjegjësi i asaj çka ndodhi në Kosovë dhe personalisht Vuçiçi, ish-ministër në kohën e masakrave ndaj boshnjakëve dhe kosovarëve dhe sekretar i Partisë Radikale e më pas funksionar në Partinë Progresive Serbe, i shpallur *persona nongrata* nga BE-ja në maj të vitit 1999<sup>49</sup> dhe nga SHBA-ja në vitet 2000-2001, filloi të afrohej nga Perëndimi. Ishte pikërisht ai që më 23 prill 1999 deklaronte se “kriminelë të tillë si Bill Klinton dhe Toni Bler nuk mund të kenë lindur nga ndonjë nënë. Dënimi do t'i arrijë ata. Ata janë kriminelët dhe bishat më të mëdha. Hitleri ishte vetëm një fëmijë i vogël në krahasim me ta.”<sup>50</sup> Ishte ai, që në seancën e 20 korrikut të vitit 1995 të parlamentit serb kishte deklaruar se për një serb të vrarë në Bosnjë, Serbia do të vrasë 100 myslimanë. Dhe e mbajti fjalën, së bashku me bashkëpunëtorët e vet, në krye të ish-Jugosllavisë, vranë disa qindra mijëra njerëz të pafajshëm. Ky njeri, me rrethin e vet nuk ngurrojnë të përsërisin kërcënimet ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, për të cilat Perëndimi ka vendosur edhe sanksione që duken të pamotivuara, ndërkohë që liderë evropianë vizitojnë Beogradin, e përqafojnë dhe iu rrahin shpatullat Vuçiçit dhe drejtuesve të tjerë serbë.

Metamorfoza e lartpërmendur, jo lehtësisht e shpjegueshme, ka edhe një tjetër aspekt. Teksa Vuçiçi dhe grupi i tij, mbrohen, shfajësohen, amnistohen, liderët e luftës së Kosovës, prej disa vjetësh, janë

---

<sup>48</sup> Joseph Farah (1999-11-29). "The Real War Crimes". WorldNetDaily. <http://www.worldnetdaily.com/news/> Phyllis Schlafly (1999-10-19). "Numbers Game in Kosovo". Washington Times.

<sup>49</sup> Bashkimi Evropian më 10 maj 1999 publikoi një listë të zezë, në krye të së cilës ishte Millosheviqi dhe bashkëpunëtorët e tij, ndër të cilët kriminelë të luftës, si ministri i atëhershëm serb i Informacionit, A. Vuçiç, njëkohësisht edhe një nga udhëheqësit e Partisë Radikale, Vojislav Shesheli, zëvendëskryeministër, Velko Odalloviq, zëvendësshëf për “Qarkun” e Kosovës, qeveritarë dhe ushtarakë përgjegjës për krimet dhe fushatën e spastrimit etnik në Kosovë. *Kur Vuçiç ishte në listën e zezë të BE-së*, Revista *Kosovarja* 25 shtator, 2023.

<sup>50</sup> *Ludington Daily News* (23 prill 1999). *NATO strikes Serbian television's main studio*.

mbyllur në Dhomat e Specializuara të Kosovës, në Hagë, ku po gjykohen dhe, siç dëgjohet, mund të dënohen me prova të diskutueshme. Qëndron ende në krye të Serbisë Vuçiçi dhe grupi që ideoi dhe kreu krime që, për egërsinë, kapërcejnë të gjitha caqet e imagjinatës njerëzore,<sup>51</sup> ai që e shndërroi ish-Jugosllavinë, posaçërisht Kosovën, në varrezë, që e mbushi me male kufomash dhe lumenj gjaku, që e ktheu në depo gjigande avionësh, raketash, dronësh luftarakë, tankesh dhe armatimesh moderne<sup>52</sup> dhe rrinë në burg ata që udhëhoqën luftën e UÇK-së.

Rasti i Vuçiçit përforcon atë që përsëritet shpesh se, jo rrallëherë jeta e shoqërisë, karakterizohet nga veprimi me standarde të dyfishta,

<sup>51</sup> Sillet si dëshmi një ngjarje tepër e vështirë për t'u treguar, e cila ka ndodhur në Prishtinë, në vitin 1999. Forcat serbe, që kishin kapur avokatin Bajram Kelmendi dhe dy djemtë e tij, i kërkuan që të vriste një nga djemtë. Kur nuk pranoi iu propozua djalit të madh që të vriste babanë, i cili gjithashtu refuzoi. Pastaj oficerët e policisë e pyetën se cilin duhet të vrisnin të parin, dhe, me gjithë thirrjen e dëshpëruar të avokatit, qëlluan dy djemtë e tij dhe 30 sekonda më vonë e qëlluan edhe atë. Ky rast makabër dëshmon se deri ku shkonte perversiteti kriminal institucional, cinik dhe çnjerëzor i një regjimi dhe i mijëra njerëzve në shërbim të tij, të ushqyer deri në tërbim me ndjenjën mesjetare të ekspansionizmit ndaj Kosovës dhe kosovarëve. Citohet nga Krisafi, Ksenofon, - *Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike*, UMSHPRESS, Tiranë, 2018.

<sup>52</sup> Shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josef Borell, i ngarkuari me dialogun Serbi Kosovë, Miroslav Lajçak dhe jo pak të tjerë që zbresin çdo muaj në Ballkan, në Beograd a në Prishtinë, kërkojnë paseshtur nga Kosova dhe Serbia që të “merren vesh” dhe të zgjidhin problemet. Gjithmonë e fillojnë fjalinë me Kosovën, viktimën e gjenocidit dhe pastrimit etnik të Serbisë. I thonë të cedojë dhe të plotësojë kërkesat tekanoze të Beogradit. Nuk harrojnë të përsërisin domosdoshmërinë e respektimit të normave dhe parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare, të cilat fillojnë me parimin e barazisë, pastaj reciprocitetin, më tej respektimin e sovranitetit shtetëror dhe tërësisë territoriale, fqinjësinë e mirë, mosndërhyrjen në punët e brendshme të njëri-tjetrit. Por gjithë kostot e “zgjidhjes” ia kërkojnë viktimës, Kosovës asaj që i ka respektuar me korrektësi shembullore. Kjo nuk është zgjidhje. Zgjidhja vjen kur Vuçiçi të përgjigjet për krimet në Kosovë. Është thënë se ky qëndrim mbahet për ta shkëputur Serbinë nga Rusia, ndërkohë që ai vetë ndërsa deklaroi se Serbia do të mbajë neutralitetin ushtarak dhe do të vazhdojë të ndërtojë një partneritet me NATO-n, forcon pa reshtur lidhjet politike e ushtarake me Rusinë. *Vuçiç betohet si President i Serbisë: Kosova është pjesë e vendit tonë*, në Time.ikub.al. 31 Maj 2017. Tabloja e raporteve të Perëndimit me Serbinë, nuk mund të mos sjellë ndërmend deklarimin e kryetarit të Konferencës së Ambasadorëve, Eduard Greji, 111 vjet më parë, më 10 gusht 1913, kur u shpreh se vendimet e saj për copëtimin e tokave shqiptare dhe sakrifikimin e Shqipërisë, u bënë për të siguruar paqen në Evropë, që nuk e bënë dot, sepse dy vjet më pas shpërtheu Lufta e Parë Botërore dhe ajo ishte e para që u gëlltit. Ky episod tregon se Shqipërisë dhe shqiptarëve iu është ngarkuar roli i “kurbanit” të paqes evropiane.

njëri për trajtimin e njerëzve ose popujve të zakonshëm, të cilët shpërfillen dhe sakrifikohen rëndom dhe tjetri për atë të politikanëve dhe popujve “të llastuar” nga ndonjë segment i Evropës politike. Ndonjëherë e drejta, duke operuar sipas maksimës së njohur *la raison du plus fort est toujours la meilleure*, mbron të mëdhenjtë, të fuqishmit, të cilët i imponohen pjesës tjetër. Ndërkombëtaristi Antonio Cassese thotë se “fuqitë e mëdha dhe të mesme e lënë qëllimisht të drejtën në gjendjen e pasaktësisë dhe pasigurisë, në mos të paqartësisë. Në këtë mënyrë, ato mund të mbrojnë më lehtë interesat e tyre.”<sup>53</sup>

Serbët, duke shpërfillur atë çka thekson Hegeli, që i vetmi mësim nga historia, është se ne nuk mësojmë prej saj, prandaj e përsërisim me të gjitha gabimet dhe katastrofat e saj,<sup>54</sup> kanë përsëritur kurdoherë të kaluarën konfliktuale, duke tentuar ta fshijnë të vërtetën. Por, kësaj here nuk e patën të lehtë sepse, siç është shprehur Klintoni, ngjarjet në Kosovë krahasohen me ato të Holokaustit. “NATO-ja, me ndërhyrjen e saj donte të ndalte përpjekjet sistematike për pastrim etnik dhe gjenocid.”<sup>55</sup>

## Strategjia antishqiptare e Beogradit

Përballë apologjetëve të krimit serb qëndron një grup i madh politikanësh, diplomatësh, juristësh, studiuesish të së drejtës ndërkombëtare, përfaqësues të shoqërisë civile, etj. që nëpërmjet argumentesh bindëse, kanë mbrojtur juridikisht domosdoshmërinë e reagimit përmes ndërhyrjes së armatosur për qëllime humanitare, në ish-Jugosllavi dhe në Kosovë.

Argumenti më i qëndrueshëm që vjen prej tyre është se në Kosovë, aktet sistematike të përgjakjes së popujve, të gjenocidit dhe të pastrimit etnik, kishin marrë format e një tragjedie, e cila luhej në mes të Evropës së qytetëruar, në vigjilje të mijëvjeçarit të tretë. Ato kanë

---

<sup>53</sup> Cassese, Antonio - *Violence et droit dans un monde divisé*, Paris, PUF, 1990, f. 61 e në vazhdim.

<sup>54</sup> Citohet nga Latifi, Blerim, - *Mbi Luftën e Tretë Botërore*, Gazeta Express, 6 Janar 2020

<sup>55</sup> Clinton, Bill, - (1999-06-25), *Press Conference by the President*. Phyllis Schlafly, *Numbers Game in Kosovo*, në *Washington Times*, 19 octobri 1999. Tipike është edhe Masakra në Krushë të Madhe, më 25-27 mars 1999, më e madhja në Kosovë, ku forcat serbe ekzekutuan 243 civilë shqiptarë, dogjën dhe shkatërruan 893 shtëpi private dhe shtetërore. Për të askush nuk është dënuar nga gjykatat e UNMIK-ut, EULEX-it, Kosovës, Serbisë dhe Hagës. Farah, Joseph, - (1999-11-29), *The Real War Crimes*, WorldNetDaily. <http://www.worldnetdaily.com/news/>

tronditur thellë ndërgjegjen e opinionit publik botëror. Të gjykuara veç e veç, ndoshta mund të mos përfytyrohej e plotë shkalla e shkeljeve të kryera. Por, të para në tërësi dhe të shtrira në një periudhë kohore mbi njëshekullore, plotësojnë platformën strategjike antishqiptare serbe. Njohja e saj bëri që shumica e opinioneve të shprehura, të rikonfirmonin se NATO-ja nuk e shkeli të drejtën ndërkombëtare. Përkundrazi, veprimi në harmoni me frymën dhe parimet e saj themelore, që kanë si mision rregullimin e marrëdhënieve midis shteteve dhe subjekteve të tjerë, për të ruajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Nëse ato cenohen qoftë edhe në ndonjë nga skajet periferike të rruzullit mund të sjellin pasoja për pjesën tjetër të njerëzimit. Prandaj, është më se e përligjur vëmendja e të drejtës ndërkombëtare dhe institucioneve që e zbatojnë atë, përfshirë edhe OKB-në.

Ndërhyrja e NATO-s në Serbi dhe në ish-Jugosllavi, në pranverën e 1999, mund të interpretohet edhe si akt vetëmbrojtjeje nga ana e shteteve anëtare të NATO-s. Ato reaguese sepse u ndjenë të kërcënuara nga agresioni permanent serb në Kosovë, i cili u zhvendos aty, pasi kishte masakruar për disa vjet popullin boshnjak dhe popujt e tjerë të ish-Jugosllavisë. Nuk përjashtojë që të vazhdonte edhe në territoret e shteteve të tjerë përreth, anëtarë të NATO-s dhe të cenonte interesat e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

\*\*\*

Në raportin formë-përmbajtje, si rregull prevalon përmbajtja. Krimet serbe, që janë përmbajtja, nuk mund të lireshin të vazhdonin deri në infinit, nën pretekstin e mungesës së Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së – formës. Në këtë fushë, vendimet ai i merr për të garantuar paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Përndryshe, kur krimet vazhdojnë, jetët njerëzore sakrifikohen, shtëpitë shkatërrohen etj. vetëm e vetëm se nuk ka një vendim, të miratuar me votën pro të 5 anëtarëve të përhershëm të tij, nuk e ka kryer detyrën.

Në vitet 1998-1999, kur në Kosovë kryheshin krime kundër njerëzimit dhe ishte vënë në dyshim ekzistenca kombëtare e shqiptarëve, shtrohej me të drejtë, detyrimi i bashkësisë botërore për të ndërhyrë për të shpëtuar jetën njerëzore.

Ajo vendosi dhe ndërhyri. Gjithçka nisi nga ezaurimi i arsenalit të mjeteve paqësore. Kur ato nuk dhanë rezultat, u gjykua veprimi nëpërmjet përdorimit të forcës, duke bërë kujdes që të respektohej baza e duhur juridiko-ndërkombëtare dhe parimi i proporcionalitetit. Ajo

përbëhej nga një numër i madh aktesh me karakter juridiko-ndërkombëtar, vendime të organizatave ndërkombëtare, pohime të autorëve të së drejtës ndërkombëtare etj. Ata konkludojnë se ndërhyrja e NATO-s në ish-Jugosllavi dhe bombardimi i dispozitivit të saj luftarak, u krye duke mbajtur parasysh faktet dhe provat e pambarimta të gjithçkaje çnjerëzore që Serbia, autori dhe aktori kryesor, kishte bërë ndaj shqiptarëve.

## Po ndërhyrjes për qëllime humanitare

Nocioni i ndërhyrjes për qëllime humanitare nuk është i ri. Është përmendur për herë të parë në shek. XIII nga Thomas Acquini, i cili thoshte se një sovran legjitimohet të ndërhyjë në punët e brendshme të një sovrani tjetër, kur ky i fundit keqtrajton shtetasit e vet.<sup>56</sup>

Më vonë Francisco Vittoria, e konsideronte si një ndër bazat e mbrojtjes së njerëzimit, mbrojtjes së të pafajshmëve nga vdekja e padrejtë ose nga ligjet çnjerëzore. Kanë folur gjithashtu edhe ndërkombëtaristë të tjerë si Hugo Groci, Emerik de Vatel, Lassa Francis Lawrence Oppenheim, Charl Rusoi, Alfred Ferdros<sup>57</sup> etj.

Në janar të vitit 1821, Sekretari i Jashtëm britanik, Castlereagh, në një qarkore që mbante datën 19 janar 1821, deklaroi se shtetet ruajnë të drejtën për të ndërhyrë “aty ku siguria e tyre e menjëhershme ose interesi thelbësor rrezikohet seriozisht nga transaksionet e brendshme të një shteti tjetër” dhe jo si “zbatim i përgjithshëm dhe pa dallim për të gjitha lëvizjet revolucionare”.<sup>58</sup> Rasti i parë praktik i ndërhyrjes i takon vitit 1827, kur Britania e Madhe, Franca dhe Rusia ndërhyjnë në Greqi, nën pretekstin e mbrojtjes së popullsisë greke nga mizoritë turke edhe pse motivet humanitare nuk ishin të vetmet. Ajo merrte shkas nga Traktati i Londrës, një ndër aktet e para juridiko-ndërkombëtare, ku përmendet ndërhyrja për arsye humanitare. Edhe pse kishte kundërshtarë, ky rast u pranua për arsye humanitare ose morale. Precedenti i sforcuar grek shërbeu si trampolinë për shfaqjen konkrete të konceptit të ndërhyrjes humanitare dhe pati një ndikim në evoluimin e normave

---

<sup>56</sup> Arben Puto, *E drejta ndërkombëtare*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2010, f. 51.

<sup>57</sup> Po aty.

<sup>58</sup> M. Wight, *Western Values in International Relations*, në H. Butterfield and M. Wight (eds), *Diplomatic Investigations: Essays in the Theory of International Politics* (London: Allen and Unwin, 1966), f. 118. Për qasjen e Castlereagh lidhur me mosndërhyrjen shih edhe R. J. Vincent, *Nonintervention and International Order*, Princeton University Press, 1974. pp. 73–83

ndërkombëtare dhe rregullave të sjelljes në raste të fatkeqësive humanitare...<sup>59</sup>

Në atë kohë për këtë çështje është shprehur edhe Talleyrandi<sup>60</sup>, i cili në vitin 1830, nëpërmjet një formulimi që ngjason më shumë me një lojë fjalësh, thoshte se mosndërhyrja është “një fjalë diplomatike dhe enigmatike që do të thotë pak a shumë të njëjtën gjë, ndërhyrje”.<sup>61</sup>

Gjatë shekullit të kaluar ajo fitoi “të drejtën e qytetarisë” dhe filloi të trajtohet pothuajse gjithmonë e lidhur ngushtë me parimet e ndalimit të përdorimit të forcës, respektimit të sovranitetit kombëtar, të drejtat e individëve, detyrimet e shteteve etj. Në vazhde të këtij zhvillimi, në vitin 1910, Antoine Rougier vuri në dukje se doktrina e “ndërhyrjes humanitare” e njeh si të drejtë ushtrimin e kontrollit ndërkombëtar të një shteti mbi aktet e sovranitetit të brendshëm të një tjetri, kur ato bien në kundërshtim me të drejtën humanitare... Nëse të drejtat e njeriut të një populli injorohen gjithmonë nga sundimtarët e tij, një ose më shumë shtete mund të ndërhyjnë në emër të Lidhjes së Kombeve, nëse do të kërkonin anulimin e akteve të dënueshme të pushtetit publik, për të parandaluar rifillimin e akteve të tilla në të ardhmen ose për të kompensuar mosveprimin e qeverisë duke marrë masa parandaluese emergjente dhe duke zëvendësuar përkohësisht sovranitetin e shtetit të kontrolluar.<sup>62</sup>

Argumenteve të kësaj natyre i shtohet edhe një precedent që vjen nga viti 1950. Në tentativat për të gjetur zgjidhje për konfliktin e përgjakshëm në Kore (Lufta e Koresë), u synua të veprohej nëpërmjet Këshillit të Sigurimit. Por ai nuk mund të merrte vendim për shkak të vetos së ish-Bashkimit Sovjetik. Situata u kapërcye duke “përfutur nga

<sup>59</sup> Alexis Heraclides, Ada Diaila, *Intervention in the Greek War of Independence, 1821–1832*, <https://doi.org/10.7228/manchester/9780719089909.003.0006>, pp. 105–133, Published: July 2015; Mosely, Philip E. - *Intervention and nonintervention in Spain, 1838-1839*, *The Journal of Modern History*, Vol. 13, No. 2 (Jun., 1941), Published By: The University of Chicago Press pp.195-196.

<sup>60</sup> Charles-Maurice de Talleyrand, princ i Bénévent, burrë shteti dhe diplomat francez.

<sup>61</sup> Stapleton, Augustus Granville, - *Intervention and Non-Intervention or the Foreign Policy of Great Britain from 1790 to 1865*, London: John Murray, 1866, p.15. Te Wight, ‘*Western Values in International Relations*’, 115, gjendet në një version disi më të ndryshëm, në vend të fjalëve diplomatike dhe enigmatike përdoren fjalët *metaphysical and political*.

<sup>62</sup> Rougier, Antoine - *La théorie de l'intervention d'humanité*, Paris: A. Pedone, 1910. Citohet nga Fernández, Luis Peral, - *Exodos masivos, supervivencia y mantenimiento de la paz*, Madrid: Editorial Trotta, SA 2001.

mungesa” e ambasadorit sovjetik në një nga mbledhjet e Këshillit të Sigurimit. Mosprezenca e tij u shfrytëzua për hedhjen në votë dhe miratimin e vendimit me 9 vota. Akti përkatës ishte Rezoluta 82, e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, miratuar më 25 qershor 1950.<sup>63</sup> Ajo është bërë objekt debatesh të ashpra politike e diplomatike në OKB dhe në forume të tjera botërore. Është analizuar gjerësisht edhe në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare, ku studiuesit nuk kanë arritur në mendim të përbashkët. Gjithsesi ajo ka hyrë në fondin e saj dhe referohet në raste zhvillimesh problematike.<sup>64</sup>

Shumë kohë më vonë, për këtë çështje do të shprehej edhe Parlamenti Evropian, i cili “konsideron se e drejta ndërkombëtare në fuqi *nuk paraqet domosdoshmërisht pengesë* për njohjen e së drejtës së ndërhyrjes humanitare”.<sup>65</sup> Shihet se opinioni i PE-së është shprehur jo në formën e drejtpërdrejtë pohuese, por në formë mohuese, në mungesën e pengesës për të vepruar, një mënyrë specifike, e përdorur jo rrallë në të drejtën ndërkombëtare. Kujtojmë se kjo formë u përdor edhe në vendimin e GJND-së për sa i përket të drejtës së Kosovës për shpalljen e njëanshme të pavarësisë.

Është një akt tjetër që vlen të përmendet, fjalimi i Kofi Ananit në Asamblenë e Përgjithshme në vitin 1999. Ai u shpreh se nëse ndërhyrja humanitare përbën me të vërtetë një sfidë të papranueshme ndaj parimit të sovranitetit, atëherë si mund të reagojmë ndaj një Ruande, ndaj një Srebrenice dhe ndaj një mase shkeljesh sistematike të të drejtave të njeriut, të cilat vënë në pikëpyetje edhe parimin e bashkësisë njerëzore?<sup>66</sup>

Në vijim pati një zhvillim konkret që erdhi si reagim i qeverisë kanadeze, e cila me ndihmën e disa fondacioneve të rëndësishme, mori nismën për themelimin e Komisionit Ndërkombëtar për Ndërhyrjen dhe Sovranitetin Shtetëror (ICISS). Ai do të punonte për reflektimin mbi të

---

<sup>63</sup> Résolutions du Conseil de Sécurité - 1950. Nations Unies, Septembre 2000, 82 (1950). Résolution du Conseil de Sécurité, du 25 juin 1950

<sup>64</sup> Rezolutën e KS të OKB, të qershorit 1950, e përmendi edhe Rexhep Taip Erdogan, në fjalën e mbajtur në mbledhjen e kabinetit qeveritar turk, më datën 2 tetor 2024. Duke iu referuar luftës midis Izraelit, Hamasit, Hezbollaut, ku është përfshirë edhe Libani, ai tha se “Asambleja e Përgjithshme e OKB-së duhet të zbatohet me shpejtësi autoritetin për të rekomanduar përdorimin e forcës, siç bëri me rezolutën e vitit 1950, *Bashkimi për Paqe*, nëse Këshilli i Sigurimit nuk mund të tregojë vullnetin e nevojshëm”.

<sup>65</sup> *Official Journal of the European Communities* Nr. C 128/226, Wednesday April 20, 1994;

<sup>66</sup> Secretary-General presents his Annual Report to General Assembly, 20 September 1999, Press Release, SG/SM/7136, GA/9596.

drejtën e ndërhyrjes humanitare dhe pajtueshmërinë e saj me doktrinën e sovranitetit shtetëror. Puna e tij u prezantua në Otava, në vitin 2001, në një dokument voluminoz, me titullin *Responsibility to Protect*.<sup>67</sup> Ajo u bë pjesë e një “pakete” alternativash për zgjidhjet më të përshtatshme në këto raste, të cilat rekomandojnë se gjithçka duhet të fillojë nga përdorimi i mjeteve paqësore. Në varësi të rezultateve, mund të avancojë deri te ndërhyrja e armatosur, e cila konsiderohet veprim legjitim. Ato janë pjesë e institutit të ndërhyrjes në punët e brendshme për qëllime humanitare dhe duhen realizuar sipas përcaktimeve të së drejtës ndërkombëtare<sup>68</sup>, me korrektesën e duhur për të identifikuar zgjidhjen përkatëse, e cila jo gjithmonë është pranuar.

### Ndërhyrja për qëllime humanitare në të drejtën ndërkombëtare

Kjo çështje trajtohet gjerësisht edhe nga autorë të së drejtës ndërkombëtare. Midis tyre dallohen Nguyen Quoc Dinh, Patrick Daillier, Alain Paillet, autorë të një botimi mjaft prestigjioz, *Droit International Public*. Duke analizuar në mënyrë koncize atë çka ndodhi në ish-Jugosllavi, në vitet 1998-1999, shkruajnë se kortezhi i pafundmë i krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit dhe karakteri i konfliktit të armatosur, që ishte ndërkombëtar, por edhe i brendshëm, i bëri të papërbalueshëm kufijtë e qasjes juridike tradicionale. Mbështetur në kreun VII të Kartës, si dhe në vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, të 8 prillit 1993 (Rezoluta 819 e KS të 16 prillit 1993) pranojnë se organet kryesore të Kombeve të Bashkuara e kishin bërë asistencën humanitare objekt kryesor të ndërhyrjes kolektive dhe të justifikimit të ndërhyrjes së armatosur, si dhe të embargos në disa zona (rezoluta 724 e KS të 15 dhjetorit 1991). Ata bien dakord me konkluzionet e Boutros Boutros-Ghali, të cilat i cilësojnë si veçanërisht të mençura. Në vijim e citojnë të plotë pohimin e tij, se “nuk ka vend për t’u fiksuar në dilemën respektimi i sovranitetit apo të drejtave të njeriut. OKB-ja nuk ka aspak nevojë për një përplasje të re ideologjike. Ajo që është në lojë, nuk është e drejta e ndërhyrjes, por detyrimi kolektiv që kanë shtetet për të dhënë

<sup>67</sup> Një version elektronik i dokumentit është i disponueshëm në internet në adresën: <http://www.dfait-maeci.gc.ca/iciss-ciise/menu-en.asp>.

<sup>68</sup> Zanetti, Véronique, - *Le droit à l'analyse humanitaire: une analyse conceptuelle*, në *Le Cosmopolitanisme, Enjeux et débats contemporains*, 2019, fq. 151-175

ndihmë dhe kontribute në situatat urgjente, ku të drejtat e njeriut janë në rrezik.”<sup>69</sup>

Duke vazhduar këtë linjë arsyetimi, të tjerë autorë, pohojnë se për ndërhyrjen e armatosur për qëllime humanitare “ekziston një prirje qartësisht e dallueshme nga pëlqimi te konsensusi si bazë për detyrimet juridiko-ndërkombëtare” ku konsensusi nënkupton “një shumicë dërrmuese, një konvergjencë të opinionit ndërkombëtar, një epërsi, për diçka që është më shumë sesa shumicë e thjeshtë, por më pak sesa unanimitet ose universalizëm”.<sup>70</sup> Pranohet gjithashtu se e drejta ndërkombëtare nuk buron vetëm prej rregullave për të cilat shtetet kanë dhënë pëlqimin, por edhe prej rregullave në përputhje me të cilat bashkësia botërore në tërësi ka arritur solidaritet ose konsensus, ndonëse disa shtete refuzojnë të japin pëlqimin dhe miratimin e tyre për këto rregulla. Kjo është rrjedhojë e një konceptimi modern të së drejtës ndërkombëtare, e cila është zhvilluar si një e drejtë e bashkësisë ndërkombëtare dhe jo si dikur që angazhonte vetëm shtetet, si e drejtë e interesuar edhe për bashkëpunimin ekonomik, social e mjedisor midis njerëzve dhe jo vetëm për bashkekzistencën midis shteteve, si e drejtë në të cilën konsensusi është shndërruar në burimin e detyrimit imponues për t’u bindur, jo si e drejtë në të cilën shtetet e veçanta mund të shpërfillin konsensusin e bashkësisë botërore, duke mos dhënë miratimin e tyre, por si e drejtë që interpretohet në mënyrë dinamike e krijuese.

Në zhvillimin e saj historik e drejta ndërkombëtare, sikurse edhe degët e tjera të së drejtës, kanë ardhur duke u zhvilluar e përsosur. Deri në fillimet e shekullit XX, ajo konsiderohej e drejta e kombeve të “civilizuara” apo e kombeve kristiane. Ishin vetëm ata, gjithsej rreth 40 shtete në të gjithë lëmshin tokësor, subjekte të së drejtës ndërkombëtare. Kujdesi i tyre në ato kohë ishte drejtuar kryesisht për përpunimin dhe sanksionimin e parimeve për gjendjen e luftës. E drejta ndërkombëtare ishte e “drejta e më të fortit”. Zhvillimet tragjike të ditëve tona tregojnë se disa eksponentë me sjellje kriminale, të ndodhur në krye të ndonjë shteti, janë rikthyer te ky koncept. Ka ngjarje tragjike që e konfirmojnë, siç janë pushtimi rus i Ukrainës, lufta e Netanjahut kundër palestinezëve, sulmet e tij në Liban etj.

Në zbatim të sovranitetit, detyrimi për të mbrojtur shtetasit, u përket shteteve, shtetësinë e të cilëve ata mbajnë. Megjithatë, kur ata

---

<sup>69</sup> Nguyen Quoc Dinh, Patrick Daillier, Alain Paillet, *Droit International Public*, 7-ème édition, Paris 2002, p. 449.

<sup>70</sup> Richard Falk, Kratochwil, Friedrich, and Saul H. Mendlovitz, eds. “*International Law: A Contemporary Perspective*”. Boulder, CO: Westview, 1985, pp. 122-131.

eksponohen ndaj trajtimeve mizore, komuniteti ndërkombëtar përligjet të ndërhyjë, pasi të jenë ezauruar të gjitha masat e tjera. Ndërhyrja duhet të jetë proporcionale dhe të ketë shanse të arsyeshme për sukses, duke u shoqëruar me një pjesë të përgjegjësisë për rindërtimin.<sup>71</sup>

Shkaku i ndërhyrjes duhet të jetë i drejtë dhe i tillë konsiderohet, kur ndërmerret se a) ka vdekje në përmasa të mëdha, që i atribuohen gjenocidit të “qëllimshëm ose të paqëllimshëm”, b) ka “pastrim etnik” etj.<sup>72</sup> Ndërhyrja duhet të ketë si qëllim ndalimin ose parandalimin e vuajtjeve njerëzore, të vendoset në mënyrë shumëpalëshe dhe të realizohet nga një koalicion shtetesh.

Parimi i mosndërhyrjes është rregulli, kurse ndërhyrja përbën përjashtim prej tij.<sup>73</sup> Ndërkohë, nëse viktimat kanë të drejtën e ndihmës nëpërmjet ndërhyrjes, vendet e tjera kanë detyrim për të ndërhyrë, kur rrethanat korrespondojnë me ato të përcaktuara nga parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare.<sup>74</sup> Kjo hedh një dritë të ndryshme, sepse pavarësisht nga pengesat që kërkon të nxjerrë politika, e drejta e ndërhyrjes pranohet, si zgjidhje kur në jetën e shteteve vazhdonin të vërtetoheshin raste të ushtrimit të dhunës së organizuar shtetërore ndaj grupeve të caktuara të popullsisë apo ndaj një bashkësie shtetasish. Organizata ndërkombëtare, posaçërisht OKB-ja dhe, në raste të caktuara edhe

<sup>71</sup> *Commission internationale sur l'intervention et la souveraineté des États (ICISS), Responsabilité de protéger*, Otava, 2001: <http://www.dfait-maeci.gc.ca/iciss-ciise/menu-en.asp>, Otava, 2001. Citohet nga Véronique Zanetti, *-Le droit à l'analyse humanitaire: une analyse conceptuelle*, në *Le Cosmopolitanisme, Enjeux et débats contemporains*, 2019, fq. 151-175.

<sup>72</sup> Po aty.

<sup>73</sup> Joseph Isensee, *Intervention zwischen Menschenrechtsschutz und Großmacht-politik*, në Hartmut Jäckel (ed.), *Ist das Prinzip der Nichteinmischung überholt?*, Baden-Baden, Nomos, 1995, f. 29-48. Stefan Oeter, *Humanitäre Intervention und Gewaltverbot: Wie handlungsfähig ist die Staatengemeinschaft*, në Hauke Brunkhorst (ed.), *Einmischung erwünscht?*, Frankfurt/Main, Fisher Taschenbuch Verlag, f. 198 27-60; si dhe Christopher Greenwood, *Gibt es ein Recht auf humanitarian Intervent?* në *Europa-Archiv*, nr 4, 1993, f. 93-106; Mary Kaldor, *Neue und alte Kriege*, Frankfurt/Main, Szweite Moderne, 1999; Herfried Münkler, *Die neuen Kriege*, Hamburg, Rowohlt, 2002; Thomas Kesselring, *Ethik der Entwicklungspolitik. Gerechtigkeit im Zeitalter der Globalisierung*, München, CH Beck, 2003; Emmanuel Kant, *Gesammelte Werke*, Preußische Akademie der Wissenschaften, Berlin, 1910, VIII, f. 313; Antonio Cassese, *Violence et droit dans un monde divisé*, Paris, PUF, 1990, f. 61 e në vazhdim.

<sup>74</sup> Heribert Franz Köck, *Die Humanitäre Intervention*, në Gustav Gusstenau (regji.), *Humanitäre militärische Intervention zwischen Legalität und Legitimität*, Baden-Baden, Nomos, 2000, f. 32;

NATO-ja, vendosën dhe ndërmorën ndërhyrjen me trupa ushtarake për qëllime humanitare. Trupat e dërguara nga OKB-ja në pjesë të ndryshme të rruzullit njihen ndryshe edhe me emërtimin “kaska blu”.

Sfida ndaj sovranitetit motivohet në emër të respektimit të një standardi të domosdoshëm të të drejtave dhe lirive themelore universale të njeriut, çka shërbeu si motiv për ndërhyrjet humanitare në Bosnje e Hercegovinë, në Timorin Lindor, në Kosovë etj.

## Përkufizimi i ndërhyrjes për qëllime humanitare

Për ta lehtësuar disi trajtimin dhe përcaktimin e qëndrimit rreth kësaj çështjeje, mund të shërbente identifikimi i përkufizimit të ndërhyrjes për qëllime humanitare edhe pse ende nuk ka një të tillë. Pranohet se me ndërhyrje humanitare nënkuptohet përdorimi i forcës së armatosur nga një ose disa shtete dhe/ose organizata ndërkombëtare, në territorin e një shteti tjetër, pa marrëveshjen e tij me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në të gjithë dimensionin e tyre, por gjithashtu edhe siguria kombëtare ose ndërkombëtare, monopoli dhe kontrolli ndërkombëtar i pushtetit, interesat ekonomike, gjeostrategjike dhe gjeopolitike, siguria e kapitalit, pasurisë, tregut dhe botës së financave etj.

Për ndërhyrjen në punët e brendshme të një shteti për qëllime humanitare, doktrina ka parasysh disa lloje, nga të cilat dy prej tyre përmenden posaçërisht. *E para* përdorimi i forcave ushtarake, mbështetjes logjistike ose luftarake për të garantuar ruajtjen dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare, të ofruara nga shtete, organizata ndërkombëtare për popullatat e ndodhura në rrezik ose në kushtet e nevojës ekstreme, në rrethanat e katastrofave humanitare ose natyrore, epidemive të rënda, zhvillimeve ekstreme politike etj. Përdorimi i forcës në këto raste synon të krijojë kushte për rikthim në jetën normale, sikurse ndodhi me operacionin (Alba) Pelikan, në Shqipëri, në vitin 1997, nga forcat e armatosura të një numri vendesh, si përpjekje për të zgjidhur krizën e rëndë sociale që kishte pasuar rënien e skemave piramidale në Shqipëri.<sup>75</sup> Kjo “ndërhyrje humanitare” dallohet nga ndërhyrjet si pjesë

---

<sup>75</sup> Humbja e kursimeve të investuara në këto skema, u bënë shkak i shpërthimit të revoltave në vend, i cili u përfshi nga kaosi, dhuna, plaçkitja. Me Rezolutën 1101 të 27 marsit 1987, KS i OKB-së, autorizoi fillimin e operacionit Alba, si përpjekje për të stabilizuar situatën dhe zgjidhjen e çështjeve emergjente. Operacioni filloi më 15 prill 1997. Colonel Marchio, Riccardo (2000). *Operation Alba: A*

e operacioneve paqeruajtëse dhe e veprimeve humanitare në rastet e konflikteve. *E dyta* konsiston në përdorimin e forcës së armatosur për t'i dhënë fund shkeljeve të rënda, masive dhe sistematike të të drejtave themelore të njeriut dhe për të mbrojtur viktimat e këtyre shkeljeve kundër kriminelëve.<sup>76</sup> Një prej studiuesve të së drejtës ndërkombëtare, Romualdo García Bermejo, duke pranuar ndërhyrjen për qëllime humanitare, arsyeton se me të kuptohet “e drejta e shteteve për të përdorur forcën në territorin e çdo shteti tjetër për mbrojtjen e personave që i nënshtrohen trajtimit çnjerëzor nga i njëjti shtet, i cili nuk mund të shmanget ndryshe përveç se nëpërmjet përdorimit të forcës”<sup>77</sup>. Sepse, siç thotë Fernando R. Teson, “mbrojtja dhe forcimi i të drejtave natyrore të qytetarëve është justifikimi përfundimtar i shteteve, një qeveri që kryen shkelje thelbësore të të drejtave të njeriut do të tradhtonte objektivin real për të cilin ekziston dhe kështu do të humbasë jo vetëm legjitimitetin e brendshëm, por edhe legjitimitetin ndërkombëtar”<sup>78</sup>.

Duke e konsideruar të pranuar opsionin e legjitimitetit të ndërhyrjes, autorët e pranimit të saj duhet të gjenin edhe mekanizmin e kapërcimit të pengesës procedurale, që e lidhte me kreun VII të Kartës së OKB-së. Ajo u gjet, sërish brenda hapësirave që ofron e drejta ndërkombëtare, e cila pranon se kur dhunohen të drejtat e njeriut, kur preket tërësia territoriale e një shteti, kur shkelet rendi dhe siguria botërore, agresori mund të përballet edhe me kundërpërgjigje kolektive nga ana

---

*European approach to peace support in the Balkans* (PDF). f. iii. *Albanian Rebellion of 1997*, www.onwar.com. Alì, Maurizio, *L'attività di peacekeeping della Forza Multinazionale di Protezione in Albania*. (Rome, Italy, Facoltà di Scienze Politiche - Università Roma Tre). 2003. “Resolution 1101”. unscr.com. Tripodi, P. (2010-09-08). *Operation Alba: A Necessary and Successful Preventive Deployment*. *International Peacekeeping* (në anglisht). 9 (4): 89–104. doi:10.1080/714002777. ISSN 1353-3312. *Albania: Italy's Prime Minister Faces Uncertain Future Over Security Force*, Radio Free Europe/Radio Liberty (në anglisht). 2008-04-09. *CNN - French, Italian troops lead mission to Albania* - Apr. 15, 1997, www.cnn.com. *Resolution 1114*. unscr.com. *Albania: parliamentary elections Kuvendi Popullor, 1997*, archive.ipu.org. 1997. *The Alba Mission in the framework of the FMP, Carabinieri. Albania - Alba - Esercito Italiano*. www.esercito.difesa.it.

<sup>76</sup> Fernando M. Mariño Menéndez, *Derecho Internacional Público*, Parte General, Universidad Carlos III de Madrid. Instituto de Estudios Internacionales y Europeos Francisco de Vitoria, Madrid, 1999, p. 108

<sup>77</sup> Romualdo García Bermejo, Eugenia Lopez-Lacoiste Diaz, *De la intervencion por causas humanitarias a la responsabilidad de proteger, fundamentos, similitudes y diferencias*, Guadernos de estrategia, 2013; Pignatelli y Meca, 2001, 689

<sup>78</sup> Fernando R. Teson, *Humanitarian Intervention: An Inquiry Into Law and Morality*, - Transnational, 1997.

e një grupi shtetesh. Mund të jenë anëtarë të një bashkësie, organizate ndërkombëtare universale, si fjala vjen OKB-ja etj. ose organizatë rajonale, siç është NATO-ja, që veproi në rastin e Kosovës. Për ithtarët e zgjidhjes radikale nëpërmjet ndërhyrjes së armatosur, bombardimet vlerësoheshin si reagim i botës demokratike ndaj Serbisë, sepse ajo ishte afirmuar si shtet që shkelte sistematikisht normat e së drejtës ndërkombëtare dhe kishte dhunuar jo vetëm jetën e shqiptarëve, por edhe rendin dhe sigurinë botërore.

### Këshilli i Sigurimit mund të autorizojë ndërhyrjen e armatosur

Rregulli i përgjithshëm i sanksionuar nga e drejta ndërkombëtare është që “asnjë shtet ose grup shtetesh për çfarëdo arsye, nuk ka të drejtë të ndërhyjë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në punët e brendshme ose të jashtme të një shteti tjetër. Rrjedhimisht, jo vetëm ndërhyrja e armatosur, por edhe çdo formë tjetër ndërhyrjeje apo kërcënimi, i drejtuar kundër personalitetit të një shteti ose ndaj elementëve të tij politikë, ekonomikë dhe kulturorë, janë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.”<sup>79</sup> Pohimi i mësipërm gjendet në Deklaratën mbi Marrëdhëniet Miqësore, të miratuar në vitin 1970.

Megjithatë ndërhyrja nuk përjashtohet tërësisht. Ajo mund të realizohet vetëm me vendim të KS të OKB-së. Si rregull, sipas kreut VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit është organi kompetent që mund të autorizojë përdorimin e forcës së armatosur për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. E thotë këtë shprehimisht neni 39, i formuluar në trajtën e mëposhtme: “Këshilli i Sigurimit është ai, që përcakton, nëse kemi të bëjmë me një kërcënim ose prishje të paqes ose sulm; ai jep rekomandimet e tij dhe vendos se cilat masa duhen marrë sipas neneve 41 dhe 42, për të ruajtur ose për të rivendosur paqen botërore dhe sigurinë ndërkombëtare.”<sup>80</sup>

Duke iu referuar neneve të sipërpërmendura Karta përcakton se “Këshilli i Sigurimit mund të vendosë se cilat masa duhen marrë – duke përjashtuar ndërhyrjen me armë – në mënyrë, që vendimet e tij të bëhen të efektshme... Këtu përfshihen ndërprerjet e plota ose të pjesshme të marrëdhënieve ekonomike, të transportit hekurudhor, ujqor dhe ajror, të lidhjeve postare, telegrafike dhe me radiomarrëse dhe të mundësive të

---

<sup>79</sup> UN, General Assembly, Resolution 2625 (XXV), 24 octobre 1970.

<sup>80</sup> Neni 39 i Kartës së OKB-së.

tjera të qarkullimit, si dhe ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike... Nëse (ai) është i mendimit se masat e parashikuara në nenin 41 do të jenë të pamjaftueshme ose nëse ato kanë rezultuar të tilla, atëherë ai mund të realizojë masat e nevojshme për ruajtjen apo rivendosjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare, duke përdorur forcat e armatosura tokësore, ajrore dhe ujore. Në këto masa përfshihen demonstrimet e forcës, bllokada dhe angazhime të tjera të forcave të armatosura tokësore, ajrore dhe ujore.”<sup>81</sup> Për vënien në jetë të masave të përcaktuara më sipër, neni 43 i Kartës ka parashikuar se “(1) Të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara marrin përsipër të kontribuojnë në ruajtjen e paqes botërore duke vënë në dispozicion, me kërkesën e Këshillit të Sigurisë, sipas përcaktimeve të një apo disa marrëveshjeve lidhur me këtë të fundit, trupat e tyre të armatosura, duke ofruar mbështetjen e tyre dhe lehtësira të tjera deri edhe marshimin e trupave, për sa kohë që kjo është e nevojshme për ruajtjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare.”<sup>82</sup>

Duke pasur parasysh vështirësitë që mund të krijoheshin nga zbatimi në praktikë i parimit të vetos në veprimtarinë e Këshillit të Sigurimit, anëtarët themelues të OKB-së, parashikuan edhe mundësinë juridike të tejkalimit të këtij handikapi. Në pjesën hyrëse dhe pikat 1, 3 dhe 4 të nenit 2 të Kartës, thuhet se “Organizata dhe anëtarët e saj veprojnë në zbatim të qëllimeve të përcaktuara në nenin 1 sipas parimeve të mëposhtme: 1. Organizata bazohet në parimin e barazisë sovrane të të gjithë anëtarëve të saj... 3. Të gjithë anëtarët i zgjidhin konfliktet e tyre me mjete paqësore, në mënyrë të tillë që paqja botërore, siguria ndërkombëtare dhe drejtësia të mos rrezikohen. 4. Të gjithë anëtarët ndalojnë në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare çdo kërcënim apo përdorim dhune, që drejtohet kundër paprekshmërisë territoriale apo pavarësisë politike të një shteti ose që bie ndesh me qëllimet e Kombeve të Bashkuara...”<sup>83</sup>

Duket sikur çështja merr një zgjidhje në nenin 52 të Kartës, ku thuhet se “(1) (ajo) nuk e përjashton ekzistencën e marrëveshjeve rajonale për trajtimin e atyre çështjeve, që kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare, në kuadër të të cilave merren masa të natyrës rajonale; kusht paraprak për këtë është, që këto marrëveshje ose institucione dhe efekti i tyre të përputhen me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara. (2) Anëtarët e Kombeve të

<sup>81</sup> Nenet 41 dhe 42 të Kartës së OKB-së.

<sup>82</sup> Neni 43 i Kartës së OKB-së.

<sup>83</sup> Neni 2 i Kartës së OKB-së.

Bashkuara, që lidhin të tilla marrëveshje apo ngrenë të tilla institucione, përpiqen me të gjitha mundësitë e tyre, që, duke iu referuar këtyre marrëveshjeve ose institucioneve rajonale, të zgjidhin në mënyrë paqesore konfliktet e kufizuara nga pikëpamja lokale, përpara se me to të merret Këshilli i Sigurimit...<sup>84</sup>. Mirëpo çështja nuk e merr ende zgjidhjen, sepse neni 53 i Kartës përbën një pengesë formalo-juridike. Ai stipulon në mënyrë taksative se "... pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit nuk mund të merren masa detyruese parashikuar në marrëveshje rajonale apo nga ana e institucioneve rajonale..."<sup>85</sup>

Por, pavarësisht nga neni 53 i Kartës, ka një mendim mbizotërues, sipas të cilit ndërhyrja e forcave të NATO-s në ish-Jugosllavi, në mars-qershor 1999, nuk ishte në kundërshtim me kriteret e pranuar nga doktrina juridike në përgjithësi dhe ajo juridiko-ndërkombëtare në veçanti.

Për të gjykuar me objektivitet duhet mbajtur parasysh se përpunimi dhe redaktimi përfundimtar i Kartës, u bë në rrethana dhe në realitete të caktuara historike. Sapo kishte përfunduar Lufta e Dytë Botërore. Ata që ngrenë OKB-në, që ishin edhe protagonistët kryesorë të Luftës së Madhe, me qëllimin themelor garantimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, morën përsipër angazhime, vendosën parime e qëllime për të siguruar të ardhmen paqësore të njerëzimit. Ato analizuan dhe pasqyruan përvojën tragjike, por edhe episodet pozitive të së shkuarës së shoqërisë njerëzore, dëshirën për sanksionimin e atmosferës premtuese të periudhës së pasluftës, si dhe aspiratat e një të ardhmeje edhe më të sigurt. Në emër të tyre u bënë kompromise politike, gjeostrategjike, sociale, ekonomike etj. të formuluara përmes frazave e fjalëve, që ishin dhe do të bëheshin objekt interpretimesh në të ardhmen. Kuptimi i tyre nxirrej nga realitetet, por edhe nga përfytyrimet e të ardhmes, të gjykuara sipas koncepteve të asaj kohe, kur nuk imagjinoheshin ndryshimet marramendëse që do të ndodhnin më pas në jetën e shoqërisë njerëzore, përmbysjet që sollën zbulime të tilla si përdorimi i energjisë bërthamore, kibernetika, digjitalizimi, inteligjenca artificiale etj. në shkencën dhe teknologjinë, por edhe në jetën e shoqërisë njerëzore, në marrëdhëniet ndërmjet shteteve. Nuk do të ishte as e drejtë dhe as normale që fenomenet dhe zhvillimet e sotme, të interpretohen e të zgjidhen sipas kodifikimeve të kalçifikuara të një epoke të kaluar, që nuk përkon me ditët e sotme të njerëzimit.

---

<sup>84</sup> Neni 52 i Kartës së OKB-së.

<sup>85</sup> Neni 53 i Kartës së OKB-së.

Në rastin e ish-Jugosllavisë ndërhyrja u iniciua kur u tejkalua tërësisht caku i durimit të bashkësisë botërore përkundrejt skenave të tmerrshme të terrorit të saj shtetëror ndaj shqiptarëve. Duhet mbajtur parasysh gjithashtu edhe se dëbimi i kosovarëve drejt vendeve fqinje shoqërohej realisht me rrezikun potencial të destabilizimit të Ballkanit, sinonimit të “fuçisë së barotit”. Turbulencat e fuqishme të shkaktuara nga lufta, vuajtjet e shumta, mund t’i tërhiqnin shqiptarët, që jetonin në pesë vende ballkanike, në veprime destabilizuese për të gjithë fqinjët e Kosovës. Nuk përjashtohet mundësia e përhapjes së konfliktit me vendet fqinje dhe cenimi i marrëdhënieve midis shteteve anëtare të NATO-s - Greqisë dhe Turqisë. Ishte e nevojshme që të parandalohesh me çdo kusht një zhvillim i tillë.

Prandaj nuk ka arsye për të qëndruar të mbërthyer në mënyrë metafizike te germa e përcaktimeve të paqarta, që eventualisht identifikohen në ndonjë dispozitë të Kartës. Nuk duhen konsideruar ato si një dogmë penguese, për të mos u përdorur ashtu siç konceptohet realisht në kohën e miratimit si akti themelor, tek i cili shtetet e vitit 1945, shkonin gjithë shpresë për të realizuar ëndrrën e botës së tyre, të ardhme të sigurt. Sepse, siç shprehet Martin Wight dhe këtu dalim te thelbi i çështjes, “fusha për veprim konstruktiv nëpërmjet Kombeve të Bashkuara është e ngushtuar nga kufizimet politike dhe strukturore, veçanërisht nga vetoja e pesë anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit.”<sup>86</sup>

Kur NATO-ja ndërmoi fushatën e bombardimeve në ish-Jugosllavi, një pjesë e mirë e opinionit publik botëror shpresoi se do të mbaronin dhimbjet që provonin dy milionë shqiptarë në Kosovë dhe rreth katër milionë të tjerë në Shqipëri dhe në trojet shqiptare në Ballkan, që ishin traumatizuar nga barbarizmat e serbëve. Shpresohet se do t’i jepej fund një padrejtësie që kishte për autore diplomacinë e Fuqive të Mëdha të fillimit të shekullit XX, që i copëtoi shqiptarët dhe shpërndau në pesë shtete.

NATO-ja në këtë rast bëri historinë dhe jo vetëm për shqiptarët, që i shpëtoi nga robëria serbe, por edhe për Evropën dhe mbarë botën, që i shpëtoi nga ndonjë konflagracion rajonal dhe eventualisht kontinental. Veprimi i saj sanksionoi përfundimisht një mënyrë veprimi në dobi të njerëzimit, duke tejkaluar rregullat strikte të së drejtës ndërkombe-tare. Tashmë u bë e qartë se e drejta e ndërhyrjes mund të realizohet edhe jashtë përcaktimeve të Kartës së OKB-së.

<sup>86</sup> Wight, Martin, - *Power politics: the definitive study of international relations*, Publisher West Drayton: Penguin, 1986

Vendimi për të ruajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare përfshirë edhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nuk mund të kundërshtohet as edhe të pengohet me motive formale. Ai duhet zbatuar kur shumica e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit e konsiderojnë atë të justifikuar moralisht dhe politikisht, siç ishte rasti me ndërhyrjen e forcave të NATO-s në Kosovë,<sup>87</sup> në vitet 1998-1999<sup>88</sup>, kur u shfaq edicioni më i fundit i gjenocidit serb dhe kur në favor shfaqeshin edhe faktorë, elemente, argumente të tjerë. Ishte koha kur serbët donin të realizonin shkatërrimin dhe likuidimin e paramenduar të një bashkësie kombëtare, racore, fetare ose sociale, të bashkësisë shqiptare.<sup>89</sup>

Bota nuk mund të harronte që krimet e Millosheviqit dhe të hordhive serbe ndaj shqiptarëve, nuk ishin as të vetme, as të reja, as edhe të panjohura. Ishin pjesë e platformave strategjike afatgjate për debimin, asimilimin, asgjësimin fizik të shqiptarëve dhe spastrimin e tyre etnik, për krijimin e *spazio-s vitale* për veten e tyre.<sup>90</sup> Ç’ mund të kërkohet tjetër veç pranisë së qindra e qindra rasteve të masakrave nga më çnjerëzoret, jo vetëm të dokumentuara, por edhe të pohuara gjithë krenari perverse nga ideatorët dhe autorët e tyre. U përmend më lart biseda e Millosheviqit me Uesli Clarkun, në nëntor të vitit 1998, ku ai i deklaroi se “e di unë se si të merrem vesh me këta shqiptarët. E kemi bërë dhe më parë”. Në përgjigje të pyetjes së Clarkut se si kishin vepruar, u shpreh, “i vrasim të gjithë”.<sup>91</sup> Të njëjtën gjë ka pohuar, pa iu dridhur qerpiku i syrit edhe kriminelin Vojsllav Sheshel, duke thënë hapur që “nëse NATO-ja vendos të na bombardojë, nëse Amerika vendos

---

<sup>87</sup> Véronique Zanetti, - *Le droit à l'analyse humanitaire: une analyse conceptuelle*, në *Le Cosmopolitanisme, Enjeux et débats contemporains*, 2019, fq. 151-175

<sup>88</sup> Në marsin e 1999 forcat serbe me “ndërmarrjen e përbashkët kriminale” (Joint Criminal Enterprise), nisën një fushatë të përbashkët gjatë të cilës vranë, abuzuan dhe ndoqën mijëra civilë, shkatërruan objekte fetare dhe kulturore, dogjën shtëpi dhe shumë fshatra deri në themel”, thotë ish-prokurori i Tribunalit të Hagës, Eliott Behar... Aktgjykim, Vëllimi 1 prej 4, icty.org [https://www.icty.org/cases/090226\\_vol1](https://www.icty.org/cases/090226_vol1), PDF.

<sup>89</sup> Kështu kishin vepruar serbët më parë edhe në Bosnjë e Hercegovinë, kështu vepron aktualisht rusët në Ukrainë (prill 2023) dhe Izraeli në territoret palestineze në Gaza dhe në Libanin e Jugut.

<sup>90</sup> Një kronikë e dhimbshme masakrash të padëgjua do të mbushte faqet e shtypit të kohës, duke gjetur pasqyrimin e vet të hollësishëm edhe në veprat e një vargu autorësh nga vende të ndryshme të botës. Një prej tyre, Leo Freundlich, shkruan se “...(serbët) do të dëshironin me shpirt që të shfarosnin një komb me rrënjë e me degë...”. (Leo Freundlich, *Golgota Shqiptare*, shtëpia botuese “LILO”, Tiranë, 1995, f. 41.)

<sup>91</sup> “Me shqiptarët e kemi bërë edhe më parë. I vrasim të gjithë”, gjenerali Wesley Clark tregon çka i tha Millosheviq në vitin 1998, gazeta *Telegraf*, 24.03.24.

të vazhdojë me këtë agresion, serbët do të vuajnë, por në Kosovë nuk do të ketë më shqiptarë”.<sup>92</sup>

## Tejkalimi i Kartës së OKB-së

Për sa i përket invokimit të aspekteve juridike dhe jo vetëm juridike, të ndërmarrjes së veprimeve të duhura, për domosdoshmërinë e tejkalimit të pengesave formale që vijnë nga një pjesë e ngurtësuar e së drejtës ndërkombëtare, mendoj se do të shërbente arsytimi mjaft i goditur i senatores dhe ish-ministres së jashtme italiane, Emma Bonino. Ajo është shprehur se pakkush do të kundërshtonte që “ekzistojnë vlera dhe parime universale që bëjnë të mundur themelimin dhe justifikimin e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë në territorin e një vendi sovran kur ky i fundit zbaton vendime në kundërshtim me normat dhe konventat e komunitetit ndërkombëtar”.<sup>93</sup> I të njëjtit mendim është edhe Eusebio Fernández García, i cili thoshte se “për të ruajtur energjinë e një bërthame minimale të fortë të të drejtave themelore, të domosdoshme dhe universale të njeriut, si e drejta për jetën dhe e drejta për integritet fizik dhe moral, komuniteti ndërkombëtar duhet të reagojë, duke përfshirë edhe forcën, kur ato shkelen në mënyrë serioze, masive dhe sistematike”.<sup>94</sup> Duke shkuar edhe më tej, filozofi i njohur francez, Bernard-Henry Levy pohonte se Millosheviqi ishte dashur të dënohej dhe të pengohej qysh në fillim të viteve 1990, në mënyrë që të mos ndodhte shkatërrimi i qyteteve, vrasja e qindra mijëra qytetarëve dhe një shkatërrim i paparë në Evropë qysh nga Lufta e Dytë Botërore.

Me interes është edhe pikëpamja e shprehur nga Ivo H. Daalder dhe Michael E. O’Hanlon. Ata e pranojnë dhe e përlligjin ndërhyrjen e NATO-s në ish-Jugosllavi, por vlerësojnë edhe bashkëpunimin e saj me UÇK-në, i cili u institucionalizua dhe u rrit, hap ky jo i lehtë. Sepse NATO-ja, duke pasur parasysh shqetësimet e saj për natyrën dhe qellimet e saj, nuk dëshironte të afrohej haptazi me UÇK-në. “Udhëheqësit e Aleancës nuk donin të humbnin qëndrimin neutral në konflikt; ndërsa

<sup>92</sup> Fejtoni - 25 vjet nga bombardimet e NATO të Serbisë (26): Nxitimi i Drashkoviçit, qortimet e Çernomirdinit dhe paralajmërimet e Chomsky, NATO bombardovanje Srbije Burim: Večernje novosti, Shkruan për Kosovo online: Dragan Biseniq, 26 prill 2024.

<sup>93</sup> Bonino Ema.- *Las distintas formas de intervención*, në *Revista de Occidente*, n°236-237.

<sup>94</sup> Eusebio Fernández García, - *Lealtad cosmopolita e intervenciones bélicas humanitarias*, në *Revista de Occidente*, n°236-237.

në mënyrë të qartë, ishin në anën e shqiptarëve etnikë në fushën e betejës, ata ende shpresonin të luanin rolin ndërmjetësues në diskutimet e mëvonshme për të ardhmen politike të Kosovës, madje dhe kur rifilluan negociatat.”<sup>95</sup>

Me këtë ide afrohet pak a shumë edhe Jef Huysmans, i cili thotë se NATO-ja e shndërroi kapitalin e saj ushtarak në kapital politik – domethënë në reputacion dhe në autoritet në kompleksin evropian të sigurisë - duke demonstruar se si kapitali ushtarak është i nevojshëm për aksion, si në lojën e mbrojtjes kolektive, ashtu edhe në bashkësinë e vlerave. Këto aksione janë stabiliteti evropian, mbrojtja e kufijve të bashkësisë së vlerave, ndihma dhe mbrojtja e viktimave të praktikave që cenojnë vlerat që ndan bashkësia, që përfshin rindërtimin e shoqërive të shkatërruara nga lufta.<sup>96</sup>

Gazetari gjerman i *Die Welt*, Gerhard Gnauk, duke shkruar për mbështetjen që i ishte dhënë NATO-s nga vendet anëtare dhe shumë vende ballkanike, thotë se me intervenimin e NATO-s ishte bërë një hap i madh përpara, duke shtuar se “të rinjtë nga Parisi, Berlini apo Danzing-u janë të gatshëm të vdesin për Prishtinën me qëllim që të mos humbin më jetët e njerëzve në Kosovë”.

Ishte periudha kur NATO-ja me sulmet e saj ajrore kundër objekteve ushtarake serbe, në fakt, po e ndihmonte kauzën e UÇK-së dhe të shqiptarëve të Kosovës në përgjithësi, largimin e forcave ushtarake, policore dhe të administratës serbe.

Gjyqtari i GJND-së, italiani Giorgio GAJA, është shprehur se “Këshilli nuk është themeluar nga Karta si një gjykatë e aftë për të sanksionuar shkeljet e ligjit.”<sup>97</sup>

\*\*\*

Njohja, në thelb, e strategjisë politike antishqiptare të Beogradit dhe krimet e kryera në zbatim të saj, duhet të ketë ndikuar me siguri në konsolidimin e bindjes se NATO-ja në thelb nuk e shkeli të drejtën ndërkombëtare. Ajo veprimi në harmoni me misionin e ruajtjes së jetës, me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Sepse, nëse ato

---

<sup>95</sup> Ivo H. Daalder, Michael E. O'Hanlon, - *Winning ugly: NATO's war to save Kosovo* / Washington, D.C.: Brookings Institution Press, ©2000, p. 152.

<sup>96</sup> Jef Huysmans, *Shape-shifting NATO: humanitarian action and the Kosovo refugee crisis*, në *Review of International Studies* (2002), 28, 599–618 Copyright © British International Studies Association, p. 618.

<sup>97</sup> Gaja, Giorgio,- *Reflections on the role of the Security Council in the new world order*, in the General Review of public international law, 1993, p. 300.

cenohen, qoftë edhe në ndonjë nga skajet periferike të rruzullit mund të sjellin pasoja për pjesën tjetër të njerëzimit.

Arsyet e dhëna nga politikanët perëndimorë për ndërhyrjen e NATO-s varionin nga mbrojtja e popullatës në Kosovë, stabilizimi i situatës në Ballkanin Perëndimor të shkatërruar nga lufta dhe bllokimi i Këshillit të Sigurimit të OKB-së nga vetoja e Rusisë dhe Kinës.

Ministrat e Punëve të Jashtme të vendeve të Bashkimit Evropian, më 8 prill 1999, miratuan një deklaratë të përbashkët, në të cilën e gjykonin “të nevojshëm dhe të justifikuar” operacionin e NATO-s në Jugosllavi dhe e bënëin Slllobodan Milosheviqin krejtësisht përgjegjës. Ata shpreheshin të skandalizuar nga tragjedia humanitare, viktimitë e së cilës ishte popullsia e Kosovës dhe nga aktet barbare të kryera nga ana e autoriteteve serbo-jugosllave. Uniteti dhe vendosmëria e Aleatëve, sipas ShBA-së, ishte nënvleftësuar nga Beogradi.<sup>98</sup>

Aktet që plotësojnë bazën juridike të të drejtës së NATO-s për ndërhyrje në ish-Jugosllavi, janë të shumta në numër, të shumëllojta në përmbajtje dhe me autorësi nga më të ndryshmet. Një i tillë, por me rëndësi të veçantë është Rezoluta “*Situata e të drejtave të njeriut në Republikën Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mali i Zi), në Republikën e Kroacisë dhe në Bosnjë e Hercegovinë*”<sup>99</sup> miratuar nga KDNj-ja në Gjenevë. Ajo trajton situatat që kalonin popujt e ish -Jugosllavisë, të përgjakur nga regjimi i Milosheviqit për të vetmen arsye se nuk pranonin t’i nënshtroheshin zgjedhës serbe.<sup>100</sup>

E përgatitur me propozimin e përfaqësuesit të ShBA-së, ajo u diskutua në seancën e 52-të të sesionit të 55-të, më 23 prill 1999. U

<sup>98</sup> AFP, ATS 7.4.1999, 9.4.1999.

<sup>99</sup> Autorë të saj ishin Gjermania, Bullgaria, Kanadaja, Spanja, ShBA-ja, Hungaria, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Maroku, Holanda, Portugalia, Rumania, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Sllovakia, Sllovenia. Më pas u bashkuan si autorë edhe *Shqipëria*, Australia, Austria, Belgjika, Qiproja, Danimarka, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Finlanda, Franca, Greqia, Italia, Japonia, Malta, Norvegjia, Zelanda e Re, Polonia, Republika Çeke, Suedia dhe Zvicra. E/CN.4/1999/L.34/Rev.1, *Situation des droits de l'homme en République fédérale de Yougoslavie (Serbie et Monténégro), en République de Croatie et en Bosnie-Herzégovine*, si dhe A/RES/54/184, A/54/PV.83, - 17 déc. 1999, 123-2-34, -*Situation des droits de l'homme en Bosnie-Herzégovine, en République de Croatie et en République fédérale de Yougoslavie (Serbie et Monténégro)*. Shih edhe Ksenofon Krisafi, *Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike*, Onufri UMSHPRESS, Tiranë, 2018.

<sup>100</sup> CHR 55 ème 23/04/1999, E/CN.4/RES/1999/18, *Situation des droits de l'homme en République fédérale de Yougoslavie (Serbie et Monténégro), en République de Croatie et en Bosnie-Herzégovine*.

ritheksua “tronditja dhe tmerrri për masakrat dhe aktet e tjera të represionit brutal për pastrimin etnik, të kryera në Kosovë nga forcat serbe të sigurisë dhe paraushtarakët, në shkelje flagrante të normave ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare, që kanë shkaktuar humbje të jetëve njerëzore dhe një tragjedi njerëzore masive që prek gjithë rajonin.”<sup>101</sup>

Rezoluta “dënonte krimet e luftës dhe shkeljet e rënda dhe të tmerrshme të të drejtave të njeriut, që vazhdonin të ndodhnin në Kosovë, ndjekjet dhe pastrimin etnik, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, masakrat dhe shkeljet flagrante...” Ajo “insistonte që qeveria e Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mali i Zi), të merrte menjëherë masat për t’i dhënë fund represionit të vazhdueshëm të ushtruar kundër popullsisë shqiptare dhe bashkësive të tjera që jetojnë në Kosovë dhe të ndalonte shndërrimin e tyre në objekt dhune, të ndalonte torturat, brutalitetet, hetimet e papërligjura, burgimet arbitrare, proceset e padrejta, dëbimet dhe linçimet arbitrare dhe të papërligjura, shkatërrimet e shtëpive në shkallë të gjerë dhe taktikën e tokës së djegur.”<sup>102</sup>

Paralajmëronte shkaktarët dhe përgjegjësit e drejtpërdrejtë të masakrave njerëzore, autoritetet dhe drejtuesit politikë të Beogradit dhe cilindo që ishte përfshirë në veprime të tilla, se një ditë do të përgjigjeshin penalisht për krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidit ndaj popullit të Kosovës dhe popujve të tjerë të ish-Jugosllavisë. Rezoluta iu përcoll Këshillit Ekonomik e Social, i cili pasi e diskutoi dhe e miratoi, ia kaloi për veprime të mëtejshme Këshillit të Sigurimit.<sup>103</sup>

Në këtë kategori aktesh përfshihet gjithashtu edhe fjalimi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kofi Annan, mbajti në punimet e sesionit të 55-të të Komisionit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së, në 7 prill të vitit 1999, në Gjenevë.<sup>104</sup> Ai tha se “Në historinë e njerëzimit, midis gjithë dhunimeve flagrante, gjenocidi nuk ka ekuivalent... shenja

---

<sup>101</sup> E/CN.4/1999/L.34/Rev.1

<sup>102</sup> Po aty.

<sup>103</sup> E/1999/23, E/C.4/1999/167, Commission des Droits de l'Homme, Rapport sur la cinquante - cinquième session, (22 mars - 30 avril 1999), Conseil Économique et Social, Documents Officiels, 1999, Supplément N0 3, Nations Unies, New York et Genève, 1999, p.20. 7. *Situation des droits de l'homme en République fédérale de Yougoslavie (Serbie et Monténégro), en République de Croatie et en Bosnie-Herzégovine.*

<sup>104</sup> E/CN.4/1999/SR.19, p. 3-4.

të të cilit duket se janë duke u verifikuar edhe në Kosovë... Edhe pse OKB-ja është një organizatë, anëtarë të së cilës janë shtetet, të drejtat dhe idealet që ajo synon të mbrojë, janë ato të popujve. Organizata e vendos qenien njerëzore në qendër të veprimtarisë së saj. Në asnjë vend, qeveria nuk ka të drejtë të fshihet pas sovranitetit kombëtar për të shkelur të drejtat e njeriut ose liritë themelore të banorëve të atij vendi. Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të çdo personi janë të shenjta.”<sup>105</sup> Kjo normë ndërkombëtare duhet të përbëjë një sfidë themelore për OKB-në, e cila duhet t’u shërbejë idealeve që frymëzuan themelimin e saj. Një shpresë e tillë për njerëzimin vjen ndoshta shumë vonë për miliona fatkeqët që janë dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre në Kosovë dhe për qindra, në mos mijëra të tjerë, që janë vrarë. Por nuk do të ishte shumë vonë për OKB-në, nëse ajo jep kurajo për t’u drejtuar shekullit të ardhshëm duke riafirmuar vullnetin e vet për të mbrojtur të drejtat e çdo burri, të çdo gruaje e të çdo fëmije, pavarësisht nga përkatësia e tij etnike, kombëtare ose fetare, përfundoi Annan.<sup>106</sup>

Ish-sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Annan, tha gjithashtu se “fushata (serbe), para së gjithash kishte një qëllim: të largojë dhe të vrasë sa më shumë shqiptarë të Kosovës”. Duke i njohur këto ambicie të Serbisë së Milosheviqit, komuniteti ndërkombëtar kishte përgjegjësi për ta mbrojtur popullatën civile (*Responsibility to Protect*) në Kosovë përballë agresionit ushtarak serb.<sup>107</sup>

Do të mjaftonin fjalët e numrit 1 të politikës shumëpalëshe botërore, të thëna me qartësi të skajshme, në një nga organet më autoritare dhe më kompetente ndërkombëtare, që konfirmojnë të vërtetën e pamohueshme se bashkësia ndërkombëtare nuk kishte vetëm të drejtë për të ndërhyrë, por ishte e detyruar të mbronte jetë njerëzore dhe të ndëshkonte Beogradin.

Përmenden, siç u tha edhe mjaft akte të tjera.<sup>108</sup>

## Akte të organizatave të tjera ndërkombëtare

Në një numër pa fund dokumentesh zyrtare të OKB-së dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, ka argumente të pakontestueshme të karakterit juridik, që e kapërcejnë “shqetësimin” e pengesës së kreut

<sup>105</sup> Po aty.

<sup>106</sup> Nga fjala e Kofi Annan, E/CN.4/1999/SR.19, p. 3-4.

<sup>107</sup> Kofi Annan, *Interventions: A Life in War and Peace*, Penguin Books, 2012,

<sup>108</sup> E/CN.4/1999/SR, më 9 korrik 1999.

VII të Kartës së OKB-së. Në to gjenden me bollëk emërtimet: gjenocid, pastrim etnik, krime lufte, krime kundër njerëzimit etj. për aktet e kryera nga Serbia në Kosovë. Gjenden edhe përshkrime të hollësishme se ç'kishte bërë Beogradi në trojet e shqiptarëve.

Prej tyre përforcohet edhe më tej legjitimiteti i ndërhyrjes në ish-Jugosllavi. Atyre u shtohen edhe disa rezoluta të hershme të Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, siç janë fjala vjen Rezoluta 47/121 e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara e 18 dhjetorit 1992, e cila dëbimin masiv nga shtëpitë e veta të civilëve të pambrojtur dhe zbatimin e politikës së spastrimit etnik e konsideron një formë gjenocidi, Deklarata dhe Plani i Veprimit i Konferencës Botërore të të Drejtave të Njeriut, organizuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Vjenë, më 25 qershor 1993,<sup>109</sup> rezolutat e Këshillit të Sigurimit me nr.1160 e 31 marsit 1998, nr.1168 e 21 majit 1998, nr. 1199 e 23 shtatorit 1998, nr.1203 e 24 tetorit 1998, nr. 1239 e 14 majit 1999, nr. 1244 e 10 qershorit 1999, si dhe Rezoluta S/RES/1820 e 19 qershorit 2008<sup>110</sup>, Rezoluta S/RES/2467 e 23 prillit 2019, për përgjegjësinë e shteteve për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe përndjekjes penale, përgjegjësve për krime të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, të kryera kundër civilëve<sup>111</sup>, Raporti për situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë, paraqitur më 7 shtator 1999 në Byronë e Komisionit nga Komisarja e Lartë e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, rezoluta e 20 prillit 1994, e Parlamentit Evropian, ku flitej për “të drejtën e ndërhyrjes për qëllime humanitare” etj. Ajo “konsideron se e drejta ndërkombëtare aktuale nuk paraqet domosdoshmërisht pengesë për njohjen e së drejtës së ndërhyrjes humanitare”.

Argument tjetër në favor të ndërhyrjes është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948, Konventa Ndërkombëtare mbi të

---

<sup>109</sup> Paragrafi 28 i saj thekson se praktika e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut në format e gjenocidit, 'spastrimit etnik' dhe përdhunimit sistematik të grave në situata lufte, si dhe eksodi masiv i njerëzve nga vendbanimet dhe vendi i tyre, janë krime të pafalshme dhe të dënueshme në çdo kohë.

<sup>110</sup> Rezoluta thekson se “përdhunimi dhe format e tjera të dhunës seksuale mund të përbëjnë krim të luftës, krim kundër njerëzimit, apo dhe akt konstitiuv të gjenocidit”, si dhe kërkon përjashtimin e dhunës seksuale nga dispozitat për amnisti në kontekstin e proceseve për zgjidhjen e konflikteve, S/RES/1820 e 19 qershorit 2008.

<sup>111</sup> S/RES/1820 e 19 qershorit 2008. Aty shprehet shqetësimi se vetëm një numër shumë i kufizuar i autorëve të dhunës seksuale vihen para drejtësisë.

Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të njohura edhe si Paktet e vitit 1966 dhe një sistem i tërë aktesh dy e shumëpalëshe. Në interpretim të tyre, ndërhyrja në ish-Jugosllavi, nuk mund të konsiderohet si shkelje e Kartës, por zbatim i frymës dhe misionit të saj. Ajo u ndërmor për të ndaluar gjenocidin dhe pastrimin etnik të Milosheviqit ndaj shqiptarëve, pak a shumë siç u veprua gjatë Luftës së Dytë Botërore për të ndaluar Hitlerin.

## Shqipëria në krah të NATO-s dhe Kosovës

E bindur në drejtësinë e pakontestueshme të vendimit të NATO-s për domosdoshmërinë e bombardimeve në ish-Jugosllavi, Shqipëria u rreshtua përkrah saj. Disa qindra djem kapërcyen kufirin, rrëmbyen armët dhe u përfshinë në radhët e UÇK-së. Një pjesë e tyre flijuan jetën në altarin e lirisë së Kosovës. Ndërkohë, qeveria dhe gjithë strukturat e tjera shtetërore, për vite me radhë, u angazhuan, për pritjen dhe sistemin në Shqipëri të disa qindra mijëra refugjatëve nga Kosova, si dhe për të sensibilizuar faktorin ndërkombëtar dhe opinionin e gjerë publik në përkrahje të kauzës së saj. Në këtë mision, kur NATO-ja filloi sulmin në ish-Jugosllavi, në punimet e Komisionit të të drejtave të njeriut të OKB-së, ishin të pranishëm edhe delegatët e Shqipërisë. Ata, me të drejtën e përfaqësuesve të popullit, gjysma e të cilit ishte bërë objekt i gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit etj. në zbatim edhe të angazhimeve shtetërore politike dhe juridiko-kushtetuese, ndjeheshim të justifikuar të kërkonim që Komisioni, të bënte të gjitha përpjekjet, për të dhënë kontributin maksimal, që popullit të Kosovës t'i rikthehej sa më parë jeta, paqja, qetësia, shpresa, garancia për të ardhmen.<sup>112</sup>... Përfaqësuesit shqiptarë shprehnin deziluzion për qëndrimet që mbaheshin nga disa prej shteteve aleate të ish-Jugosllavisë. “Nuk mund të mos ndjesh keqardhje kur dëgjon zëra që e paraqesin në mënyrë të shtrembëruar ndërhyrjen e NATO-s,-tha në një nga fjalimet e veta kryetari i delegacionit shqiptar... Ne do të dëshironim t'i kujtonim opinionit publik se këta zëra heshtën kur granatat serbe shkatërronin shtëpitë e shqiptarëve dhe falangat e Milosheviqit digjnin me zjarr gjithçka që gjenin përpara, ata heshtën kur masakroheshin gratë dhe fëmijët kosovarë, heshtën kur shqiptarët largoheshin me qindra e me mijëra

<sup>112</sup> Ksenofon Krisafi, *Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike*, Onufri UMSPRESS, Tiranë, 2018,

drejt maleve për t'i shpëtuar vdekjes, heshtën kur policia, ushtria serbe dhe bandat e neofashistit Arkan vrisnin shqiptarët për të vetmen arsye se ishin shqiptarë.<sup>113</sup>... Me të drejtë shtrohet pyetja, - kush nga këta që sot luajnë rolin e avokatit në mbrojtje të Milosheviqit foli... kur Kosova iu nënshtrua për vite të tëra një regjimi të pashpirt të terrorit shtetëror? Si mund të tolerohet që një regjim gjakatar të mbajë peng një popull prej më shumë se dy milionë banorësh nën pretekstin absurd të domosdoshmërisë së respektimit të “sovrانيتit” të papërligjur?<sup>114</sup>

## Konkluzion

Edhe pse përmes vështirësish të shumta të karakterit politik, strategjik, ekonomik, social, etj. të paraqitura nën koperturën e “argumenteve” formalo-juridike, aleanca euroatlantike e NATO-s, në pranverën e vitit 1999, e gjeti rrugën dhe mundësinë e mirëfilltë ligjore të ndërhyrjes në ish-Jugosllavi, duke iu ardhur në ndihmë shqiptarëve të Kosovës, të cilët i ndihmoi të çliroheshin nga zgjedha serbe, të shpallnin pavarësinë dhe të krijonin shtetin e tyre të pavarur.

Pavarësisht ndonjë zëri të mekur që tenton të justifikojë përpjekjen e dështuar të Serbisë për ta mbajtur ende nën sundim Kosovën, tashmë çështja e legjitimitetit të ndërhyrjes së NATO-s në ish-Jugosllavi, e ka marrë përgjigjen e vet. Ajo veprimi në respekt të normave dhe parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare. Realizoi në mënyrë shembullore një ndërhyrje të armatosur për qëllime humanitare në punët e brendshme të një shteti që kishte instaluar një kompleks sistemesh të terrorit dhe dhunës shtetërore ndaj popullit të Kosovës.

---

<sup>113</sup> Po aty.

<sup>114</sup> Po aty.

## Bibliografia

### I.-

- Albright, Madeleine,- *Zonja Sekretare: autobiografi*. Tiranë: Dudaj, 2004.
- Annan, Kofi,- “*Interventions: A Life in War and Peace*”, Penguin Books, 2012.
- Bermejo, Romualdo García, Eugenia Lopez-Lacoiste Diaz,- *De la intervencion por causas humanitarias a la responsabilidad de proteger, fundamentos, similitudes y diferencias*, Guadernos de estrategia, 2013; Pignatelli y Meca, 2001.
- Blair, Tony,- *Një rrugëtim*, Shtëpia botuese “55”, Tiranë 2011.
- Blair,Toni,- *Për Shqiptarët, ‘ALBPAPER’*, Tiranë, 2005,
- Bonino Ema.- *Las distintas formas de intervención*, në *Revista de Occidente*, n°236-237
- Brownlie, Ian, - *International Law and the Use of Force by States*, 1st edition, Clarendon Press (1991
- Cassese, Antonio - *Violence et droit dans un monde divisé*, Paris, PUF, 1990.
- Clinton, Bill,- (1999-06-25), *Press Conference by the President*. Phyllis Schlafly, *Numbers Game in Kosovo*, në *Washington Times*, 19 octobre 1999.
- Cohen, William, - *War in Europe, NATO’s war against Serbia over Kosovo*, në *FRONTLINE*, November, 2015.
- Daalder, Ivo H. Michael E. O’Hanlon, - *Winning ugly: NATO’s war to save Kosovo / Washington, D.C.: Brookings Institution Press, ©2000, Democracy and Human Rights*, New Haven/London 1999.
- Dictatorship and Punishment: a Reply to Scanlon and Teitel*, në Harold Hongju Koh and Ronald C. Slye (eds.), *Deliberative*
- Eusebio Fernández García, - *Lealtad cosmopolita e intervenciones bélicas humanitarias*, në *Revista de Occidente*, n°236-237
- Falk, Richard,- Kratochwil, Friedrich, and Saul H. Mendlovitz, eds. “*International Law: A Contemporary Perspective*”. Boulder, CO: Westview, 1985
- Farah, Joseph,- (1999-11-29), *The Real War Crimes*. WorldNetDaily. <http://www.worldnetdaily.com/news/>
- Fernández, Luis Peral, - *Exodos masivos, supervivencia y mantenimiento de la paz*, Madrid: Editorial Trotta, SA 2001.
- Fischer, Joschka,- *Vitet kuq-gjellbër*, Koha, Prishtinë, 2008,
- Freundlich, Leo,- *Golgota Shqiptare*, shtëpia botuese “LILLO”, Tiranë, 1995.
- Gaja, Giorgio,- *Reflections on the role of the Security Council in the new world order*, in the General Review of public international law, 1993.
- Gecaj, Bajram,- *Konferenca e Rambujesë*, AIKD, Prishtinë, 2009,

- Greenwood, Christopher,- *Gibt es ein Recht auf humanitarian Intervent?* në *Europa-Archiv*, nr<sup>4</sup>, 1993.
- Heraclides, Alexis Ada Dialla, *Intervention in the Greek War of Independence, 1821–1832*, <https://doi.org/10.7228/manchester/9780719089909.003.0006>, Published: July 2015 pp.195-196.
- Hoxha, Mentor, - *Zhak Shirak, Presidenti më proshqiptar në historinë e Francës. Meriton një shtatore gjigande në Tiranë dhe Prishtinë. Ja 7 arsytet. Gazeta Fjala*, 05/04/2022.
- Huysmans, Jef,- *Shape-shifting NATO: humanitarian action and the Kosovo refugee crisis*, në *Review of International Studies* (2002), 28, 599–618 Copyright © British International Studies Association.
- Kadare, Ismail,- *Ditari për Kosovën*, 23-24 mars 1999.
- Kaldor, Mary,- *Neue und alte Kriege*, Frankfurt/Main, Szweite Moderne, 1999;
- Kant, Emmanuel,- *Gesammelte Werke*, Preußische Akademie der Wissenschaften, Berlin, 1910, VIII.Kesseling, Thomas,- *Ethik der Entwicklungspolitik. Gerechtigkeit im Zeitalter der Globalisierung*, München, CH Beck, 2003;
- Köck, Heribert Franz,- *Die Humanitäre Intervention*, në Gustav Gustenau (regji.), *Humanitäre militärische Intervention zwischen Legalität und Legitimität*, Baden-Baden, Nomos, 2000.
- Klinton, Bill,- “*Ne luftën, ju paqen*”, “Albania”, Tiranë 2000.
- Klinton, Bill, *Jeta Ime*, Dudaj, Tiranë, 2005.
- Krisafi, Ksenofon,- *Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike*, UMSHPRESS, Tiranë, 2018.
- Kurti, Albin, - *Vuçiq në koordinim me Rusinë, mbi varrezat masive, po përgatit kërcënime dhe ultimatumet të reja ndaj Kosovës*,
- Latifi, Blerim, - *Mbi Luftën e Tretë Botërore*, *Gazeta Express*, 6 Janar 2020
- Leurdijk, Dick A., - *Kosovo: A case of 'coercive diplomacy*, *Helsinki Monitor*, 10 (2), 1999.
- Maurizio, Ali,- *L'attività di peacekeeping della Forza Multinazionale di Protezione in Albania*. (Rome, Italy, Facoltà di Scienze
- Menéndez, Fernando M. Mariño, - *Derecho Internacional Público*, Parte General, Universidad Carlos III de Madrid. Instituto de Estudios Internacionales y Europeos Francisco de Vitoria, Madrid, 1999.
- Mendiluce, José María,- *La nueva política. Por una globalización democrática*, Barcelona, 2002, Planeta.
- Mosely, Philip E. - *Intervention and nonintervention in Spain, 1838-1839*, *The Journal of Modern History*, Vol. 13, No. 2 (Jun., 1941), Published By: The University of Chicago Press.
- Münkler, Herfried,- *Die neuen Kriege*, Hamburg, Rowohlt, 2002;

- Oeter, Stefan,- *Humanitäre Intervention und Gewaltverbot: Wie handlungsfähig ist die Staatengemeinschaft*, në Hauke Brunkhorst (ed.), *Eingemischung erwünscht?*, Frankfurt/ Main, Fisher Taschenbuch Verlag.
- Oraa J., *La gran paradoja de los derechos humanos en el mundo contemporáneo*, në Marzal A. (ed.), *Los derechos humanos en el mundo*, Barcelona, J.M. Bosch/ESA-DE. Citohet nga David Sánchez Rubio, *Interventions humanitaires: principes, concepts et réalités*, në Alternatives Sud, VOLUME Vol.XI 2004/3, DATE 08/2004. CETRI. Interventions humanitaires? LA COLLECTION
- Politiche - Università Roma Tre). 2003. “Resolution 1101”. unscr.com. Tripodi, P. (2010-09-08).
- Puto, Arben,- *E drejta ndërkombëtare*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2010.
- Quoc Dinh, Nguyen Patrick Daillier, Alain Paillet,- *Droit International Public*, 7-ème edition, Paris 2002,
- Riccardo Colonel Marchio,- *Operation Alba: A European approach to peace support in the Balkans* (PDF). (2000).
- Rougier, Antoine - *La théorie de l'intervention d'humanité*, Paris: A. Pedone, 1910.
- Rubio, David Sánchez,- *Interventions humanitaires: principes, concepts et réalités*, në Alternatives Sud, VOLUME Vol.XI 2004/3, DATE 08/2004. CETRI. Interventions humanitaires? LA COLLECTION Sundhassen, Holm, - *Jugoslawien und seine Nachfolgestaaten 1943-2011*, Böhlau Verlag Wien · Köln · Weimar, 2012.
- Schlaflly, Phyllis,- (1999-10-19). *Numbers Game in Kosovo*, Washington Times.
- Stapleton, Augustus Granville,- *Intervention and Non-Intervention or the Foreign Policy of Great Britain from 1790 to 1865*, London: John Murray, 1866,
- Teson, Fernando R.- *Humanitarian Intervention: An Inquiry Into Law and Morality*, - Transnational, 1997.
- Todorov,Tzvetan,- *Imperfect Garden: The Legacy of Humanism*, 2002, Published by: Princeton University Press,
- Valdés, Ernesto Garzón,- *Guerra e diritti umani*, Región Practica, nº 13, 1999
- Von Heinegg, Wolff Heintschel & N. Schmitt, Michael,- *Detention and Occupation in International Humanitarian Law*, Published June 10, 2019 by Routledge.
- Wight, Martin,- *Power politics: the definitive study of international relations*, Publisher West Drayton: Penguin, 1986.
- Wight, M.- *Western Values in International Relations*, në H. Butterfield and M. Wight (eds), *Diplomatic Investigations: Essays in the Theory of International Politics* (London: Allen and Unwin, 1966), f. 118
- Vincent, R. J.- *Nonintervention and International Order*, Princeton University Press, 1974.
- Zanetti,Véronique, - *Le droit à l'analyse humanitaire: une analyse conceptuelle*, në *Le Cosmopolitanisme, Enjeux et débats contemporains*, 2019

## II.-

AFP,

Agjencia Telegrafike Shqiptare, 13 shtator 2024.

AP 13.4.1999.

FRONTLINE, November, 2015.

Gazeta Express, 6 Janar 2020

Gazeta Fjala, 05/04/2022

Gazeta Telegrafi, 24.03.24.

Ludington Daily News (23 prill 1999). *NATO strikes Serbian television's main studio.*

Le Monde, 22 mai 1999.

Newsbomb, 24 Mars 2024,

*Albania: Italy's Prime Minister Faces Uncertain Future Over Security Force*, 2008-04-09. CNN - French, Italian troops lead mission to Albania - Apr. 15, 1997, www.cnn.com. *Resolution 1114*. unscr.com. *Albania: parliamentary elections Kuvendi Popullor, 1997*, archive.ipu.org. 1997. *The Alba Mission in the framework of the FMP, Carabinieri. Albania - Alba - Esercito Italiano*. www.esercito.difesa.it.

Fejtoni - 25 vjet nga bombardimet e NATO të Serbisë (26): Nxitimi i Drashkoviçit, qortimet e Çernomirdinit dhe paralajmërimet e Chomsky, NATO bombardovanje Srbije Burim: Veçernje novosti, Shkruan për Kosovo online: Dragan Biseniq,

Radio Free Europe/Radio Liberty (në anglisht).

## III.-

*Commission internationale sur l'intervention et la souveraineté des États (ICISS), Responsabilité de protéger*, Otava, 2001: <http://www.dfait-maeci.gc.ca/iciss-ciise/menu-en.asp>, Otava, 2001.

E/CN.4/1999/SR.14, p. 18.E/CN.4/1999/SR.13.

E/CN.4/1999/SR.14.

Karta e OKB-së.

E/CN.4/1999/L.34/Rev.1, *Situation des droits de l'homme en République fédérale de Yougoslavie (Serbie et Monténégro), en République de Croatie et en Bosnie-Herzégovine*, si dhe

A/RES/54/184,

A/54/PV.83,- 17 déc. 1999, 123-2-34,-*Situation des droits de l'homme en Bosnie-Herzégovine, en République de Croatie et en République fédérale de Yougoslavie (Serbie et Monténégro)*.

CHR 55 ème 23/04/1999,

E/CN.4/RES/1999/18, *Situation des droits de l'homme en République fédérale de Yougoslavie (Serbie et Monténégro), en République de Croatie et en Bosnie-Herzégovine.*

E/1999/23, E/C.4/1999/167, Commission des Droits de l'Homme, Rapport sur la cinquante - cinquième session, (22 mars - 30 avril 1999), Conseil Économique et Social, Documents Officiels, 1999, Supplément N0 3, Nations Unies, New York et Genève, 1999, *Situation des droits de l'homme en République fédérale de Yougoslavie (Serbie et Monténégro), en République de Croatie et en Bosnie-Herzégovine.*

E/CN.4/1999/SR.19.

E/CN.4/1999/SR, më 9 korrik 1999.

S/RES/1820 e 19 qershorit 2008.

Nations Unies, E, Conseil Économique et Social, Distribution Générale, E/CN.4/1999/SR.62, 18 juin 1999, Commission des Droits de l'Homme, Cinquante-cinquième session, Compte rendu analytique de la 62ème séance, tenue au Palais des Nations, à Genève, le vendredi 30 avril 1999.

*Official Journal of the European Communities* Nr. C 128/226, Wednesday April 20, 1994;

Press Release, SG/SM/7136, GA/9596

Résolution du Conseil de Sécurité, du 25 juin 1950

Résolutions du Conseil de Sécurité - 1950. Nations Unies, Septembre 2000, 82 (1950).

Secretary-General presents his Annual Report to General Assembly, 20 September 1999.

UN, General Assembly, Resolution 2625 (XXV), 24 octobre 1970.

Human Rights watch; *Nën urdhërat: Krimet e luftës në Kosovë* (2001),

Aktgjykim, Prokuroria e Tribunalit të Hagës, Vëllimi 1, prej 4, icty.org [https://www.icty.org/cases/tjug/090226\\_vol\\_1](https://www.icty.org/cases/tjug/090226_vol_1), PDF.

Nations Unies, E, Conseil Économique et Social, Distribution Générale, E/CN.4/1999/SR.62, 18 juin 1999, Commission des Droits de l'Homme, Cinquante-cinquième session, *Compte rendu analytique de la 62ème séance*, tenue au Palais des Nations, à Genève, le vendredi 30 avril 1999.

*Albanian Rebellion of 1997*, [www.onwar.com](http://www.onwar.com).

*Operation Alba: A Necessary and Successful Preventive Deployment*. International Peacekeeping (në anglisht). 9 (4): 89–104. doi:10.1080/714002777. ISSN 1353-3312.

AFP, ATS 7.4.1999, 9.4.1999.

Paskal Milo

## ROLI I DIPLOMACISË SHQIPTARE NË KONFERENCËN E RAMBUJESË

Konferenca e Rambujesë e 25 viteve më parë hyn në kategorinë e atyre ngjarjeve historike që kanë karakter dhe rëndësi shumëdimensionale në historinë e kombeve dhe që krijojnë epokë. Për meritat e saj kryesore është shkruar e folur shumë në këtë çerek shekulli. Përvjetori i sivjetshëm i saj është jo vetëm rasti, por edhe një obligim për ta përkujtuar e për të reflektuar, sepse ajo veçanërisht sot mbetet një referencë historike e pazëvendësueshme për të nxjerrë mësim. Duke qenë i nderuar për ftesën që më është bërë për të folur në këtë Konferencë, unë po paraqitem me kapacitetin tim si historian, por njëkohësisht edhe si dëshmitar e veprimtar i ngjarjeve në Rambuje.

Si historian për vendin dhe rolin e Konferencës së Rambujesë kam arritur në disa përfundime që po i rendit më poshtë:

**I.** Për herë të parë çështja e Kosovës u bë objekt i një Konference ndërkombëtare pas Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të vitit 1913 që nuk e la në përbërje të shtetit të pavarur shqiptar që u krijua. Duhet bërë dallimi midis ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës si proces që nisi që me ngjarjet e pranverës së vitit 1981 dhe aksionit të përqendruar diplomatik ndërkombëtar në formën e një Konference ndërkombëtare siç ishte ajo e Rambujesë.

**II.** Konferenca e Rambujesë si forum ndërkombëtar për herë të parë shtroi për zgjidhje çështjen e Kosovës si çështje kombëtare dhe jo si çështje e të drejtave të njeriut e të minoriteteve. Për herë të parë në dokumentin themelor të saj përmes togfjalëshit “vullnet i popullit” në mënyrë të tërthortë u njoh e drejta e shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje pas tre vjetësh.

**III.** Konferenca e Rambujesë ishte arritje kulmore e bashkimit të të gjithë faktorëve kryesorë politikë shqiptarë të Kosovës. Ajo shënoi njohjen nga ana e ndërkombëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si një realitet politik dhe ushtarak dhe si një aktor i rëndësishëm, në mos kryesori në kërkim të zgjidhjes së konfliktit shqiptaro-serb në Kosovë.

**IV.** Konferenca e Rambujesë dhe marrëveshja në përfundim të saj shërbeu si bazë konsensuale për Shtetet e Bashkuara dhe vendet kryesore të BE-së, anëtarë të NATO-s, që pas refuzimit të regjimit të Milosheviqit për t'iu bashkuar kësaj marrëveshjeje, të ndërmerrenin operacione ushtarake ajrore për të shkatërruar infrastrukturën ushtarake të këtij regjimi. Ky operacion nuk ishte një akt klasik lufte mes palëve, por ishte një ndërhyrje e motivuar nga e drejta dhe morali njerëzor për të shpëtuar nga shfarosja qindra mijëra njerëz të pafajshëm. Pa marrëveshjen e Rambujesë nuk do të kishte ndërhyrje të NATO-s në Kosovë.

**V.** Çlirimi i Kosovës më 9 qershor 1999 ishte rrjedhim logjik i Marrëveshjes së Rambujesë, përfundim i detyruar i një angazhimi ndërkombëtar për t'i hapur rrugë zbatimit të saj.

**VI.** Zhvillimi i ngjarjeve në Kosovën e çliruar e nën protektorat ndërkombëtar, në rrethanat e reja të vetëqeverisjes së vëzhguar i materializoi dhe i kapërceu klauzolat e Marrëveshjes së Rambujesë. Periudha tranzitore disavjeçare përmes negocimit të ndërmjetësuar ndërkombëtar krijoi konturet e shtetit të Kosovës si protektorat nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara, por duke lënë të hapur të drejtën e shqiptarëve për vetëvendosje.

**VII.** Akti i 17 shkurtit 2008 kur Kuvendi i Kosovës shpalli shtetin e pavarur ishte përmbyllja e misionit që u skicua me aq mundim e përplasje në sallat e Kështjellës së Rambujesë në ato ditë shkurti 1999. Ishin thuajse të njëjtët aktorë kryesorë politikë me përjashtim të Presidentit Ibrahim Rugova. Konferenca e Rambujesë pati si faktor vendimtar ndërkombëtar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe po kështu edhe Pavarësia e Kosovës.

Diplomacia shqiptare ka luajtur një rol të rëndësishëm në Konferencën e Rambujesë e pas saj. Anëtarë të delegacionit të shqiptarëve të Kosovës kanë riprodhuar momentet dramatike të kësaj Konference për lexuesit dhe opinionin publik. Të tjerë, analistë, shqiptarë e të huaj, këshilltarë dhe ndihmës të delegacionit shqiptar kanë sjellë detaje dhe përshtypje rreth saj. Mbresat dhe shënimet e mia më të shumta për këtë Konferencë e zhvillimet e mëvonshme janë botuar në një libër të veçantë të 15 vjet më parë.<sup>1</sup> Por gjithnjë ka pasur dhe ka vend për të sjellë informacione dhe këndvështrime të reja që vijnë nga deklasifikimi i dokumenteve arkivore të kohës, por edhe nga njëfarë “çlirimi” që rrjedh me kalimin e viteve nga përgjegjësia e ruajtjes së disa sekreteve shtetërore diplomatike.

Diplomacia shqiptare në të hyrë të vitit 1999 ftoi në Tiranë njërin pas tjetrit të gjithë faktorët kryesorë politikë shqiptarë të Kosovës.

Qëllimi ka qenë që të nxitej krijimi i një organizmi konsultativ por edhe vendimmarrës mbarëshqiptar për të folur me një zë në kërkim të një statusi sa më të avancuar të Kosovës. Masakra e Reçakut e 15 janarit me dramacitetin që përcolli dhe sensibilitetin që ngjalli në mënyrë ulëritëse paralajmëroi përsëritjen e akteve gjenocidale të përmasave të mëdha të regjimit nacionalist të Slobodan Milosheviqit të tipit të Srebrenicës ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës.

Komuniteti ndërkombëtar, veçanërisht Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe etj. e përjetuan masakrën e Reçakut si një sfidë të madhe që Milosheviqi po u bënte atyre. Këtë herë në dallim nga më parë vendimi ishte i menjëhershëm dhe unanim. Grupi i Kontaktit i mbledhur në Londër në 29 janar 1999 vendosi “që të mbledhin bashkë përfaqësuesit nga Qeveritë e RFJ-së dhe Serbisë dhe përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës, në Rambuje, më 6 shkurt, nën bashkëkryesinë e Huber Vedrin-it dhe Robin Kuk-ut, për të filluar negociatat me përfshirjen direkte të G.K”. Deklarata e ministrave të jashtëm të Grupit të Kontaktit njohu se baza për një zgjidhje të drejtë e që duhej të pranohej nga të dy palët ishte **autonomia thelbësore e Kosovës**. Ministrat e jashtëm u bënë thirrje palëve që të tregonin përkushtim për të përfunduar negociatat për një zgjidhje politike brenda 21 ditëve, për të sjellë paqe në Kosovë dhe se do t’i konsideronin të dyja palët përgjegjëse nëse ato dështonin në shfrytëzimin e këtij rasti që iu ofrohej.<sup>2</sup>

Deklarata e Grupit të Kontaktit ishte gati një ultimatum që u bëhej si Slobodan Milosheviqit ashtu edhe shqiptarëve të Kosovës, partive politike e sidomos UÇK-së. Ajo ngjalli një debat të brendshëm mbarëshqiptar, veçanërisht në Kosovë, por edhe në Shqipëri. Pati forca dhe individë politikë me emër që reagueshan menjëherë kundër pranimin të ftesës, pa bërë analizë dhe pa llogaritur rrjedhojat por edhe përfitimet. Në Kosovë një prej tyre ishte i mirënjohuri Adem Demaçi, në atë kohë përfaqësuesi politik i UÇK-së, i cili në 2 shkurt në një deklaratë të posaçme për shtyp njoftoi se “**unë i kam rekomanduar Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që të mos shkojë në Rambuje të Francës**”.<sup>3</sup> Në Tiranë kundër vajtjes në Rambuje u shpreh Partia Demokratike dhe kryetari i saj zoti Sali Berisha.

Qeveria shqiptare menjëherë mbështeti zyrtarisht Deklaratën e Grupit të Kontaktit. Me kërkesë dhe në koordinim me Departamentin e Shtetit ajo u bëri thirrje partive politike shqiptare në Kosovë që t’i përgjigjen pozitivisht propozimit të Grupit të Kontaktit dhe të shkonin në Rambuje me një qëndrim unik. Në mënyrë të veçantë Qeverisë shqiptare iu kërkua që të ndikonte për të bindur UÇK-në që të merrte pjesë

në Konferencë. Ditët pas Deklaratës së Grupit të Kontaktit një pjesë e udhëheqjes së UÇK-së me në krye Hashim Thaçin u ndodh në Tiranë. Përfaqësues të institucioneve të larta të shtetit shqiptar, presidenti, kryetari i Parlamentit, kryeministri dhe ministri i Jashtëm u takuan disa herë me ta dhe pas bisedimeve e diskutimeve intensive u mor premtimi se UÇK-ja do të shkonte në Konferencën e Rambujesë. Në pasditen e 2 shkurtit, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së përmes zëdhënësit Jakup Krasniqi shpalli vendimin për të marrë pjesë në Konferencën e Rambujesë. Po në mesditën e 2 shkurtit, një vendim të tillë e kishin marrë edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja e Bashkuar Demokratike (LBD). Në 5 shkurt këto tre faktorë kryesorë shqiptarë arritën një marrëveshje parimore për përfaqësim të barabartë në delegacionin e përbashkët në Konferencë, për miratimin me konsensus të vendimeve, si dhe për caktimin e kryetarit të grupit negociator.

Konferenca e Rambujesë u hap në 6 shkurt 1999 pasdite. Ajo u përshëndet nga Presidenti i Francës Zhak Shirak. Dy bashkëkryetarët e Konferencës Vedrin dhe Kuk mbajtën fjalët e rastit. Ditën tjetër, në 7 shkurt të dy delegacioneve, atij shqiptar dhe serbo-jugosllav iu dha projektdokumenti i hartuar në emër të Grupit të Kontaktit, “Korniza e Marrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë”.<sup>4</sup> Ky dokument do të shërbente si bazë për diskutime dhe arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare kompromisi mes palëve.

Konferenca e Rambujesë ishte dhe u përjetua si një sfidë e madhe mbarëkombëtare. Ajo ishte e tillë jo vetëm për shqiptarët e Kosovës dhe delegacionin e tyre në Rambuje, por për të gjithë shqiptarët kudo që ndodheshin. Konferenca dhe Lufta që erdhi pas saj vuri në provë cilësitë më të vyera të shqiptarëve si komb të cilat u demonstruan në shkallë sipërore dhe me sukses.

Konferenca ishte gjithashtu pasqyra ku u reflektuan aftësitë dhe potencialet intelektuale, profesionale, politike dhe diplomatike të shtetit shqiptar. Ka qenë pikërisht Konferenca e Rambujesë dhe gjithë periudha e Luftës që ka shënuar një nga faqet më të ndritura të diplomacisë shqiptare për gjatë gjithë historisë së saj. Ky nuk është një vlerësim subjektiv por një përfundim që është nxjerrë nga arritjet konkrete e të matshme të saj nga ekspertë e analistë, shqiptarë e ndërkombëtarë, diplomatë të huaj dhe udhëheqës botërorë. Për ta bërë më të qartë e më të prekshëm këtë rol të diplomacisë shqiptare po radhiten disa nga veprimtaritë kryesore të saj gjatë dhe pas Konferencës:

**I. Qeveria shqiptare u kërkoi bashkëkryetarëve të Konferencës që t’i jepnin Shqipërisë statusin e vëzhguesit në të, kërkesë që u refuzua**

me argumentin se ajo nuk ishte një konferencë ndërkombëtare si ajo e Parisit për Bosnjën e Hercegovinën, por e kufizuar në rreth 25 vetë.<sup>5</sup> Për të ndjekur sa më afër Konferencën e në ndihmë të Ambasadës shqiptare në Paris, për t’u dhënë brenda mundësive që do të krijoheshin sa më shumë mbështetje dhe ekspertizë diplomatike delegacionit të shqiptarëve në Rambuje, nga Tirana në Paris u dërguan përfaqësues të lartë diplomatikë, si dhe ekspertë të çështjeve të sigurisë. Detyrë e tyre ndër të tjera ishte të kontaktonin në mënyrë intensive qarqet diplomatike franceze dhe ato të huaja të akredituara në Paris dhe sidomos të mbanin lidhje të ngushta bashkëpunimi me ambasadorin dhe ndërmjetësuesin amerikan Kristofer Hill. Gjithashtu përfaqësia e lartë diplomatike kishte për mision të dërgonte informacione dhe analiza për zhvillimin e punimeve të Konferencës gati në mënyrë të përditshme në Tiranë.

**II.** Pranë ministrisë së punëve të jashtme në Tiranë u ngrit një grup i posaçëm me ekspertë konstitucionalistë e juristë të shquar për të studiuar, analizuar dhe për të dhënë rekomandime alternative për çështjet që përmbanin dokument – propozimet e Grupit të Kontaktit dhe të ndërmjetësuesve ndërkombëtarë të cilat iu përcollën delegacionit të shqiptarëve në Rambuje.

**III.** Udhëheqja e shtetit shqiptar, presidenti, kryetari i Kuvendit, Kryesia dhe deputetët e tij, Kryeministri dhe Qeveria si dhe përfaqësues të tjerë të lartë të politikës shqiptare u angazhuan në takime dhe aktivitete ndërkombëtare e diplomatike në mbështetje të kauzës kombëtare që përfaqësonte dhe mbronte delegacioni i shqiptarëve të Kosovës në Rambuje.

**IV.** Trupi diplomatik shqiptar i akredituar në vende të ndryshme të botës dhe në organizata ndërkombëtare u udhëzua dhe zhvilloi kontakte intensive me përfaqësues zyrtarë të qeverive respektive dhe me titullarë e diplomatë të ambasadave të shteteve të tjera të akredituar aty. Një detyrë e veçantë për diplomatët shqiptarë ishte që të sqaronin opinionin publik të vendeve përkatëse edhe përmes shkrimeve në gazetat kryesore të tyre dhe me pjesëmarrje në debate televizive të organizuara me këtë rast.

**V.** Shoqëria civile dhe emrat e shquar të letërsisë, të artit, të kulturës dhe të shkencës shqiptare u përfshinë tërësisht në funksion të përmbylljes me sukses të kësaj sfide të madhe historike.

Përfaqësia e lartë diplomatike shqiptare në Paris së bashku me Ambasadën kryen që në fillim një aktivitet të ngjeshur diplomatik. Një javë pasi kishte filluar Konferenca ajo e informoi Ministrinë e Jashtme në Tiranë se **“kemi arritur të vendosim një kanal komunikimi me**

**delegacionin kosovar brenda Kështjellës së Rambujesë. Duke filluar që sot takimet do të jenë ditore gjatë të cilave ne ashtu siç kemi bërë deri sot, do të përcjellim mesazhet që vijnë nga Tirana dhe t'u japim informacionet që arrijmë të sigurojmë nëpërmjet kontakteve tona diplomatike...|Ajo që është bërë deri tani nga ana e Shqipërisë është vlerësuar shumë nga i gjithë delegacioni dhe herë pas here na vijnë mesazhe të mirënjohjes së tyre...Ata presin që t'u përcjellim sa më shumë materiale me mendime, sugjerime dhe formulime konkrete".<sup>6</sup>**

Negociatat në Rambuje pas javës së parë erdhën duke u veshtirësuar. Delegacioni serbo-jugosllav me qëndrimet që mbante dhe me kërkesat që parashtronte synonte ta sabotonte Konferencën e cila u shty edhe një javë tjetër. Sekretarja e Shtetit, Madeleine Albright bëri takime të veçanta me delegacionet e të dy palëve, ndërkohë ndërmjetësuesi amerikan K. Hill shkoi më 16 shkurt në Beograd në përpyetje që S. Milosheviqit t'i afroheshin disa elemente kompromisi që mund të çonin në arritjen e marrëveshjes.

Delegacioni shqiptar i Kosovës i ndodhur nën trynininë e urgjencës që sa vinte e shtoej nga Grupi i Kontaktit dhe përfaqësuesit e lartë amerikanë për të nënshkruar marrëveshjen, rezistoi, hezitoi dhe bëri kalë të betejës së tij negociuese tre çështje kryesore: **garancinë se në përfundim të periudhës kalimtare trevjeçare për statusin e Kosovës do të zhvillohej një referendum, përcaktimin** në terma konkrete të fatit të UÇK-së pas marrëveshjes, si dhe praninë e NATO-s. Në gjirin e Grupit të Kontaktit nuk kishte unanimitet për vendosjen e klauzolës së referendumit në tekstin e marrëveshjes. Albright që u investoi shumë për arritjen e saj i bëri delegacionit shqiptar një propozim që në vend të termit "referendum" të vendosej togfjalëshi "vullneti i popullit". Hezitimimi dhe përgjegjësia para një vendimi për të pranuar një zgjidhje që kishte mjaft të panjohura, bëri që bisedimet e Albright-it me delegacionin shqiptar dhe veçanërisht me kryetarin e tij, Hashim Thaçi në 21 shkurt të acaroheshin dhe të shtyheshin për tre ditë të tjera.

Ky ishte momenti kur Madeleine Albright dhe Departamenti i Shtetit e ndjenë se mund të dështonin dhe e gjithë sipërmarrja e tyre jo vetëm diplomatike, por edhe strategjike të humbiste. Kjo do të ishte një disfatë për prestigjin amerikan jo vetëm në rajon por edhe në botë, një dështim për ta vendosur S. Milosheviqin me shpatulla pas muri dhe për t'i hapur rrugë ndëshkimit të regjimit të tij përmes ndërhyrjes së parajlmëruar të NATO-s. Por mbi të gjitha do të ishte një humbje e

pakthyeshme për vetë shqiptarët e Kosovës dhe për çështjen kombëtare në përgjithësi.

Pikërisht në këto zhvillime dramatike amerikanët kërkuan ndihmën urgjente të Qeverisë shqiptare. Ishte vetë M. Albright që vonë në mbrëmjen e 21 shkurtit dhe në mëngjesin e ditës tjetër, disa herë bisedoi me kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm shqiptar dhe kërkoi: **“Bëni një deklaratë publike dhe mbështesni ato që propozojmë ne. U thoni shqiptarëve të Kosovës se ato që bëjmë të çojnë në referendum. Kanë gjithçka që ka të bëjë me referendumin. Përdorni influencën tuaj për t’i bindur ata që të pranojnë. Në qoftë se shqiptarët i thonë po marrëveshjes, ne do ta dërgojmë mesazhin në Bruksel te NATO”**.<sup>7</sup> Në përgjigje të thirrjeve këmbëngulëse të Albright-it, duke e gjykuar situatën tejet alarmante dhe në rrezik për të humbur shansin historik të krijuar për shqiptarët e Kosovës, në Tiranë u vendos që ministri i Jashtëm shqiptar i shoqëruar nga kryetari i Komisionit për Politikën e Jashtëme në Kuvendin e Shqipërisë, zotin Sabri Godo të shkonin urgjentisht në Rambuje dhe të bënin një përpjekje të fundit për të ndikuar në qëndrimin e delegacionit shqiptar.

Në Rambuje 23 shkurti ishte dita e fundit e Konferencës. Vëmendja mbarëshqiptare ishte përqendruar atje. Delegacioni shqiptar jetonte me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë kombëtare mbi supe, i dyzuar para vendimit që i duhej të merrte dhe nën presione që vinin nga brenda dhe jashtë Konferencës, nga amerikanët dhe miqtë e tjerë ndërkombëtarë, por edhe nga segmente të caktuara të UÇK-së në terren. Një ditë më parë Presidenti i Republikës, Rexhep Meidani, i kishte dërguar një letër Delegacionit në Rambuje ku me terma të zgjedhura i inkurajonte që përkundrejt vështirësive me mençuri dhe kthjelltësi të merrnin vendimin e duhur.<sup>8</sup> Dhe po në të njëjtën ditë, shkrimtari Ismail Kadare i shkruante delegacionit: **“Ky është një shans i madh përpara popullit shqiptar të Kosovës dhe gjithë kombit shqiptar” dhe “shanset nuk përsëriten kaq lehtë. Kam bindjen se këtij shansi kurrsesi nuk i duhet rënë me shkelm”**.<sup>9</sup>

Përfaqësuesit zyrtarë të shtetit shqiptar më 23 shkurt paradite bënë dy takime me një përfaqësi të delegacionit shqiptar në Rambuje të kryesuar nga Hashim Thaçi, njërin në orën 8.<sup>00</sup> të mëngjesit dhe tjetrin në orën 13.<sup>00</sup>. Takimi i parë që zgjati rreth një orë me gjithë përpjekjet që u bënë dhe argumentet që u sollën nuk e thyen rezistencën e Thaçit për të mos e nënshkruar marrëveshjen. Gjithçka po dukej se po shkonte drejt dështimit. Një thirrje dëshpëruese e ndërmjetësuesit amerikan, Ambasadorit Hill, gjysmë ore para përfundimit të afatit të Konferencës

e detyroi ministrin e Jashtëm shqiptar që t'i drejtohej përsëri Rambujesë. Hillin e kishin lëshuar nervat dhe në ligjëratë të drejtë tha: **“Zonja Albright s’ke qenë kurrë më e zemëruar sesa dje. Ajo është zhgënjyer nga qëndrimi i delegacionit shqiptar dhe veçanërisht nga qëndrimi i të ashtuquajturit kryetar Thaçi... Më shumë s’kemi ç’të bëjmë. Mjaft më... Amerika deri tani i ka mbështetur shumë ata. Nuk e kuptojnë se ka shumë amerikanë që nuk duan që ne të ndërhyjmë në Kosovë”**.<sup>10</sup>

Deklaratat nervoze të Hillit treguan se amerikanët thuajse i kishin humbur shpresat për të bindur delegacionin shqiptar dhe për të shmanhur dështimin e Konferencës që do të ishte njëkohësisht edhe dështimi i tyre. Dhe jo vetëm kaq. Mbyllja pa rezultat e Konferencës do të ishte, në radhë të parë, një humbje e madhe për vetë shqiptarët e Kosovës dhe një goditje e rëndë për të ardhmen dhe aspiratat e tyre kombëtare.

Përfaqësia e shtetit shqiptar e ndërjegjishme për misionin që kishte dhe rëndësinë kapitale të momentit me iniciativën e saj kërkoi një takim të dytë me delegacionin e shqiptarëve të Kosovës. Ky takim që u zhvillua në limitet e Konferencës për nga rrjedhojat që solli **mbetet një nga pikat kulmore të diplomacisë shqiptare dhe një ngjarje me rezonancë historike kombëtare**. Këmbëngulja dhe argumentet e përfaqësisë shtetërore shqiptare të shoqëruara edhe me telefonatat e kryeministrit Majko bënë atë që u shfaq si dritë në fund të tunelit, dakodësinë e Hashim Thaçit për të reflektuar. Dy orë më vonë Delegacioni shqiptar i dërgoi Sekretares së Shtetit Albright letrën e firmosur nga Veton Surroi në të cilën në parim shprehej dakord me përmbajtjen e Projektmarrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë.<sup>11</sup> Zyrtarisht kjo Marrëveshje u nënshkrua tri javë më vonë në 18 mars në Qendrën “Kleber” në Paris, por vetëm nga përfaqësuesit shqiptarë Ibrahim Rugova, Hashim Thaçi, Rexhep Qosja dhe Veton Surroi, si dhe nga dy prej tre ndërmjetësuesve ndërkombëtarë, Ambasadorit amerikan Kristofer Hill dhe Wolfgang Petrich, Ambasadori i Bashkimit Evropian.

Delegacioni serbo-jugosllav refuzoi ta nënshkruajë Marrëveshjen. Grupi i Kontaktit dhe, në veçanti, Shtetet e Bashkuara i vazhduan bisedimet me Beogradin për ta bindur për ta nënshkruar Marrëveshjen e për të shmangur ndëshkimin e paralajmëruar nga NATO-ja. Më 22-23 mars, ambasadori i posaçëm amerikan Richard Hollbrook shkoi për herë të fundit në Beograd, takoi Millosheviqin, por pa sukses. Ai mbrojti deri në fund pozicionin e tij për Konferencën dhe Marrëveshjen që ajo prodhoi duke deklaruar se **“Rambu je nuk ishte një negociim. Ajo**

**ishte një diktat i administratës Klinton. Nuk ishte një: o merre o lëre. Thjeshtë merre... Rambuje ishte një recetë për pavarësinë e Kosovës, të cilën qartë ne nuk mund ta prananim... Por qasja amerikane ishte të favorizonte komunitetin shqiptar”<sup>12</sup>**

Qëndrimi kategorik refuzues i regjimit të Beogradit çoi në ndërhyrjen ushtarake ajrore të NATO-s në Jugosllavi e në Kosovë nga 24 marsi deri në 9 qershor 1999. Lufta dhe rrjedhojat që ajo solli i tejkaluan objektivat e Rambujesë dhe shtruan në rend të ditës një zgjidhje tjetër edhe më të avancuar se Marrëveshja e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë. Diplomacia shqiptare gjatë gjithë kohës që zgjati konflikti qëndroi në krye të misionit të saj kombëtar dhe përballoi sfida të tjera shumë të rëndësishme për çështjen e Kosovës, analiza e të cilave është një temë tjetër që kërkon një trajtim më vete. Por, asnjëherë nuk duhet harruar se ajo çfarë u arrit në qershor 1999 zanafillën e kishte në ato ditë shkurti të atij viti në Rambuje.

Duke respektuar kufijtë modestë të pretendimeve dhe të kontributeve të diplomacisë shqiptare në luftë për çlirim dhe pavarësinë e Kosovës, nuk duhen lejuar përpjekjet që janë bërë e bëhen nga individë të veçantë, politikanë, analistë apo edhe ndonjë historian që të mohojnë e të shtrembërojnë të vërtetat historike të Konferencës së Rambujesë. Shqiptarët, në përgjithësi, por ata të Kosovës në veçanti e kanë vlerësuar përkushtimin dhe profesionalizmin e diplomacisë shqiptare gjatë Konferencës së Rambujesë dhe gjatë gjithë konfliktit në Kosovë.

Këto kontribute i kanë njohur dhe çmuar edhe partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë e të shqiptarëve në atë kohë, sidomos Shtetet e Bashkuara dhe përfaqësues të lartë politikë e diplomatikë të vendeve evropiane e të Bashkimit Evropian. Ndër shumë nga këto vlerësime po japim disa prej tyre: Presidenti i Shteteve të Bashkuara Bill Klinton në mesazhin që i dërgoi popullit shqiptar në përfundim të konfliktit deklaroi: “...**Asnjë vend tjetër nuk mbajti peshë më të madhe sesa Shqipëria. Asnjë vend tjetër nuk bëri më shumë për të ndihmuar fitoren e humanizmit**”<sup>13</sup> Departamenti i Shtetit, në 19 mars, një ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Rambujesë në Qendrën “Kleber” në Paris falënderoi zyrtarisht “**qeverinë e Shqipërisë dhe diplomacinë shqiptare për angazhimin dhe rolin që ka luajtur për nënshkrimin e Marrëveshjes nga ana e kosovarëve...**”<sup>14</sup>

Qeveria laburiste e Britanisë së Madhe ishte një nga mbështetësit më të fuqishëm të kauzës së shqiptarëve të Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me Administratën demokrate të Presidentit Klinton. Diplomacia shqiptare punoi shumë ngushtë me Qeverinë britanike dhe gjeti

mbështetjen e saj të plotë por edhe vlerësimet më të larta të saj. Kryeministri britanik Toni Bler, në maj 1999 në vizitën e tij në Tiranë u shpreh se **“nuk gjej fjalë se si ta vlerësoj punën tuaj për unifikimin e faktorit shqiptar në Rambuje”**.<sup>15</sup> Sekretari për Punët e Jashtme i kësaj Qeverie, Robin Kuk-u më 11 mars në një letër që i drejtonte homologut të tij shqiptar i shkruante: **“jam i inkurajuar nga angazhimi juaj i palëkundur për paketën që është bërë në Rambuje, dhe e di që influenza e nevojshme e Qeverisë suaj me shqiptarët e Kosovës do të vazhdojë të jetë një faktor i rëndësishëm për t’i bindur ata rreth përfitimeve të asaj çka ofrohet në tavolinë”**.<sup>16</sup>

Këto vlerësime dhe shumë të tjera që janë bërë nga përfaqësues të lartë të diplomacisë e të politikës evropiane të kohës nuk ishin thjesht akte kortezie diplomatike për rolin e diplomacisë shqiptare. Ata në një farë mënyre u befasuan për ndikimin që ajo pati në mes të shqiptarëve të Kosovës dhe për këtë shkak u krijua një ndjenjë besimi në rritje për aftësinë e politikës së jashtme të shtetit shqiptar. Nuk ishin as edhe vetëm interesat e çastit që i bënë autoritetet e larta politike e diplomatike amerikane dhe evropiane që të flasin me simpati për diplomacinë shqiptare dhe rolin e saj. Dhjetë vjet më vonë nga Konferenca e Rambujesë dhe përfundimi i konfliktit në Kosovë, ambasadori dhe ndërmjetësuesi i Bashkimit Evropian në Konferencën e Rambujesë, Wolfgang Petritsch do të shkruante se aty **“Qeveria shqiptare dhe ministri i saj i Jashtëm vepruan me shumë përgjegjësi dhe profesionalizëm...Në këtë mënyrë ata i bënë një shërbim të madh Komunitetit Ndërkombëtar, i cili donte ta zgjidhte konfliktin sipas çështjeve të rëna dakord më parë në Grupin e Kontaktit...duhet thënë se mbështetja që Shqipëria dha për zgjidhjen paqësore dhe demokratike të konfliktit, nuk është reflektuar aq sa ajo e meriton në opinionin e gjerë publik”**.<sup>17</sup>

E vërteta vonon, por nuk harron thotë një fjalë e urtë. Deklasifikimi i dokumenteve arkivore amerikane dhe evropiane të kohës që ka filluar për Rambujenë dhe konfliktin në Kosovë po sjell dëshmitë e para të drejtpërdrejta për rolin e diplomacisë shqiptare në ato vite. Të tjera që do të pasojnë do të konfirmojnë plotësisht atë të vërtetë të jetuar, dinjitoze e krenare për mbarë shqiptarinë.

## Literatura

1. Paskal Milo. Ditari i një ministri të jashtëm. Konflikti i Kosovës 1997 – 2001. Parathënie nga Ambasadori Wolfgang Petritsch. Botimet TOENA, Tiranë, 2009.
2. Deklarata e Grupit të Kontaktit mbi Kosovën. Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (AMEPJ). Viti 1999.
3. Konferencë për shtyp e zotit Adem Demaçi. Tel. i Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Beograd për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 2 shkurt 1999. AMEPJ. Viti 1999.
4. “Korniza e Marrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë”. AMEPJ. Viti 1999.
5. Tel. i Ambasadorit shqiptar në Paris Luan Rama për ministrin e jashtëm shqiptar në Tiranë, 3 shkurt 1999. AMEPJ. Viti 1999.
6. Informacion i Grupit të punës në Ambasadën shqiptare në Paris, dërguar ministrit të jashtëm, 13 shkurt 1999. AMEPJ. Viti 1999.
7. Biseda telefonike Albright-Milo-Hill, 21-22 shkurt 1999. Paskal Milo. Ditari i një ministri të jashtëm. Konflikti i Kosovës, 1999-2001... f.155-158.
8. Letër e Presidentit të Shqipërisë, Rexhep Meidani dërguar delegacionit shqiptar në Rambuje, 23 shkurt 1999. AMEPJ. Viti 1999.
9. Letër e shkrimtarit Ismail Kadare dërguar delegacionit shqiptar në Konferencën për Kosovën, 22 shkurt 1999. AMEPJ. Viti 1999.
10. Informacion i Ambasadorit shqiptar në Paris, Luan Rama dërguar ministrit të punëve të jashtme, Paskal Milo, 25 shkurt 1999. AMEPJ. Viti 1999.
11. Letër e delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë dërguar Sekretares së Shtetit, Madeleine Albright, 23 shkurt 1999. AMEPJ. Viti 1999.
12. Intervistë e Sllobodan Milosheviqit dhënë Agjencisë UPI, 30 prill 1999. AMEPJ. Viti 1999.
13. Mesazh i Presidentit Clinton drejtuar popullit shqiptar, 21 qershor 1999. AMEPJ. Viti 1999.
14. Tel. i Ambasadorit shqiptar në Uashington, Petrit Bushati për ministrin e punëve të jashtme, Paskal Milo, 19 mars 1999. AMEPJ. Viti 1999.
15. Informacion për vizitën e Toni Blair në Tiranë, maj 1999. AMEPJ. Viti 1999.
16. Letër e Sekretarit për Punët e jashtme të Britanisë së Madhe, Robin Cook, dërguar ministrit të punëve të jashtme të Shqipërisë, Paskal Milo, 11 mars 1999. AMEPJ. Viti 1999.

17. Paskal Milo. Ditari i një ministri të jashtëm. Konflikti i Kosovës, 1997-2001, f. 13.

Frashër Demaj

## ROLI I POLITIKËS PAQËSORE NË DIMENSIONET E NDËRKOMBËTARIZIMIT TË ÇËSHTJES SË KOSOVËS 1990-1997

### Përmbledhje

Veprimet antikushtetuese të Serbisë ndaj Kosovës më 23 mars 1989 në mbledhjen e Kuvendit të KSA të Kosovës dhe suprimimi i autonomisë nxitën reagime të fuqishme qytetare të manifestuara me protesta e demonstrata në mbrojtje të statusit politik të Kosovës. Si kundërpërgjigje ndaj suprimimit të autonomisë, delegatët e Kuvendit të Kosovës, pasi nuk u lejuan nga policia speciale për t'u futur në sallën plenare, u mblodhën para dyerve të Kuvendit më 2 korrik 1990 dhe miratuan Deklaratën Kushtetuese sipas së cilës Kosova shpallej Republikë.

Më 7 shtator 1990 në Kaçanik delegatët e Kuvendit të Kosovës e miratuan Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kurse nga 26 deri më 30 shtator të vitit 1991 u organizua Referendumi për Kosovën Shtet i Pavarur dhe Sovran. Më 24 maj 1992 u organizuan zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale. Pas legjitimitimit të institucioneve u krijua platforma politike e mbështetur në synimet për realizimin e pavarësisë përmes politikës paqësore. Bartës i kësaj politike u bë Ibrahim Rugova dhe elita politike kosovare. Rugova u njoh dhe u trajtua si lider i shqiptarëve të Kosovës i cili takonte deputetë, senatorë, kongresmenë, ministra, kryeministra, presidentë dhe bartës fronesh të monarkive të cilët i njoftonte me situatën në vend dhe bënte sensibilizimin e çështjes së Kosovës. Elita politike e Kosovës përmes kursit paqësor e shihte si zgjidhje fatlume për palët dialogun Kosovë- Serbi me ndërmjetësim ndërkombëtar dhe si të vetmen rrugë për realizimin e pavarësisë së Kosovës dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal.

Kursi i politikës paqësore e ngriti Kosovën në nivele të larta të diplomacisë ndërkombëtare. Si rezultat i kësaj politike, çështja e Kosovës mori përmasa dhe dimensione të reja ndërkombëtare. Historia i dha të drejtë konceptit rugovian të politikës paqësore, sepse fuqia ma e madhe ushtarake në historinë e njerëzimit u vu në mbrojtje të kosovarëve duke bombarduar një shtet sovran siç ishte Serbia dhe "RFJ", dhe kjo ndodhi si rezultat i përkrahjes dhe ndërkombëtarizimit të problemit të Kosovës dhe krijimit të miqve ndërkombëtarë pa anashkaluar këtu edhe rolin vendimtar të luftës çlirimtare të shqiptarëve të cilat rezultuan me çlirimin përfundimtar të Kosovës dhe rrugëtimin drejt pavarësisë së plotë.

Prandaj, përfundimisht duhet vlerësuar diskursi paqësor i të bërit politikë i cili në themel kishte realizimin e të drejtës themelore, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, diskurs ky që e nxori Kosovën nga margjinat serbe dhe jugosllave, e shndërroi në çështje ndërkombëtare, e fitoi simpatinë e shteteve më të fuqishme si SHBA-së dhe vendet kryesore të Bashkimit Evropian dhe sot funksionon si shtet demokratik dhe i pavarur.

*Fjalët çelës:* Kosova, Serbia, diplomacia, Evropa, SHBA, politika paqësore, Ibrahim Rugova, kongresmenë, senatorë, lufta.

Përfundimi i Luftës së Ftohtë ndryshoi gjeopolitikën dhe gjeostrategjinë e superfuqive botërore të cilat nga vitit 1947 deri më 1989-1991 rrezikuan të tejkalonin konfrontimet politiko-diplomatike dhe të nisnin një luftë të re me përmasa botërore. Prandaj qytetërimi perëndimor në krye me SHBA-në, ishin interesuar në vazhdimësi që të ndihmonin shpërbërjen e shteteve komuniste, diktatoriale të cilat përbënin fuqi politike, ushtarake, demografike dhe rrezikonin qëndrueshmërinë e paqes botërore. Pikë referimi në Evropë ishin kryesisht BRSS-ja dhe RSFJ. Sidoqoftë në demokracitë perëndimore dhe politikën ndërkombëtare artikulohehin ide pro dhe kontra shpërbërjes së RSFJ-së dhe jo të gjithë ishin të një mendjeje nëse kjo federatë duhej të funksiononte edhe më tutje si shtet unitar apo duhet të shpërbëhej. Në disa kryeqytete evropiane dominonte ideja se ky shtet nuk duhet të shpërbëhet sepse një Jugosllavi unike është faktor qëndrueshmërie rajonale meqë kishte shërbyer edhe si tampon zonë midis Lindjes dhe Perëndimit, për shkak se kishte disa dallime të theksuara krahasuar me shtetet e tjera komuniste e diktatoriale.<sup>1</sup> Kurse të tjerët mendonin se shpërbërja e Jugosllavisë do të krijonte mundësi për demokratizimin e republikave, krahinave dhe popujve që jetonin në federatën e përbashkët. SHBA-ja si një nga superfuqitë botërore që ishte e implikuar në gjithë globin në mbrojtje të paqes dhe stabilitetit, fillimisht kishte një qëndrim më të balancuar ndaj mundësisë së shpërbërjes së shtetit jugosllav, duke e konsideruar se menaxhimi i situatës në Jugosllavi ishte detyrë evropiane.<sup>2</sup> Megjithatë SHBA-ja asnjëherë nuk kishte shfaqur kompromis me totalitarizmin si koncept politik që pengonte krijimin e shoqërive demokratike edhe në vendet ish-komuniste. Evoluimi i politikës amerikane dhe interesave strategjike të saj u vuri pikë dilemave të ngritura në horizont kur Shtëpia e Bardhë kërkoi që jo vetëm gjashtë republikat, por edhe dy krahinat të gëzojnë të drejtën e tyre për organizimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike të bazuara në pluralizmin politik.<sup>3</sup> Ky qëndrim i Uashingtonit ishte mesazh “i heshtur” që nënkuptonte shpërbërjen e Jugosllavisë përmes demokratizimit të brendshëm, ku secili nga subjektet e Federatës Jugosllave të kishte të drejtën e patjetërsueshme përmes vullnetit politik të deklarohet për të ardhmen e vet. Ndërkohë edhe Gjermania dhe Franca, ranë dakord që “Jugosllavia nuk mund të mbahet

<sup>1</sup> Frashër Demaj, “Qëndrimi i politikës ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës në fillim të viteve 90”, botuar në Institucionalizimi i Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992, ASHAK, Prishtinë 2022, f. 137.

<sup>2</sup> Dario Malnar, *SHBA dhe Kosova*, Prishtinë 2013, f. 100.

<sup>3</sup> Mehmet Elezi, *Kosova midis politikës dhe realpolitikës*, Tiranë 1999, f. 21.

e bashkuar me forcë”.<sup>4</sup> Në qarqet politike ndërkombëtare ideja për mos-përkrahjen e shpërbërjes së RSFJ-së dhe BRSS-së vinte si shkak-pasoje e rrezikut të përhershëm të cenimit të paqes botërore. Pra, shpërbërja e RSFJ-së paraqiste rrezik për paqen ballkanike, kurse dezintegrimi i BRSS-së rrezikonte luftë me përmasa të mëdha. Në këtë situatë SHBA-ja dhe vendet kryesore evropiane, përveçse të brengosura, ishin shumë të kujdesshme në qëndrime sa u takon këtyre dy federatave komuniste.<sup>5</sup>

Hezitimi për përkrahjen e shpërbërjes së RSFJ-së ngufaste nismat nacionaliste për avancimin e të drejtave të tyre kombëtare, rasti i shqiptarëve të Kosovës dhe hungarezëve të Vojvodinës, krahina këto të cilat për shkak të hibriditetit kushtetues konsideroheshin pjesë të Republikës së Serbisë e Jugosllavisë dhe prirjeve nacionaliste e sececioniste të republikave jugosllave për krijimin e shteteve të tyre kombëtare. Kurse përkrahja e shpërbërjes së Jugosllavisë trimëronte qarqet nacionaliste të cilat kërkonin momentin e volitshëm për realizimin e interesave të tyre kombëtare. Serbia, interesat e saj nacionaliste i kishte mbështetur në mbajtjen gjallë të frymës jugosllave përmes së cilës shtypte të drejtat kombëtare të shqiptarëve dhe hungarezëve dhe pretendonte hegjemoni edhe ndaj popujve dhe republikave të tjera.

Që nga viti 1981, Republika e Serbisë, me bekimin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, përmes pushtetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës që dominohej në shumicë nga serbët dhe malazezët vazhdoi me fushatë denigruese, shpifëse dhe akuzuese ndaj shqiptarëve që kërkonin të drejtat e tyre kombëtare. Pas vitit 1981 regjimi serb nisi me vrasjen e demonstruesve, burgosjen masive të të rinjve, diferencimet dhe izolimet e intelektualëve, arrestimet arbitrare, torturat dhe keqtrajtimet e të burgosurve, helmimet e nxënësve, bastisjet dhe ekspeditat ndëshkuese nëpër shumë fshatra dhe lagje të qyteteve në gjithë Kosovën. Kundër shqiptarëve filluan diskriminimet dhe një represion i vazhdueshëm policor dhe ushtarak. Metodot e dhunës dhe të linçimit policor në Kosovë çdo ditë intensifikoheshin. Vetëm në periudhën 1981-1988 më se 584.000 shqiptarë u trajtuan në organet policore.<sup>6</sup> Përveç shqiptarëve të Kosovës, me metoda të dhunshme policore u trajtuan edhe shumë shqiptarë në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në

---

<sup>4</sup> Frashër Demaj, “Qëndrimi i politikës ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës në fillim të viteve 90”... f. 137.

<sup>5</sup> Po aty

<sup>6</sup> Hivzi Islami, “Tendencat serbe për shkatërrimin e themeleve të jetës së shqiptarëve”, botuar në Gjenocidi dhe masakrat e Serbisë në Kosovë (1998-1999), ASHAK 2023, f. 68.

Medvegjë, Bujanovc dhe Preshevë, me akuzat për veprimtari armiqësore ndaj Serbisë dhe Jugosllavisë.

Ardhja e Slobodan Milosheviqit në pushtet në Serbi, rinovoi agjendën e ringjalljes së nacionalizmit serb dhe forcimit të pozitave të tij politike. Në Serbi u përhap një eufori nacionaliste e cila ndërkohë arriti deri atje sa serbët me lule e këngë nacionaliste i përcillnin tanket dhe makinat e blinduara drejt luftërave kundër popujve me të cilët kishin jetuar në një shtet të përbashkët.<sup>7</sup> Kësaj shtate i shërbeu edhe Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë (1986) që, për fat të keq, u shndërrua në instrument në duar të politikës ditore duke dalë krejtësisht nga natyra e angazhimit dhe përgjegjësisë që në rrethana normale do të duhej të kishte institucioni më i lartë i shkencës dhe artit të një vendi.<sup>8</sup> Të nxitur nga pushteti dhe ndjenjat nacionaliste edhe shkrimtarët serbë u shndërruan në objekt të manipulimeve të politikës ditore duke ngritur zërin kundër kombeve të tjera, pavarësisht se shkrimtarët do të duhej të ishin në shërbim të paqes dhe humanizmit.<sup>9</sup> Madje në vend se të merrte përgjegjësinë, Shoqata e Shkrimtarëve të Serbisë dhe disa udhëheqës të Lidhjes Komuniste në Beograd akuzonin Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës dhe kryetarin e saj Ibrahim Rugova për nacionalizëm e separatizëm, nxitje të protestave shqiptare dhe destabilizimit të Kosovës. Në përgjigje të këtyre akuzave Rugova deklaronte: "... nuk ka këtu asnjë nxitje, por kjo që po ndodh është kryengritje e popullit kundër dhunës, për shkak të dhunës, sepse populli i Kosovës lufton për të drejtat e tij."<sup>10</sup> Zërave të sinkronizuar antishqiptarë iu bashkua edhe Kisha Ortodokse Serbe e cila në vend se të kërkonte paqe midis popujve, "bekonte" veprimet e dhunshme e çnjerëzore dhe i motivonte vullnetarët serbë për luftë kundër shqiptarëve të cilët historikisht kishin treguar tolerancë dhe harmoni fetare ndaj religjioneve të komuniteteve nacionale që jetonin në Kosovë. Agresioni i hapur i Serbisë ndaj Kosovës dhe shqiptarëve shpërtheu më 24 prill 1986 në mitingun nacionalist të serbëve në Fushë Kosovë ku ishte prezent Slobodan Milosheviqi. Aty u inskenua një ndërhyrje e policisë ndaj turmave serbe për të krijuar pretekstin se serbët po dhunoheshin nga organet e rendit. Në atë moment, Milosheviqi e ndërpreu mbledhjen që po mbante

<sup>7</sup> Stefan Karastojanov, *Kosova (një analizë gjeopolitike)*, Shkup 2007, f. 197.

<sup>8</sup> Janusz Bugajski, *Ngritja e Kosovës, artikuj dhe fjalime nga okupimi deri te pavarësia*, Prishtinë 2006, f. 23.

<sup>9</sup> "Veçer", Intervju z Ibrahimom Rugovo, "*Naj rečejo, da živim v diktaturi*" Maribor 22.4.1989.

<sup>10</sup> "L'Unita", Intervista a Ibrahim Rugova, "*Questa è una rivolta popolare, Belgrado non la vuole capire*", Roma, 30.3.1989.

me përfaqësuesit politikë, doli jashtë dhe iu drejtua turmës me fjalët: "Askush nuk guxon t'ju rrahë". Kurse turma e ngazëllyer me ovacione thërriste emrin e Slllobodan Millosheviqit. Ky moment shënon nisjen e ngritjes së hovshme të tij në karrierën politike në Serbi dhe Jugosllavi.<sup>11</sup> Pra Millosheviqi duke nxitur nacionalizmin serb e malazez dhe shfrytëzuar brishtësinë e situatës në Kosovë u shndërrua në një lider të pakontestueshëm, me autoritet dhe i gjithëpushtetshëm në Serbi dhe në qarqet e politikës serbe në Kosovë. Mitingjet e tij me tone nacionaliste vazhduan edhe gjatë viteve në vijim, sidomos në përvjetorët e "Betejës së Kosovës", të cilën pa asnjë të drejtë historike e përvetësuan duke e shndërruar në simbol të nacional-shovinizmit serb.<sup>12</sup> Fundja serbët pothuajse ishin popull ndër të rrallët që kauzën nacionaliste e ndërtuan mbi simbolikën e humbjes së një beteje mesjetare (Beteja e Kosovës e vitit 1389 F.D) që në realitet ishte betejë e humbur e popujve ballkanikë në luftë kundër Perandorisë Osmane.<sup>13</sup> Logjika politike serbe e cila bazohej në mitologji, deformonte historinë e vet dhe të popujve të tjerë duke e portretizuar Serbinë si viktimë të historisë dhe duke u përpjekur që përmes stereotipizimit etnik të bazuar në rrëfime ciklike, për lirinë, tradhtinë, skllavërinë, robërinë dhe nevojën e luftës të mbante gjallë ndjenjën nacionaliste serbe.<sup>14</sup> Milosheviqi duke kundërshtuar legjislacionin jugosllav e konsideronte se Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 1974 e ka dobësuar sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën dhe Vojvodinën, dhe kjo është bërë me qëllim nga regjimi i Titos për ta dobësuar Serbinë.<sup>15</sup> Prandaj, për të realizuar politikën nacionaliste serbe duhej rishikuar kushtetutshmëria e Serbisë dhe Jugosllavisë dhe duhej bërë përgatitjen e ndryshimeve kushtetuese të cilat do të krijonin lidhje të ngushta vartësie të krahinave autonome me Serbinë.

Pas përgatitjes së terrenit në nivele të larta politike, dhuna dhe represioni serb në Kosovë shënoi shkallë të lartë të zhvillimit dhe mori dimensione të reja me aktin antikushtetues të Kuvendit të Republikës

---

<sup>11</sup> Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë 1998, f. 356.

<sup>12</sup> Beteja e Kosovës e vitit 1389, ishte luftë në mes popujve ballkanikë dhe Perandorisë Osmane. Betejën e fitoi P. Osmane, kurse Millosheviqi dhe liderët serbë u munduan ta tjetërsojnë duke e quajtur luftë serbo-osmane dhe e manipuluan skajshëm duke e keqpërdorur politikisht.

<sup>13</sup> Më gjerësisht: Anna di Lellio, *The Battle of Kosovo 1389*, An Albanian epic, London 2009.

<sup>14</sup> Isa Mustafa, "Dhuna sim jet për arritjen e qëllimeve politike", botuar në Gjenocidi dhe masakrat e Serbisë në Kosovë (1998-1999), ASHAK 2023, f. 15.

<sup>15</sup> Janusz Bugajski, *Ngritja e Kosovës...* f. 23.

së Serbisë të vitit 1989, me të cilin u suprimua autonomia e KSA të Kosovës që ishte e garantuar me Kushtetutën e vitit 1974.

Më 23 mars në Mbledhjen e Kuvendit të Kosovës morën pjesë edhe mysafirë të shumtë në mesin e të cilëve ishte Sinan Hasani, anëtar i Kryesisë së RSFJ-së, Shefqet Jashari anëtar i Kryesisë së Serbisë, Velimir Vukmanoviç dhe Ferat Ahmeti, nënkryetarë të Kuvendit të Republikës së Serbisë, nënkryetarë të Komisionit Kushtetues të Republikës së Serbisë, përfaqësues të Armatës Popullore të Jugosllavisë, përfaqësuesit e organizatave shoqëroro-politike të krahinës dhe mysafirë të tjerë.<sup>16</sup> Kurse në pikën e parë të Rendit të Ditës ishte vendosur: Shqyrtimi i Amendamenteve nga IX-XLIX të Kushtetutës së Serbisë.<sup>17</sup> Në këtë mbledhje kryetari i Kuvendit të KSAK Vukashin Jokanoviç, me “mysafirët” në mënyrë kundërkushtetuese vendosën për miratimin e ndryshimeve kushtetuese të cilat sollën rrënimin antikushtetues të autonomisë së Kosovës.

Këto veprime i dhanë mundësi Serbisë të shpallte “krijimin e Serbisë unike” që nënkuptonte bashkimin e KSA të Kosovës dhe KSA të Vojvodinës me Republikën e Serbisë. Me suprimimin e autonomisë, Kosovës gjatë viteve 1989-1990, iu hoqën shumë të drejta kushtetuese dhe ndër të më të rëndësishmet ishin: pushteti qendror dhe lokal, arsimit kombëtar, mediet në gjuhën shqipe, policia, planifikimi ekonomik, drejtësia, mbrojtja territoriale dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.<sup>18</sup> Në këto rrethana, përderisa në Beograd festohej, në Kosovë shqiptarët po manifestonin indinjatën dhe kundërshtimin e tyre përmes protestave dhe demonstratave. Ndërhyrja brutale e policisë ndikoi që këto protesta të rezultonin me shumë të arrestuar, të marrë në biseda informative, të rrahur dhe të burgosur. Ata trajtoheshin nga policia, sigurimi shtetëror serb dhe instanca të tjera të ndjekjes në mënyrat më çnjerëzore. Qëllimi ishte që të arrestuarit dhe të burgosurit të pranonin se u takonin grupeve të ndryshme ilegale nacionaliste e separatiste që luftonin kundër “shtetit ligjor të Serbisë dhe Jugosllavisë”.<sup>19</sup>

<sup>16</sup> Arkivi i Kosovës, më tej AK, Magnetofonski snima zajednicke sednice sva tri veka Skupstine Socialisticke Autonomne Pokrajine Kosova održane 23.3.1989, f. 2.

<sup>17</sup> Po aty.

<sup>18</sup> “Der Spiegel”, Interview mit Ibrahim Rugova, “Die serben kommen als Rächer wieder”, nr. 26, Hamburg 1989.

<sup>19</sup> Raportet e KMDLNJ për shkeljen e lirive dhe të drejtave të shqiptarëve nga ana pushtetit të Serbisë dhe Jugosllavisë në Kosovë; KMDLNJ është formuar më 14 dhjetor 1989 nga një grup i veprimtarëve për të drejtat e njeriut në Kosovë.

Federata dhe republikat e tjera, si: Sllovenia, Kroacia, Bosnjë dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia, të bindura se Serbia do të ndalet në Kosovë, fillimisht i dhanë përkrahje të plotë veprimeve policore e ushtarake dhe e ndihmuan politikisht dhe në mënyra të tjera represionin dhe segregacionin ndaj shqiptarëve; e dhanë pëlqimin që në Kosovë të vihej gjendja e jashtëzakonshme, të likuidohet me forcë autonomia federale, të vendosej sistemi diskriminues e kolonial dhe të stimulohej politika e kolonizimit të serbëve dhe e spastrimit etnik të shqiptarëve me qëllim që të ndërrohej struktura etnike e Kosovës. Millosheviqi e shfrytëzoi mirë këtë përkrahje të ish-Jugosllavisë dhe duke manipuluar me mitin mbi Kosovën dhe duke i instrumentalizuar serbët e Kosovës, u shndërrua në një lider të gjithëpushtetshëm.<sup>20</sup>

Duke shpifur tezën mbi pozitën diskriminuese, degraduese e inferiore të Serbisë e të serbëve, establishmenti politik e militarist i Millosheviqit mobilizoi gjithë energjitë e popullit serb për konfrontim politik dhe luftëra me popujt e tjerë. Përkrahja që i dhanë republikat e tjera Serbisë kundër Kosovës dhe shqiptarëve shumë shpejt iu kthye të gjithëve bumerang dhe kriza eskaloi në konfrontim të hapët të Serbisë e të serbëve me komunitetet e tjera etnike fillimisht në Slloveni e pastaj në Kroaci e Bosnjë e Hercegovinë me synim të realizimit të projektit ekspansionist. Të gjithë serbët në një shtet të vetëm; – pra, në një “Jugosllavi serbe” apo “Serbi të Madhe”.<sup>21</sup> Projekti për Serbinë e Madhe nuk ishte ndonjë ide e re por vazhdimësi e projekteve dhe elaboreteve serbe që fillojnë nga viti 1844 e deri në vitin 1989 kur veprimet antikushtetuese u vunë në themel të politikës hegjemoniste serbe kundër popujve me të cilët kishte jetuar dhe ende bashkëjetonte në një shtet të përbashkët.

Në këtë situatë Kosova u gjet në një pozicion shumë të pafavorshme dhe e detyruar të mbrohej me reagime qytetare dhe protesta paqësore. Gjithashtu ndaj këtyre veprimeve çnjerëzore dhe antikushtetuese reagoi elita intelektuale e Kosovës që ishte pjesë e forumeve të ndryshme politike e jopolitike dhe opinioni i gjerë publik i cili u solidarizua dhe përkrahu me forcë shfaqjen e pakënaqësisë qytetare përmes protestave paqësore të cilat për një kohë të shkurtër u organizuan në të gjitha qytetet dhe vendbanimet e Kosovës. Kurse serbët dhe malazetët e Kosovës në vend të solidarizimit dhe reagimit kundër dhunës u vunë në shërbim të politikës ditore, duke përkrahur masat e dhunshme

---

<sup>20</sup> Hivzi Islami, “Tendencat serbe për shkatërrimin e themeleve të jetës së shqiptarëve”..., f. 69.

<sup>21</sup> Po aty.

policore ndaj qytetarëve shqiptarë. Lidhur me këto akuza dhe tortura Ibrahim Rugova ishte shprehur se: “këto etiketa nuk e shprehin realitetin, por ishin kualifikime për të justifikuar represionin, sepse ato po mbysin ide, po e mbysin realitetin, po mbysin edhe njerëz fizikisht, por edhe në pikëpamje psikike, sociale...”<sup>22</sup>

Pavarësisht nga dhuna dhe represioni i pashembullt ndaj popullsisë civile, shqiptarët befasuan opinionin ndërkombëtar me sjelljen e tyre qytetëruese e cila ndërkohë në fjalorin e përditshëm u quajt “politikë aktive paqësore” që mbështetej në padëgjueshmërinë qytetare përballë pushtetit të Serbisë dhe Jugosllavisë. Politika paqësore për realizimin e interesave kombëtare shqiptare u përzgjedh për dy arsye themelore: e para për shkak se çështja e Kosovës nuk ishte e njohur në botë dhe nevojitej domosdoshmërisht njohja dhe sensibilizimi ndërkombëtar dhe e dyta Serbia ishte ushtarakisht shumë e fuqishme meqë e kishte në dorë gjithë arsenalin ushtarak të RSFJ-së dhe hyrja eventuale e Kosovës në luftë përbënte një gabim fatal që do të rezultonte me shumë të vrarë, dëbime dhe shpëpullim të Kosovës nga elementi shqiptar.

Proklamimi i politikës paqësore me protesta kundër dhunës, realizimi i synimeve politike me dialog dhe kërkesa për demokratizimin e Kosovës krijuan simpati ndaj shqiptarëve në Evropë dhe SHBA. Politika paqësore dhe vlerësimet pozitive ndaj saj çdo ditë e më shumë i legjitimonin kërkesat e shqiptarëve të Kosovës.<sup>23</sup> Elita intelektuale e kishte të qartë se sensibilizimi dhe ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës mund të arrihej vetëm përmes politikës së urtë e paqësore dhe krijimit të miqve në politikën dhe diplomacinë ndërkombëtare. Qëllimi final i kësaj politike ishte fitimi i përkrahjes nga SHBA-ja, Britania e Madhe, Gjermania, Italia dhe Franca si bartësit kryesorë të politikës ndërkombëtare dhe frymëzues të demokracisë liberale dhe nuk pajtoheshin me politikat dhe sistemet totalitare që shtypnin popuj e komunitete etnike, racore dhe religjioze.

Me gjithë kundërvënien paqësore, Serbia vazhdonte me masa agresive dhe shumë të dhunshme ndaj shqiptarëve të arrestuar dhe burgosur të cilët persekutoheshin për shkak të përkatësisë së tyre kombëtare dhe bindjeve politike. Torturat ishin nga më të ndryshmet duke filluar që nga maltretimet psikike, detyrimi i dhunshëm për pranimin e fajit, rrahja në pjesë të ndjeshme të trupit dhe metoda të tjera

<sup>22</sup> “Fjala”, Prishtinë më 15 maj 1990.

<sup>23</sup> Oliver Jens Schmit, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, Prishtinë 2012, f. 248.

çnjërëzore.<sup>24</sup> Një formë tjetër e dhunës dhe represionit serb ndaj shqiptarëve ishte ndarja fizike e klasave nëpër shkolla (serbët dhe malazezët në një ndërrim, kurse shqiptarët në tjetrin F.D) dhe helmimi masiv i nxënësve shqiptarë me helme të luftës në periudhën mars-maj 1990, në klasat dhe shkollat ku ata mbanin mësim<sup>25</sup>. Helmimin e fëmijëve shqiptarë, shteti serb e quante “aktrim”, kurse në rezultatet e analizave të helmuarve në laboratorët ndërkombëtarë u konstatua se nxënësit ishin helmuar me helme luftime. Këto ngjarje nxitën reagimin e komunitetit ndërkombëtar, sidomos të organizatave që merreshin me liritë dhe të drejtat e njeriut në Evropë dhe SHBA të cilat i gjykuan këto veprime dhe akuzuan instancat e shtetit serb.<sup>26</sup> Metodat e përdorura nga policia sekrete serbe ngjanin në helmimin dhe mbytjen e hebrenjve në dhomat e gazit në kohën e holokaustit nëpër kampet e përqendrimit nazifashist, në periudhën e Luftës së Dytë Botërore. Në kanalet kryesore televizive dhe në ballinat e gazetave prestigjioze shfaqeshin çdo ditë pamje nga trajtimet më çnjërëzore që u bëheshin shqiptarëve nga policia serbe dhe ajo federale.<sup>27</sup> Opinioni publik dhe politik ndërkombëtar, fillimisht shprehu solidaritet dhe keqardhje për ngjarjet në Kosovë, dhunën dhe represionin serb dhe jugosllav ndaj shqiptarëve të Kosovës. Por ndërkohë këto ndjenja u kthyen në simpati, solidaritet dhe përkrahje ndaj një populli i cili dhunës po i përgjigjej me protesta e demonstrata paqësore.<sup>28</sup> Solidarizimi i komunitetit ndërkombëtar në qarqet politike, diplomatike, mediale krijuan një lloj përgjegjësie morale kolektive ndërkombëtare sa u takon sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës. Politika ndërkombëtare problemin e Kosovës fillimisht e konsideronte si shkelje të liritë dhe të drejtave të njeriut e më vonë si shkelje e të drejtave të një populli i cili po kërkonte liri dhe pavarësi nga një shtet që ushtronte dhunë ndaj tyre. Mirëpo, kishte edhe shefa shtetesh dhe kryeministra të vendeve perëndimore që e shihnin Kosovën si çështje të brendshme të Serbisë dhe tërhiqnin vëmendjen se statusi i Kosovës duhet të mbetet krahinë autonome dhe jo republikë me të drejtë

---

<sup>24</sup> Më gjerësisht, Raportet ditore dhe njoftimet e Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KMLDNJ) në Prishtinë.

<sup>25</sup> Frashër Demaj, *Afrim Gjuraj, Jeta dhe vepra*, Prishtinë 2009, f. 62.

<sup>26</sup> Më gjerësisht shih: Bajram Shatri, *Arsimi Shqip në Kosovë 1990-1999*, Shtëpitë Shkolla, sfidat, arritjet dhe aspiratat, Prishtinë 2010; Bajram Shatri, *Arsimi dhe shkollat e mesme në Kosovë në shekullin XX*, Zhvillimi i arsimit në shekullin XX, vëll. 1,2,3,4,5, Prishtinë 2019.

<sup>27</sup> Ksenofon Krisafi, *Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike*, Tiranë 2018, f. 110.

<sup>28</sup> Frasher Demaj, “Qëndrimi i politikës ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës në fillim të viteve 90”... f. 140.

shkëputjeje dhe çështja e lirive dhe të drejtave të njeriut të zgjidhet brenda legjislacionit serb dhe jugosllav.<sup>29</sup> Me kalimin e kohës, kundërshtarët e pavarësismit të Kosovës në politikën ndërkombëtare ishin të bindur se çështja e Kosovës nuk duhet të trajtohet si status politik që duhej zgjidhur, por si “autonomi kulturore” brenda Serbisë dhe Jugosllavisë.

Pavarësisht nga zërat pro dhe kontra në politikën ndërkombëtare, delegatët e Kuvendit të Kosovës u mblodhën më 2 korrik 1990 për të mbajtur seancë plenare ku do të diskutohej situata e rëndë politike në Kosovë. Mirëpo, Kuvendi i Kosovës ishte i rrethuar me pjesëtarë të policisë dhe sigurimit shtetëror të Serbisë dhe Jugosllavisë.<sup>30</sup> Kjo ishte një situatë e pazakontë, sepse delegatët shqiptarë, pavarësisht se ishin përfaqësues të popullit, nuk u lejuan të futeshin në sallën plenare të Kuvendit për të ushtruar të drejtat dhe detyrimet e tyre me të cilat i ngarkonte detyra e “delegatit të popullit” dhe obligimet kushtetuese. Bllokimi i Kuvendit me polici dhe pamundësia për t’u futur në sallën plenare i detyroi delegatët që në hyrje të Kuvendit të Kosovës të miratojnë Deklaratën Kushtetuese sipas së cilës Kosova shpallej Republikë në kuadër të Federatës apo Konfederatës së Jugosllavisë, varësisht për cilën nga këto variante do të vendosnin subjektet kushtetuese të Jugosllavisë (Sllovenia, Kroacia, Bosnjë e Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, Kosova, Vojvodina dhe Maqedonia)<sup>31</sup>. Kuvendi i Kosovës me këtë akt legjitim dhe legal në kuadër të strukturës së federalizmit multinacional të Federatës Jugosllave vendosi barazinë politiko-juridike të Kosovës me njësitë e tjera të RSFJ-së.<sup>32</sup> Ky veprim i delegatëve kosovarë, që dukej se ishte i papritur për qeverinë serbe ndikoi në radikalizimin e masave të establishmentit policor të njësive speciale të vëna në shërbim të politikës ditore të cilat prisnin urdhër për ndërhyrje. Si kundërveprim ndaj shpalljes së Deklaratës Kushtetuese më 5 korrik, Kuvendi i Serbisë suprimoi Kuvendin e Kosovës, Këshillin Ekzekutiv, institucionet administrative e gjyqësore, mbylli Radiotelevizionin e Prishtinës, ndaloi gazetën “Rilindja”, të vetmen në gjuhën shqipe dhe ndërmori masa të tjera të dhunshme kudo nëpër institucione publike.<sup>33</sup> Këto veprime të dhunshme të pushtetit të

<sup>29</sup> Oliver Jens Schmit, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike...* f. 252.

<sup>30</sup> Jusuf Bajraktari, “*Dimensioni historik i pavarësisë së Kosovës*” botuar në Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit, ASHAK, Prishtinë 2019, f. 15.

<sup>31</sup> Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, më tej AIHP, Shih: Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990.

<sup>32</sup> Arsim Bajrami, Florent Muçaj, *E Drejta Kushtetuese*, Prishtinë 2018, f. 215.

<sup>33</sup> Frashër Demaj, “*Sensibilizimi dhe nderkombëtarizimi i çështjes së Kosovës 1990-1996*”, botuar në Kosova – rruga drejt lirisë, në 20 vjetorin e çlirimit të Kosovës, Instuti I Historisë, Prishtinë 2020, f. 155.

Serbisë kishin për qëllim të ndëshkonin përfaqësuesit e popullit të Kosovës dhe institucionet e saj, si dhe frikësimin e përfaqësuesve dhe elitës intelektuale shqiptare, përmes kërcënimit, shantazhit, izolimit dhe metodave të tjera të njohura që përdornin regjimet totalitare. Shqiptarët nuk ndaluan as pas këtyre veprimeve të dhunshme, sepse kërkoheshin që të ndërmerreshin hapa tjerë për harmonizimin legjislativ në përputhje me statusin e ri politik të Kosovës, por gjithmonë të mbështetur në doktrinën e politikës paqësore të ideuar nga elita intelektuale e Kosovës, veçanërisht nga Ibrahim Rugova i cili gradualisht po merrte tiparet e një udhëheqësi politik dhe përfaqësues i interesave shqiptare në Kosovë. Për veprimet arbitrare dhe të dhunshme të Serbisë u njoftuan ambasadat e shteteve të huaja në Beograd dhe u ndërmor një fushatë sensibilizuese për të vënë në dijeni faktorin ndërkombëtar për shkeljet kushtetuese që po bënte Serbia me rastin e dhunimit të së drejtës së Kosovës që ia garantonte Kushtetuta e Jugosllavisë.

Krahas politikës paqësore që u vu në themel të veprimeve të përditshme, delegatët e Kuvendit të Kosovës (pas shpalljes së Republikës së Kosovës), më 7 shtator 1990 u mblodhën në qytezën e Kaçanikut dhe miratuan Kushtetutën e Republikës së Kosovës siç njihet ndryshe Kushtetuta e Kaçanikut<sup>34</sup>. Vendimi për mbledhjen e delegatëve në Kaçanik ishte i bazuar në veprime konfidenciale dhe strategjike të kohës. Kaçaniku u zgjodh si vendtakim i delegatëve kosovarë për shkak se konsiderohej se nuk do t'i shkonte ndërmend sigurimit shtetëror dhe policisë serbe se delegatët e Kuvendit do të mblidheshin në një sallë modeste të një qyteze periferike siç ishte Kaçaniku. Në këtë mbledhje delegatët e të tri dhomave aprovuan edhe dokumentet përcjellëse dhe nxorën Ligjin për zgjedhjet, si dhe disa vendime të rëndësishme politike.

Hapat e ardhshëm politikë që ndërmori Kosova në drejtim të shtetbërjes së saj ishin të bazuar në vendimet politike, aktet juridike dhe veprimet të tjera që i hapnin rrugë afirmimit të synimeve për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur. Bazuar në Kushtetutën e Kaçanikut, nga 26 deri më 30 shtator të vitit 1991 u organizua Referendumi për Kosovën Shtet i Pavarur dhe Sovran. Më shumë se 99% të zgjedhësve nga 87% të trupit elektoral që përveç shqiptarëve morën pjesë edhe qytetarë nga komunitete të tjera etnike, si boshnjak, turq e komunitet RAE<sup>35</sup>, u deklaruan për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur. Pra, përveç serbëve dhe malazezëve, me shqiptarët, për Kosovën e pavarur u rreshtuan edhe

---

<sup>34</sup> AIHP, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar më 7 shtator në Kaçanik.

<sup>35</sup> Komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian-RAE u konsolidua dhe mori këtë emër pas luftës së vitit 1999.

komunitetet të cilat përmes vullnetit të tyre politik dëshironin të përcaktoheshin për të ardhmen e vet politike larg hegjemonisë nacional- shoviniste serbe. Rezultatet e referendumit dhe informatat e plota për mbarëvajtjen dhe pengesat nga policia serbe që kishte pasur në këtë proces u bënë publike. Me këto rezultate u njoftua edhe bashkësia ndërkom-bëtare, qarqet politike dhe jopolitike, si dhe organizatat që merreshin me liritë dhe të drejtat e njeriut. Politika paqësore e udhëhequr nga Rugova filloi të jepte rezultate konkrete, sepse pavarësisht se policia serbe ushtroi dhunë ndaj shqiptarëve në procesin e përgatitjes dhe mbajtjes së referendumit, ata u përgjigjën me rezistencë aktive paqësore duke mos hequr dorë në asnjë moment nga qëllimet e tyre. Pa u mbushur një vit nga referendumi, më 24 maj 1992, në pajtim me Kushtetutën e Kaçanikut dhe amendamentet kushtetuese që buronin nga kjo Kushtetutë, u organizuan zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale me të cilat pretendohesh të legjitimohej rendi kushtetues dhe demokratik në Republikën e Kosovës<sup>36</sup>. Pushteti serb u mundua të pengonte mbajtjen e këtyre zgjedhjeve, por nuk arriti t'i ndalonte pavarësisht se gjatë kontroleve në punktet e policisë serbe u arrestuan shumë shqiptarë të cilëve iu gjetën materiale zgjedhore të cilat për shtetin e Serbisë ishin ilegale. Në zgjedhje, shumicën absolute i fitoi Lidhja Demokratike e Kosovës, por ulëse fituan edhe disa parti të tjera si Partia Fshatare e Kosovës, Partia Shqiptare Demokristiane, Partia Socialdemokrate, Partia e Boshnjakëve të Kosovës (SDA)<sup>37</sup> etj.

Në bazë të dokumentacionit zyrtar të kohës, në zgjedhjet e drejtpërdrejta, LDK-ja kishte fituar 76.44 % të numrit të përgjithshëm të votave. Partia Parlamentare e Kosovës 4.86%, Partia Fshatare e Kosovës 3.15%, dhe Partia Shqiptare Demokristiane 3.10%. Pra sipas Ligjit zgjedhor të bazuar në Kushtetutën e Kaçanikut, këto tri parti meqë kanë fituar më shumë se 3% të votave të përgjithshme, kanë fituar të drejtën sipas sistemit proporcional në zgjedhjen e 30 deputetëve të tjerë, ndërsa, “kandidatët e pavarur” prej subjekteve të tjera zgjedhore, të cilët kanë fituar më pak se 3% të votave të përgjithshme, nuk marrin pjesë në ndarjen proporcionale të këtyre 30 vendeve, ndonëse kanë fituar 3.29% të votave, sepse nuk ishin subjekt partiak.<sup>38</sup> Partitë e tjera politike

<sup>36</sup> Këto zgjedhje Serbia i konsideronte ilegale dhe paralele, kurse shqiptarët i konsideronin si zgjedhje legjitime në bazë të të cilave krijuan institucionet e pavarura kosovare.

<sup>37</sup> SDA- Stranka Demokratska Akcija.

<sup>38</sup> Jusuf Bajraktari, “Programet e partive politike dhe pjesëmarrja e tyre në zgjedhjet e vitit 1992”, botuar në Institucionalizimi i Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992, ASHAK, Prishtinë 2022, f. 12.

që morën pjesë në zgjedhje kanë fituar më pak se 3% të votave duke filluar prej 1.87% e deri në 0.02%, prandaj sipas Ligjit nuk fituan të drejtën për të marrë pjesë në Parlament sipas sistemit proporcional.<sup>39</sup> Sipas rezultatit të zgjedhjeve numri i vendeve dhe konfiguracioni politik në Parlamentin e Republikës së Kosovës dukej kështu: LDK - 96 deputetë; PPK - 12 plus 1 deputet; PFK - 7 deputetë; PSHDK - 7 deputetë; “Kandidat të pavarur” - 2 deputetë. Pjesëtarët e nacionalitetit boshnjak sipas përqindjes së popullsisë, fituan 4 deputetë në Parlament në bazë të sistemit proporcional plus 1 deputet, i cili është kandiduar si i koalicionit LDK-PAD. Kështu që në Parlament janë zgjedhur 5 deputetë të nacionalitetit boshnjak.<sup>40</sup>

Komuniteti turk në zgjedhjet e drejtpërdrejta kishin fituar 2 vende në Parlament përmes LDK-së. Serbët e malazezët nuk morën pjesë në votime atëherë, sipas përqindjes së popullsisë të këtyre dy nacionaliteteve u janë lënë 14 vende të lira, numër ky i dalë nga përqindja e popullsisë serbo-malazeze nga demografia e përgjithshme e Kosovës. Pra, Parlamenti i Republikës së Kosovës sipas Ligjit mbi Zgjedhjet duhet t’i ketë së paku 130 deputetë, aq sa janë zgjedhur në rastin konkret në mënyrë efektive kurse 14 vende të tjera për deputetë të nacionalitetit serb e malazez janë të paplotësuara, dhe si të tilla mbesin të lira.<sup>41</sup> Pavarësisht nga refuzimi i serbëve dhe malazezëve, gatishmëria e partive politike shqiptare për të përfshirë të gjitha komunitetet në pjesëmarrjen e ndërtimit të institucioneve demokratike krijoi një imazh pozitiv dhe gjithnjë e më shumë solidaritet dhe përkrahje në politikën ndërkombëtare.

Në këto zgjedhje president i Republikës së Kosovës me votim të drejtpërdrejtë u zgjodh dr. Ibrahim Rugova. Presidenti e propozoi mandatar për kryetar të Qeverisë dr. Bujar Bukoshin i cili ishte një nga anëtarët e LDK-së. Kështu 2 Korriku, 7 Shtatori, referendumi për sovranitetin e Kosovës dhe zgjedhjet parlamentare e presidenciale, për popullsinë Kosovës ishin arritje të rëndësishme, legjitime dhe legale, por nuk u njohën nga bashkësia ndërkombëtare. I vetmi shtet që njohu këto akte politiko-juridike ishte Republika e Shqipërisë në qershor të vitit 1991 në Mbledhjen e Kuvendit Popullor. Si rrjedhojë e seancës së Kuvendit, qeveria e Shqipërisë mbështeti referendumin për pavarësi të Kosovës

---

<sup>39</sup> Po aty.

<sup>40</sup> Po aty, f. 13.

<sup>41</sup> Po aty.

dhe njohu e mbështeti qeverinë e Kosovës me kryeministër Bujar Bukoshin.<sup>42</sup> As serbët lokalë nuk i pranuan rezultatet e zgjedhjeve dhe autoritetin e institucioneve të Republikës së Kosovës, për më keq ata u shndërruan në marioneta të qeverisë së Serbisë në Kosovë. Sidoqoftë qytetërimi perëndimor e njohu Ibrahim Rugovën si lider të shqiptarëve të Kosovës, dhe kjo i dha mundësi që të përfaqësonte Kosovën brenda dhe në politikën ndërkombëtare, të takonte deputetë, senatorë, kongresmenë, ministra, kryeministra, presidentë dhe bartës fronesh të monarkive të cilët i njoftonte me situatën në vend dhe proklamonte politikën paqësore dhe dialogun Kosovë- Serbi me ndërmjetësim ndërkombëtar, si të vetmen rrugë për realizimin e pavarësisë së Kosovës dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal.<sup>43</sup> Përveç liderëve botërorë dhe bartësve të funksioneve shtetërore, Rugova arriti ta takonte edhe Papa Gjon Pali II në Vatikan nga i cili kishte kërkuar që ta ndihmonte Kosovën dhe popullin e saj për t’u çliruar nga Serbia. Duke e vlerësuar politikën paqësore të Rugovës ai ruante një respekt të veçantë dhe krijoi një lidhje specifike me Kosovën. Përfaqësuesit e Kosovës pavarësisht nga vullneti dhe pretendimet e tyre, nuk arrinin gjithmonë që të kenë mirëkuptim për kauzën e tyre. Shpeshherë në qarqet ndërkombëtare, kryesisht ruse dhe proserbe e jugosllave, Kosova krahasohej padrejtësisht me disa zona të krizës në botë duke e konsideruar si “rast universal” dhe të krahasueshëm me probleme dhe kriza të shkaktuara nga mungesa e lirive dhe të drejtave të njeriut. Pra pengesat kryesore në rrugëtimin ndërkombëtar të çështjes së Kosovës ishin: diplomacia ruse, diplomacia serbe dhe autoriteti i Jugosllavisë. Me gjithë vështirësitë, Kosova për shumë arsye historike, politike, demografike, gjeografike dhe juridiko-kushtetuese ishte rast “Sui Generis”, dhe nga kjo pikëpamje filloi të trajtohet nga eksponentë të rëndësishëm të politikës amerikane dhe vendeve të Bashkimit Evropian.<sup>44</sup>

Pozitën e shqiptarëve e vështirësonte edhe më shumë fushata intensive e diplomacisë serbe kundër çështjes së Kosovës, meqë autoriteti i Jugosllavisë në marrëdhëniet ndërkombëtare ishte në nivel shumë të lartë. Antishqiptarizmi serb më së shumti gjente terren të “vendet e treta” të cilat për arsye të mospasjes së informacioneve të duhura e të

<sup>42</sup> Mero Baze, *Shqipëria dhe lufta në Kosovë*, Tiranë 1998, f. 28

<sup>43</sup> Më gjerësisht: Munish Hyseni, *Kështu foli Rugova* (Intervista 1990-2005), Prishtinë 2019.

<sup>44</sup> Më gjerësisht: Dr. Islam Lauka, *Kosovo a Universal case or Sui generis*, Tiranë 2007.

drejta dhe për shkak të autoritetit të RSFJ-së në “Lëvizjen e të Painkuadruarve”, problemin e Kosovës e quanin si problem të brendshëm të Serbisë dhe Jugosllavisë.<sup>45</sup> Faktor tjetër negativ ishte edhe mungesa e interesave politike, ekonomike, tregtare etj. e vendeve afrikane dhe aziatike në Kosovë dhe rajon. Vështirësitë të shumta që pengonin promovimin ndërkombëtar të kauzës së Kosovës vinin edhe nga paradigma e krijuar nga tri momente definuese: e para, sepse bashkësia ndërkombëtare fillimisht ishte kundër zhbërjes së ish-Jugosllavisë sepse druhej nga shpërthimi i konflikteve të armatosura dhe krijimi i precedentit, pra përpiquej me çdo kusht ta ruante atë; e dyta, çështja e Kosovës shihej e reduktuar në çështjen e të drejtave të njeriut, pra, pa të drejtë për subjektivitet të pavarur dhe e treta, sepse në perceptimet e hershme ndërkombëtare Kosova shihej si çështje e brendshme e Serbisë<sup>46</sup>. Dhe për t’u ndryshuar këto qëndrime të ngurta duhej kohë, angazhim dhe potenciale diplomatike joformale (meqë Kosova nuk kishte mundësi të tjera) të paktën në Uashington, Nju Jork, Bruksel dhe disa qendra të tjera evropiane. Pra, ishte shumë e vështirë të thyhen kornizat e ngurta të tabusë dhe paragjykimit, si dhe shpërthimi i margjinave të hekurta serbe dhe jugosllave që ishin pengesat më të fuqishme të depërtimit të së vërtetës për Kosovën dhe shqiptarët në një kohë kur potencialet e vetme ndihmuese në diplomacinë prokosovare ishin kapacitetet e kufizuara të Republikës së Shqipërisë, përmes Ministrisë së Jashtme e ambasadave dhe miqtë jo të shumtë që kishte krijuar Kosova për një kohë të shkurtër. Prandaj për t’u ndërkombëtarizuar kauza e Kosovës në botë, prioritet ishte afirmimi i politikës paqësore pa hequr dorë nga synimi final që ishte liria dhe pavarësia e Kosovës. Pa ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës edhe lufta nuk do të jepte rezultatet e kërkuara, madje ajo mund të kishte kundërefekt dhe të kthehej në bumerang nëse fillohej para se të krijoheshin kushte dhe rrethana favorizuese që vareshin jo nga vullneti i shqiptarëve, por nga politika e diplomacia ndërkombëtare.

Sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit të problemit të Kosovës i kontribuuan edhe aktivitetet e klubeve, shoqatave dhe asociacioneve shqiptaro-amerikane që funksiononin në Washington, New York dhe shtete e tjera amerikane, si dhe aktiviteti i shqiptarëve në qytete të

---

<sup>45</sup> Frasher Demaj, “Qëndrimi i politikës nderkombëtare ndaj çështjes së Kosovës në fillim të viteve 90”... f. 143.

<sup>46</sup> Edita Tahiri, *Diplomacia e Kosovës në periudhën e okupimit*, Kumtesë e lexuar në Simpoziumin shkencor “Çlirimi i Kosovës”, mbajtur më 12 qershor 2009 në Prishtinë, f. 7.

rëndësishme të Evropës Perëndimore si në: Berlin, Londër, Paris, Romë, Bruksel, Vjenë, Gjenevë, Bernë, Amsterdam etj. Rritja e nivelit të njohjes së çështjes së Kosovës në Washington D.C ishte pjesë e strategjisë së gjithëmbarshme kosovare për ndërkombëtarizimin e kësaj çështjeje në qeveritë dhe parlamentet e shumë vendeve.<sup>47</sup> Për t'i shërbyer sa më shumë kontekstit diplomatik të kauzës kosovare, mërgata shqiptare organizoi në Evropën Perëndimore dhe në SHBA protesta masive në shërbim të sensibilizimit të kauzës kosovare dhe denoncimit të dhunës dhe terrorit serb e jugosllav ndaj shqiptarëve. Ibrahim Rugova i kishte varur shpresat për përkrahjen e politikës paqësore në Kongres, Senat dhe Departamentin e Shtetit Amerikan. Ai ishte i bindur se demokracitë perëndimore në veçanti SHBA-ja do të kuptojnë drejt synimet e kosovarëve për çlirim nga Serbia dhe krijimin e shtetit demokratik ku secili qytetar i Kosovës pavarësisht nga nacionalitetit që i takonte dhe dallimeve të tjera do të gëzonte të drejtat me standardet më të avancuara demokratike. Gjithashtu Rugova besonte që “gandizmi” kosovar çdo ditë e më shumë po fitonte simpati për mënyrën e rezistencës aktive dhe padëgjueshmërisë qytetare të shprehur përmes demonstratave dhe protestave paqësore.

Rezultatet e para konkrete të filozofisë paqësore dolën në sipërfaqe në maj 1990 kur Tom Lantosh (1828-2008) një kongresmen demokrat nga Kalifornia, një hebre i lindur në Hungari, i mbijetuar i holokaustit<sup>48</sup> dhe Joe Dioguardi një kongresmen republikan, udhëhoqën një delegacion amerikan për vizitë në Kosovë për t'u njohur drejtpërdrejt me situatën e krijuar pas suprimimit të autonomisë dhe demonstratave paqësore si kundërreagim ndaj veprimeve antikushtetuese dhe të dhunshme të Serbisë. Pas mbledhjes së fakteve dhe dëshmive konkrete për dhunën dhe terrorin shtetëror serb ndaj shqiptarëve, ata i dënuan këto veprime dhe e cilësuan Millosheviqin si diktator modern dhe armik të demokracisë në Jugosllavi. Tom Lantosh shfaqti tone admirimi dhe përkrahje për politikën paqësore shqiptare dhe aspiratat e kosovarëve për liri dhe demokraci, kurse Dioguardi u shpreh hapur me tone favorizuese për paqen, lirinë dhe demokracinë. Ai në takim me Ibrahim Rugovën dhe përfaqësuesit e partive politike në Kosovë shprehu hapur përkrahjen ndaj kauzës paqësore kosovare duke theksuar se “kosovarët kanë

<sup>47</sup> David L. Phillips, *Çlirimi i Kosovës*, Diplomacia këmbëngulëse dhe ndërhyrja e SHBA-së, Tetovë 2015, f. 83.

<sup>48</sup> <https://www.congress.gov/110/cpr/JPRT40700/CPRT-110JPRT40700.pdf>;  
<https://www.jewishvirtuallibrary.org/tom-lantos-2>;  
<https://tomlantosinstitute.hu/who-we-are/tom-lantos>.

miq në Amerikë dhe udhëheqës të mirë si dr. Rugova në Kosovë”. Mirëpo fjalitë e Dioguardit që e shqetësuan më së shumti regjimin e Beogradit ishin citimi i vargjeve të Nolit “Mbahu nënë mos ke frikë se i ke djemtë në Amerikë” dhe “Rroftë Kosova”.<sup>49</sup> Qeveria serbe në reagimet e saj publike, përmes instancave shtetërore dhe medieve të shkruara dhe elektronike, në edicionet e lajmeve gjykonte me tone kërcënuese deklarata të Dioguardit duke e akuzuar edhe si përkrahës të nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar. Për qëndrimet e tij pro Kosovës në korrik 1990 Dioguardit zyrtarisht iu ndalua nga ana e regjimit të Milosheviqit hyrja në Jugosllavi, me motivacionin: për "akte armiqësore ndaj shtetit".<sup>50</sup>

Qëndrimet e kongresmenëve amerikanë në kryeqytetin e Kosovës ishin motiv shtesë për t'u mbështetur me forcë në dinamizimin e veprimeve politike që afirmonin politikën paqësore kosovare në qarqet e politikës ndërkombëtare. Ky dinamizim aktivizoi potencialet shqiptare në SHBA të jenë edhe më aktivë në fushata lobimi për Kosovën në qarqet politike amerikane. Më 29 gusht të vitit 1990 me kërkesën e Ligës Qytetare shqiptaro-amerikane, senatori Bob Doll, republikan i lindur në Kanzas, personalitet i shquar, që shërbeu në Senatën Amerikanë gjatë viteve 1969-1996, më vonë kandidat për president të SHBA<sup>51</sup> dhe gjashtë senatorë të tjerë të SHBA-së vizitojnë Prishtinën, duke parë nga afër brutalitetin e establishmentit policor e ushtarak të Millosheviqit dhe gjendjen e popullatës shqiptare që po vuante nga represioni shtetëror dhe masat e dhunshme të instaluar nga Serbia.<sup>52</sup> Delegacioni amerikan që e kryesonte senatori Doll, në përbërjen e vet kishte senatorët Xhon Varner, Alfons D'Amato, Xhek Gorn, Don Nikëlls, Stiv Sims dhe Keni Mak të shoqëruar nga ambasadori i SHBA-ve në Beograd Uoren Zimmerman.<sup>53</sup> Në Prishtinë ata u priten nga delegacioni shqiptar i kryesuar nga Ibrahim Rugova dhe përfaqësues të tjerë të partive politike shqiptare, intelektualë të pavarur, sindikatat e pavarura, përfaqësues të Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, gazetarë, përfaqësues nga shoqëria civile etj. Në mesin e emrave më të njohur ishin: Fehmi Agani, Adem Demaçi, Rexhep Qosja, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Veton Surroi, Luljeta Pula, Shkelzen Maliqi, Gazmend Pula,

---

<sup>49</sup> Adnan Merovci, Fakte (Emission dokumentar), *Vizita e kongresistëve Tom Llantos dhe Xho Diogardi në Kosovë*, 1990, Pjesa 1, 6 dhjetor 2021.

<sup>50</sup> Albanian American Civil League, <http://www.aacl.com/our-25-year-history>, shikuar më 03.02.2018.

<sup>51</sup> [https://www.senate.gov/senators/FeaturedBios/Featured\\_Bio\\_DoleRobertJ.htm](https://www.senate.gov/senators/FeaturedBios/Featured_Bio_DoleRobertJ.htm)

<sup>52</sup> Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, London 2000, f. 89.

<sup>53</sup> Adnan Merovci, Fakte (Emission dokumentar) *Vizita historike e delegacionit amerikan në krye me senatorin Bob Doll, 1990*, Pjesa 1, 21 dhjetor 2021.

Bujar Bukoshi, Ramadan Kelmendi, Agim Hyseni, Avni Spahiu, Ble-  
rim Shala etj.<sup>54</sup> Ky bashkim i mendjeve intelektuale kishte si qëllim të  
vetëm paraqitjen e gjendjes reale dhe ofrimin e fakteve për ngjarjet e  
ndodhura gjatë viteve 1989-1990, që nisën me suprimimin e autonomi-  
së së Kosovës dhe vazhduan me protesta, greva e demonstrata paqësore  
të shqiptarëve në mbrojtje të drejtave të tyre qytetare e kombëtare.  
Senatorët amerikanë ishin shumë të interesuar të dëgjonin të dy palët,  
shqiptare dhe serbe, si dhe të grumbullonin sa më shumë argumente për  
të vërtetën për Kosovën. Shqiptarët ofruan argumente të mjaftueshme  
që faktonin shkeljet kushtetuese të Serbisë me rastin e suprimimit të  
autonomisë dhe institucioneve të tjera të Kosovës dhe dhunën e repres-  
sionin serb ndaj shqiptarëve, protestues paqësor që kërkonin të drejtat e  
tyre, arrestimet dhe burgosjet e shumta dhe dënimet e shqiptarëve për  
bindje politike. Diskutimet e delegacionit shqiptar u mbështetën me  
dokumentacion përkatës dhe fotografi si dëshmi për senatorët ameri-  
kanë, të cilët u zotuan që gjithë këtë eksperiencë dhe faktet e ofruara do  
t'i përcillnin në Senat, Stejt Departament dhe te presidenti i SHBA-së.  
Amerikanët u takuan edhe me të dërguarit e Serbisë që kryesoheshin  
nga nënkryetari i qeverisë së Serbisë Momqillo Trajković, Radosllav  
Zllatanović, përfaqësues i “Këshillit për të vërtetën për Kosovën”, Mir-  
ko Çupiq, nënkryetar i “Këshillit”, Atanasije Jevtiq përfaqësues i Patri-  
kanës së Pejës dhe përfaqësues të tjerë politikë serbë.<sup>55</sup> Sipas dekla-  
ratave të pjesëmarrësve, takimi me përfaqësuesit serbë u zhvillua në një  
situatë të tendosur, me ankesa të pambështetura, me tone të ngritura, pa  
argumente dhe shumë i acaruar, meqë serbët përveç shovinizmit anti-  
shqiptar nuk kishin ofruar asnjë argument që fliste për ndonjë agresion  
konkret të shqiptarëve ndaj serbëve. Zhgënjimin e tyre e përjetuan edhe  
senatorët amerikanë të cilët në takim, por edhe në konferenca të shtypit  
denoncuan shkeljen e lirive dhe të drejtave qytetare të shumicës së  
shqiptarëve nga pakica serbe përmes pushtetit të dhunshëm serb në  
Kosovë.<sup>56</sup>

Lobi shqiptar në SHBA mbante kontakte të vazhdueshme me  
kongresmenë, senatorë, drejtues të fondacioneve, përfaqësues të orga-  
nizatave që merreshin me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe politikanë të  
niveleve të ndryshme amerikane. Më 25 shtator, Rugova ndërmori një

<sup>54</sup> Frasher Demaj, “Qëndrimi i politikës ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës në fillim të viteve 90”... f. 148.

<sup>55</sup> Adnan Merovci, Fakte (Emision dokumentar) *Vizita historike e delegacionit amerikan në krye me senatorin Bob Doll, 1990*, Pjesa 1, 21 dhjetor 2021

<sup>56</sup> Po aty.

udhëtim drejt SHBA-së me shpresë të takonte kongresmenë, senatorë dhe funksionarë të tjerë të Departamentit të Shtetit për t'i njoftuar me situatën e fundit në Kosovë dhe për të kërkuar përkrahjen e tyre. Në Washington ai takoi Bob Dollin, Joseph Biden dhe senatorë të tjerë, që u njoftuan për helmimin masiv të nxënësve shqiptarë në shkollat e Kosovës dhe për dhunën e policisë serbe ndaj qytetarëve shqiptarë.<sup>57</sup>

Rugova deklaronte se është optimist racional, pra ai nuk mbërthehej nga optimizmi i tepruar dhe nuk ekzagjeronte rezultatet e takimeve të tij dhe delegacioneve kosovare me diplomatë të rëndësishëm të rangut të lartë ndërkombëtar.<sup>58</sup> Megjithatë proklamimi i politikës paqësore dhe koncepti i tij për rezistencën aktive paqësore bazohej në demokracinë perëndimore dhe vlerat e saj duke besuar se “Kosova nuk mund të jetë oazë e pushtuar në detin e Evropës Demokratike” dhe “... durimi i ka kufijtë e vet dhe ai do të na shpjerë drejt fitores...” deklarohet Rugova në paraqitjet e tij publike.<sup>59</sup> Rugova në diskursin e tij politik e mbështeste politikën paqësore dhe dialogun si mjet për zgjidhjen e çështjes, mirëpo duke qenë në pikëpamje të ruajtjes së vlerave kombëtare paksa konservator dhe duke u mbështetur edhe nga eksperiencia e fatit të babait dhe gjyshit të tij të vrarë pabesisht, nuk e përjashtonte asnjëherë rrezikun dhe domosdonë e mobilizimit të shqiptarëve në rast lufte me Serbinë.<sup>60</sup> Politika paqësore rugoviane shpeshherë është quajtur si politikë qyqare nga qarqe të ndryshme politike sidomos nga emigracioni i Kosovës. Kundërshtarët e politikës paqësore i takonin krahut marksist-leninist, shumica prej tyre ishin entuziastë dhe situatën në Kosovë e përjetonin me emocion duke mos e njohur realitetin, domosdoshmërinë për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, fuqinë dhe pafuqinë në rast lufte të parakohshme me Serbinë dhe rrethanat ekzistuese në vend. Kundërshtimin ndaj “qarqeve radikale” dhe politikën e tij paqësore, Rugova e arsyetonte me faktin se: “Nuk më duhet Kosova pa shqiptarë”, kurse sinjalet prej “radikali” i dërgonte përmes konceptit të traditës që “duhet mbrojtur pragu i shtëpisë”.<sup>61</sup> Pra ai nuk e përjashtonte faktin që Kosova një ditë duhet të luftojë për lirinë e saj por ai synonte që para luftës me armë duhet fituar beteja diplomatike. Në këtë rast historia i

---

<sup>57</sup> David L. Phillips, *Çlirimi i Kosovës...* f. 85.

<sup>58</sup> “Kosovarja”, Prishtinë, qershor 1990, Intervistë me dr. Ibrahim Rugova, kryetar I LDK-së.

<sup>59</sup> “Zëri i Rinisë”, Prishtinë, 11 gusht 1990, Intervistë me dr. Ibrahim Rugova, kryetar I LDK-së.

<sup>60</sup> Frasher Demaj, “Qëndrimi i politikës ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës në fillim të viteve 90”... f. 149.

<sup>61</sup> Po aty.

dha të drejtë konceptit rugovian, sepse fuqia më e madhe ushtarake në historinë e njerëzimit u vu në mbrojtje të kosovarëve duke bombarduar një shtet sovran siç ishte Serbia dhe “RFJ”, dhe kjo ndodhi si rezultat i ndërkombëtarizimit të problemit të Kosovës dhe krijimit të miqve ndërkombëtarë pa anashkaluar këtu edhe rolin vendimtar të luftës çlirimtare të shqiptarëve.<sup>62</sup>

Në kuadrin e angazhimeve politike në planin e brendshëm, Lidhja Demokratike e Kosovës kishte hartuar edhe projektin rezervë përveç dy opsioneve të më hershme politike (federatë apo konfederatë), ku përfshihej opsioni i bashkimit kombëtar si një zgjidhje e natyrshme që mund të bëhej e mundur në rast të hapjes së çështjes së kufijve në Ballkan.<sup>63</sup> Ky opsion pavarësisht se ishte i planifikuar si “plan rezervë” ishte shumë i vështirë të ndodhte sepse për t’u realizuar kërkesa për bashkim kombëtar, shumë kufij të njohur ndërkombëtarisht duhej të prisheshin, dhe kjo dukej fare e pamundur për rrethanat e kohës sepse mund të shkaktonte edhe luftëra e përplasje me përmasa së paku ballkanike dhe natyrisht që nuk do të lejohej nga SHBA-ja dhe fuqitë kryesore të Bashkimit Evropian. Duke ndier rrezikun e eskalimit të situatës në vitin 1991-1992 kishte filluar edhe përgatitjet për vetëmbrojtje në rast të sulmeve ushtarake serbe ndaj Kosovës. Për këtë qëllim në tetor të vitit 1991, bazuar në një marrëveshje gjentelmene në mes të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ramiz Alia dhe dr. Ibrahim Rugovës kishin shkuar në Shqipëri për stërvitje ushtarake dy grupe rekrutësh të udhëhequr nga Sali Çekaj ku bënin pjesë edhe Adem Jashari, Zahir Pajaziti dhe personalitete të tjera që më vonë dolën të jenë bartës të luftës për liri e pavarësi. Shumica nga këta vullnetarë nga Kosova, Maqedonia dhe mërgata udhëtuan në Shqipëri përmes kanaleve të sigurta duke ndjekur rrugët nga Shkupi e Prishtina drejt Zvicrës për të kaluar pastaj në Trieste dhe prej andej në Durrës dhe direkt në kampin e ushtrimeve ushtarake në Surrel të Tiranës.<sup>64</sup> Rekrutët e këtyre dy grupeve të para stërvitore ishin vullnetarë me botëkuptime të ndryshme politike por të përbashkuar rreth interesit nacional, përgatitjes për luftë të armatosur kundër policisë serbe e cila po ushtronte dhunë çnjerëzore ndaj qytetarëve të zakonshëm shqiptarë dhe ushtrisë serbe

<sup>62</sup> Po aty, f. 150.

<sup>63</sup> AIHP, QIK (Qendra Informative e Kosovës), Shih “Deklarata politike e Këshillit Koordinues të Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi” e miratuar më 12 tetor 1991, Albanian Democratic Movement in Former Yugoslavia, Documents: 1990-1993, Kosova Information Center, Prishtina 1993, 21-23.

<sup>64</sup> Më gjerësisht: Frasher Demaj, Salih Çekaj, veprimtaria politike dhe ushtarake, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2024.

në rast të përfshirjes në luftë. Serbia dhe Jugosllavia në ditët e fundit të saj shpeshherë kishin nxjerrë ushtrinë nga kazernat për të demonstruar fuqi dhe mbjellë frikë te republikat dhe popujt që jetonin në Jugosllavi.

Stërvitja ushtarake në Shqipëri pavarësisht nga synimet për të mbetur në konfidencë, nuk arriti të mbahej e fshehtë. Ajo u dekonspirua meqë, disa kryeqytete evropiane morën në dijeni zhvillimin e ngjarjeve dhe ushtruan presion ndaj qeverisë shqiptare për mbylljen e kampeve të stërvitjes së rekrutëve nga Kosova. Në të njëjtën kohë edhe ambasadat “jugosllave” dhe ruse i kishin dërguar nota diplomatike qeverisë shqiptare ku e akuzonin se po stërviste “terroristë” për të sulmuar një vend fqinj.<sup>65</sup> Por pavarësisht nga presionet serbe, ruse dhe ndërkombëtare, dy grupet e para përfunduan me sukses të plotë stërvitjet e tyre dhe disa prej tyre u kthyen në Kosovë të armatosur dhe të gatshëm për luftë eventuale në rast të eskalimit të situatës.

Organizimi grupeve të gatishmërisë vazhdoi në vitin 1992 duke mobilizuar nëpër fshatra dhe qytete, roje nate dhe rekrutime grupesh të gatshme për rezistencë të armatosur në rast se Serbia do të tentonte të hapte front të drejtpërdrejtë me shqiptarët. Mirëpo, si shkak-pasojë e dekonspirimit, shumë drejtues, oficerë ushtarakë dhe policorë shqiptarë u arrestuan, u burgosën dhe u dënuan me shumë vite burg nga ana e Serbisë. Në rrethanat e shtimit të represionit serb, Rugova vazhdonte të ndiqte kursin paqësor duke mos e pranuar as ofertën kroate për “frontin e jugut”. Megjithatë, ai në një nga deklaratimet e tij publike shprehej: “... ne jemi këtu, do të qëndrojmë, duam dhe mund të mbrohemi nëse paraqitet nevoja...”.<sup>66</sup> Ai gjithashtu ishte i bindur që nëse e radikalizonte diskursin politik, ai do të humbte simpatinë e krijuar për kursin e politikës paqësore dhe dialogut, në politikën ndërkombëtare.

Shqiptarët kishin ideuar një platformë që përmbante dy parime kryesore: që negociatat të jenë të ndërmjetësuar nga një palë e tretë ndërkombëtare me fuqi garantuese, duke kërkuar rolin udhëheqës të SHBA-së në bashkëpunim me BE-në; dhe që negociatat të zhvillohen mbi parimin e mosprejudikimit të statusit final të Kosovës.<sup>67</sup> Elita politike kosovare në kuadrin e politikës paqësore kërkonte gjithashtu ven-

---

<sup>65</sup> Frashër Demaj, *Stërvitjet ushtarake në Shqipëri dhe hyrja e rekrutëve të armatosur në Kosovë nën drejtimin e Sali Çekaj*, Kumtesë e mbajtur në Pejë, 2.12.2021.

<sup>66</sup> “Zëri”, Prishtinë, 1 prill 1992, Intervistë me dr. Ibrahim Rugova.

<sup>67</sup> Frasher Demaj, “*Qëndrimi i politikës nderkombëtare ndaj çështjes së Kosovës në fillim të viteve 90*”... f. 151.

dosjen e forcave të NATO-s në territorin e Kosovës, sepse fuqia ushtarake e aleancës ishte i vetmi faktor që do të siguronte paqen, do të parandalonte një luftë me përmasa shkatërruese dhe të shmangte spastrimin etnik të shqiptarëve. Shqiptarët e shihnin te SHBA-ja partnerin e fuqishëm i cili historikisht i kishte ndihmuar popujt e shtetet në nevojë.

Në vitet 1990-1993, simpatia perëndimore e krijuar për rezistencën aktive paqësore në Kosovë nuk u shndërrua në mbështetje konkrete politiko-diplomatike që mund ta zgjidhte çështjen kosovare. Diplomacia perëndimore mendohej t'i menaxhonte pritjet e shoqërisë kosovare, duke miratuar disa rezoluta ndërkombëtare dhe qëndrime që e dënonin dhunën e regjimit serb në Kosovë, por pa diskutuar për statusin final të Kosovës. Megjithatë, rezolutat nuk kishin karakter detyrues që nënkupton se nuk kalonin më shumë se një "dënim verbal", por për palën kosovare trajtimi i kësaj çështjeje edhe në nivel rezolutash mbante gjallë shpresën se me kalimin e kohës do të shpërblehej edhe kursi paqësor i politikës kosovare.

Zhgënjimi i parë i kosovarëve ndodhi me rastin e mbajtjes së Konferencës së Paqes për Jugosllavinë në Hagë më 27 gusht 1991, ku u ftuan përfaqësuesit e republikave jugosllave, por jo edhe Kosova dhe Vojvodina, pavarësisht se sipas Kushtetutës së Jugosllavisë ishin element konstitutiv i kësaj Federate. Mirëpo bashkësia ndërkombëtare nuk dëshironte që të acaronte marrëdhëniet me Serbinë e cila po jepte prova çdo ditë e më shumë se është e gatshme të hynte në luftë me secilën republikë federale nëse cenoheshin interesat e saj. Përfshirja e popujve të Jugosllavisë përnjëherësh në luftë mes tyre rrezikonte të implikonte edhe Shqipërinë, Greqinë, Turqinë, Bullgarinë dhe eventualisht ndonjë vend tjetër të rajonit të Ballkanit.

Kosova nuk u përfshi as në projektplanet e paqes për Jugosllavinë. Konferenca themeloi Misionin e Komunitetit Evropian të Monitorimit dhe Komisionin e Arbitrazhit, i njohur ndryshe si Komisioni Badinter për të negociuar zgjidhjet e mundshme në kuadrin e shpërbërjes së Jugosllavisë.<sup>68</sup>

As në dy konferencat vijuese ndërkombëtare në vitet 90 nuk u trajtua çështja e Kosovës. E para ishte Konferenca e Londrës, e cila u përjetua si fyerje dhe injorim nga ana e popullit të Kosovës kurse e dyta ishte Konferenca e Dejtonit. Në vitin 1992 kishte shpresa se Kosova do të ftohej në Konferencën për Jugosllavinë, e cila do të mbahej në

<sup>68</sup> Enika Abazi, "Çështja e Kosovës dhe diplomacia ndërkombëtare (1991-1999): një konflikt i parashikueshëm", Studime Historike 3-4, Tiranë 2013, f. 192.

Londër, në muajin gusht.<sup>69</sup> Këto shpresa u bënë realitet në momentin kur u ftua Ibrahim Rugova, që në atë kohë ishte zgjedhur kryetar i Kosovës.<sup>70</sup> Mirëpo ftesa ishte me hile sepse delegacioni i Kosovës nuk mori pjesë aktivisht në punimet e konferencës, meqë nuk ishte i ftuar i barabartë me të tjerët. Për delegacionin e Kosovës ishte organizuar një dhomë e veçantë, e emëruar si “sallë dëgjimi” (*salla d’ecoute*).<sup>71</sup> Të ndodhur në këtë situatë përfaqësuesit kosovarë duhet të tregoheshin të shkathët dhe të takonin personalitetet e shquara përfaqësuese dhe vendimmarrëse në margjinat e konferencës në mënyrë që të trajtonin domosdoshmërinë e diskutimit të çështjes së Kosovës si një nga nyjat e rëndësishme në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë. Delegacioni kosovar kishte rastin të bisedonte herë pas here me Lordin Karrington (Peter Alexander Ruper Carrington, 6th baron Carrington) që ishte udhëheqës i Konferencës së Londrës dhe me diplomatë të tjerë përfaqësues dhe të interesuar.<sup>72</sup> Për shkak të mospjesëmarrjes së Kosovës në nivele të barabarta me të tjerët, kundërshtarët politikë të Rugovës e kishin “këshilluar” që të mos merrte pjesë në këtë Konferencë. Sidoqoftë Rugova vendosi që pavarësisht nga kritikrat, skepticizmi dhe statusi i të ftuarit, të merrte pjesë në një takim të rëndësishëm ndërkombëtar ku ishte e fokusuar e gjithë politika dhe diplomacia botërore. Rugova ishte i bindur se pjesëmarrja në këtë aktivitet ndërkombëtar është sa e rëndësishme po aq edhe e domosdoshme, sepse përcaktimi i zgjidhjes së çështjes së Kosovës me politikë paqësore dhe diplomaci ishte faktor i rëndësishëm në krijimin e miqve dhe përkrahjes ndërkombëtare. Ai në një nga intervistat e tij deklaronte:” Ne e pranuan ftesën më shumë për kooperim. Unë e kam thënë edhe publikisht se nuk jemi të kënaqur me statusin, por marrë në përgjithësi nuk mund të jemi të pakënaqur”.<sup>73</sup> Rugova më tej vlerësonte se Konferenca e Londrës për shqiptarët ishte një hap përpara, ndërsa formimi i Grupit të posaçëm për Kosovën në Gjenevë është edhe një sukses i radhës në projektin kosovar për sensi-

---

<sup>69</sup> Më gjerësisht shih: Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë 2009, f. 93-127.

<sup>70</sup> Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë 2009, f. 103.

<sup>71</sup> *Po aty*, f. 104.

<sup>72</sup> <https://www.britannica.com/biography/Peter-Carrington-6th-Baron-Carrington-of-Upton>; <https://www.theguardian.com/politics/2018/jul/10/peter-carrington-lord-carrington-obituary>, hulumtuar me 3 maj 2022.

<sup>73</sup> “Zëri”, Prishtinë, 26 shtator 1992, Intervistë me presidentin e Republikës së Kosovës dr. Ibrahim Rugova.

bilizimin dhe ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Ne do të kërkojmë që shqiptarët të kenë të drejtë plebishitare që të deklarohen për vetëvendosje, por do të bëjmë çmos që edhe më tej t'i shpëtojmë luftës shprehej Rugova më 6 nëntor të vitit 1992.<sup>74</sup> Shqiptarët duhet të qëndrojnë dhe të rezistojnë në rrugën që kanë zgjedhur, sepse çështja e Kosovës do të zgjidhet përmes një procesi që mund të jetë i gjatë dhe i mundimshëm.<sup>75</sup>

Politika kosovare pavarësisht nga vështirësitë, po e fuste gradualisht në agjenda ndërkombëtare çështjen e Kosovës, po rriste simpatinë perëndimore dhe përkrahjen ndaj saj, po krijonte bindjen absolute se çështja e Kosovës ishte një problem që nuk mund të neglizhohej gjatë dhe kërkonte zgjidhje të shpejtë e substanciale.<sup>76</sup>

Vazhdimi i trajtimit të shqiptarëve me masa represive dhe rrezikimi i paqes rajonale nga ana e Serbisë pas fillimit të luftës së ashpër midis Serbisë dhe Kroacisë shqetësoi tej mase Uashingtonin dhe Brukselin të cilët druhashin për përhapjen e mëtejme të konfliktit.

Në këtë situatë krize ishte shpresëdhënëse për paqen dalja e Presidenti *George H. W. Bush* me qëndrimin e “vijës së kuqe” për Kosovën në fund të vitit 1992. Presidenti Bush në letrën drejtuar Milloshëviqit shprehej: “Shtetet e Bashkuara do të jenë të përgatitura të përdorin forcën ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe në Serbi”.<sup>77</sup> Ky qëndrim i presidentit amerikan u njoh edhe si “Kërcënim i Krishtlindjeve” dhe ishte vërejtja më serioze ndaj Serbisë dhe Jugosllavisë në rast të përshkallëzimit të dhunës në Kosovë. Qëndrimi i presidentit Bush për shumë politikanë dukej i papritur, por për shqiptarët ishte i mirëseardhur si një shpërblim amerikan për politikën paqësore dhe zgjidhjen e problemeve përmes dialogut me ndihmën e palës së tretë. Disa muaj më vonë, Sekretari i Shtetit i Administratës Klinton, Warren Christopher, deklaroi se SHBA-ja është e shqetësuar, nëse dhuna serbe zgjerohet drejt Kosovës, ajo do të përfshinte në konflikt vende të tjera

<sup>74</sup> “Bujku”, Prishtinë, 6 nëntor 1992, “Qëndrojmë në opcionin tonë për Kosovën e pavarur dhe neutrale”, Intervistë e Presidentit të Kosovës dr. Ibrahim Rugova.

<sup>75</sup> “Bujku”, Prishtinë, 27 shtator 1993, *Organizimi ynë kërkon një reformism të brendshëm*, intervistë e Presidentit dr. Ibrahim Rugova.

<sup>76</sup> Beqir Meta, “Konteksti ndërkombëtar i rezistencës paqësore të shqiptarëve të Kosovës i udhëhequr nga Presidenti Rugova në vitet e 90-ta”, botuar në Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit, ASHAK, Prishtinë 2019, f. 29.

<sup>77</sup> <https://www.reuters.com/article/world/day-of-mourning-in-kosovo-for-bush-seen-as-hero-for-1992-letter-idUSKBN1O41MY/>;  
<https://www.govinfo.gov/content/pkg/CHRG-105shrg49265/html/CHRG-105shrg49265.htm>.

të rajonit si Shqipërinë, Greqinë dhe Turqinë. SHBA-ja është e bindur se duhet të parandalojnë zgjerimin e konfliktit që do të përfshinte aleatët tanë të NATO-s dhe të çonte pjesë të gjera të Evropës në luftë dhe ndoshta, siç ka ndodhur më parë, kjo do të eskalonte në një luftë botërore.<sup>78</sup>

Mbështetja amerikane për Kosovën ishte motiv shtesë për shqiptarët dhe politikën paqësore që po ndiqte Rugova për arritjen e qëllimeve politike. Mirëpo, pavarësisht nga paralajmërimet amerikane, Serbia nuk pushoi së ushtruari dhunë, vrasje, arrestime, burgosje dhe trajtime të tjera çnjerëzore ndaj shqiptarëve, e bindur gjithmonë se përkrahja ruse ndaj politikës serbe do të ishte më e fortë dhe kërcënuese në krahasim me përkrahjen e zbehtë të SHBA-së dhe Evropës Perëndimore ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Me gjithë gjykimet nga këndvështrimet dhe interesat e ndryshme të “kërcënimit të krishtlindjeve”, nga janari i vitit 1993 u krijua një klimë e re për Kosovën. Takimet e përfaqësuesve kosovarë me personalitetet të rëndësishme të politikës ndërkombëtare njohën ritme të reja të zhvillimit. U intensifikua pjesëmarrja në konferenca e forume ndërkombëtare dhe në takime me burrshtetas të vendeve të interesuara për çështjen e Kosovës. Ndër takimet më të rëndësishme të nivelit të lartë të udhëhequr nga Presidenti Rugova ishin: në SHBA me sekretarët e shtetit, *Warren Christopher* dhe *Madeleine Albright*; në Gjermani me ministrin e Jashtëm *Klaus Kinkel*; në Britaninë e Madhe me ministrat e Jashtëm *Douglas Hurd* dhe *Malcom Rifkind*; në Francë me ministrin e Jashtëm *Hubert Vedrine*; në Austri me ministrin e Jashtëm *Wolfgang Schüssel*, në Itali me ministrin e Jashtëm *Lamberto Dini*; në Spanjë me ministrin e Jashtëm *Javier Solana* etj.<sup>79</sup> Takime të rëndësishme të delegacioneve kosovare u zhvilluan edhe në nivele të tjera përfaqësuese të institucioneve të përbashkëta evropiane me të gjithë kryesuesit e radhës së BE-së, Komisararin politik *Hans van den Broek*, kryetarin e Komisionit Evropian *Jacques Santer*, me Kryesuesin e radhës së OSBE-së *Flavio Cotti*<sup>80</sup>, e takime të tjera. Çështja e Kosovës u bë e njohur edhe në opinionin publik ndërkombëtar duke qenë prezent gati çdo ditë në

---

<sup>78</sup> Stephen Engelberg, *Weighing Strikes in Bosnia, US Warns of Wider War*, The New York Times, 25 prill 1993; Mark Danner, “Endgame in Kosovo: Ethnic Cleansing and American Amnesia”, në botimin: *Kosovo: Contending Voices on Balkan Interventions*, Edited by William Joseph Buckley, f. 69.

<sup>79</sup> Edita Tahiri, *Diplomacia e Kosovës në periudhën e okupimit*, Kumtesë e lexuar në Simpoziumin shkencor “Çlirimi i Kosovës”, mbajtur më 12 qershor 2009 në Prishtinë.

<sup>80</sup> Po aty f. 17.

mediet prestigjioze ndërkombëtare si: në Euronews, ZDF, RTL, CNN, BBC, Rai Uno, Voice of America, Deutsche Welle, dhe medime të shkruara si: Herald Tribune, Washington Post, New York Times, Tageszeitung, Frankfurter Allgemeine Zeitung, Le Parisien, Liberation, Der Spiegel, Le Figaro, Corriere della Sera etj.<sup>81</sup>

Në vazhdimësinë e aktiviteteve të rëndësishme për Kosovën, Rugova pati takime në Kongres dhe Senatit amerikan në vitin 1994. Ai deklaronte se vizita në SHBA ishte ndër takimet më të suksesshme sepse u zhvilluan biseda të rëndësishme me zyrtarët më të lartë të administratës së presidentit Klinton. Për herë të parë bisedat ishin të hapura miqësore dhe të përzemërta. Nga këto deklarata mund të konstatohet se në këto takime ai mori garanca nga SHBA-ja, por natyrisht që nuk duheshin bërë publike për arsye politiko dhe strategjike. Edhe këtë herë u rikonfirmua se kërcënimi i Presidentit Bush dhe ai i Presidentit Klinton janë garancë se SHBA-ja janë të gatshme të bëjnë çmos për ta ndaluar konfliktin në Kosovë dhe të intervenojnë nëse Serbia tenton të bëjë luftë të hapur kundër Kosovës.<sup>82</sup>

Në gjysmën e parë të vitit 1995, Kosova sërish ishte në qendër të vëmendjes në agjendat ndërkombëtare të institucioneve dhe organizatave politike e diplomatike. Rugova deklaronte se:” ne si shtet duhet të kemi sa më shumë kontakte, të bëjmë sa më shumë miq, të jemi krenarë për përkatësinë tonë kombëtare, të krijojmë mundësi për brezin e ri të cilin unë e quaj brezi i republikës dhe ta inkuadrojmë shtetin tonë në proceset integruese shqiptare, ballkanike dhe evropiane”.<sup>83</sup>

Një goditje jo e lehtë ndaj Kosovës dhe politikës paqësore erdhi nga mungesa e ftesës për pjesëmarrje të barabartë në Konferencën e Dejtonit. Në Dejton më 21 nëntor 1995 në bazën ushtarake amerikane “Wright Peterson” në Ohajo u arrit marrëveshja për ndarjen e Bosnjës e Hercegovinës në 51 për qind në territorin e Federatës së Bosnjës e Hercegovinës dhe 49 për qind të territorit në Republika Srpska.<sup>84</sup> Dejtoni zbehu kursin politik paqësor të ndjekur nga kosovarët dhe nxiti

<sup>81</sup> Frasher Demaj, “Qëndrimi i politikës nderkombëtare ndaj çështjes së Kosovës në fillim të viteve 90”... f 154.

<sup>82</sup> “Koha”, Prishtinë, 29 dhjetor 1994, “Zgjidhja premtuese-Administrimi Civil” intervistë e Presidentit dr. Ibrahim Rugova.

<sup>83</sup> “Zëri”, Prishtinë, 13 maj 1995, “Bashkësia ndërkombëtare po punon intensivisht për fillimin e bisedimeve për Kosovën”, intervistë e Presidentit dr. Ibrahim Rugova.

<sup>84</sup> www.zeriamerikes.com, “Marrëveshja e Dejtonit, vështrim retrospektiv nga aktorët kryesorë”. Hulumtuar më 10 janar 2018.

qarqet radikale në Kosovë dhe jashtë saj që të proklamonin luftën e armatosur si të vetmen alternativë për çlirimin e Kosovës.

Mungesa e ftesës në Konferencë dhe fakti se në Dejton nuk u bë fjalë për çështjen e Kosovës u interpretua në mënyra të ndryshme në Prishtinë dhe Beograd, si dhe nga vëzhguesit politikë dhe nga zyrtarët e vendeve të ndryshme evropiane.<sup>85</sup> Edhe opinioni publik dhe politik ndërkombëtar u nda në qëndrime pro dhe kontra. Disa mendonin se mos ftesa e Kosovës në Dejton ishte indiferencë totale ndaj kësaj çështjeje dhe politikës paqësore e cila dukej e parrezikshme për cenimin e paqes dhe stabilitetit rajonal. Kurse të tjerë mendonin se diplomacia ndërkombëtare e kishte fokusuar gjithë energjinë e vet në zgjidhjen e çështjes së Bosnjës e Hercegovinës, sepse lufta e pamëshirshme e kishte shkatërruar këtë vend dhe pas zgjidhjes së krizës atje do t'i vinte radha për trajtim Kosovës. Në disa qarqe politike u krijua përshtypja se mungesa e trajtimit të çështjes së Kosovës në Dejton ishte provë e tezës serbe se Kosova është “çështje e brendshme e Serbisë dhe e Republikës Federale Jugosllavisë” (Serbi- Mali i Zi) dhe se shqiptarët duhet ta braktisnin shpresën për trajtimin e Kosovës në Konferenca Ndërkombëtare.<sup>86</sup> Kurse skeptikët mendonin se nuk do të ketë trajtim serioz të çështjes së Kosovës pa filluar lufta kundër Serbisë, sepse politika ndërkombëtare nuk e trajtoi seriozisht dhe nuk i mori masat për të ruajtur paqen as kur Sllovenia, Kroacia dhe Bosnjë e Hercegovina e shpallën pavarësinë e tyre. Pra, Kosova do të trajtohet seriozisht me gjithë kompleksitetin e saj nëse fillon një luftë që do të rrezikonte paqen dhe stabilitetin rajonal të Evropës Juglindore e me këtë rast edhe interesat e SHBA-së dhe vendeve kryesore të Bashkimit Evropian.

Për Konferencën e Dejtonit ishte deklaruar edhe presidenti Rugova i cili pavarësisht nga mospajtimet për mostrajtimin e problemit të Kosovës, ishte treguar i matur dhe optimist me qëllim të mosshfaqjes së papajtueshmërisë dhe luhatjes së përkrahjes ndërkombëtare të çështjes kosovare. Optimizmi i tij ishte i bazuar edhe në marrëdhëniet e veçanta me SHBA-në, përkrahjen amerikane për Kosovën dhe arsye të tjera që nuk duhej të bëheshin publike. Ai më 28 nëntor 1995 deklaronte se Marrëveshja e Dejtonit do të reflektonte në mënyrë pozitive. Qëllimi i parë i Dejtonit ishte që të ndërpritet lufta në Bosnjë e pastaj të gjenden zgjidhje për të gjitha problemet në Jugosllavi e Ballkan. “Kam

---

<sup>85</sup> Muhamedin Kullashi, “Evoluimi i opinionit publik ndërkombëtar rreth pavarësisë së Kosovës” botuar në Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit, ASHAK, Prishtinë 2019, f. 62.

<sup>86</sup> Po aty f. 63

të drejtë të jem optimist si president i Kosovës dhe si qytetar i saj. Optimizmin e mbështes te përkrahja e miqve të Kosovës, sepse ata flasin gjithkund me simpati dhe tone pozitive për kauzën tonë” vlerësonte Rugova.<sup>87</sup> Pra, ai ishte i bindur se qëndrimi i bashkësisë ndërkombëtare kishte shënuar ngritje cilësore në procesin e sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit. Elita politike e Kosovës nuk besonte verbërisht në fitimin e lirisë dhe pavarësisë me mjete paqësore por politikën paqësore e shihte si mundësinë e vetme për të fituar “luftën diplomatike” kundër Serbisë, sepse proceset që do të pasonin përfshirë edhe luftën eventuale do të ishin më të lehta dhe me rezultate pozitive në favor të kauzës së lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Proceset politike dhe lufta në Bosnjë e Hercegovinë i dhanë të drejtë kursit paqësor dhe përcaktimit të politikës kosovare për dialogun, sensibilizimin, ndërkombëtarizimin dhe zgjidhjen e çështjes politike përpara se të provohet zgjidhja e saj me luftë. Bosnjë e Hercegovina ishte Republikë e RSFJ-së, por pas luftës u nda në dy entitete politike Federata Boshnjako-Kroate dhe “Republika Srpska” dhe tri entitete kombëtare, pra realisht u shënuar degradim i thellë dhe qindra e mijëra jetë të njerëzish të humbura, kurse Kosova me statusin e krahinës autonome ndoqi kursin e politikës paqësore, arriti të fitonte luftën diplomatike dhe pas saj të organizonte luftën çlirimtare (edhe pse me vështirësi të shumta) dhe me ndihmën e NATO-s të çlironte Kosovën me humbje shumë më të vogla krahasuar me Bosnjën. Prandaj, përfundimisht duhet vlerësuar diskursi paqësor të bërit politikë i cili në themel kishte realizimin e së drejtës themelore, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, diskurs ky që e nxori Kosovën nga margjinat serbe dhe jugosllave, e shndërroi në çështje ndërkombëtare, e fitoi simpatinë e shteteve më të fuqishme si SHBA-ja dhe vendet kryesore të Bashkimit Evropian dhe sot funksionon si shtet demokratik dhe i pavarur.

## THE ROLE OF POLITICAL PACIFISM IN THE INTERNATIONAL DIMENSIONS OF THE KOSOVA ISSUE 1990-1997

### Summary

The course of political pacifism raised Kosova to high levels of international diplomacy. As a result of this politics, the Kosova issue took on new and international dimensions. History gave justice to the Rugovian concept of political pacifism because the greatest military power in the history of mankind was put in defense of the Kosovars by bombing a sovereign state such as Serbia and "FRY"

<sup>87</sup> “Bujku”, Prishtinë, 28 nëntor 1995, “*Të koncentrohemi të gjithë në çështjen e Kosovës*” intervistë e Presidentit dr. Ibrahim Rugova.

and this happened as a result of the support and internationalization of the problem of Kosova and the creation of international allies without overlooking here the decisive role of the liberation war of the Albanians.

Therefore, the pacifist discourse which was based on the realization of the basic right, freedom and independence of Kosova should be evaluated. This discourse took Kosova out of the Serbian and Yugoslav margins, and transformed it into an international issue, which won the sympathy of the most powerful countries such as the USA and the main countries of the European Union.

The political elite of Kosova saw political pacifism as the only possibility to win the "diplomatic war" against Serbia because the processes that would follow, including the eventual war, would be easier and with positive results in favor of the cause of freedom and independence of Kosova. The political processes and the war in Bosnia and Herzegovina gave the right to the pacifist course and the determination of the Kosovar policy for dialogue, awareness, internationalization and the solution of the political issue before trying to solve it by war. Bosnia and Herzegovina was a republic of the SFRY, but after the war it was divided into two political entities: the Bosnian-Croat federation and "Republika Srpska" and three national entities, so in reality there was a deep degradation and hundreds of thousands of people's lives were lost, while Kosova with the status of the autonomous province followed the course of political pacifism, managed to win the diplomatic war, after that to organize the liberation war and with the help of NATO to liberate Kosova with much smaller losses compared to Bosnia.

## Bibliografia

- “Bujku”, Prishtinë, 27 shtator 1993, *Organizimi ynë kërkon një reformism të brendshëm*, intervistë e Presidentit dr. Ibrahim Rugova.
- “Bujku”, Prishtinë, 28 nëntor 1995, *“Të koncentrohemi të gjithë në çështjen e Kosovës”* intervistë e Presidentit dr. Ibrahim Rugova.
- “Bujku”, Prishtinë, 6 nëntor 1992, *“Qëndrojmë në opcionin tonë për Kosovën e pavarur dhe neutrale”*, Intervistë e Presidentit të Kosovës dr. Ibrahim Rugova.
- “Der Spiegel”, Interview mit Ibrahim Rugova, *“Die serben kommen als Rächer wieder”*, nr. 26, Hamburg 1989.
- “Fjala”, Prishtinë më 15 maj 1990.
- “Koha”, Prishtinë, 29 dhjetor 1994, *“Zgjidhja premtuese-Administrimi Civil”* intervistë e Presidentit dr. Ibrahim Rugova.
- “Kosovarja”, Prishtinë, qershor 1990, Intervistë me dr. Ibrahim Rugova, kryetar I LDK-së.
- “L’Unita”, Intervista a Ibrahim Rugova, *“Questa è una rivolta popolare, Belgrado non la vuole capire”*, Roma, 30.3.1989.
- “Veçer”, Intervju z Ibrahimom Rugovo, *“Naj rečejo, da živim v diktaturi”* Maribor 22.4.1989.
- “Zëri i Rinisë”, Prishtinë, 11 gusht 1990, Intervistë me dr. Ibrahim Rugova, kryetar I LDK-së.
- “Zëri”, Prishtinë, 1 prill 1992, Intervistë me dr. Ibrahim Rugova.
- “Zëri”, Prishtinë, 13 maj 1995, *“Bashkësia nderkombëtare po punon intenzivisht për fillimin e bisedimeve për Kosovën”*, intervistë e Presidentit dr. Ibrahim Rugova.
- “Zëri”, Prishtinë, 26 shtator 1992, Intervistë me presidentin e Republikës së Kosovës dr. Ibrahim Rugova.
- Abazi Enika, *“Çështja e Kosovës dhe diplomacia ndërkombëtare (1991-1999): një konflikt i parashikueshëm”*, Studime Historike 3-4, Tiranë 2013.
- AIHP, QIK (Qendra Informative e Kosovës), *“Deklarata politike e Këshillit Koordinues të Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi”* e miratuar me 12 tetor 1991, Albanian Democratic Movement in Former Yugoslavia, Documents: 1990-1993, Kosova Information Center, Prishtina 1993, 21-23.
- Albanian American Civil League, <http://www.aacl.com/our-25-year-history>.
- Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, AIHP.
- Arkivi i Kosovës, AK, Magnetofonski snima zajednicke sednice sva tri veka Skupstine Socialistickie Autonomne Pokrajine Kosova održane 23.3.1989.
- Bajraktari Jusuf, *“Programet e partive politike dhe pjesëmarrja e tyre në zgjedhjet e vitit 1992”*, botuar në Institucionalizimi i Republikës së

- Kosovës në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992, ASHAK, Prishtinë 2022.
- Bajraktari Jusuf, *Dimensioni historik i pavarësisë së Kosovës*” botuar në Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit, ASHAK, Prishtinë 2019.
- Bajrami Arsim, Muçaj Florent, *E Drejta Kushtetuese*, Prishtinë 2018.
- Baze Mero, *Shqipëria dhe lufta në Kosovë*, Tiranë 1998.
- Bugajski Janusz, *Ngritja e Kosovës, artikuj dhe fjalime nga okupimi deri te pavarësia*, Prishtinë 2006.
- Clark Howard, *Civil Resistance in Kosovo*, London 2000.
- Danner Mark, “Endgame in Kosovo: Ethnic Cleansing and American Amnesia”, në botimin: *Kosovo: Contending Voices on Balkan Interventions*, Edited by William Joseph Buckley.
- Demaj Frashër, “*Qëndrimi i politikës nderkombëtare ndaj çështjes së Kosovës në fillim të viteve 90*”, botuar në Institucionalizimi i Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992, ASHAK, Prishtinë 2022.
- Demaj Frashër, “*Sensibilizimi dhe nderkombëtarizimi i çështjes së Kosovës 1990-1996*”, botuar në Kosova –rruga drejt lirisë, në 20 vjetorin e çlirimit të Kosovës, Instuti I Historisë, Prishtinë 2020.
- Demaj Frashër, *Afrim Gjuraj, Jeta dhe vepra*, Prishtinë 2009.
- Demaj Frasher, Salih Çekaj, veprimtaria politike dhe ushtarake, Instituti i Historisë "Ali Hadri", Prishtinë, 2024.
- Demaj Frashër, *Stervitjet ushtarake në Shqipëri dhe hyrja e rekrutëve të armatosur në Kosovë nën drejtimin e Sali Çekaj*, Kumtesë e mbajtur në Pejë, 2.12.2021.
- Elezi Mehmet, *Kosova midis politikës dhe realpolitikës*, Tiranë 1999.
- Engelberg Stephen, *Weighing Strikes in Bosnia, US Warns of Wider War*, The New York Times, 25 prill 1993;
- <https://www.britannica.com/biography/Peter-Carrington-6th-Baron-Carrington-of-Upton>. <https://www.theguardian.com/politics/2018/jul/10/peter-carrington-lord-carrington-obituary>.
- <https://www.congress.gov/110/cprt/JPRT40700/CPRT-110JPRT40700.pdf>;
- <https://www.jewishvirtuallibrary.org/tom-lantos-2>;
- <https://tomlantosinstitute.hu/who-we-are/tom-lantos>.
- <https://www.govinfo.gov/content/pkg/CHRG-105shrg49265/html/CHRG-105shrg49265.htm>.
- <https://www.reuters.com/article/world/day-of-mourning-in-kosovo-for-bush-seen-as-hero-for-1992-letter-idUSKBN1O41MY/>;
- [https://www.senate.gov/senators/FeaturedBios/Featured\\_Bio\\_DoleRobertJ.htm](https://www.senate.gov/senators/FeaturedBios/Featured_Bio_DoleRobertJ.htm)
- Hyseni Munish, *Kështu foli Rugova* (Intervista 1990-2005), Prishtinë 2019.

- Islami Hivzi, “Tendencat serbe për shkatërrimin e themeleve të jetës së shqiptarëve”, botuar në Gjenocidi dhe masakrat e Serbisë në Kosovë (1998-1999), ASHAK 2023.
- Karastojanov Stefan, *Kosova (një analizë gjeopolitike)*, Shkup 2007.
- Krisafi Ksenofon, *Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike*, Tiranë 2018.
- Kullashi Muhamedin, “Evoluimi i opinionit publik ndërkombëtar rreth pavarësisë së Kosovës” botuar në Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit, ASHAK, Prishtinë 2019.
- Lauka Islam, *Kosovo a Universal case or Sui generis*, Tiranë 2007.
- Lellio di Anna, *The Battle of Kosovo 1389*, An Albanian epic, London 2009.
- Malcolm Noel, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë 1998.
- Malnar Dario, *SHBA dhe Kosova*, Prishtinë 2013.
- Merovci Adnan, Fakte (Emission dokumentar) *Vizita historike e delegacionit amerikan në krye me senatorin Bob Doll, 1990*, Pjesa 1, 21 dhjetor 2021
- Merovci Adnan, Fakte (Emission dokumentar) *Vizita historike e delegacionit amerikan në krye me senatorin Bob Doll, 1990*, Pjesa 1, 21 dhjetor 2021.
- Merovci Adnan, Fakte (Emission dokumentar), *Vizita e kongresistëve Tom Llantos dhe Xho Diogardi në Kosovë, 1990*, Pjesa 1, 6 dhjetor 2021.
- Meta Beqir, “Konteksti ndërkombëtar i rezistencës paqësore të shqiptarëve të Kosovës i udhëhequr nga Presidenti Rugova në vitet e 90-ta”, botuar në Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit, ASHAK, Prishtinë 2019.
- Mustafa Isa, “*Dhuna si mjet për arritjen e qëllimeve politike*”, botuar në Gjenocidi dhe masakrat e Serbisë në Kosovë (1998-1999), ASHAK 2023.
- Phillips L. David, *Çlirimi i Kosovës*, Diplomacia Këmbëngulëse dhe nderhyrja e SHBA-ve, Tetovë 2015.
- Schmit Jens Oliver, *Kosova histori e shkurtër e një treve qëndrore ballkanike*, Prishtinë 2012.
- Shatri Bajram, *Arsimi Shqip në Kosovë 1990-1999*, Shtepitë Shkolla, sfidat, arritjet dhe aspiratat, Prishtinë 2010.
- Shatri Bajram, *Arsimi dhe shkollat e mesme në Kosovë në shekullin XX*, Zhvillimi i arsimit në shekullin XX, vëll. 1,2,3,4,5, Prishtinë 2019.
- Tahiri Edita, *Diplomacia e Kosovës në periudhën e okupimit*, Kumtesë e lexuar në Simpoziumin shkencor “Çlirimi i Kosovës”, mbajtur më 12 qershor 2009 në Prishtinë.
- Weller Marc, *Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë 2009.
- www.zeriamerikes.com, “Marrëveshja e Dejtonit, vështrim retrospektiv nga aktorët kryesorë“.

Hajredin Kuçi

## REFLEKSIONE POLITIKO-JURIDIKE DHE HISTORIKE PËR REAGIMIN NDËRKOMBËTAR NDAJ KRIZËS SË KOSOVËS <sup>1</sup>

### 1. Hyrje

Është një përpjekje për të pasqyruar veprimet kryesore diplomatike të bashkësisë ndërkombëtare ndaj kërkesave të shqiptarëve të Kosovës dhe zhvillimeve në Kosovë nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë deri në ndërhyrjen ushtarake të NATO-s si kulmi i reagimit ndërkombëtar.

Krizat e krijuara në ish-botën komuniste dhe në ish-Jugosllavi në veçanti janë refleksion i marrëdhënieve midis Lindjes dhe Perëndimit, si dhe zhvillimeve të brendshme me pakënaqësi në drejtim të barazisë kombëtare, sociale, identiteteve dhe çështjeve të tjera të barazisë dhe prirjeve për dominim. Natyrisht, problemet territoriale dhe ato kombëtare ishin më të pranishmet, duke mos përjashtuar problemet e tjera të përmendura më lart. Rënia e komunizmit ishte një rast i mirë për zgjidhjen e këtyre problemeve apo edhe për t'i thelluar ato. Ashtu siç dihet nga historia politike pas viteve '90, këto kriza nuk mund të zgjidheshin pa ndihmën, ndikimin apo edhe ndërhyrjen e pjesës perëndimore të botës.

Analiza e këtyre ngjarjeve në Kosovë nuk është vetëm një vështrim historik, juridik apo politik i atyre zhvillimeve, por edhe një analizë e mësimave për sjelljen e ardhshme përballë problemeve të mbetura dhe krizave eventuale që mund të krijohen.

Reagimi dhe ndihma e bashkësisë ndërkombëtare, e „Botës Perëndimore“ sikur thotë Fisher-i<sup>2</sup>, BE-ja, SHBA-ja, Kanadaja, Australia dhe Japonia – në realizimin e plotë të kërkesave tona për një shtet sovran dhe të pavarur, ishin pjesë e strategjisë politike të Kosovës të asaj kohe dhe janë të tillë edhe sot.

Bashkësia ndërkombëtare ka pasur një rol shumë të madh, më të madhin dhe më pozitivin në historinë e shqiptarëve në tërësi dhe të

---

<sup>1</sup> Ky punim është kumtesë e prezantuar në ASHAK me dt 10 qershor 2024.

<sup>2</sup> Joschka Fisher dhe Arsim Buxhovi, Vitet kuq-gjelbër: politika e jashtme gjermane-nga Kosova te 11 shtator. Botues “Koha“ Prishtinë. 2008.

Kosovës në veçanti, dhe sfiduesin më të madh deri në atë kohë pas mbarimit të Luftës së Ftohtë.

Roli i bashkësisë ndërkombëtare ka qenë me shumë ndikim në realizimin e kërkesave tona legjitime dhe legale, në vetë marrëdhëniet Kosovë-Serbi, por edhe në vendimmarrjen e aktorëve vendorë. Pra, ata ishin pjesë përbërëse e zhvillimeve, të arriturave dhe ngecjeve.

Koha e mbarimit të Luftës së Ftohtë është gjithashtu koha e hapjes së mundësisë për „ndërhyrje në punët e brendshme” të shteteve. Ky punim nuk synon të paraqesë një histori të plotë të zhvillimeve, për të cilat ka shumë autorë të huaj dhe vendas që i kanë trajtuar; ai synon të japë një pasqyrë lidhur me veprimet kryesore të aktorëve ndërkombëtarë përballë krizës së Kosovës dhe të nxjerrë mësimë për të ardhmen. Natyrisht, periudha është shumë e dendur dhe më dinamike në historinë tonë të re.

Kryesisht janë përmbledhur aktivitetet e aktorëve kryesorë, si Grupi i Kontaktit, KS i OKB-së, BE-ja dhe SHBA-ja, dhe jo të shteteve fqinje apo ndonjë shteti tjetër në veçanti. Në aspektin kohor, janë trajtuar aktivitetet gjatë dy periudhave: e para, ajo e politikës paqësore, që zgjat deri në mars të vitit 1998, dhe e dyta, pas shpërthimit të luftës së armatosur në Kosovë deri në fillim të vitit 1999.

## 2. Reagimet ndërkombëtare në kohën e politikës paqësore (1991-Mars 98)

Rënia e komunizmit hapi mundësinë e shpërbërjes së ish-Bashkimit Sovjetik dhe ish-Jugosllavisë, duke rritur shpresat e shqiptarëve të Kosovës për realizimin e qëllimeve politike për një shtet sovran dhe të pavarur.

Kosova ishte një prej njësive federale që, në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, kishte dy ndikime: e para, ajo ndikoi në shpërbërje dhe, e dyta, shpërbërja ndikoi në Kosovë. Zhvillimet në Kosovë, sidomos nga viti 1981, përfshinin reagimin politik të qytetarëve shumicë në Kosovë, shqiptarëve, për barazi me njësitë dhe kombet e tjera në atë federatë, si dhe shtypjen përmes dhunës fizike nga regjimi i ish-Jugosllavisë. Kjo periudhë përfshinte një "unitet" jugosllav, të formësuar nga politika shoviniste serbe për shtypjen dhe dhunën ndaj kërkesave dhe bartësve të tyre, por edhe ndaj kombit shqiptar në ish-Jugosllavi. Po ashtu, dhuna institucionale iu bashkëngjiti dhunës fizike ndaj popullit të Kosovës, duke sjellë ndryshime jokushtetuese dhe të dhunshme; në vend që të

avancohej statusi i shqiptarëve në ish-Jugosllavi si komb dhe i Kosovës në nivel Republike, ndodhi e kundërta – kërkesat legjitime jo vetëm që u shtypën me dhunë, por edhe statusi juridik dhe politik i Kosovës dhe i shqiptarëve u degradaa.

Ndryshimet e dhunshme dhe joligjore të statusit të Kosovës më 23 mars 1989 prishën balancën në ish-Federatën Jugosllave dhe për pasojë u forcua roli i Serbisë në kontrollin e Federatës. Kjo situatë bëri që Republika e Sllovenisë fillimisht, e më pas edhe njësitë e tjera, ta shihnin veten si "prenë" e ardhshme të nacionalizmit dhe shovinizmit serb, që kishte qëllime më të mëdha se vetëm shkatërrimi i autonomisë së krahinave dhe dëmtimi i statusit kombëtar të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Reagimi i tyre i mëvonshëm, qoftë politik në nivel federate, apo aktet politike të pavarësimit, e madje edhe lufta, përshpejtuan shpërbërjen e ish-Federatës Jugosllave. Këto zhvillime nuk janë objekt trajtimi në këtë punim, por ky sqarim i shkurtër tregon se, në fakt, rrënjët e konfliktit të ish-Jugosllavisë ishin në Kosovë, e po ashtu Kosova përfitoi nga këto veprime të ish-republikave jugosllave.

Nuk mund të thuhet se ishte vetëm një faktor në krizën e Kosovës, por shumë autorë si Jon Parry<sup>3</sup>, theksojnë se Millosheviqi ka qenë në zemër të shumicës së problemeve. Veprimet e tij ishin opresive, nga të cilat ndodhi radikalizimi i shqiptarëve të Kosovës, thekson një raport i MPJ-së së Britanisë së Madhe ne vitin 2000<sup>4</sup>. Natyrisht, nacionalizmi serb ishte burimi i krizave dhe konflikteve, deri në luftë të armatosur me Kosovën dhe të tjerët. Nëse analizojmë zhvillimet politike, por edhe „produktet” intelektuale të Serbisë që nga viti 1912 e tutje, shohim se ky mentalitet nationalist ka prodhuar njerëz si Millosheviqi për të realizuar synimet e tyre, dhe jo e kundërta.

Reagimet diplomatike ishin prezente që nga viti 1990 ndaj zhvillimeve në Kosovë, me intensitet dhe forma të ndryshme, dhe çështja e Kosovës hyri gjerësisht në arenën ndërkombëtare, sidomos për shkak të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe jo si problem i të drejtave politike dhe statusit territorial<sup>5</sup>.

Mund të themi se ishte një qasje jo e drejtë, ngase veprimet dhe masat nuk ishin të mjaftueshme, pasi nuk ndryshoi gjendja për gati 10 vjet. Po ashtu, dekurajoi palën e Kosovës që problemet të zgjidhen në

---

<sup>3</sup> Jon Parry, *The Politics of Patriotism*, Cambridge University Press, UK.2006;

<sup>4</sup> Raport i MPJ te Britanise se Madhe per Kosoven,2000, QC 5-6.

<sup>5</sup> H. Kuçi, Reagimi i bashkësisë ndërkombëtare ndaj krizës së Kosovës 1991-mars 1999, „E drejta“ Nr.4/2003. Fakulteti Juridik-Universiteti i Prishtinës.fq.81-111.

mënyrë paqësore dhe inkurajoi palën serbe për shtypjen e kërkesave politike (reale) të shqiptarëve të Kosovës.

## 2.a. Reagimi i Bashkësisë Ekonomike Evropiane (BEE), pastaj i Unionit Evropian (UE)<sup>6</sup>

Qëndrimi i BEE-së ishte fillestar dhe më i rëndësishëm në kohën e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë<sup>7</sup> Në vitet e para të fillimit të viteve '90, është vërejtur një injorim në një masë, zvogëlim i rëndësisë së çështjes dhe mohimi i të drejtave të Kosovës. Përfaqësuesit e Kosovës nuk u ftuan në Konferencën për Jugosllavinë, e cila u thirr në Hagë nga Lordi Carrington në shtator 1991. Në dhjetor të vitit 1991, BEE-ja refuzoi të njihnte kërkesën e shqiptarëve të Kosovës për pavarësi<sup>8</sup>.

Më 16 dhjetor të vitit 1991, kur BEE, përmes Mendimeve të Bandinterit<sup>9</sup>, ofroi të njohë pavarësinë e republikave që e kërkonin atë, refuzoi kërkesën e Kosovës për pavarësi, duke u bazuar në Parimet mbi Njohjen e Shteteve të Reja në Evropën Lindore dhe Bashkimin Sovjetik, që ishte një interpretim i parimit të vetëvendosjes.

Ky qëndrim jo vetëm që mohoi të drejtën dhe refuzoi kërkesën e Kosovës për pavarësi, por ndikoi shumë në orientimet e bashkësisë ndërkombëtare ndaj krizës së Kosovës, duke dëmtuar rëndë statusin e Kosovës për vite me radhë. Nga çështje e kërkesave politike, të drejtave etnike dhe territoriale, Kosova u trajtua si çështje e të drejtave të njeriut.

Në vitin 1996, në prill, shtetet anëtare të BE-së vendosën të njohin ish-Republikën Federale të të Jugosllavisë<sup>10</sup>, duke injoruar qoftë edhe të drejtën për autonomi për Kosovën, që në një mënyrë ishte bërë politikë zyrtare e BEE-së në atë kohë. Duket se sigurimi i kooperimit të Millosheviqit për Bosnjën kishte pasur prioritet, me mundësi për leshime përballë kërkesave të Kosovës.

<sup>6</sup> Bashkësia Ekonomike Evropiane(BEE) mbante këtë emër deri në vitin 1993 në Marrëveshjen e Mastroitit, kur ndërron emrin në Union Evropian (EU) ndërsa me Traktatin e Lisbonës bëhet një etnitet juridik. Përdorimi i emrit është sipas kohës së ndërmarrjes së aktiviteteve.

<sup>7</sup> Edhe organizmii i konferencave edhe Komisioni i Bandinterit

<sup>8</sup> H. Kuçi, Vep. E cit.fq.85

<sup>9</sup> Po aty

<sup>10</sup> Njohja ishte për RFJ-në, shtet i ri i formuar pas shpërberjes se ish RSFJ-së, pra njohja përfshinte shtetin e ri i cili përbëhej nga: Serbia, Mali i Zi duke përfshirë edhe Kosovën dhe Vojvodinën. Ky shtet më vonë u shpërbë duke u pavarësuar Mali i Zi fillimisht e pastaj edhe Kosova. Po aty fq.86

Plani më serioz evropian ishte ai i shtatorit të vitit 1997, plani Franko-Gjerman (Kinkel- Vedrin)<sup>11</sup>, i cili u refuzua nga pala serbe. U bënë edhe tri takime në vitin 1997, por jo në nivel formal dhe pa sukses. Ndërkohë, hendeku mes Kosovës dhe Serbisë po thellohej.

Mund të theksojmë se reagimi i Evropës në vitet '90 ishte pasiv, ndërsa reagimi ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut nga Millosheviqi ishte i vonuar dhe pa vendosmëri. Po ashtu, mund të themi se është vërejtur që qysh në vitin 1991, me rënien e Bashkimit Sovjetik, mund të ndodhnin konflikte në Evropën Lindore, por ato nuk paraqisnin rrezik që të zgjeroheshin në Perëndim, dhe kjo ndikoi që të mos e kishte vëmendjen e duhur.

## 2.b. Reagimi i SHBA-së

Të dy palët i kanë përcjellë me kujdes reagimet e SHBA-së në këtë periudhë. Reagimi më serioz ishte ai i dhjetorit 1992 nga ish-Presidenti Bush: "Në rast të konfliktit në Kosovë, të shkaktuar nga veprimet e Serbisë, SHBA-ja do të jetë e gatshme ta përdorë forcën ushtarake ndaj serbëve në Kosovë dhe brenda Serbisë".<sup>12</sup> Një kërcënim të ngjashëm ka bërë edhe Presidenti Klinton në mandatin e tij të parë.<sup>13</sup> Ka autorë që mendojnë se për qëllime të brendshme, politikanët kosovarë e interpretonin mbështetjen për të drejtat e njeriut si mbështetje për pavarësinë nga ana e amerikanëve në atë kohë.

SHBA-ja ka mbajtur një qëndrim të fortë ndaj sanksioneve, duke përjashtuar Jugosllavinë nga institucionet financiare ndërkombëtare<sup>14</sup>. Këto sanksione, megjithatë, nuk ishin të unifikuara nga Bashkësia Ndërkombëtare dhe ishin të paefektshme. Disa mendime, si ai i Tihomir Loza<sup>15</sup> sugjerojnë se edhe sikur sanksionet të ishin më të plota, ato përsëri nuk do të ishin të mjaftueshme për të zgjidhur krizën e Kosovës përmes sanksioneve financiare ndërkombëtare. Deri në Luftën e Prekazit në fillim të vitit 1998, nuk ishin ndërmarrë hapa konkretë ose të drejtpërdrejtë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

Nëse e analizojmë me kujdes, pozicioni zyrtar i Washingtonit dhe Evropës Perëndimore në atë kohë ishte rritja e statusit brenda ish-RFJ-

---

<sup>11</sup> Po aty

<sup>12</sup> Kosovo Spring...fq 24

<sup>13</sup> Po aty

<sup>14</sup> H. Kuçi, vep e cit.fq.88

<sup>15</sup> Tihomir Loza, vep e cit.p.4

së, ndërsa pas Luftës dhe masakrës së Prekazit kërkuan një zgjidhje që do të përfshinte diçka në mes të autonomisë dhe Republikës së Kosovës brenda RFJ-së. Vlen të theksohet se Washingtoni, në vitin 1996<sup>16</sup>, ka hapur Zyrën e Përfaqësisë në Prishtinë, e cila ka ndihmuar në monitorimin e ngjarjeve, artikulimin e kërkesave, por edhe në rritjen e nivelit të interesimit të tyre për Kosovën.

Marrëveshja e Dejtonit<sup>17</sup> krijoi një precedent jo të mirë për popullin e Kosovës, pasi u pa se përdorimi i forcës mund të jepte rezultate, dhe pastrimi etnik mund të ishte realizim i qëllimeve politike. Kjo hoqi iluzionet se përmes politikës paqësore mund të arriheshin qëllimet politike, siç thekson Fabian Shmit<sup>18</sup> në atë kohë. U mendua se kriza e Bosnjës duhej të zgjidhej aty dhe jo të trajtoheshin të gjitha çështjet e ish-Jugosllavisë, sipas disa pjesëmarrësve. Gjatë kësaj periudhe, janë bërë përpjekje për normalizimin e çështjeve të arsimit përmes ndërmjetësimit të Sen Egjidios<sup>19</sup>.

Në këtë periudhë të politikës paqësore, SHBA-ja ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe në kuadër të Grupit të Kontaktit, OKB-së dhe NATO-s. Grupi i Kontaktit u themelua gjatë krizës së Bosnjës<sup>20</sup> dhe, me kërkesë të OKB-së, çështja e Kosovës u shqyrtua për herë të parë në shtator të vitit 1997.

Në Deklaratën e Grupit të Kontaktit, më 24 shtator 1997<sup>21</sup>, theksohet ndër të tjera: “Nevoja për implementimin e marrëveshjes së arsimit, zgjidhja paqësore e problemeve dhe me dialog brenda kufijve të

<sup>16</sup> Zyra në Kosovë është kuptuar si rritje e statusit të interesimit të SHBA-së për Kosovën.

<sup>17</sup> Konferencë e organizuar në Dejton SHBA në nëntor 1995 që përfundoi luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë

<sup>18</sup> Fabian shmit *Teching wrong lessons in Kosova.* "Transition". Vol.2.No.14 July 1996 p.37

<sup>19</sup> San Egjidios, ishte organizoate religjioze e cila ndohmoi për arritjen e marrëveshjes për normalizimin e arsimit të shqiptarëve të Kosovës e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë më 2 shtator 1996. Kjo Marrëveshje kishte më shumë ndikim në uljen e tensioneve sesa në përmirësimin e gjendjes në arsim edhe pse u bënë disa hapa simbolikë si p.sh. Kthimi i studentëve të UP-së në disa prej objekteve të tyre.

<sup>20</sup> Grupi i Kontaktit ishte një organizim joformal i SHBA-së, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Ruisë që u themelua në kohën e krizës në Bosnjë dhe Hercegovinë, 1994, por vazhdoi edhe në vitet vijuese duke luajtur një rol me rëndësi edhe në krizën e Kosovës. Ky grupim paraqiste fuqinë ndikuese në botën ish- komuniste, përfshirë krizat në ish -Jugosllavi.

<sup>21</sup> Deklarata e Grupit të Kontaktit, Reuters 24 shtator 1997.

ish-Jugosllavisë, duke ofruar një autonomi reale për shqiptarët e Kosovës.” Po ashtu, NATO në dhjetor **1997**<sup>22</sup> ka shprehur brengosjen e saj për krizën në Kosovë.

Veprimet e atëhershme të bashkësisë ndërkombëtare mund të përshkruhen në këta objektiva: A) Përmirësimi i gjendjes humanitare në Kosovë; B) Nxitja e dialogut politik; C) Promovimi i autonomisë më të madhe për shqiptarët e Kosovës, duke ruajtur kufijtë e ish-RFJ-së; D) Ruajtja e stabilitetit rajonal; E) Dekurajimi i përdorimit të forcës për zgjidhjen e dallimeve politike<sup>23</sup>

Derisa arriti fillimi i luftës, nuk ka pasur angazhime të tjera serioze dhe është humbur mundësia e parandalimit të konfliktit para paraqitjes së UÇK-së, do të theksonte Tim Judah në vitin 1997<sup>24</sup>. Ndërsa autori turk Hasan Unal thekson: "Gjendja në Kosovë është fragjile dhe, në mungesë të kërcënimeve serioze ndaj Serbisë, lordi Owen do të duhej të negocionte për një gjenocid tjetër në Kosovë“<sup>25</sup>. Ky mendim, i shprehur në vitin 1996, fatkeqësisht nuk u mor seriozisht dhe doli i vërtetë.

### 3. Reagimet ndërkombëtare ndaj krizës së Kosovës pas shpërthimit të luftës së armatosur në Kosovë

Duhet theksuar se përpjekjet ndërkombëtare për parandalimin e luftës kanë dështuar, por po ashtu duhet theksuar se politika e jodhunës ka krijuar mundësi për të kuptuar se lufta ishte zgjidhja e fundit dhe e imponuar. Bashkësia ndërkombëtare ka përkrahur politikën paqësore në Kosovë, por jo edhe qëllimet politike të Kosovës. Andaj, mospasja e politikës paqësore për realizimin e qëllimeve politike, vazhdimi i represionit të Serbisë ndaj shumicës shqiptare të Kosovës, nxiti vullnetin për një shkallë më të lartë të sakrificës së shqiptarëve të Kosovës, për luftë të armatosur për të hequr dhunën e shtetit serb dhe për të realizuar qëllimet politike për një shtet sovran dhe të pavarur, por edhe për të fituar përkrahje ndërkombëtare, aq shumë e nevojshme për arritjen e këtyre qëllimeve.

Në shqyrtimet e mëtejshme, por edhe në zhvillimet politike e ushtarake në Kosovë dhe jashtë saj, vërejmë se këto synime, pavarësisht

---

<sup>22</sup> Shih: [www.Nato.int](http://www.Nato.int)

<sup>23</sup> H.Kuçi, Vep. E cit.fq.90

<sup>24</sup> Tim Judah, Vep. E cit. Fq.36

<sup>25</sup> Hasan Unal, Trop de Zele. The National Interest No.43 Spring 1996 p.95

nga vuajtjet dhe humbjet e mëdha, shqiptarët e Kosovës i arritën. Dalja publike e UÇK-së në nëntor 1997<sup>26</sup> hoqi misticizmin për të. Pas këtij akti, dhe sidomos pas Luftës dhe masakrës së Prekazit, lufta mori hov. Siç thekson z. Sabri Godo<sup>27</sup> në atë kohë Kryetar i Komisionit për Politikën e Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë: „Kjo shënon përfundimin e politikës paqësore në Kosovë.“

Mossuksesi i politikës pa dhunë dhe status quo-ja, si dhe mungesa e mbështetjes ndërkombëtare, krijuan përshtypjen që një epror anonim i UÇK-së, më 23 mars në gazetën Bujku<sup>28</sup>, thotë: „Ne kemi mësuar se dhuna jep efekte. Kjo është e vetmja rrugë në këtë pjesë të botës për të fituar atë që dëshironi dhe për të pasur vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare.“ Në një mënyrë, edhe ambasadori Petriç, ish-deleguari i BE-së për Kosovën, e vërteton në librin e tij *Rruga e gjatë në luftë*: „Çka nuk ishte e mundur të arrihej me protesta paqësore dhe mosbindje qytetare, u arrit brenda pak muajsh me anë të dhunës“<sup>29</sup>. I njëjti thotë: „Bashkësia ndërkombëtare ka vepruar në rolin e zjarrit-shuarës, për ta shuar atë, pavarësisht nga fakti që e dinte se zjarri do të ndizej“<sup>30</sup>. Afërsisht njëjtë shprehen edhe autorët vendorë, si z. Maliqi: „, Kriza në Kosovë u shfaq befasisht, por jo papritur, dhe diplomacia preventive ka arritur tek asgjëja“<sup>31</sup>.

Fillimi i luftës së armatosur, kriza paraprake në Bosnjë, frika e përshkallëzimit brenda dhe jashtë Kosovës ndikuan në vënien në lëvizje të mekanizmave ndërkombëtarë, si Grupi i Kontaktit, OSBE-ja, Këshilli i Evropës, BEE-ja, NATO-ja dhe OKB-ja.

Pas Luftës së Prekazit, zyrtarët amerikanë ishin më të zëshëm. Madeleine Albright thekson: „Ne nuk do të rrijmë të shikojmë atë që do të bëjë Millosheviqi në Kosovë, ashtu siç kanë bërë jo shumë kohë më parë në Bosnjë“<sup>32</sup>. Edhe zv/sekretari Strobe Talbott thekson: „Beogradi do të mbajë përgjegjësinë e plotë për vënien në dyshim të ekzistencës dhe rrezikimin e shtetit të tyre“<sup>33</sup>.

<sup>26</sup> Me dt 28 Nëntor 1997 në Llaushë, Skënderaj është bërë dalja publike e UÇK-së. Shih: Gazeta: „Bujku“ 29 Nëntor 1997.

<sup>27</sup> TVSH trasmentim i dt 7 Mars 1998 në orën 18:30

<sup>28</sup> Gazeta „Bujku“ 23 Mars 1998 Prishtinë fq.3.

<sup>29</sup> W.Petric dhe R.Pichler, *Rruga e gjatë në lufte-Kosova dhe Bashkësia 1989-1999*. Për botimin në gjuhën shqipe (c) kompania „Koha“ Prishtinë, 2002.fq. 89

<sup>30</sup> Po aty fq.90

<sup>31</sup> Maliqi

<sup>32</sup> Reuters 7 mars 1998

<sup>33</sup> Strob Talbot, Reuters 26 Mars 1998

### 3.a. Roli Grupit të Kontaktit – OKB-së

Herën e parë, Grupi i Kontaktit, përveç takimit të parë në shtator 1997 që theksuam, i themeluar në vitin 1994, riaktivizohet dhe më 9 mars 1998<sup>34</sup> nxjerr deklaratë për Kosovën, ku ndër të tjera theksohet: tërheqja e njërive speciale nga Kosova brenda dhjetë ditëve, të lejohej prania ndërkombëtare, të fillonte dialogu, të lejohej misioni i OSBE-së dhe i dërguarit Felipe González, etj.

Nëse analizohet deklarata, vërehet se mbështetet rritja e statusit të Kosovës brenda Jugosllavisë. Nuk mbështet pavarësinë, por as statusin e quajti. Kishte dallime midis SHBA-së dhe MB-së për masa më radikale se të tjerët.

Këto qëndrime sollën Rezolutën 1160 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Më 3 Mars 1998<sup>35</sup>, është hera e dytë që Këshilli i Sigurimit të OKB-së diskuton për Kosovën (herën e parë në vitin 1993 për misionin e OSBE-së).

Rezoluta bazohet në qëndrimet e Grupit të Kontaktit të nxjerra në mbledhjet e 9 dhe 25 marsit 1998 dhe të 11 marsit të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së në Vjenë. Si pika më të rëndësishme janë: nxitja e dialogut, kthimi i misionit të OSBE-së, pranimi i pranisë ndërkombëtare, autorizohet zyra e Prokurorit të Tribunalit Ndërkombëtar që të veprojë sipas Rezolutës 827 (1993) të 25 majit 1993, për të filluar mbledhjen e informacionit për dhunën në Kosovë, si dhe obligon autoritetet e Beogradit të bashkëpunojnë. Në këtë rezolutë i premtohet RFJ-së që, nëse shënon progres për të drejtat e njeriut në Kosovë, do të hiqen masat financiare, përndryshe do të mbeten të aplikueshme.

Kjo rezolutë ka pasur efekt politik më shumë se praktik. P.sh., embargo ndaj armëve, serbët e përshkruanin sikur t'i ndalohej Arabisë Saudite importi i naftës<sup>36</sup>

Më 29 prill 1998<sup>37</sup> u mbajt mbledhja e Grupit të Kontaktit, ku u propozuan masa shtesë pas Rezolutës 1160, por u kërkua edhe nga shqiptarët të distancoheshin nga dhuna.

---

<sup>34</sup> Grupi i Kontaktit 9 Mars 1998

<sup>35</sup> Shih: Reuters. Mbledhja e KS të OKB-së 31 Mars 1998

<sup>36</sup> Shih më shumë: H. Kuçi, vep. e cit. fq. 91

<sup>37</sup> Shih: Deklarata e Grupit të Kontaktit, publikuar në gazetën: “Bujku“ dt 30 Prill 1998.

Politika e Kosovës bëri përpjekje duke krijuar Grupin për Negociata më 23 mars 1998<sup>38</sup> edhe pse pa përfaqësues të UÇK-së. Nga ana tjetër, pala serbe organizoi një referendum për mosndërhyrje në punët e brendshme më 23 prill 1998, duke dëshiruar ta trajtonte këtë si çështje të brendshme.

Gjatë muajve të verës pati një paqe ndërkombëtare, por gjithashtu një përshkallëzim të gjendjes me shumë vrasje (më shumë se 2000 civilë) dhe zhvendosje, si dhe dëme materiale. Dikush mund ta mendonte si një testim të mbijetesës së UÇK-së. Ambasadori amerikan Hill, fillimisht, pastaj Petrich-i, dhe herë pas here Hoolbrooke, patën angazhime<sup>39</sup>.

Rezoluta 1199 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së<sup>40</sup> është vazhdimësi e angazhimeve të Grupit të Kontaktit dhe OKB-së ndaj zhvillimeve në Kosovë. Kjo rezolutë është bazuar në qëndrimet e Grupit të Kontaktit të datave 12 qershor 1998 dhe 8 korrik 1998. Ishte një ftesë për armëpushim dhe dialog politik. Edhe kjo rezolutë pati fatin e asaj paraprake, si në kuptim politik, ashtu edhe në kuptim praktik.

### *3.b. Marrëveshja Holbrooke-Milloshëviq – 13 tetor 1998<sup>41</sup>*

Ishte angazhimi më serioz për implementimin e rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kërkesa për armëpushim, tërheqje të trupave në kazerma, qasjen e organizatave ndërkombëtare humanitare, bashkëpunim me hetuesit ndërkombëtarë, etj. E veçantë ishte pranimi i misionit prej 2000 anëtarësh të OSBE-së, mbikëqyrja e hapësirës ajrore mbi Kosovën nga NATO-ja, ofrimi i një vetëqeverisjeje, etj. Ishte marrëveshja më serioze deri atëherë. Për këtë qëllim, Sekretari i NATO-s, z. Solana, dhe z. Clark shkuan në Beograd më 15 tetor 1998<sup>42</sup> për të kërkuar implementimin dhe për të bërë me dije gatishmërinë për veprim nëse nuk kryheshin obligimet. Kjo Marrëveshje nuk ofroi një zgjidhje të

<sup>38</sup> Pala kosovare ka themeluar grupin: G-15 për negociata me përfaqësues të spektrit politik dhe të shoqërisë civile, por pa përfaqësuesit e UÇK-së.

<sup>39</sup> Janë bërë disa takime në Prishtinë dhe në Beograd me qëllim të arritjes së ndonjë marrëveshjeje, por pa sukses.

<sup>40</sup> Rezoluta e miratuar në takimin 3930 të 23 shtatorit 1998. E publikuar në mjetet e informimit të përditshëm si „Koha“ „Bujku“ etj.

<sup>41</sup> Marrëveshja Holbrooke-Milloshëviq e nënshkruar në Beograd me dt 13 tetor 1998 e publikuar në mjetet e informimit të kohës dhe pastaj në shumë dokumente zyrtare, artikuj dhe libra.

<sup>42</sup> Shih Reuters 15 tetor 1998

përgjithshme për Kosovën, por zvogëloi intensitetin e konfliktit. Marrëveshjet e përmendura morën ngjyrën e formulës juridike me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1203<sup>43</sup>, më 24 tetor 1998.

Duhet theksuar se të gjitha këto marrëveshje, edhe pse lidhen me Kosovën, nuk përfshijnë pjesëmarrjen direkte të palës kosovare dhe njohën sovranitetin e RFJ-së.

Misioni i OSBE-së bëri shumë angazhime, por më 20 mars 1999 u tërhoq nga Kosova<sup>44</sup>. Ky mision nuk mund të shihet si i dështuar, por si një mision me mandat të kufizuar dhe më shumë si raportues për zhvillimet në Kosovë. Ka autorë që mendojnë se ky mision mundësoi rimëkëmbjen e UÇK-së, por ka të tjerë që thonë se shtyu intervenimin e NATO-s. Në çdo rast, është një mision unik dhe përtej misioneve që organizon OSBE-ja në mandatin e saj.

Zhvillimet e luftës në Kosovë, por edhe dhuna sistematike dhe masakrat e Serbisë kundër popullsisë civile deri në shkallë gjenocidi, sollën angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare për organizimin e Konferencës në Rambuje<sup>45</sup>. Para saj u ofruan 4 plane nga ambasadori Hill, i deleguari i SHBA-së, që ishin edhe testim të opinionit në Kosovë dhe Serbi më shumë. Konferenca u mbajt nga 6 deri më 23 shkurt 1999, ku pjesëmarrës ishin përfaqësuesit e Grupit të Kontaktit dhe palët perkatëse. Pala kosovare e pranoi marrëveshjen me aneksin e implementimit më 15 mars 1999, që ndër të tjera parashikonte prezencën ndërkombëtare në Kosovë.

Nënshkrimi zyrtar u bë më 18 mars 1999 dhe dështimi u publikua më 19 mars për fajin e palës serbe. U bënë përpjekje për të bindur palën serbe për praninë dhe në fund erdhi konstatimi për bombardimet, ku Bill Clinton, Presidenti i SHBA-së, theksoi: „Nëse Milosheviqi nuk ka vullnet të krijojë paqen, ne kemi vullnet ta pengojmë luftën e tij“. Fillimi i bombardimeve të NATO-s kundër trupave paramilitare dhe ushtarake të Serbisë ishte kulmi i angazhimit ndaj krizës së Kosovës. Angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare gjatë bombardimeve të NATO-s dhe më pas, deri më sot dhe ndoshta në të ardhmen, është dhe mund të jetë objekt studimi për çdo autor, shqiptar apo të huaj.

---

<sup>43</sup> Rezolutë e miratuar nga KS i OKB-së 24 tetor 1998 e publikuar në mjetet e informimit ditor si “Bujku“ „Koha“ „Reuters“ etj.

<sup>44</sup> Pas presionit të Serbisë dhe veprimeve represive të saj ndaj shqiptarëve të Kosovës nga krimet e luftës deri në shkallë gjenocidi bashkësia ndërkombëtare vendosi ta tërheqë këtë mision dhe ta përgatisë terrenin për reagim më të ashpër atë të NATO-s.

<sup>45</sup> Konferenca e Rambujës

## 4. Përfundime

Nga analiza e ndikimit ndërkombëtar në krizën e Kosovës, qoftë ndikim politik, ushtarak apo ekonomik, ose misione, tregohet një përvojë se kushdo që ka pranuar dhe nënshkruar propozimet e tyre nuk i ka fituar të gjitha, por ata që nuk i kanë nënshkruar i kanë humbur të gjitha. Shihet gjithashtu se synimet tona kanë qenë më të mëdha sesa mbështetja ndërkombëtare. Sikurse edhe këto të arritura ishin sfiduar pa një mbështetje që mund ta quajmë të balancuar, herë-herë në simetri me kërkesat tona.

Palët kanë bërë veprime përballë faktorëve ndërkombëtarë, pala shqiptare duke respektuar kërkesat e tyre, shpesh duke vënë në provë autoritetin e tyre dhe qëllimet politike të shqiptarëve, ndërsa pala serbe ka bërë të kundërtën. Këto veprime, pa dilemë, kanë pasur ndikim pozitiv në vendimet e bashkësisë ndërkombëtare përballë Kosovës.

Pas vitit 1990 është hapur koha postkonfliktuozë dhe janë hapur mundësitë për ndikim dhe integrim në Bashkimin Evropian dhe NATO të Ballkanit Perëndimor, por edhe mundësia për ndikim të BE-së dhe SHBA-së, respektivisht NATO-s, në rajon. Luftërat në Ballkan kanë qenë një ndër rastet më të shprehura kur komuniteti ndërkombëtar nuk ka gjetur gjuhë të përbashkët sa i përket intervenimit potencial. Debatimi në Këshillin e Sigurimit shpesh e dëshmon këtë.

Ka autorë që, kur analizojnë krizat në Ballkan dhe përgjigjen e Evropës, konsiderojnë se Ballkani ka lëvizur disponimin e Evropës nga ajo që Fukuyama thotë "end of history" në "clash of civilizations" të Huntingtonit. Ndoshta shpërbërja relativisht e qetë e Bashkimit Sovjetik dhe bashkimi i Gjermanisë krijoi një nënvlerësim të Evropës për nacionalizmat në ish-Jugosllavi, në veçanti ai i Milosheviqit, dhe këtu pa dilemë ishte me ndikim edhe mendimi i Badinterit si qasje për shpërbërjen paqësore.

Gjenocidi në Bosnjë dhe pastaj në Kosovë ka prishur këtë perceptim të Evropës për shpërbërje paqësore. Moszgjidhja e problemeve dhe ngecja e proceseve integruese ka ndërthurur ambient për nacionalizëm, por edhe për ndikim të faktorëve të tjerë jashtë BE-së dhe SHBA-së, që do të thotë Ruisë dhe të tjerëve. Në Ballkan, dhe veçanërisht në Bosnjë dhe Kosovë, angazhimi më i madh ka qenë në krijimin e paqes dhe rehabilitim. Në shtetet fragjile mundësia e ndikimit është më e

madhe. Ka autorë që theksojnë se angazhimi i BE-së ka qenë në procesin e ndërtimit të paqes, ndërsa në fakt procesi integruar është më shumë se ai i paqes dhe parandalimit të konflikteve. Sikurse thekson Johana Deimel<sup>46</sup> nga Munihu, Ballkani dhe Kosova në veçanti kanë ndikim direkt në marrëdhëniet BE-Rusi. Është përshtypja sikur në Evropë nuk vërehet kërcënimi i jashtëm i Rusisë në Ballkan, sikurse në Evropën Qendrore, të cilat me çdo kusht janë integruar në BE. Kërcënimi në Ballkan më shumë trajtohet si konflikt nga fqinjët e menjëherëshëm në rajon, ose si rezultat i tensioneve etnike. Ndoshta vitet e fundit, pas fillimit të luftës Ukrainë-Rusi, ka filluar të vërehet ky ndikim në deklaratat e ndryshme të zyrtarëve evropianë dhe amerikanë. Memoria e ish-Jugosllavisë, kur kanë shkuar ndaras nga blloku sovjetik dhe kanë përfutur nga Perëndimi një trajtim të privilegjuar, është gjithashtu një faktor kyç. Është politika e shkopit dhe e karotës, që krijon përshtypjen se ato shtete që kanë alternativë, në këtë rast Rusinë, krijojnë balancë më lehtë. Në këtë rast, Serbia sillet si fëmija i prindërve të divorcuar mes Brukselit dhe Moskës.

Nën udhëheqjen e SHBA-së, roli i evropianëve është komplementar. SHBA-ja e ka bërë Evropën të veprojë në mënyrë unike në shumë raste. Kjo do të zgjasë derisa bota të jetë monopolare. Robert Kagan, në librin "Bota që krijoi Amerika"<sup>47</sup>, thotë: „Kur të bjerë Perandoria e SHBA-së, aleatët e saj, nëse jo më herët, bien njëkohësisht me të“. Në shekullin 21 mund të dalin edhe fuqi të reja, por është përgjegjësi që të ruhet rendi i krijuar. Harta e Ballkanit asnjëherë nuk ka qenë neutrale, thotë Harley<sup>48</sup> në librin e tij *Dekonstrukt i Hartave*. Po ashtu, edhe hartat mentale dhe konstruktivet kolektive sociale kanë ndryshuar gjatë gjitha kohërave, shkruan Schenk-u në librin *Hartat Mentale*. Ka autorë që thonë se Evropa nuk paramendohet pa pjesën orientale, Ballkanin apo të tjerë. Vetëm në kokat e akademikëve të teoricienëve të marrëdhënieve ndërkombëtare mund të jetë zero-sum game, ngase në jetën reale në Evropën e shekullit 21, secili shikon të fitojë diçka.

---

<sup>46</sup> Johana Deimel, SEE in Focus: External Non-EU Actors-Russia. No.1/2019

<sup>47</sup> Robert Kagan, Bota që krijoi Amerika. Botues.IDK.2013.fq.175

<sup>48</sup> JB Harley, Deconstructing the map, "Cartographica Vol.No.2 Summer 1989 USA.pp.1-20



Bekim Baliqi

TRANSFORMIMI I SOVRANITETIT NË  
MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE PAS  
NDËRHJRJES SË NATO-S: NGA INTERVENIMI  
HUMANITAR NË ‘PËRGJEGJËSINË PËR TË  
MBROJTUR’

Abstrakt

Ky artikull elaboron ndikimin e thellë dhe shumëdimensional të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë në konceptimin e sovranitetit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Më tej punimi argumenton se ndërhyrja sfidoi nocionin konvencional të sovranitetit shtetëror, duke i hapur rrugë një rikonceptualizimi të sovranitetit dhe duke rishqyrtuar njëkohësisht dimensionet ligjore, politike dhe etike të intervenimit humanitar. Artikulli tutje diskuton rolin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe rezolutat kryesore të saj, të cilat dënonin dhunën, përligjen nevojën për ndërhyrje dhe miratuan praninë e misionit ndërkombëtar civil dhe ushtarak në Kosovë. Ndërhyrja e NATO-s po ashtu çoi në shfaqjen e doktrinës së ‘përgjegjësisë për të mbrojtur’, e cila ripërcaktoi sovranitetin si përgjegjësi. Sipas kësaj doktrine, sovraniteti nuk i mbron më shtetet nga ndërhyrjet e jashtme, por i mban ata përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut. Kjo ndërhyrje ka ripërcaktuar parametrat e sovranitetit shtetëror dhe rolin e bashkësisë ndërkombëtare në parandalimin e mizorive masive nga ana e shtetit. Për më tepër rasti i Kosovës shërben si një rast studimor i veçantë për të kuptuar ndërlikimet dhe implikimet e ndërhyrjes humanitare, sovranitetin dhe normat në zhvillim të qeverisjes globale që ka prioritet respektimin e drejtave të njeriut para parimeve rigjide të sovranitetit, siç ishte mosndërhyrja e integriteti territorial. Përfundimisht çështja u zhvendos nga e drejta për të intervenuar në përgjegjësinë për të mbrojtur për bashkësinë ndërkombëtare, duke forcuar nevojën për bashkëpunim dhe koordinim më të vendosur të bashkësisë ndërkombëtare në adresimin dhe parandalimin e krizave humanitare në të ardhmen.

*Fjalët çelës: Ndërhyrja humanitare, sovraniteti, përgjegjësia për të mbrojtur, NATO, Kosova.*

## 1. Hyrje

Ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999, pati ndikim thelbësor në nocionin dhe parimin e sovranitetit në marrëdhëniet dhe në të drejtën ndërkombëtare. Duke sfiduar kështu kuptimin konvencional të sovranitetit, si e drejta absolute e një shteti për të ushtruar autoritetin e tij të brendshëm pa ndërhyrje të jashtme nga ndonjë shtet apo bashkësia ndërkombëtare. Prandaj, ky intervenim humanitar e ri-konceptoi sovranitetin si një përgjegjësi e shtetit për të mbrojtur të drejtat e njeriut.

Sikurse edhe i tejkaloi kufizimet e parimit të mosndërhyrjes në punët e brendshme të një shteti, atëherë kur shteti nuk arrin të përmbushë përgjegjësinë e tij për të mbrojtur qytetarët e vet. Debati në marrëdhënie dhe në të drejtën ndërkombëtare i nxitur me rastin e ndërhyrjes së NATO-s, u zhvendos nga e drejta e shteteve për të intervenuar, në përgjegjësinë e bashkësisë ndërkombëtare për të mbrojtur popullatën civile nga rrezikimi prej vrasjeve sistematike dhe mizorive masive në ndonjë shtet të caktuar.

Intervenimi humanitar në Kosovë ishte një pikë referimi në këtë drejtim. Pavarësisht se i mungonte baza legale, pra një mandat i qartë i Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ajo u dëshmuar se ishte plotësisht legjitime. Sepse gjendja në Kosovë ishte bërë një krizë e vërtetë humanitare dhe rrezikimi nga gjenocidi ishte evident. Kjo ndërhyrje u pa e nevojshme për shkak të dështimit të rezolutave të OKB-së dhe misioneve verifikuese të OSBE-së në parandalimin e krimeve të kryera nga forcat serbe, siç dëshmohet edhe nga masakra në fshatin Reçak. Ndërhyrja e NATO-s ngriti çështjen dhe hapi debate për natyrën e ndërhyrjes humanitare dhe lidhjen e saj me konceptin e sovranitetit. Për më tepër, ky rast u bë shkas për zhvillim të debatit në të drejtën ndërkombëtare, veçanërisht në afirmimin e përgjegjësisë për të mbrojtur dhe ridefinimin e kufizimeve të mosndërhyrjes kur shteti nuk arrin të mbrojë qytetarët e vet. Disa vjet më vonë, saktësisht më 2011 me miratimin e Rezolutës 1973 të Këshillit të Sigurimit me të cilën u autorizua ndërhyrja humanitare në Libi, bashkësia ndërkombëtare vulosi një zhvillim afirmativ të tillë, e që kishte filluar me intervenimin e NATO-s. Ajo përbën një pikë kthese paradigmatiche në këtë kontekst, sepse përveç që sfida kufizimet nga parimi i mosndërhyrjes në punët e brendshme, krijoi njëkohësisht parakushtet për krijimin e parimit të njohur si ‘përgjegjësia për të mbrojtur’. Për më shumë, forcoi stabilitetin, paqen dhe respektimin e drejtave të njeriut në rajon dhe më gjerë. Ndërsa, tani me rastin e 25 - vjetorit të fitores së NATO-s dhe çlirimit të Kosovës, intervenimi paraqet edhe premisën e lirisë dhe të demokracisë në procesin e shtetndërtimit.

## 2. Sovraniteti si koncept dhe parim në marrëdhëniet ndërkombëtare

Pas ndërhyrjes ushtarake të NATO-s kundër ish-Jugosllavisë, nocioni i sovranitetit pësoi ndryshime thelbësore duke e sfiduar kuptimin

konvencional të saj në shumë dimensione. Kështu, në kuptimin tradicional sovraniteti nënkupton të drejtën ekskluzive të shtetit për të pasur kontroll dhe vendosur autoritet brenda kufijve të vet. Sipas këtij kuptimi, siguria e qytetarëve brenda territorit dhe përfaqësimi i interesave të tyre jashtë saj, mund të bëhet vetëm nga ana e një shteti sovran. Marrëdhëniet ndërkombëtare bazohen në parimin e sovranitetit të shtetit. Kështu sovraniteti i jashtëm varet edhe nga njohja nga ana e shteteve të tjera, si një prejtributeve bazë të shtetësisë, bazuar në Konventën e Montevideos për të drejtat dhe detyrime të shteteve. Së këndejmi, sovraniteti përkufizohet; “(...) si praninë nga aktorët e brendshëm dhe të jashtëm që shteti ka autoritet ekskluziv për të ndërhyrë edhe me forcë në veprimtaritë dhe çështjet brenda territorit të saj.”<sup>1</sup>

Sovraniteti si parim qenësor i shtetësisë dhe temë bosht në të drejtën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare ka qenë debat i shumë punimeve shkencore që nga koha e filozofit Jean Bodin gjatë shekullit XVI, i cili e shtjellonte sovranitetin si autoritet absolut dhe të patjetërsueshme, ku monarku kishte pushtet të pakufizuar e të pacenuar nga askush, madje as nga populli. Që nga ajo kohë koncepti i tillë për sovranitetin ka evoluar mjaft shumë dhe është tejkualuar dukshëm, si zbatim të tij brenda shteteve ashtu edhe në praktikën e së drejtës ndërkombëtare. Duke iu referuar konceptit tradicional të sovranitetit vlejnjë edhe rregullat për njohjen e entiteteve si shtete të pavarura si subjekte ndërkombëtare. Ndër parimet themelore janë; ai i barazisë ligjore ndërmjet shteteve, si dhe parimi i mosndërhyrjes së një shteti në çështjet e brendshme të shtetit tjetër. Sipas autorit të mirënjohur mbi sovranitetin Stephen Krasner, ai i rendit katër lloje të sovranitetit;

- sovraniteti sipas së drejtës ndërkombëtare,
- sovraniteti Vestfalian, që bazohet mbi parimin e territorialitetit dhe mosndërhyrjen e jashtme në çështje të brendshme,
- sovraniteti i brendshëm apo vendor që i referohet organizimit formal të autoritetit politik brenda shtetit dhe aftësive të autoriteteve që të ushtrojnë kontroll efektiv brenda juridiksionit të vet.
- sovranitetin e ndërvarur që i referohet aftësisë së shtetit për të rregulluar marrëdhëniet dhe kushtet në planin global në aspekte të ndryshme.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Janice E. Thomson: State Sovereignty in International Relations. Bridging the Gap between Theory and Empirical Research. in: International Studies Quarterly, Vol. 39, No. 2. 1995, fq. 219.

<sup>2</sup> Stephen D. Krasner: Sharing Sovereignty. New Institutions for Collapsed and Failing States, in: International Security Vol. 29, No. 2. 2004, fq.15-16.

Por, sovraniteti është një koncept dinamik, i cili ka evoluar me kalimin e kohës dhe rrethanave politike e shoqërore duke ndryshuar kështu vazhdimisht kuptimin e vet. Në këtë kontekst Roland Paris përshkruan këtë transformim në këtë mënyrë, ku vala e parë ishte me revolucionet amerikane dhe franceze prej të cilave liria dhe barazia e qytetareve ishin postulatet kryesore duke kaluar deri te periudha pas Luftës së Parë Botërore kur hyri parimi i vetëvendosjes që u mundësoi disa shteteve në Evropë shtetformimin e deri pas Luftës së Dytë Botërore kur ky parim u universalizua edhe në kuadër të proceseve të dekolonizimit u përhap botërisht. Si dhe periudha pas Luftës së Ftohtë ku parimi i zgjedhjeve të lira dhe demokracia liberale janë bërë norma dhe standarde të legjitimitimit ndërkombëtar.<sup>3</sup> Megjithëse sovraniteti me kalimin e kohës ka pësuar ndryshime, domethënia thelbësore mbetet si autoriteti më i lartë brenda një territori të caktuar. Rëndësia e tij qëndron në faktin se që nga ekzistimi, sovraniteti ka qenë dhe mbetet parimi përcaktues në marrëdhëniet midis shteteve dhe mund të cilësohet si bazë e ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Sigurisht që autoriteti i shteteve nuk mbështetet vetëm në forcën detyruese dhe pushtetin si mjete të nevojshme të shtrirjes së autoritetit, ato duhet edhe të pranojnë dhe mbështeten si të tilla edhe nga qytetarët dhe nga shtetet e tjera. Me fjalë të tjera, sovraniteti nënkupton edhe legjitimitetin e brendshëm, nga qytetarët e vet dhe atë të jashtëm, nga bashkësia ndërkombëtare.

### 3. Rezolutat për Kosovën të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Në vazhden e përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare për të parandaluar konfliktin e përgjakshëm dhe gjetur një zgjidhje për çështjen e Kosovës, ishin edhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Situata çdoherë e më rënduar asokohe në Kosovë, ishte objekt i rezolutave të shumta të Këshillit të Sigurimit, deri në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999), e cila aprovoi praninë e një misioni civil dhe ushtarak ndërkombëtar. Kështu, më 31.03.1998 Këshilli i Sigurimit miratoi rezolutën 1160, me të cilën dënonte sulmet e armatosura të UÇK-së si dhe aksionet policore serbe kundër civilëve, si dhe ftonte palët që të ndalojnë dhunën

<sup>3</sup> Roland Paris: Peacekeeping and the Constraints of Global Culture. in: European Journal of International Relations, Vol. 9, No.3. 2003, fq. 444-445.

menjëherë. Duke vendosur embargo në armë ndaj Jugosllavisë, si edhe paralajmëruar se mund të ndërmerrete veprime sipas nenit 7 të Kartës së OKB-së, mbi bazën e cilës mund të kryente ndërhyrje ushtarake për të ndaluar konfliktin.<sup>4</sup>

Si rezultat i negociatave të mundimshme, si dhe me pëlqimin e Federatës Ruse, Këshilli i Sigurimit arriti të miratojë Rezolutën 1199 më 23 shtator 1998. Në këtë rezolutë, Këshilli i Sigurimit përsëri dënoi ashpër përdorimin e tepruar të dhunës nga forcat serbe të sigurimit dhe ushtria jugosllave, e cila ushtrohej kryesisht ndaj popullatës civile dhe u kushtoi me jetë shumë qytetarëve. Mirëpo, rëndësia e veçantë e saj ishte se Këshilli i Sigurimit në Rezolutën 1199 konstatonte prerazi se *“përkeqësimi i situatës në Kosovë (Republika Federale e Jugosllavisë) përbën kërcënim për paqen dhe sigurinë në rajon”*.<sup>5</sup>

Me qëllim për t’iu përmbajtur Rezolutës 1199 të OKB-së, NATO së pari lëshoi një paralajmërim për RFJ-në më 24 shtator 1998, duke kërkuar ndërprerje të menjëhershme të të gjitha veprimeve të dhunshme. Në këtë kontekst, shtetet anëtare të NATO-s vendosën të lëshojnë një aktivizimi-paralajmërim (AKTËARN), i cili përfshinte mundësinë e manovrave të kufizuara nga forcat ajrore. Për shkak të dhunës së forcave serbe dhe masakrave të mëtejshme ndaj popullsisë shqiptare, shtetet e NATO-s vendosën të rrisin presionin me urdhrin e aktivizimit (AKTORD). Me lëshimin e urdhrit të aktivizimit, NATO-ja u përgatit për një sulm eventual ushtarak. Si rezultat i kësaj, u shtuan njëkohësisht edhe përpjekjet diplomatike për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore. Ndërkohë i dërguari special i SHBA-së, Richard Holbrooke udhëtonte në Beograd për negociuar një marrëveshje armëpushimi me Milosheviqin, sipas së cilës forcat jugosllave ndalojnë veprimet, shumica e forcave të policisë duhej të tërhiqen menjëherë, si dhe refugjatët të kthehen në shtëpitë e tyre. Kështu me 13 tetor u arrit marrëveshja e ashtuquajtur Holbruk-Milosheviq, e cila përfshinte stacionimin e 2000 vëzhguesve të paarmatosur të OSBE-së, si dhe fluturimet e avionëve të paarmatosur të NATO-s në hapësirën ajrore mbi Kosovë. Më 24 tetor 1998, Këshilli i Sigurimit miratoi rezolutën 1203, me të cilin Misioni Verifikues i OSBE-së në Kosovë (KVM) mori mandatin e tij.<sup>6</sup>

---

<sup>4</sup> Hendrik Jaeschke: Die Humanitäre Intervention im internationalen Völkerrecht, Legitimierung der NATO-Luftoperationen in Bosnien - Herzegowina und dem Kosovo. GRIN Verlag, 2010, fq.17.

<sup>5</sup> Theodor Schweisfurth: Völkerrecht. Mohr Siebeck, Tübingen, 2006, 447.

<sup>6</sup> Bekim Baliqi: Externes State-Buildung durch die Vereinten Nationen: Am Fallbeispiel des Kosovo. SVH-Verlag, Saarbrücken, 2009.

Të gjitha këto rezoluta, pra ajo 1160 (31 mars 1998), 1199 (23 shtator 1998) dhe 1203 (24 tetor 1998) u hartuan në kuadër të Kartës së OKB-së duke iu bërë thirrje palëve për një zgjidhje paqësore të konfliktit në Kosovë. Me ç'rast palëve në konflikt u bëhej thirrje të gjenin një zgjidhje politike e të pranueshme për të gjithë. Këshilli i Sigurimit i OKB-së e cilësoi situatën në Kosovë si kërcënim për paqen dhe sigurinë, por pa dhënë autorizim për shpalljen e masave shtrënguese dhe të ndërhyrjes ushtarake. Megjithatë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së ishte i përgatitur të konsideronte marrjen e masave të mëtejshme në rast dështimi të mjeteve të tjera diplomatike e paqësore. Këshilli i Sigurimit i OKB-së në fund miratoi rezolutën 1244 cila aprovoi praninë e një misioni civil dhe ushtarak, duke hapur rrugën kështu të administrimit ndërkombëtar në Kosovë. Prania e një force të fuqishme ndërkombëtare dukej e domosdoshme pas të gjitha përvojave me shkeljet e shumta të marrëveshjes dhe brutalitetin e palës serbe.

Përndryshe, as rezolutat e OKB-së dhe as OSBE-ja dhe misioni i saj verifikues nuk ishin në gjendje të parandalonin krimet e bëra nga forcat serbe, siç e dëshmoi qartë masakra në fshatin Reçak. Mirëpo, këto ishin dëshmi shtesë për nevojën, si dhe premisa për krijimin e opinionit publik dhe vullnetit politik që mori vendim të ndalonte krimet e mëtejshme të Serbisë në Kosovë përmes intervenimit humanitar. Ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës përmes rezolutave të OKB-së, OSBE-së dhe mjaft organizatave të tjera, si dhe përvoja nga luftërat e bëra në ish-Jugosllavi dhe krimet e kryera nga forcat serbe, bën që për bashkësinë ndërkombëtare ndërhyrja ushtarake për qëllime humanitare mbeti zgjidhja e vetme dhe e duhur për të vepruar.

#### 4. Intervenimi humanitar si mbrojtës i drejtave të njeriut

Çka është intervenimi humanitar dhe/ose çfarë është humanitare në lidhje me të? Intervenimi në kuptimin e ngushtë të fjalës është një ndërhyrje e dhunshme në punët e një shteti tjetër kundër vullnetit të qeverisë së atij shteti ose të paktën të një pjese të konsiderueshme të saj. Ndërsa intervenimi humanitar i referohet ndërhyrjes ushtarake nga shtetet, aleancat e shteteve ose organizatat ndërkombëtare në një konflikt të armatosur në një shtet për të mbrojtur jetët e njerëzve të pafajshëm dhe për të shmangur gjenocidin eventual. Intervenimi mund të konsiderohet si humanitar nëse qëllimi i tij është parandalimi i shkeljeve të rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut dhe krimeve që kryhen nga shteti i sulmuar ndaj qytetarëve ose ndaj ndonjë pakice nën

pushtetin e të njëjtit shtet. Kjo nënkupton se intervenimi humanitar u kundërvihet dëbimit, keqtrajtimit dhe vrasjeve të një numri të konsiderueshëm njerëzish nën pretekstin e ushtrimit të autoritetit shtetëror ose të çështjeve të brendshme të shtetit.

“Asnjë shtet nuk mund të pranojë se po bën një luftë agresive dhe më pas të mbrojë veprimet e tij. Megjithatë, termin 'ndërhyrje' e kuptojmë ndryshe; nuk përkufizohet si veprim kriminal, dhe megjithëse praktika kërcënon pavarësinë e shteteve që i nënshtrohen pushtimit, ndonjëherë është e mundur të justifikohet. Por është më e rëndësishme të theksohet që në fillim se legjitimi është gjithmonë i nevojshëm”.<sup>7</sup>

Michael Walzer, i cili është njëri ndër filozofët më të shquar që trajtoi intervenimin humanitar nga principi i ‘luftës së drejtë’. Ai konsideronte se intervenimi humanitar edhe me mjete ushtarake justifikohet vetëm atëherë kur niveli i shkeljeve të të drejtave të njeriut brenda shtetit arrin në atë masë që trondit edhe ndërgjegjen e mbarë njerëzimit. Në këtë kontekst, që nga mesi i viteve 1990 me ‘spastrimet etnike’, gjenocidin dhe krimet e luftës në ish-Jugosllavi dhe konflikte të tjera, ka pasur një debat të nxehtë nëse bashkësia ndërkombëtar duhet të ndërhyjë ushtarakisht në një shtet nëse një grup etnik kërcënohet nga ana e aparatit shtetëror dhe nëse ka shkelje sistematike të të drejtave të njeriut dhe rrezik nga krimet kundër njerëzimit. Në debatin për ndërhyrjen humanitare, në parim ekzistojnë dy qëndrime themelore: njëri qëndrim e konsideron ndërhyrjen ushtarake në punët e brendshme të një shteti si shkelje të parimit të sovranitetit dhe rrjedhimisht të së drejtës ndërkombëtare, ndërsa nga ana tjetër është qëndrimi se në situata emergjente dhe me rrezik të gjenocidit, komuniteti ndërkombëtar është përgjegjës për të ndërhyrë edhe me ushtri për të shpëtuar jetë njerëzish, prandaj ndërhyrja është moralisht e nevojshme edhe politikisht legjitime. Me gjithë këto dilema, vitet 1990 konsiderohen nga shumë studiues edhe si dekada e intervenimeve humanitare. Kështu Mary Kaldor, studiuese e shquar në fushën e qeverisjes globale dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, e potenconte imperativin moral që komuniteti ndërkombëtar e ka për detyrë të ndërhyjë në rastet e mizorive masive, duke theksuar nevojën për të balancuar parimet e mosndërhyrjes me detyrimin për të parandaluar krizat humanitare.<sup>8</sup>

---

<sup>7</sup> Michael Walzer: *Gibt es den gerechten Krieg?* Klett-Cotta, Stuttgart 1982, fq.136.

<sup>8</sup> Mary Kaldor: *Neue und alte Kriege. Organisierte Gewalt im Zeitalter der Globalisierung.* Suhrkamp, Frankfurt am Main, 2000

Bazuar në këtë dilemë, ish-sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan, shtroi pyetjen bazë nëse komuniteti ndërkombëtar duhet të ndërhyjë në një shtet për t'i dhënë fund shkeljeve të rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut. Ai vetë mbajti qëndrimin afirmativ se komuniteti ndërkombëtar duhet të krijojë norma ligjore të vlefshme për të mbrojtur të drejtat e njeriut brenda kornizës së ligjit ndërkombëtar dhe të krijojë norma veprimi të vlefshme globalisht që mund të parandalojnë shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut. Këshilli i Sigurimit duhet të marrë përsipër detyrën e një 'parlamenti global' dhe të veprojë në emër të bashkësisë ndërkombëtare, ku duhet të përfaqësohen jo vetëm interesat e shteteve individuale, por mbi të gjitha vullneti kolektiv dhe të mbrohen të drejtat e njeriut. Kështu ish-sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Annan e përshkroi këtë rol të ri të OKB-së si më poshtë:

„Detyra jonë është të intervenojmë: të parandalojmë konfliktin aty ku është e mundur, të ndalojmë aty ku veçse ka shpërthyer, apo- kur asnjëra nga këto nuk janë të mundshme- të paktën për ta përmbajtur dhe parandaluar përhapjen e tij.”<sup>9</sup>

Kështu, Annan theksonte rolin e bashkësisë ndërkombëtare, veçanërisht të OKB-së në vendosjen e normave të vlefshme të veprimit për të parandaluar shkeljet serioze të të drejtave të njeriut, duke reflektuar në diskursin mbi intervenimin humanitar dhe më pas mbi zhvillimin e doktrinës të 'përgjegjësisë për të mbrojtur'. Në përgjithësi, Rezoluta 688 e 5 prillit 1991 për mbrojtjen e kurdëve të persekutuar në Irakun Verior, konsiderohet si fillimi i një epoke të intervenimit humanitar brenda kornizës së OKB-së. Kjo rezolutë identifikoi një kërcënim për paqen dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, por e argumentoi këtë me dimensionin ndërkombëtar të një problemi të refugjatëve që mund të shndërrohej në një kërcënim për shtetet fqinje. Rezoluta çoi në krijimin e zonave të ndalim-fluturimit në veri dhe jug të Irakut, të cilat u siguruan nga forcat aleate për të mundësuar ndihmën humanitare.

Në rastin e Somalisë, me Rezolutën 794 të 3 dhjetorit 1992, ku u evidentua shkelja e rëndë e të drejtave të njeriut dhe që rezultoi me krizë të thellë humanitare, për herë të parë dhe në mënyrë eksplicite u cilësua nga OKB-ja si një kërcënim i drejtpërdrejtë për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Këshilli i Sigurimit e ndoqi këtë interpretim në rezolutat pasuese për Haitin, Ruandën dhe Bosnjë e Hercegovinën. Megjithatë, siç u pa në rastin e Kosovës, OKB-ja ishte e kufizuar për të vendosur për ndërhyrjet humanitare. Edhe pse Këshilli i Sigurimit i OKB-së

<sup>9</sup> Kofi Annan: The Question of Intervention. United Nations, New York, 1999, fq. 4.

e kishte përshkruar situatën në Kosovë si kërcënim për paqen në Rezolutën 1199 të 23 shtatorit 1998, ai nuk ishte në gjendje të miratonte një mandat për ndërhyrje ushtarake për shkak të qëndrimit të Rusisë dhe Kinës. Kjo është arsyeja pse NATO, e cila tashmë ishte e përfshirë në rajon dhe në Bosnjë e Hercegovinë, u tregua e gatshme për të kryer ndërhyrje ushtarake për të mbrojtur popullsinë në Kosovë. Ajo iu referua Rezolutës 1160 dhe 1199 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së tashmë të miratuar për konfliktin në Kosovë. Duhet theksuar gjithashtu se sulmet e NATO-s, përveç motiveve humanitare, kishin për qëllim të shmangnin zgjerimin e konfliktit në Ballkanin e trazuar. Debati për ndërhyrjen humanitare sillej rreth dilemës ndërmjet respektimit të sovranitetit të një shteti dhe përgjegjësisë së bashkësisë ndërkombëtare për të ndërhyrë në rastet e shkeljeve të rënda e sistematike të të drejtave të njeriut dhe rrezikimit të paqes në botë.

Karta e OKB-së njeh sovranitetin dhe integritetin territorial të shteteve anëtare; megjithatë, nëse një shkelje ose kërcënim për paqen ndërkombëtare përcaktohet nga Këshilli i Sigurimit, ai mund të autorizojë përdorimin e forcës sipas Kreut VII të Kartës së OKB-së. Debati rreth përdorimit të forcës sipas Kreut VII dhe rolit të vendeve me veto si Rusia dhe Kina, e ndërlikonte më tej raportin midis sovranitetit dhe ndërhyrjes humanitare. Sipas këtij kreu, vetëm Këshilli i Sigurimit është i autorizuar të marrë vendimet dhe masat përkatëse. Megjithatë, ky koncept është dëshmuar se nuk është lehtë i realizueshëm në praktikë, sepse Këshilli i Sigurimit në shumë raste ka qenë i paralizuar në vendimmarrjen e tij, për shkak të drejtës së vetos dhe konflikteve të interesave midis anëtarëve të tij të përhershëm. Miratimi i Rezolutës 1973 të Këshillit të Sigurimit më 17 mars 2011, e cila e autorizoi intervenimin humanitar e ushtarak në Libi, paraqet një pikë referimi dhe kthesë paradigmatisht në historinë e përpjekjeve ndërkombëtare për të mbrojtur civilët nga vrasjet dhe persekutimet masive.

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë jo vetëm që sfidoi kuptimin tradicional të sovranitetit, por gjithashtu nxiti një rivlerësim të rolit të bashkësisë ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ajo nxori në pah kufizimet e kuadrit ekzistues të sovranitetit shtetëror kur përballej me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut brenda një shteti sovran. Kjo çoi në një ndryshim të paradigmës në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke theksuar imperativin moral që komuniteti ndërkombëtar të veprojë në rastet e krizave humanitare, edhe nëse kjo nënkupton cenimin e sovranitetit të një shteti. Sidoqoftë, ndërhyrja e NATO-s kishte ndikim të jashtëzakonshëm edhe në nxitjen e paqes dhe stabilitetit

në rajon. Ajo shërbeu edhe si një lloj katalizatori për vendet e Ballkanit që aspirojnë të anëtarësohen në NATO dhe Bashkimin Evropian (BE), duke promovuar bashkëpunimin dhe paqen në rajon.

## 5. ‘Përgjegjësia për të mbrojtur’ si rikonceptim i sovranitetit

Sipas një këndvështrimi moral të të drejtave të njeriut, nëse një person posedon këto të drejta, atëherë kjo nënkupton që personat e tjerë kanë edhe detyrim moral t’ia mbrojnë e sigurojnë të drejtat nga rrezikimi apo shkelja e tyre nga personat e tjerë. Rrjedhimisht edhe shtetet duhet të veprojnë sipas kësaj logjike, domethënë jo vetëm se duhet t’i respektojnë të drejtat e qytetarëve të vet, por kanë edhe përgjegjësi që ato t’i mbrojnë edhe në ato shtete që nuk i respektojnë këto të drejta. Siç u theksua edhe më parë, justifikimet ligjore për ndërhyrjet me forcë, veçanërisht në mungesë të një mandati të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kanë qenë objekt debati të ashpër në marrëdhënie ndërkombëtare, me implikime për krijim edhe të doktrinës së ‘përgjegjësisë për të mbrojtur’.

Ndërhyrja ushtarake e NATO-s ndaj ish-Jugosllavisë, gjegjësisht në Kosovë ndodhi pa pasur ndonjë mandat vendimtar nga Këshilli i Sigurimit dhe në këtë mënyrë mund të interpretojë se ishte një ndërhyrje në punët e brendshme të një shteti dhe të cilësohej si shkelje e sovranitetit të tij. Megjithatë, bashkësia ndërkombëtare e justifikoi intervenimin mbi domosdoshmërinë humanitare dhe mbrojtjen e drejtave të njeriut, duke e theksuar se ishin shtetuar të gjitha mundësitë diplomatike për të gjetur zgjidhje paqësore të konfliktit dhe ishin miratuar një varg rezolutash që ftonin palën serbe për përmbajtje dhe de-përshkallëzim. Përfshirë këtu edhe rezolutat e miratuara nga OKB-ja, si rezolutat 1160, 1199 dhe 1203 të cilat bazohen të gjitha në Kapitullin VII të Kartës së OKB-së. Mirëpo, ishte Rusia dhe Kina me drejtën e vetos, që hodhën poshtë një rezolutë tjetër që autorizonte përdorimin e forcës kundër ish-Jugosllavisë. Ndërkohë veprimi ushtarak i NATO-s u justifikua duke u thirrur në Rezolutën 1199 dhe referuar në Kapitullin VII të Kartës së OKB-së. Si rezultat i këtij argumentimi sulmet e NATO-s nuk ishin në kundërshtim me frymën e OKB-së, e cila parasheh mundësinë edhe të ndërhyrjes. Përveç kësaj, Kapitulli VIII, Neni 52 i Kartës së OKB-së, ofron kuadrin ligjor për marrëveshjet

rajonale dhe funksionimin e tyre për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Sovraniteti i shtetit, siç njihet që nga ‘Paqja e Vestfalisë’, ka ndryshuar rëndësisht, veçanërisht gjatë këtyre dekadave të fundit. Pas krizave humanitare dhe konflikteve si ato në Ruandë dhe Somali, u formua një komision i pavarur dhe ndërkombëtar, i cili paraqiti raportin e tij ‘Përgjegjësia për të mbrojtur’ (Responsibility to protect) në dhjetor 2001. Në raport theksohej se sovraniteti nuk duhet kuptuar më si kontroll apo sovranitet absolut, por si përgjegjësi. Kjo do të thotë se mbrojtja e qytetarëve dhe të drejtave të njeriut nuk është vetëm çështje e çdo shteti, por një detyrim i lidhur me normat dhe kriteret ndërkombëtare. Prandaj, koncepti i sovranitetit ka ndryshuar “(...) nga *sovraniteti si kontroll në sovranitet si përgjegjësi* si në funksionet e brendshme ashtu edhe në detyrat e jashtme”.<sup>10</sup> Sipas doktrinës ‘përgjegjësia për të mbrojtur’ sovraniteti nuk i mbron tutje shtetet nga ndërhyrja e huaj, sepse ato janë përgjegjëse dhe mbahen si të tilla për mirëqenien e qytetarëve. Shteti pra ka përgjegjësinë për të mbrojtur qytetarët e tij dhe është i detyruar për respektimin e të drejtave të tyre njerëzore. Nëse shteti nuk e përmbush këtë detyrë, raporti rekomandon që bashkësia ndërkombëtare duhet të vijë në ndihmë dhe të marrë përsipër mbrojtjen e popullatës së kërcënuar. Veprimet e bashkësisë ndërkombëtare duhet të zhvillohen në tre dimensione;

“Thelbi i përgjegjësisë për të mbrojtur është sigurimi i mbrojtjes dhe ndihmës jetësore për popullatat në rrezik. Kjo përgjegjësi ka tre komponentë përbërës dhe thelbësorë: jo vetëm përgjegjësinë për të reaguar ndaj një katastrofe humanitare aktuale ose të paraparë, por përgjegjësinë për ta parandaluar atë, si dhe përgjegjësinë për të rindërtuar atë pas ngjarjes.”<sup>11</sup>

Në këtë kontekst, vlen të theksohet që tendenca në rritje e bashkësisë ndërkombëtare për të ndërhyrë në situatat e krizës dhe për të vendosur kriteret e qarta për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përveç të tjerash, ka parasysh edhe çështjen e sigurisë. Sepse çfarëdo konflikti i armatosur që rezulton me krizë të thellë humanitare rrezikon përkrahëllëzimin e përmasave të gjerë, valë refugjatesh dhe pasoja të tjera të

---

<sup>10</sup> ICISS: The Responsibility to Protect. Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty, International Development Research Centre, Ottawa, 2001

<sup>11</sup> Po aty., fq.17.

dëmshe e të paparashikueshme.<sup>12</sup> Prandaj liderët politikë duhet t'i japin përparësi qasjeve multilaterale ndaj ndërhyrjeve humanitare, duke theksuar rolin e organizatave rajonale si p.sh. NATO-s dhe të OKB-së në autorizimin dhe mbikëqyrjen e veprimeve humanitare. Kjo kërkon edhe angazhim më të shtuar të bashkësisë ndërkombëtare për të forcuar veprimet e mekanizmat diplomatikë për të adresuar konfliktet dhe krizat e mundshme.

Ndërkaq, ndërhyrja e NATO-s dhe shpëtimi i popullatës civile në Kosovë nga forcat ushtarake e paraushtarake serbe nga shfariosja e etnike dhe gjenocidi, sikurse edhe kthimi i menjëhershëm e masiv i refugjatëve ka shërbyer si një shembull i duhur i nevojës së bashkësisë ndërkombëtare që të vendosë për parimin e drejtave të njeriut para parimit të sovraniteti dhe mosndërhyrjes në çështjet e brendshme të shtetit. Koncepti i të drejtave të njeriut në thelb ka një karakter intervencionist: të drejtat e njeriut vlejné edhe brenda familjes, shteti duhet p.sh. të ndërmarrin masa kundër dhunës ndërmjet bashkëshortëve ose abuzimit të fëmijëve nga prindërit e tyre. Për marrëdhëniet ndërkombëtare vlen i njëjti parim në përgjithësi. Shtetet janë legjitime nëse shprehin vullnetin e qytetarëve të tyre dhe kështu bazohen në parimin e sovranitetit popullor si përgjegjësi dhe jo vetëm si çështje e brendshme dhe e drejtë e pakontestueshme. Me këtë rast transformimi i parimit të sovranitetit si përgjegjësi ka afektuar edhe në ndryshimin e kornizës legale në të drejtën ndërkombëtare dhe qasjen e rendit global. Sukese edhe e ka shtyrë bashkësinë ndërkombëtare drejt një qëndrimi më afirmativ e veprimi më proaktiv në parandalimin e shkeljeve masive të drejtave të njeriut dhe rrezikimit të paqes.

## 6. Konkluzione

Janë shtruar shumë pyetje dhe ngritur diskutime të panumërta politike e akademike në lidhje me ndërhyrjen e NATO-s dhe administrimin ndërkombëtar në Kosovë. Në përgjithësi, rasti i Kosovës ka pasur një rëndësi të madhe në rimendimin e konceptit, si dhe rregullimin e parimit të sovranitetit në Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Në këtë kontekst janë marrë në konsideratë aspektet legale, politike dhe etike të ndërhyrjes së bashkësisë ndërkombëtare në një shtet sovran. Që nga ajo

<sup>12</sup> Michael Ignatieff: Die Politik der Menschenrechte. Europäische Verlagsanstalt, Hamburg 2002, fq.65.

kohë, rasti studimor i Kosovës ka shërbyer jo rrallë herë për të argumentuar rëndësinë e angazhimit të bashkësisë ndërkombëtare në vatrat e konflikteve me qëllimin e mbrojtjes së drejtave të njeriut, si dhe në sigurimin e paqes në botë. Pas ndërhyrjes së NATO-s, regjimet brutale e vrastare nuk mund të pretendonin më lirshëm në 'integritetin territorial' ose të drejtën për të rregulluar 'çështjet e brendshme', atëherë kur shkelnin sistematikisht të drejtat e njeriut. Kur një shtet abuzon me sovranitetin e tij për të 'pastruar etnikisht' apo për të detyruar në shpërngulje ndonjë pakicë, nuk mund të arsyetohet aq lehtë e pa pasoja në rendin e ri botëror, të krijuar pas ndërhyrjes së NATO-s. Krimet e luftës në Kosovë nuk ishin 'çështje e brendshme' e Jugosllavisë apo Serbisë, këtë e ka vulosur parimi i ri i sovranitetit mbi të cilin u realizua edhe intervenimi humanitar i NATO-s. Ndërsa, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka vendosur që gjenocidi shkel parimin themelor të drejtësisë për të cilën të gjitha shtetet kanë një interes ligjor për ta mbrojtur. Kontributi më i madh i intervenimit humanitar të NATO-s në diskutimet dhe konceptimet në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare nuk ishte vetëm në ri-konceptualizimin e sovranitetit por mbi të gjitha tek ai i zhvendosjes së fokusit të debatit nga e drejta për të intervenuar në përgjegjësinë për të mbrojtur si detyrim etik dhe veprim faktik për bashkësinë ndërkombëtare. Edhe pse i konsideruar shpesh si rast sui generis, ndërhyrja e NATO-s krijoi një precedent për ndërhyrjet e ardhshme humanitare, duke ndikuar në diskursin mbi legjitimitetin e veprimeve të tilla. Sikurse nxiti rishqyrtimin e kriterëve për ndërhyrje, parakushtet për veprim ushtarak dhe ekuilibrin midis sovranitetit shtetëror dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ndikimi afatgjatë i ndërhyrjes në evoluimin e marrëdhënieve dhe normave ndërkombëtare, veçanërisht në lidhje me përgjegjësinë për të mbrojtur, vazhdon ende të ndikojë e formësojë diskutimet bashkëkohore për sovranitetin.

### Summary

This article elaborates on the profound and multidimensional impact of NATO's intervention in Kosovo on the concept of sovereignty in International Relations. The article argues that this humanitarian intervention fundamentally challenged the understanding of state sovereignty, paving the way for a reconceptualization of sovereignty, and at the same time reconsidering the legal, political, and ethical dimensions of humanitarian intervention. This research discusses the role of the UN Security Council, its pivotal resolutions concerning Kosovo, which condemned the violence, justified the need for intervention, and approved a presence of the international civilian and military

mission in Kosovo. NATO's intervention also led to the emergence of the 'Responsibility to Protect' doctrine, which redefined sovereignty as a responsibility. According to this doctrine, sovereignty no longer protects states from foreign interference, but holds them accountable for human rights violations. This intervention redefined the conditions of state sovereignty and the role of the international community in preventing mass atrocities by the state. Moreover, the case of Kosovo serves as a helpful case study to understand the complications and implications of humanitarian intervention, sovereignty and the evolving norms of global governance that prioritize respect for human rights over rigid principles of sovereignty, such as non-intervention and territorial integrity. The international community's focus shifted from the right to intervene to the responsibility to protect. Additionally, it has strengthened the need for more determination and coordination of the international community in addressing and preventing humanitarian crises in the future.

*Keywords:* Humanitarian intervention, Sovereignty, Responsibility to Protect, NATO, Kosovo.

## Bibliografia

- Annan, Kofi (1999): *The Question of Intervention*. United Nations, New York
- Baliqi, Bekim (2009): *Externes State-Buildung durch die Vereinten Nationen: Am Fallbeispiel des Kosovo*. SVH-Verlag, Saarbrücken
- ICISS (2001): *The Responsibility to Protect*. Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty, International Development Research Centre, Ottawa
- Ignatieff, Michael (2002): *Die Politik der Menschenrechte*. Europäische Verlagsanstalt, Hamburg
- Kaldor, Mary (2000): *Neue und alte Kriege. Organisierte Gewalt im Zeitalter der Globalisierung*. Suhrkamp, Frankfurt am Main
- Krasner, Stephen D. (2004): *Sharing Sovereignty. Neë Institutions for Collapsed and Failing States*, in: *International Security* Vol. 29, No. 2.
- Jaeschke, Hendrik (2010): *Die Humanitäre Intervention im internationalen Völkerrecht, Legitimierung der NATO-Luftoperationen in Bosnien - Herzegowina und dem Kosovo*. GRIN Verlag.
- Paris, Roland (2003): *Peacekeeping and the Constraints of Global Culture*. in: *European Journal of International Relations*, Vol. 9, No.3.
- Thomson, Janice E. (1995): *State Sovereignty in International Relations. Bridging the Gap between Theory and Empirical Research*. in: *International Studies Quarterly*, Vol. 39, No. 2.
- Schweisfurth, Theodor (2006): *Völkerrecht*. Mohr Siebeck, Tübingen.
- United Nations General Assembly Resolution S/RES/1160, 31. March 1998
- United Nations General Assembly Resolution S/RES/1199, 23. September 1998
- Walzer, Michael (1982): *Gibt es den gerechten Krieg?* Klett-Cotta, Stuttgart



Ibrahim Gashi

## LUFTA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS (1998-1999)

Të shkruhet për Luftën Çlirimtare të Kosovës, nga një distancë relativisht e shkurtër historike, në një kohë kur ende shumë informacione dhe burime primare nuk janë deklasifikuar dhe rrjedhimisht nuk janë të qasshme, është sfidë për historianët dhe studiuesit e tjerë të shkencave sociale. Por megjithatë një rrethanë që favorizon studiuesit është fakti se Kosova dhe lufta e saj çlirimtare gjatë periudhës 1998-1999, sidomos në pjesën e epilogut të saj, për shkak të ndërhyrjes së NATO-s ishte bërë çështje që ka nxitur interesim dhe si rezultat janë bërë studime dhe shkrime autoriale, por edhe shkrime memoriale nga protagonistët, të huaj dhe vendorë, të cilët ku në mënyrë të drejtpërdrejtë e ku në mënyrë kontekstuale kanë ndriçuar shumë dimensionet e kësaj lufte.

Kumtesa ime sot nuk ka për synim që të shpalsë faktografinë lidhur me pjesën operacionale të luftës, për disa arsye. E para, një përshkrim i tillë do të kërkonte hapësirë kohore më të madhe për ta shpalosur. E dyta, një përshkrim të tillë do të mund ta bënin shumë më mirë ekspertët e fushës së doktrinës dhe strategjisë ushtarake, e treta, të gjithë studiuesit e huaj dhe ekspertët ushtarakë nuk e kanë vënë theksin shumë te përmasat dhe sukseset e veprimeve operacionale të vetëdijshëm për disproporcionin e madh në raportin e forcave midis palëve, por janë fokusuar tek efektet reale që kanë prodhuar ato veprime luftarake për të krijuar një kohezion të ri ndërkombëtar mbështetës për kauzën shqiptare të çlirimit dhe të shkëputjes nga sundimi serb.

Kur bëhet fjalë për arsyet e kalimit nga strategjia e kundërshtimit paqësor dhe mosbindjes civile në drejtim të luftës së armatosur po thuaj shumica e autorëve pa dallim pajtohen se mospërfshirja, madje mospërmendja e çështjes së Kosovës në Konferencën e Dejtonit, ishte momenti kur besimi i opinionit të brendshëm në politikën paqësore mori një goditje serioze, duke i hapur prespektivë opsionit të luftës së armatosur. Sekretarja e shtetit Medelin Albright do të shkruajë: “Pas Marrëveshjes së Dejtonit situata filloi të rëndohej më shumë.... Marrëveshja nuk bëri asgjë për shqiptarët.... Shumë syresh e kishin humbur durimin. Disa nga këta iu kthyen rezistencës dhe u bashkuan në një lëvizje që u quajt

“Ushtria çlirimtare e Kosovës (UÇK)”<sup>1</sup> Edhe studiuesi Mark Weller në këtë linjë do të shprehej: Përmbyllja e Marrëveshjes së Dejtonit pa u përmendur Kosova në të, në thelb minoi besueshmërinë e qeverisë Rugova... Në vend se të shpërbleheshin se kishin vepruar në mënyrë të përgjegjshme kosovarët u injoruan. Në këtë klimë dekurajuese ata që kishin insistuar për zgjidhje ushtarake u bënë me ndikim”<sup>2</sup>

Për të kuptuar drejt historinë e Luftës Çlirimtare, dhe formacionit që e zhvilloi këtë luftë, UÇK-së duhet të rikthehemi për një moment në parahistorinë e saj, përkatësisht periudhën e ilegalitetit të saj 1992-1997, periudhë kur ishin krijuar celulat e para të saj. Kjo ishte koha kur populli i Kosovës i vetëdijshëm për pafuqinë për t’iu kundërvënë aktivist makinerisë policore dhe ushtarake serbe kishte mbështetur një lëvizje të kundërshtimit paqësor dhe mosbindjes civile duke varur shpresat te ndërhyrja ndërkombëtare për të ndaluar veprimet e dhunës, aparteidit dhe terrorit policor serb. Kjo nuk ishte periudha kur UÇK-ja mund të krijonte mbështetjen e saj. Këtë e kishin të çartë edhe vetë krerët e saj. As aksionet e armatosura që në mënyrë sporadike që u organizuan gjatë viteve 1992,1993,1994 dhe 1995, kundër efektivave dhe stacioneve policore serbe nuk arritën ta krijojnë një momentum të favorshëm ku do të mbështetej opsioni e luftës së armatosur. Këto veprime megjithatë ndikuan që të lëvizet në planin organizativ të UÇK-së ku iniciatorët e themelimit të saj përmes disa takimeve në Kosovë dhe në Maqedoni ndihmuan që të krijohet dhe konsolidohet hierarkia dhe të rritet shtrirja e saj.

Arritjet e limituara të lëvizjes paqësore, siç e thamë më lart, veçmas pas Dejtonit, do të ndihmojnë në zgjerimin e strukturës dhe shtrirjes së njësiteve të para të UÇK-së, madje edhe kapërcimin e fazës së ilegalitetit dhe daljen publike të saj në nëntor 1997.

Fillimi i vitit 1998 përbën sfidën e parë të hapur luftarake për UÇK-në. Beogradi tashmë e dinte se krahas kundërshtimit pacifist gjithëpopullor kishte edhe një guerilje që po synonte të konsolidohej me shpejtësi sidomos në regjionin e Drenicës, por edhe në pjesën e Kosovës Jugperëndimore. Përballjet e para në Likoshan dhe Çirez dhe veçmas luftimet treditore në Prekaz më 5-7 mars 1998 janë moment kur Serbia kishte vendosur që krahas një propagande anti UÇK ta luftonte atë më të gjitha mjetet në terren.

<sup>1</sup> Medeleine Albright, Zonja Sekretare – autobiografi, Dudaj, Tiranë, 2004, 443;

<sup>2</sup> Marc Weller, Shtetësia e kontestuar, Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi, Koha, Prishtinë, 2011, 144;

Edhe UÇK-ja pas këtyre ngjarjeve e kuptoi se krahas rezistencës se armatosur duhej luftuar edhe në planin diplomatik për të bindur vendet demokratike për ta pranuar atë si palë të re në bisedimet për Kosovën, në një kohë kur po zhvillohej një propagandë e madhe nga Beogradi, por edhe Kremli për ta paraqitur atë si organizatë terroriste. Për të evituar këtë rrezik dhe për të fituar njohjen dhe mbështetjen e botës demokratike, në prill të vitit 1998 Shtabi i UÇK-së bëri publik një program prej 9 pikash mes të cilave se ajo (UÇK-ja) ndiqte një qëllim njëkohësisht mbrojtës dhe çlirimtar, zotohej se do të respektonte konventat e Kombeve të Bashkuara dhe ligjet e luftës, dënonte terrorizmin dhe çdo aksion tjetër kundër civilëve dhe pohonte se asnjë marrëveshje s’do të mund të lidhej pa miratimin e saj. Në fund UÇK-ja u bëntë thirrje -së dhe BE-së që të mbështesnin “luftën e drejtë të popullit shqiptar në Jugosllavi”<sup>3</sup>

Pavarësisht këtij deklarami të qartë të bërë në fillimet e luftës bashkësia ndërkombëtare nuk e kishte shumë të sigurt mundësinë e mbijetesës së UÇK-së në përballjet e saj me një fuqi ushtarake që kishte Jugosllavia, ndaj dhe nuk dha shenja në mbështetje të saj. Edhe më tutje Grupi i Kontaktit në takimet e shpeshtuara të tij në gjysmën e parë të vitit 1998 nuk fliste për dy palë ndërluftuese, por për dhunën shtetërore në rritje kundër civilëve në Kosovë dhe konkludonte me propozim zgjidhjen sipas formulës se “GK nuk përkrah as ruajtjen e gjendjes ekzistuese e as pavarësinë e Kosovës”.<sup>4</sup>

Luftimet e intensitetit të shtuar në pranverën dhe verën e hershme të vitit 1998 dëshmuuan jo vetëm mbijetesën por edhe masovizimin dhe konsolidimin e UÇK-së duke e rritur si kundërpeshë numrin e forcave ushtarake dhe policore serbe në Kosovë. Këto luftime tashmë të përmasave të shtuara dhe shpeshherë frontale po krijonin me shpejtësi një realitet të ri në rrafshin ndërkombëtar së paku në dy momente. E para, në një kohë kur komuniteti ndërkombëtar i tubuar rreth GK-së po shqyrtonte si mundësi vetëm opsionin e një zgjidhjeje paqësore dhe po tërhiqte vërejtjen te Beogradi për ndaljen e dhunës, në terren po ndodhnin luftime intensive dhe një prezencë e madhe trupave dhe makinerisë ushtarake jugosllave dhe momenti i dytë që po sfidonte pritjet e fuqive të kohës ishte mbijetesja e UÇK -së, e cila tashmë paraqitej si një faktor i ri që nuk mund të anashkalohej.

---

<sup>3</sup> Jacques Baudouin, Lindja e një demokracie, Gjon Buzuku, Prishtinë, 2018, 88.

<sup>4</sup> M. Weller, Shtetësia e kontestuar..., 160

Të partë që e lexuan drejt këtë realitet të ri në kuadër të GK-së qenë SHBA-ja dhe Britania e Madhe të cilat kërkuan kalimin në një strategji të re. Takimi i Richard Holbrooke në qershor 1998 me drejtuesit e UÇK-së dhe deklarimi i tij se shqiptarët kishin të drejtë të mbroheshin nga dhuna dhe terrori serb në Kosovë, por duke mos premtuar ndërhyrjen e NATO-s për të mbrojtur dhe shpëtuar popullsinë civile, është një evolim i politikës së aleatëve perëndimorë karshi luftës dhe UÇK-së. Shumë shpejt SHBA-ja do të lëvizë drejt një qëndrimi më të fortë, si rezultat i rritjes së intensitetit të luftimeve në terren dhe përshkallëzimit të dhunës edhe ndaj civilëve.

Në dëshminë e 23 korrikut para Komitetit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Dhomës së Përfaqësuesve, ambasadori i SHBA-së Robert Gelbert vuri në dukje se “RFJ-ja nuk kishte përmbushur ende asnjë kërkesë të Grupit të Kontaktit”<sup>5</sup> Ai paralajmëroi se planifikimi për veprime të mundshme ushtarake të NATO-s ishte pothuajse i përfunduar dhe se: “të gjitha opsionet, duke përfshirë ndërhyrjen e fuqishme ushtarake në Kosovë, mbeten në tavolinë.”<sup>6</sup>

Për planifikimin e ndërhyrjes ushtarake, si pasojë e rritjes së luftimeve në terren dhe përshkallëzimit të dhunës dhe krimeve serbe ndaj civilëve flet një dokument i dalë nga zyra e presidentit Klinton. Fjala është për bisedën e regjistruar telefonike, të datës 6 gusht 1998, midis presidentit Klinton dhe Kryeministrit britanik Tony Blair. Biseda u zhvillua nga zyra ovale në Shtëpinë e Bardhë dhe zgjati 20 min (4:46 p.m-5:06 p.m). Pjesa e madhe e kësaj bisede iu kushtua situatës në Kosovë. Pas fjalive përshëndetëse rutinore midis dy burrështetasve presidenti Clinton iu drejtua kryeministrit Blair. *“Ju thirra që të bisedojmë për Kosovën. Atje po bëhet gjithnjë më keq. Kryetitujt flasin se Milloshëviqi po preferon zgjidhjen ushtarake. Forcat ushtarake serbe nuk po luftojnë vetëm UÇK-në, por po angazhohen në një fushatë sistematike kundër popullsisë civile. Mendoj se ne jemi afër një katastrofe të madhe humanitare”*.<sup>7</sup>

Nënshkrimi i marrëveshjes së armëpushimit i ndërmjetësuar nga Holbrooke, në tetor 1998 midis UÇK-së dhe ushtrisë serbe përforcoi autoritetin e UÇK-së dhe lidhjet e saj me komunitetin ndërkombëtar.

<sup>5</sup> Looking for a Strategy July-September 1998. Contact Group Statement, July 8, 1998. The Contact Group issued its statement on Kosovo following its meeting in Bonn, Germany, cituar sipas: The Kosovo Conflict - A Diplomatic History Through Documents..., f. 209-211;

<sup>6</sup> Po aty;

<sup>7</sup> Ibrahim Gashi, Studime Historike I, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2021, f. 161.

Ka shumë raporte të Misionit Diplomatik Vëzhgues të SHBA-së në Kosovë (KDOM) të fundit të vitit 1998 dhe të fillimit të vitit 1999 që flasin për respektimin e armëpushimit ku më respekt flitet për UÇK-në dhe më shumë tone kritike për Millosheviqin dhe forcat e tij në Kosovë. Njëri nga diplomatët amerikanë dhe koordinator për bisedime në kuadër të KDOM James Pardrew e përshkruan takimin e parë me UÇK-në “Shaun Bynesi, shefi i misionit të KDOM po me qonte t’i takoja pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lëvizje e pavarësisë që po luftonte praninë përherë e më shtypëse ushtarake e policore në Kosovë”.<sup>8</sup> “Bisedimet, vazhdon Pardrew, zgjatën për rreth dy orë. Këta pjesëtarë të UÇK-së nuk më dukeshin fanatikë. Përkundrazi, ishin modest dhe të hapur. Porosia ime për ta ishte fare e thjeshtë: përmbajtje, të mos bënin asgjë që mund t’i etiketonte si terroristë. I nxita të negoconin më ambasadorin Chris Hill, të cilin Holbrooke e kishte caktuar negociator rajonal amerikan për Kosovën.”<sup>9</sup>

Luftimet shumë të vështira dhe të pabarabarta të UÇK-së megjithatë po nxirrnin gjithnjë e më tepër në shesh brutalitetin e forcave serbe kundër popullsisë civile. Masakra e Reçakut dhe raportimi nga vendi i ngjarjes i shefit të Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë William Walker, do të shkruajë më vonë në librin e tij Mark Smith, këshilltar i Richard Holebrook, “zemërimi dhe gjuha jodiplomatike e Walker-it dhe imazhet që mbuluan gjithë televizionet e botës e bënë Raçakun një pikë kthese në përgjigjen e Perëndimit ndaj krizës së Kosovës.”<sup>10</sup>

Për organizimin, rrjedhën dhe veçmas epilogun që pati Konferenca e Rambujesë në dy sesionet e saj në Rambuje dhe në Paris nuk do të flas, përveç një konstatimi tashmë të pranuar ndërkombëtarisht, për rolin që patën përfaqësuesit e UÇK-së në kuadrin e delegacionit kosovar, me mosnënshkrimin e draftit fillestar të marrëveshjes dhe avancimin e ndjeshëm të tij në favor të Kosovës dhe me aktin e nënshkrimit të tij më 15 mars në Paris në momentin kur drafti tashmë ishte bërë fare i papranueshëm për palën serbe, e cila siç dihet nuk e nënshkroi duke i hapur rrugë fillimit të serisë së gjatë të sulmeve të NATO-s kundër caqeve serbe.

Roli i UÇK-së gjeti shprehje dhe u bë shumë i rëndësishëm edhe gjatë operacioneve ushtarake të NATO-së në sulmet 78 ditore nga ajri.

---

<sup>8</sup> James D. Pardrew, Paqebërësit – Lidërshipi amerikan dhe fundi i gjenocidit në Ballakn, Koha, 2021, f. 187.

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Mark Smith, Kosovo Conflict: U.S. Public Diplomacy and Eastern Public Opinion, Figueroa Press Los Angeles, 2009, f. 13.

UÇK-ja tashmë ishte aleati i vetëm i forcave të NATO-s në tokë. Ruajtja e pozicioneve të UÇK-së për NATO-n ishte tejet e rëndësishme. Në një videokonferencë Komandanti i forcave të NATO-s Gjenerali Wesley Clarck u kërkonte vartësve të tij: “deri në ora 13.00 ju do të më thoni se çfarë do të ndërmerrni për të ndihmuar UÇK-në që të mbajë pozicionet në majë të malit të Pashtrikut.... Beteja për mbrojtjen e pozicioneve të UÇK-së në majë të Pashtrikut vazhdoi edhe gjatë dy ditëve të ardhshme.”<sup>11</sup> Në vijim të rrëfimit të tij Clarck-u do të pohojë: “Tërhoqa vërejtjen se do të ketë edhe vendime të tjera të vështira: kapacitetet e UÇK-së duhet të shfrytëzohen në tërësi.”<sup>12</sup>

## Përfundim

Duke analizuar më shumë vëmendje dhe gjakftohtësi luftën çlirimtare, por edhe fazat pararendëse dhe ato pasuese të lëvizjes për pavarësi konsiderojmë se mund të nxirren disa konstatime:

1. Procesi i pavarësisë së Kosovës, shikuar nga këndvështrimi historik, politik, ushtarak dhe legal ka qenë proces shumë sfidues, jo vetëm për kosovarët, por edhe për komunitetin ndërkombëtar.

2. Ky proces ka ndjekur një trajektore të tillë që do të mund ta periodizonim në tri faza kryesore: Fillimi i një bojkotimi qytetar të institucioneve të shtetit jugosllav dhe krijimi i disa strukturave paralele shtetërore efektive kryesisht në fushën e arsimit paralel 1990-1997, si pikënisje e idesë për një shtet të pavarur, “lufta çlirimtare” si rruga që i dha shpirt idesë së pavarësisë, si fazë e dytë, dhe administrimi ndërkombëtar i OKB-së, si periudha që ndihmoi në përgatitjen e vendit për formalizimin e pavarësisë, si fazë e tretë.

3. Periudha e rezistencës paqësore krahas arritjeve dhe efekteve konkrete manifestoi pafuqi të theksuara të cilat më së shumti janë rezultat i mosveprimit. Pra, mosbindja u shoqërua me mosveprim. Organet e shtetit paralel, Kuvendi dhe Qeveria, ishin plotësisht jovepruese. Madje, këto struktura të pushtetit paralel nuk ndodheshin fare në Kosovë. Funksionimi i arsimit paralel, si segment i rëndësishëm por i vetmuar dha efekte të kufizuara. E tëra që autoritetet e Beogradit pranuan të bisedojnë, ishin vetëm çështja e kthimit të godinave shkollore për nxë-

<sup>11</sup> Wesley Clark, Të bësh luftë modern, Zëri, Prishtinë, 2003, f. 380

<sup>12</sup> Clarck, Të bësh luftë modern, f. 384.

nësit shqiptarë. Rrjedhimisht arritje të kufizuar pati edhe në sensibilizimin e mjaftueshëm të faktorit ndërkombëtar. Ky i fundit, lëvizi vetëm në raste ku kishte luftë dhe viktima, por jo edhe në Kosovë.

4. Në aktualitetin ballkanik të fillimviteve '90 të mpleksur me një mendësi të luftërave dhe të konflikteve më të përgjakshme, u provua se vetëm politika e mbështetur te fuqia, pra realpolitika, mund të sillte ndryshime. Bosnja dhe Dejtoni qenë leksione për Kosovën. Lufta mbrojtëse e UÇK-së me gjithë limitet e fuqisë së saj, arriti të krijojë një momentum të ri, ku faktori ndërkombëtar nuk mund të rrinte duarkryq. Madje, nuk mund të përmbyllte dosjen e ish-Jugosllavisë, pa i dhënë zgjidhje edhe çështjes së Kosovës. Rrjedhimisht, fuqia e luftës çlirimtare solli komunitetin ndërkombëtar para vendimeve historike të ndërhyrjes ushtarake si forma e vetme për të ndalur gjenocidin shtetëror dhe spastrimin etnik të Kosovës.

5. Administrimi ndërkombëtar i Kosovës erdhi vetëm pas triumfit të luftës çlirimtare të ndihmuar nga forcat e NATO-s mbi ushtrinë serbe përmes një marrëveshjeje ushtarake ndërkombëtare. Kjo provoi edhe njëherë definicionin më të vjetër për luftën se ajo është vazhdim i politikës me mjete të dhunshme. Serbia duke iu bindur tashmë realpolitikës se re, u detyrua të ndërrojë qëndrimin karshi Kosovës. Administrimi ndërkombëtar i Kosovës, si fazë e fundit e parapavarësisë së Kosovës, duhet konsideruar e rëndësishëm për faktin e vetëm se krijoi një ambient ku mund të punohej në përgatitjet për shpalljen e pavarësisë.

6. Të tria këto faza në vetvete kanë rëndësinë e pakontestueshme të tyre. Ato duhen parë si hallka të pashkëputshme të një zinxhiri të cilat, me gjithë dobësitë që kanë manifestuar në momente të caktuara, e kanë plotësuar njëra-tjetrën. Por, pa asnjë dyshim, fazë përcaktuese për fatin e Kosovës mbetet Lufta Çlirimtare e viteve 1998-1999, e cila mund të cilësohet si lufta me e suksesshme çlirimtare, në historinë e lëvizjeve të rezistencës antikoloniale të shekullit XX.

7. Nuk do të dëshiroja që këto konstatime të mia të shihen si qasje konformiste për të pajtuar polarizimet që rrjedhin nga kjo trashëgimi politike, por si një diskurs që duhet ta dominojë debatin akademik ndër ne. Kosova ka pasur një proces të gjatë dhe të vështirë të çlirimit dhe mëvetësimit të saj. Të gjitha ata që kontribuuan në këtë mision, duhet parë pa nihilizëm, ndaj dhe krejt në fund kam një sugjerim që për tema të tilla të debatohet në nivele të profesionistëve. Dua ta shoh edhe këtë konferencë të sotme që është vënë në funksion të këtij misioni, pra,

misionit se historinë më të re të Kosovës duhet ta shkruajnë historianët me gjakftohtësi dhe paanësi maksimale.

Salihe Salihu

## LEGJITIMITETI I INTERVENIMIT TË NATO-S NË KOSOVË DHE DOKTRINA CLINTON

### Abstrakt

Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, (NATO) ka intervenuar edhe në vende të tjera, por intervenimi i NATO-s në Kosovë paraqet detyrë imperative për ndërprerjen e përhapjes së një gjeometrie të re gjenocidale, kundër ringjalljes së veprimeve hitleriane, kundër holokaustit që ishte duke u ushtruar nga regjimi millosheviqian kundër popullit shqiptar në Kosovë. Këto ngjarje të tmerrshme zhvilloheshin në prag të fundit të shekullit XX, ndonëse në Kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB-së), që ishte hartuar pas periudhës së Luftës së Dytë Botërore, ishte e sanksionuar çdo shfaqje e gjenocidit dhe cilësohej si një veprim kriminal kundër sistemit ndërkombëtar dhe kundër vlerave njerëzore.

Sanksionet ndërkombëtare kundër gjenocidit nuk u përfillën nga regjimi i Beogradit. Qëllimi i regjimit serb ishte që t'i nxirrte nga rrënjët e veta të gjithë shqiptarët duke kryer veprime të rënda gjenocidale e duke shkaktuar vrasje masive, masakrime çnjerëzore dhe dëbime masovike. Bota u tmerrua nga pamjet e llahtarshme të veprimeve gjenocidale serbe kundër shqiptarëve. Gjendja e shqiptarëve ishte katastrofike dhe me potencial për përhapjen e kësaj katastrofe humanitare në rajon e më gjerë. Popujt në vende të ndryshme të botës bënë thirrje për të ndaluar dhe për të mos lejuar vazhdimësinë e krimeve gjenocidale.

Para Bashkësisë Ndërkombëtare (BN) u shtrua si një detyrë imperative ndërprerja e veprimeve gjenocidale serbe në Kosovë. NATO-ja e mbështetur fuqishëm nga SHBA-ja në krye me doktrinën e presidentit Clinton përcjellin vëmendshëm gjendjen e popullatës shqiptare në Kosovë. Pas shterimit të të gjitha mjeteve paqësore për ta ndërprerë vazhdimin e gjenocidit në Kosovë u paraqit nevoja për përdorimin e forcës ushtarake. Dështimi i të gjitha veglave diplomatike parashtrroi domosdoshmërinë e intervenimit të NATO-s si mjet i fundit për të ndërprerë gjenocidin që ishte duke kryer regjimi serb në Kosovë. Intervenimi ishte detyrë imperative e NATO-s për të ndërprerë gjenocidin dhe për të kufizuar përhapjen e krizës humanitare në rajon e më gjerë.

NATO-ja intervenimin humanitar në Kosovë e mbështeti në referencat e mbrojtjes së vlerave të sistemit ndërkombëtar që në mënyrë implicite e eksplicite janë legale e legjitime. Mbi këtë sfond bazik në mbrojtje të vlerave humane u unifikuan anëtarët e NATO-s dhe më 24 mars të vitit 1999-të goditën bazat e forcave ushtarake serbe që kryenin veprime gjenocidale kundër shqiptarëve. Me këtë intervenim NATO-ja dëshmoi se parimet fundamentale për mbrojtje humanitare janë mantra e saj.

*Fjalët çelës:* NATO, intervenimi, imperativi, Kosova, legjitimiteti, legaliteti, doktrina

## Hyrje

Shkaqet e nxitjes së zjarrit të konflikteve janë të natyrave të ndryshme por më të përhapurat janë nxitja e konflikteve me tipare të etnocentrizmit nacionalist, fundamentalizmit fetar apo qeverive represive, por ka raste edhe për shkak të mungesës së efektivitetit qeveritar të ndizen konfliktet. Në këto konflikte përfshirja është kolektive dhe zakonisht pasojat më të rënda i vuajnë grupet më vulnerable, gra, fëmijë e të moshuar (Thomahausen, S. 2002:88), me potencial të shaktimit të krizave humanitare dhe tendencës të përhapjes së tyre.

Në rrethana të konflikteve të ngjashme intervenimi humanitar shtrohet si imperativë dhe zë vend si kryefjalë gjatë shqyrtimit nga të gjitha organizatat që vepronë në kuadër të sistemit ndërkombëtar për të drejtuar emergjenca humanitar. Vlerësuar me këtë këndvështrim, intervenimi i NATO-s në Kosovë ishte emergjencë humanitare kundër dhunës gjenocidale transparente të Serbisë që ushtronte kundër popullatës shqiptare në Kosovë. Gjenocidi në Kosovë dëshmohej nga evidencat e mizorive serbe dhe nga të dhëna që ishin të grumbulluara nga organizatat të ndryshme që vepronin në Kosovë. Aty dëshmohej për masakrimin e civilëve të vrarë e shkatërrimin e pasurisë tyre nga forcat ushtarake serbe që përpos vrasjeve masive të civilëve shqiptarë bënë edhe pastrimin etnik të territorit të Kosovës<sup>1</sup> që ishte i banuar me popullsi shqiptare më shumë se 90%.

Në fakt intervenimi i NATO-s ishte i vonshëm po qe se e studiojmë mirë filluesën e veprimeve gjenocidale të serbëve kundër shqiptarëve në Kosovë. Historikisht, Serbia kishte kryer gjenocid ndaj shqiptarëve në periudha të ndryshme, si gjatë kohës kur Ballkani ishte nën sundim të Perandorisë Osmane, si dhe pas copëtimit të Shqipërisë dhe mbetjes së Kosovës nën mbretërinë e sllavëve<sup>2</sup>. Po ashtu, pas Luftës së Dytë Botërore dhe kohës së konstituimit të Federatës Jugosllave e më

<sup>1</sup> <https://www.jstor.org/stable/2555349?seq=1>

<sup>2</sup> Profesori i lëndës të historisë, suedezi Göran Wassenius, pohon se: "E vërteta për Kosovën është se krahina u pushtua nga serbët në Luftën Ballkanike të viteve 1912-1913. Asnjëherë nuk është arritur ndonjë konsensus apo marrëveshje mes palëve rreth territorit të pushtuar. Beogradi menjëherë kishte filluar politikën e dëbimit dhe shfarosjes, e cila vazhdoi deri në vitin 1999. Qëndrimi i serbëve ndaj shqiptarëve mund të përshkruhet më së miri me një fjalë të vetme: përbuzje." (<https://www.fria.nu/artikel/20877> vizituar me 02-04-2022).

pas në kohën e Rankoviçit gjatë viteve 1960 serbët kishin kryer gjenocid kundër popullatës shqiptare në Kosovë.

Dhuna gjenocidale serb kundër shqiptarëve gjatë viteve 1980<sup>3</sup> vazhdoi të kryhej me gjithë faktin se në botë ishin duke u bërë përpjekje për rrëzimin e qeverive diktatoriale dhe ishte duke u përmbytur sistemi komunist, ndërsa në Kosovë u fuqizua sistemi i apartheidit për shqiptarët. Nga vazhdimi dhe fuqizimi i sistemit politik të apartheidit pësuan shumë shqiptarë dhe statistikat tregojnë se një e treta e popullsisë shqiptare, rreth gjashtëqind mijë (600 000), ishin arrestuar që nga viti 1981 deri në vitin 1988 duke i marrë në pyetje hetimore apo duke kaluar procese gjyqësore. Ndërsa në të njëjtën periudhë kohore ishin dënuar 22 000 shqiptarë me dënime drakonike prej 2 deri në 14 vjet burgim (Salihu, S. 2000:22-3). Në Evropë në periudhën e viteve 1990 kishte marrë hov zhvillimi i fazës së tretë të demokracisë në Evropë, kurse në Kosovë mori hov sistemi i apartheidit dhe ndryshoi metoda e dhunës kundër shqiptarëve, nga krimet gjenocidale të maskuara kaloi në metodën e hapur me formën e vprimeve gjenocidale transparente.

Ripërplasja gjithëpërfshirëse mes qeverisë serbe dhe shqiptarëve pas demonstratave të vitit 1981, të cilat u shtypën në mënyrë të dhunshme, ndodhi në vitin 1989 kur shqiptarët dolën në protesta masovike në mbrojtje të Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974. Qeveria e Millosheviçit mori masa për suprimimin e autonomisë së Kosovës, ndërsa shqiptarët duarthatë kundërshtonin këtë shfuqizim. Akti i suprimimit të Kushtetutës ishte grusht-shtet kundër Federatës Jugosllave (Salihu, S. 2000:34), dhe ky akt u pasua me vendosjen e mjeteve juridike për të ushtruar gjenocid transparent kundër shqiptarëve. Qeveria e Serbisë me akte normative ushtronte diskriminimin ndaj shqiptarëve edhe pse në

---

<sup>3</sup> Në vitet 1980 pushteti jugosllav kreu shumë vrasje ndaj demonstruesve shqiptarë që kërkonin liri e barazi me popujt e tjerë të Federatës. Vrasjet e shqiptarëve gjatë viteve 1980 u kryen edhe mbi djemtë shqiptarë që kryenin shërbimin ushtarak në ushtrinë federative. Në këto vite nga mjekët sllavë vriteshin edhe fëmijët shqiptarë vetëm pse kishin përkatësi shqiptare. Një ndër fëmijët e vrarë ishte edhe biri im ILIRI (1985), që ishte pesë muajsh dhe që vdiq nga helmimi i ilaçeve që mori nga pediatri shovinist me emrin Panajot në qytetin e Ferizajit. Në natën e kobshme të vdekjes së tim bir ILIRIT ishin edhe 8 fëmijë të tjerë shqiptarë. Mjeku kujdestar shqiptar konstatoi se vdekja e Ilirit u shkaktua nga ilaçet vdekjeprurëse që kishte marrë nga mjeku Panajot. Vrasje të ngjashme të fëmijëve shqiptarë nga mjekët e infermierët serbë morën hov edhe më të madh në fillim të viteve 1990 duke i vrarë fëmijët shqiptarë me ngufatje gjatë procesit të lindjes së tyre nga nënat shqiptare. Për të shpëtuar fëmijët nga vdekja gjatë viteve 1990 alternativa e vetme ishte që nënat shqiptare të lindnin fëmijët e tyre në shtëpi ose të shkonin gjenin gjinekologë me përkatësi shqiptare.

Kosovë jetonin më shumë se 90% të popullatës shqiptare (Thomahausen, S. 2002:88). Politika gjenocidale transparente serbe u përditësua kundër shqiptarëve dhe i detyroi shqiptarët që të kërkoni alternativa për të mbijetuar në shtëpitë e veta. Shqiptarët nuk patën mundësi për vetëmbrojtje ushtarake, por u bashkuan rreth një diskursi politik paqësor. Në të vërtetë, Kosova u shndërrua në një vend të pasigurt për të jetuar që mbahej nën sistemin e aparteidit dhe shqiptarëve u mohojë drejta më elementare e shkollimit në gjuhën amtare. Në kushte të rënda jeta e tyre rrezikojë edhe nga varfëria ekonomike meqë shqiptarët mbetën pa punë dhe pa të ardhura ekonomike.

Shqiptarët arritën për të mbijetuar ekonomikisht dhe për të siguruar ekzistencën e tyre nga ndihmat financiare të diasporës shqiptare që vinin nga të gjitha anët e botës e në veçanti nga diaspora shqiptare në Evropë e Amerikë, pothuajse më shumë se një dekadë. Diaspora shqiptare përveç që ndihmonte ekonomikisht gjithashtu luajti një rol të rëndësishëm për sensibilizimin e çështjes shqiptare në botë dhe ndërtoi kanale të informimit të rregullt të BN-ja për gjendjen e rënduar në Kosovë.

Me gjithë sensibilizimin e çështjes shqiptare në të gjitha instancat ndërkombëtare megjithëkëtë Kosova nuk mori përkrahje të mjaftueshme. Bashkësia Ndërkombëtare gjatë asaj periudhe, gjatë viteve 1990-1995, përveç nxjerrjes së disa rezolutave nga Asambleja e Përgjithshme, si dhe nga Komisioni i Drejtave të Njeriut të OKB-së, ku dënoshin aksionet e pushtetit serb kundër shqiptarëve nuk ndërmori masa të tjera. Por këto Rezoluta nuk patën ndonjë efekt pozitiv për të ndaluar dhunën e pushtetit serb kundër shqiptarëve (Salihu, S. 2000:48-9).

Në Kosovë vazhdonin arrestimet arbitrare dhe dhuna gjenocidale e cila rritej me shpejtësi kundër shqiptarëve me autorizim shtetëror nga Serbia. Në anën tjetër, politikanët shqiptarë vazhdonin të kërkonin zgjidhje paqësore në mënyrë demokratike dhe kishin deklaruar shpalljen e pavarësisë së Republikës të Kosovës në kuadër të Federatës Jugosllave. Shqiptarët për realizimin e kërkesave të tyre mbajtën referendum dhe zgjedhën presidentin e vet (Thomahausen, S. 2002:89), por pas referendumit të vitit 1991 dhe zgjedhjes së presidentit, si dhe qeverisë në vitin 1992, nuk arritën asnjëherë që këto organe udhëheqëse të Kosovës t'i ushtronin kompetencat e tyre.

Me përshkallëzimin e gjendjes së sigurisë gjatë viteve 1990 në tërë Federatën Jugosllave dhe ushtrimin të gjenocidit kundër shqiptarëve u përkeqësua edhe më shumë situata në Kosovë. Në fillim të pranverës së vitit 1990, siç u përmend më lart, ndodhi kalimi i përdorimit të

formës së veprimit të gjenocidit të maskuar serb në formë të veprimeve gjenocidale transparente serbe kundër shqiptarëve. Gjatë kësaj kohe regjim serb i helmoi nxënësit e përkatësisë shqiptare në shkolla në mënyrë kolektive.<sup>4</sup> Pas helmimeve të nxënësve filloi fushata për përjashtimin e gjithë punëtorëve shqiptarë nga vendi i tyre i punës të cilët mezi siguronin ekzistencën e familjeve të veta. Si pasojë e përjashtimit nga vendi i punës iu rrezikua siguria ekzistenciale e jetës personale dhe të familjeve të tyre. Në përpjekje për të shpëtuar jetën e vet dhe familjeve të tyre një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve migruan dhe u paraqitën azilkërkues në shtet të tjera më të sigurta. Sipas evidencave para fillimit të luftës, gjatë periudhës së viteve 1990-1997 më shumë se pesëqind mijë shqiptarë emigruan nga Kosova (Salihu, S. 2000:43). Në fillim të luftës në Kosovë, gjatë vitit 1998, sipas profesorit të së drejtës ndërkombëtare Morton, shifra e shqiptarëve të zhvendosur nga shtëpitë e tyre ishte më shumë se dyqind mijë (Morton, S. Jeffrey 2002:76), ndërsa numri i refugjatëve në shtete fqinje kishte arritur afro katërqind mijë (Salihu, S. 2000:55), dhe kjo shifër arriti afro një milion refugjatë shqiptarë gjatë kohës së intervenimit të NATO-s.

Këto fakte i demantojnë pretendime tendencioze të disa shteteve që kundërshtuan intervenimin e NATO-s që duke e akuzuar NATO-n për përshkallëzimin katastrofik të gjendjes në Kosovë me pohimet që gjoja ushtria serbe nga zemërimi prej bombardimeve të NATO-s kryente masakra kundër popullatën shqiptare dhe dëbonte shqiptarët nga shtëpitë e veta. Mbështetur në argumentet faktike dëshmohet se vrasjet makabre dhe dëbimet e popullatës shqiptare nga forcat ushtarake u kryen sistematikisht para se të intervenonte NATO-ja. Bazuar në të dhënat statistikore vetëm gjatë një periudhe gjashtëmujore përpara fillimit të bombardimeve të NATO-s, pra gjatë viti 1998, më se 200, 000 (dyqind mijë) shqiptarë kishin braktisur shtëpitë e tyre (Morton, S. Jeffrey 2002:77) dhe katërqind mijë ishin refugjatë në vende fqinje nga përndjekja dhe dhuna që ushtronin forcat serb kundër popullatës shqiptare.

Shkaktimi i emergjencës humanitare nga veprimet gjenocidale transparente serbe e obliguan Bashkësinë Ndërkombëtare që me aksion humanitar të ndërhyjë për t'i ndërprerë këto krime jashtëzakonisht të

---

<sup>4</sup> <https://bengtsjoberg.blogg.se/2009/march/den-mystiska-sjukdomen-i-kosova.html>. Për më shumë rreth helmimit të nxënësve shqiptarë mund të gjeni në librin "Den mystiska sjukdomen: vad hände i Kosova (Kosovo) 1990?" nga Göran Wassenius. ISBN 9789186407179

përmasave të mëdha kundër shqiptarëve në Kosovë. Kryerja e masakrave në Kosovë e tërhoqi vëmendjen e botës demokratike në drejtim të Kosovës dhe i bënin thirrje Serbisë që të ndalonte vrasjen e civilëve, grave, fëmijëve, e të moshuarve civilë. Intensiteti i veprimeve gjenocidale transparente serbe u rrit në mënyrë drastike në veçanti në vitet 1998-1999 dhe nëse nuk do të ndërmerreshin masa për të ndërprerë gjenocidin transparent me një aksion humanitar, atëherë do të vihej në dyshim edhe vetë ekzistenca e sistemit ndërkombëtar dhe organeve të tij.

Bashkësia Ndërkombëtare përveç kërkesave ultimative ndaj Serbisë për ndërprerjen e veprimeve gjenocidale në Kosovë synonte edhe evitimin e përhapjes së luftës së Kosovës në rajon e më gjerë. Në përpjekje paqësore për të ndërprerë këtë krizë humanitare, Bashkësia Ndërkombëtare nuk arriti të ndalojë aksionet e ushtrisë serbe kundër popullatës shqiptare në Kosovë. Refuzimi i regjimit të Serbisë për të ndaluar kryerjen e gjenocidit kundër shqiptarëve dhe shkeljet e rënda që cenonin të gjitha Kartat e Konventat Ndërkombëtare ishte sfida me peshë të madhe për Bashkësinë Ndërkombëtare. Vazhdimësia e veprimeve gjenocidale serbe e detyruan Bashkësinë Ndërkombëtare që fillimisht të përdorte të gjitha mjetet diplomatike për të ndërprerë këto akte. Në procesin diplomatik u përdorën të gjitha format diplomatike deri në shterimin e tyre dhe pas dështimit për ndërprerje të fushatës gjenocidale serbe në Kosovë u shfaq domosdoshmëria si detyrë imperative që përmes një aksion humanitar të intervenohet ushtarakisht me forcat ajrore të NATO-s në Kosovë.

Në kërkim për gjetjen e një metode më efektive për të arritur ndalimin e aksioneve të forcave ushtarake serbe dhe pasi kishin dështuar të gjitha orvatjet për zgjidhje paqësore e vetmja masë e duhur e shpresëdhënëse ishte intervenimi humanitar. Rreth alternativës së intervenimit ajror të forcave të NATO-s pati reagime nga këndvështrime të ndryshme që zgjuan debat të nxehtë. Me gjithë kundërthëniet e përplasjet për përdorimin e metodave të NATO-s megjithëkëtë tema që dominonte në debate, ishte domosdoshmëria për ndërprerjen e dhunës gjenocidale serbe kundër shqiptarëve.

Fiaskot e Bashkësisë Ndërkombëtare që të zbatojë Konventën për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit (1948) ishin të njohura edhe në vendet e tjera pasi nuk kishte arritur të qëndronte e vendosur kundër gjenocidit dhe jetësimit të sloganit “Never Again”. Në korrigjim të këtyre fiaskove qëndronin, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-ja të cilat ishin përcaktuar që të mos lejonin që të përjetonin

përvojën e hidhur sikurse në konflikte në Ruandë e në Srebrenicë. Kryeraja e gjenocidit në këto vende dhe gjenocidi aktual në rastin e Kosovës i detyroi shtetet demokratike që të mos qëndronin indiferent. Reagim i unifikuar i nëntëmbëdhjetë shteteve demokratike ishte me një konstatim të qartë që një aksion humanitar i intervenimit të NATO-s kundër forcave ushtarake serb në Kosovë ishte çështje imperative.

Rrjedhimisht, imperativi i intervenimit të NATO-s në Kosovë u bë pjesë e historisë së ndërhyrjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Qëllimi i vendimit që përcaktoi nevojën e imperativit për intervenim ishte marrë me motivin që të ndërpriten krimet e tmerrshme të gjenocidit serb në Kosovë.

NATO-ja për intervenimin imperativ në Kosovë kishte përcaktuar objektiva të panegociushme në të cilat përfshiheshin:

1. Fundin e vrasjeve nga forcat e ushtrisë dhe policisë jugosllave në Kosovë;
2. Tërheqja e atyre forcave;
3. Vendosja e një force ndërkombëtare të udhëhequr nga NATO-ja;
4. Kthimi i të gjithë refugjatëve; dhe
5. Zgjidhja politike për Kosovën (Morton, S. Jeffrey 2002:78).

Pozicionimi dhe përkrahja e imperativit të intervenimit të NATO-s ishte një mbështetje jo vetëm ndaj Kosovës, por edhe në përkrahje të vlerave të sistemit ndërkombëtar dhe referencë kryesore kishte mbrojtja e të drejtave të njeriut. Zotimi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ishte dhe mbetet detyrim i sanksionuar në Kartën e OKB-së dhe mbi këtë bazë imperativi i intervenimit të NATO-s në Kosovë ishte legjitim dhe legal.

Aksioni imperativ i intervenimit të NATO-s në Kosovë ishte bazuar në dispozitat e Kartës së OKB-së dhe konventat e tjera përcjellëse që kanë parashtruar detyrat obligative për sigurinë dhe mbrojtjen humanitare. Në këtë këndvështrim, mbështetja dhe përkrahja në baza humanitare për të ndërprerë vazhdimin e krimit gjenocidal të regjimit të Serbisë kundër popullit shqiptar të Kosovës, rezultoi se intervenimi i NATO-s posedonte legjitimitet dhe legalitet. Këtë legjitimitet e legalitet përveç argumentimeve të mësipërme e përforcon edhe teoria e John Rawls-it, "A Theory of Justice" (1971) që parasheh që të gjitha shoqëritë e shohin çështjen e sigurisë njerëzore si një e drejtë themelore dhe bazuar në këtë të drejtë është i pakontestueshëm imperativi për intervenim humanitar me synim parësor për ta shpëtuar jetën e njerëzve.

## Legjitimiteti i intervenimit të NATO-s në Kosovë

*“Nëse ligjet ku mishërohet paqja dhe siguria njerëzore, nuk zbatohen atëherë për çfarë lloj ligji dhe rregulloreje mund të flasim?!” (Salihu. S. 2024)*

Në literaturën shkencore nga filozofë me famë, si Aristoteli e të tjerë është trajtuar pyetja se kur dhe në çfarë rrethana mund komunitetet politike të shkojnë në mënyrë legjitime në luftë (O'Driscoll, Cian). Një luftë mund të konsiderohet si luftë e drejtë kur ka për qëllim për të shpëtuar jetët e njerëzve. Ndërhyrja humanitare me qëllim të shpëtimit të jetës së njerëzve konsiderohet vetëm si një nëngrup që mishërohet si pjesë përbërëse në paradigmen e Luftës së Drejtë (Knotter, Lucas, 2022:87).

Padyshim se paradigma e Luftës së Drejtë në shpëtim të jetës së njerëzve në Kosovë është aplikuar në intervenimin humanitar të NATO-s në Kosovë më 24 mars 1999 që zgjati 78 ditë. Bashkësia Ndërkombëtare (BN) posedonte argumente faktike që dëshmonin se forcat ushtarake të Serbisë kishin filluar lëvizjet ushtarake nga një fshat në fshatin tjetër duke vrarë civilët shqiptarë dhe bombarduar e djegur shtëpitë e tyre. Kryesisht ishin civilët shqiptarë të zënë peng nga forcat ushtarake serb që përdhunoheshin dhe pas përdhunimeve barbare vriteshin. Bombardimi i fshatrave dhe masakrat kundër popullatës civile shqiptare është e sanksionuar në disa Rezoluta të BN-së, por nuk respektoheshin. Veprimet e tilla tregonin se forma e luftës në Kosovë nuk ishte një luftë e sensit tradicional, por ishte një sulm me tanke e artileri kundër popullatës së pambrojtur dhe liderëve të tyre që kërkonin zgjidhje paqësore.<sup>5</sup>

Këto rrethana bënë që bota demokratike të pozicionohet në mbrojtje të njerëzve që ishin viktimat të regjimit serb dhe të përçaktoshin për domosdoshmërinë e evitimit të përhapjes së krizës humanitare. Përplasja e qëndrimeve për këtë ndërhyrje humanitare nuk ishte se mungonte bazamenti ligjor, por mungonte vullneti i Rusisë dhe i Kinës për t'i dhënë autorizim intervenimit humanitar të NATO-s në Kosovë. Përpjekja për gjetjen e metodave për të mos përshkallëzuar kontradiktën në mesin e atyre shteteve që ishin për mbrojtje humanitare dhe atyre kundër, si Rusia e Kina që ishin anëtare të përhershme në

<sup>5</sup> <https://www.clintonlibrary.gov/sites/default/files/documents/kosovo-press-1999.pdf> vizituar me 14-5-2018

Këshillin e Sigurimit, e prolongonin intervenimin humanitar në Kosovë. Rusia dhe Kina ndiheshin inferiore në raport me unitetin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe shteteve demokratike evropiane që përkrahnin imperativin për intervenimin humanitar. Në këtë kontekst, Rusia dhe Kina ishin përqendruar për të mbrojtur interesat e veta në synim të ruajtjes së pozicionimit të fuqisë së tyre në rendin botëror ndërkombëtar dhe në këtë betejë për pushtet e bllokoni përkrahjen për të intervenuar në Kosovë. Në përpjekje për t'i dhënë përgjigje situatës në Kosovë u mbajtën takime të shumta në organet e OKB-së, por në mënyrë decisive nuk u mor vendimi për të dhënë autorizim për intervenim humanitar të NATO-s, ndonëse ekzistonte baza normative.

Në kuadër të shqyrtimit të autorizimeve për situata të ngjashme ekzistonte përgjigje e gatshme që e kishte dhënë qeveria e Mbretërisë së Bashkuar e cila shpesh kishte mbrojtur pozicionin se ndërhyrja humanitare edhe pa pëlqimin e shtetit të synuar, atëherë kur është e nevojshme pa autorizimin e shprehur të Këshillit të Sigurimit të OKB-së – është ligjërisht e lejueshme në rrethana të jashtëzakonshme (Newman, Edward 2021:632). Argumentimi i qeverisë britanike për ligjshmërinë e intervenimit humanitar kishte referencë parimet e Kartës së OKB-së dhe në mënyrë të natyrshme vlen e njëjta ligjshmëri edhe në rastin e intervenimit për t'u dhënë përgjigje rrethanave të jashtëzakonshme në Kosovë.

Fuqizimin e legalitetit dhe legjitimitetit të intervenimit humanitar e rrit vetë fakti që BN-ja është ndërtuar mbi përcaktime ligjore dhe morale për mbrojtje të paqes dhe sigurisë dhe zbatimi i këtyre përcaktimeve është normë e detyrueshme brenda një rendi ndërkombëtar. Në skicim të këtyre përcaktimeve gjenden të ngërthyera konceptet, si arsyeja, justifikimi dhe bindja. Përpunimi i këtyre koncepteve në procesin e vendimmarrjes është vlerë etike në matjen e argumentimeve dhe dëshmime faktike për të arritur deri te legjitimiteti. Kështu që vendimmarrja domosdoshmërisht duhet të paraprihet prej një debati me përmbytje morale, ligjore e politike për të arsyetuar njohjen apo mosnjohjen e legjitimitetit (Naomi, H. 2012:33). Nëse çështja kalon nëpër këtë proces atëherë në mënyrë implicite sigurohet legjitimiteti. Ligjshmëria, drejtësia e legjitimiteti së bashku kanë një marrëdhënie të ngushtë me moralin. Në thelb, të të gjitha koncepteve, ligjshmëria, legjitimiteti e drejtësia janë nxjerrë nga burimi i kthjelltësisë së moralit të pastër për të arsyetuar jetësimin e tyre dhe për të pasur mbështetje në të gjitha instancat botërore e rajonale në gjithë botën. Bazuar në këtë proces të vendimmarrjes Kosova posedonte arsye dhe justifikim moral për

imperativin e intervenimit humanitar dhe gëzonte edhe legjitimitet edhe pa autorizimin decidiv të KS-së.

Mungesa e autorizimit të Këshillit të Sigurimit (KS) nuk e zbeh aspak legjitimitetin e intervenimit të NATO-s meqë intervenimi qëndron në referencën e të gjitha parimeve mbi të cilat është etabluar OKB-ja dhe NATO-ja. Edhe në rastet kur mungon autorizimi eksplicit i KS për intervenim humanitar në ndalimin e shkeljeve të rënda sistematike ndaj të drejtave të njeriut atëherë legjitimiteti i intervenimit është i pakontestueshëm bazuar në normativat e së drejtës zakonore ndërkom-bëtare. Në këtë drejtim, në synim të ndalimit të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në Kosovë ekzistonin prova të mjaftueshme për shkelje masive të të drejtave të njeriut (Thomahausen, S. 2002:110) me përmasa të dhunës gjenocidale.

Imperativi i intervenimit e sfidoi mungesën e autorizimit të KS-së dhe më këtë sfidë u përballën edhe avokatët e të drejtave të njeriut. Avokatët, siç pohon Jonathan I. Charnet, nuk mund të rezistonin ndaj dëshmimeve të argumentuara se ishin kryer mizori në Kosovë dhe gjendja e rëndë thërriste për përdorimin e forcës në kuadër të parametrave të intervenimit humanitar për të ndërprerë ofensivën e forcave serbe kundër popullatës shqiptare. Imperativi i intervenimit bazohej në prova të spastrim etnik, përdhunimeve e formave të abuzimeve të tjera sistematike. Në sajë të këtyre dëshmimeve NATO-ja përdori forcën ushtarake ekskluzivisht me qëllim për të shmangur katastrofën humanitare.<sup>6</sup>

Po ashtu, legjitimiteti i intervenimit mbështetet edhe në deklaratat e presidentit të Këshillit të Sigurimit më 29 janar 1999 i cili e mirëpriti planin e Grupit të Kontaktit. Deklarata e presidentit të Këshillit të Sigurimit u bë pasi sekretari i përgjithshëm i NATO-s Javier Solana kishte dhënë paralajmërim kërcënues për intervenim të NATO-s kundër Serbisë. Mbështetje të ligjshmërisë së imperativit të intervenimit në Kosovë i jepte edhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Kofi Annan, i cili në prononcimin e tij bënte thirrje ndërgjegjes kolektive të njerëzimit për mbrojtje të paqes dhe drejtësisë (Salihu, S. 2000:67). Në fjalimin e Kofi Annan-it në sesionin e 55-të në Komisionin e Drejtave të Njeriut potencoi se autoritetet serbe në Kosovë kishin një objektiv antinjerëzor për të përzënë e vrarë shqiptarë dhe duke provokuar një katastrofë humanitare në rajon. Kofi Annan-i në vazhdim të fjalimit dënonte veprimet gjenocidale duke nënvizuar se gjenocidi nuk ka ekuivalent dhe shenjat e veprimeve gjenocidale në Kosovë janë duke u verifikuar (Krisafi, K.

<sup>6</sup> <https://www.jstor.org/stable/2555349?seq=1> vizituar 02-01-2024

2018:197). Kofi Annan-i edhe në prononcimin e tij në Këshillin e NATO-s (NAC) në Bruksel kërkonte bashkërendim dhe koordinim të NATO-s me OKB-në në çështjet e luftës dhe ruajtjes së paqes dhe sigurisë (Thomahausen, S. 2002:107).

Krahas legjitimitetit të intervenimit ekzistonte edhe legaliteti për intervenimin e NATO-s duke iu referuar tërësisë së rezolutave të Këshillit të Sigurimit që janë normativa detyruese të sanksionuara në dispozitat e Kartës së OKB-së. Si çështje e hapur në dispozitat e Rezolutave (nr. 1199; nr. 1203) ishte ndërmarrja e masave shtesë për të ndaluar përshkallëzimin e dhunës serbe në Kosovë dhe në mbështetje të masave shtesë legjitimohet imperativi për intervenim humanitar në Kosovë gjatë vitit 1999. Me formulimin si çështje e hapur për masa shtesë legalizohet intervenimi në mbrojtje të shqiptarëve nga dhuna vrastare e ushtrisë serbe.

Rrjedhimisht, legjitimiteti dhe legalizimi i intervenimit ishte në përputhje me Rezolutat e KS në të cilat ishte miratuar përcaktim i qartë që të merren masat e nevojshme për të mbajtur paqen ndërkombëtare dhe sigurinë rajonale (Morton, S. Jeffrey 2002:76).

Gjendja kritike në Kosovë ishte me potencial për rrezikimin e paqes ndërkombëtare dhe sigurisë rajonale dhe në instancat e BN-së ishin ngritur shqetësimet ndaj këtij rreziku, prandaj u detyrua që të angazhohet për të ndërprerë luftën në Kosovë. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara duke u bazuar në kapitullin VII miratoi tri Rezoluta nr. 1160;1199 dhe 1203 në të cilat kërkohet që palët të negocionin për të gjetur zgjidhje paqësore.

Në përputhje me dispozitat e Rezolutës 1199 u arritën dy marrëveshje që u nënshkruara nga qeveria e Serbisë me ndërkombëtarët por që u shkelën nga vetë pala serbe. Në marrëveshjen e parë ishte pranuar që Organizata e Sigurisë dhe Bashkëpunimit Evropian (OSBE) të themelojë Misionin e Verifikimit të Kosovës (MVK) që do të monitoronte situatën në Kosovë. Ndërsa Marrëveshja e dytë i lejonte NATO-s që të fillojë me një mision mbikëqyrës ajror mbi Kosovë. Gjithashtu në janar 1999, u ndërmor një nismë diplomatike ku anëtarë e Grupit të Kontaktit (Franca, Italia, Gjermania, Rusia, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA-ja) do të aranzhonin fillimin e negociimeve me palën serbe e shqiptare për hartimin e një kornize të autonomisë me të drejtë të mbajtjes së një referendumi pas tre vjetësh e cila do të ishte fazë përfundimtare për një zgjidhje paqësore. BN-ja tërhoqte vërejtjen se nëse marrëveshjet e arritura nuk do të respektoheshin atëherë paralajmërohej për bombardime nga NATO-ja (Morton, S. Jeffrey 2002:77).

Implementimit i marrëveshjeve dështoi, pasi forcat ushtarake serbe nuk e ndalën dhunën gjenocidale kundër shqiptarëve. Nga ky dështim përfundimisht u vendos që të fillohej me intervenim humanitar. Këshilli i Sigurimit të OKB-së u detyruar që, më 24 mars 1999, të mbajë një mbledhje urgjente për situatën në Kosovë, ndërsa NATO-ja filloi sulmet ajrore kundër caqeve të forcave ushtarake serbe. Intervenimi i NATO-s ngjalli reagime kundërtënëse edhe pse ishte veprim humanitar meqë disa shtete dënuan sulmet ajrore si një veprim i njëanshëm dhe shkelje të Kartës së Kombeve të Bashkuara, ndërsa shtetet e tjera pohuan se intervenimi e parandalonte zgjerimin e një katastrofe humanitare.<sup>7</sup>

Në lidhje me intervenimin, që filloi më 24 mars 1999 e zgjati 78 ditë, nga sa u tha më lart nuk mund të thuhet që nuk kishte legalitet apo legjitimitet, sepse ekzistojnë argumente të tjera shtesë. Intervenimi i NATO-s po të mos kishte legalitet atëherë do të ndërpritej menjëherë meqë Rusia së bashku me Bjellorusinë dhe Indinë, pas dy ditësh të fillimit të bombardimeve e kishte propozuar miratimin e Projekt-rezolutës për ndërprerje të bombardimeve në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Ky propozim i Projekt-rezolutës nuk u aprovuar nga Këshilli i Sigurimit. Projekt-rezoluta në fjalë, e 26 marsit, mori 3 vota pro nga Kina, Namibia, Federata Ruse, kurse kundër ishin 12 shtete të tjera anëtare. Refuzimi i Projekt-rezolutës së Ruisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së është de facto miratim i vazhdimësisë për intervenimin humanitar të NATO-s. Me këtë fuqizohet leja e vazhdimësisë së intervenimit të NATO-s dhe de facto me automatizëm ia siguron legalitetin dhe legjitimitetin e aksioneve të NATO-së në Kosovë. Këshilli i Sigurimit e hodhi poshtë Projekt-rezolutën e Ruisë dhe Bjellorusisë së datë 26 mars 1999 dhe me këtë refuzim konsiderohet se legalizimi fitoi legjitimitetin e intervenimit të NATO-s edhe nga Këshilli i Sigurimit.

Intervenimi i NATO-s u kritikua ashpër edhe në rastin e bombardimit të ambasadës së Kinës në Beograd. Ishte e menjëhershme dërgesa ankimore e Kinës në Këshillin e Sigurimit. Me kërkesë të qeverisë kineze për këtë çështje u takua sërish Këshilli i Sigurimit më 8 maj 1999. Përfaqësuesi kinez nënvizonte se NATO-ja kishte sulmuar në mënyrë flagrante Ambasadën e Kinës në Beograd me tri raketa, duke shkaktuar vdekje, lëndime dhe dëme të rënda. Kina e konsideroi si absurd argumentin justifikues nga NATO-ja që sqaronte se nuk e kishte bombarduar qëllimisht ambasadën kineze. Me gjithë kundërshtimet dhe

---

<sup>7</sup> <https://press.un.org/en/2000/20000118.sc6784.doc.html>

mospajtimet e përfaqësuesve kinezë në atë takim megjithëkëtë Këshilli i Sigurimit konstatoi se NATO-ja, nuk kishte shkelur Konventën për mbrojtjen diplomatike.

Argumenti tjetër që e forcon legjitimitetin e intervenimit është edhe refuzimi i kërkesës së qeverisë së Serbisë. Më 2 qershor 1999 Serbia iu drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për t'i dhënë urdhër NATO-s që të ndërpriste bombardimet në Kosovë. Në mbështetje të reagimeve refuzuese të instancave të nivelit ndërkombëtar për ndërprerjen e intervenimit i jep legalitet shtesë dhe legjitimitet të fuqishëm vazhdimi të intervenimit të NATO-s.

Argumentim tjetër shtesë është edhe Rezoluta 1244 në të cilën askund në asnjë fjalë në tekstin e saj nuk u dënua intervenimi i NATO-s. Në këtë Rezolutë u përcaktua të vazhdojë intervenimi humanitar i NATO-s duke ndryshuar formën e veprimit prej mënyrës së intervenimit ushtarak të NATO-s në intervenim me vendosjen e një force ushtarake ndërkombëtare në Kosovë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë (Thomahausen, S. 2002:108).

Duhet pasuar parasysh, që legaliteti dhe legjitimiteti i intervenimit të NATO-s është i mbështetur plotësisht në Deklaratën për të Drejtat e Njeriut e miratuar nga Asambleja e OKB-së në vitin 1948 me të cilën sfidohet sovraniteti i çdo shteti. Në këtë Deklaratë në nenin 29 pika 3 janë sanksionuara parimet e OKB-së dhe po të shikojmë më afër këtë nen shihet se është përfshirë mbrojtja e këtyre parimeve në tekstin e tri rezolutave të nxjerra në vitin 1998 për situatën në Kosovë. Gjithashtu, në këtë Deklaratë në nenin 30 është sanksionuar që asnjë shtet nuk ka të drejtë për të kryer çfarëdo veprimtarie ose për të bërë ndonjë veprim kundër çdo të drejte ose lirie të shpallur në këtë Deklaratë.<sup>8</sup>

Në mbështetje të këtyre parimeve doli Komisioni për të Drejtat e Njeriut të OKB-së për të debatuar gjatë në një debat special më 1 prill 1999, për tragjedinë e Kosovës dhe nga debatit i zhvilluar u konstatua se objektivi kryesor i Milosheviqit ishte zhdukja e plotë e etnisë shqiptare. Nga konstatimet përfundimtare të debatit u përligj edhe intervenimi i NATO-s. Në mbështetje të konstatimeve të Komisionit të Drejtave të Njeriut të OKB-së u deklarua edhe përfaqësuesi i Shqipërisë Ksenofon Krisafi. Në vlerësimin rreth bombardimeve të NATO-s Krisafi konstaton se operacioni i bombardimeve të NATO-s në Kosovë i jep fund teorisë klasike të së drejtës ndërkombëtare mbi modelin e sovranitetit absolut duke e zhveshur nga e drejta e ushtrimit të dhunës dhe

---

<sup>8</sup> [https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR\\_Translations/aln.pdf](https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf)

shkeljes së drejtave të njeriut nga ana e regjimeve autoritare e diktatoriale (Krisafi, K. 2018:167-87).

Në rrezikim të këtyre të drejtave me sinjale për zgjerim të krizës humanitare dhe në rastet të rrezikimit të paqes ndërkombëtare e sigurisë rajonale është detyrim obligues i OKB-së për të ndërmarre masa adekuate. Në rastin e Kosovës u përcaktuan tri parime për të intervenuar:

1) Parimi i parë kushtëzohej nga dy faktorë:

a) shkeljet e rënda të DN-së dhe

b) nënshtrimi i një shoqërie civile ndaj vuajtjeve dhe rrezikimi i jetës së tyre;

2) Parimi i dytë mbrojtja e popullsisë së viktimizuar;

3) Parimi i tretë merr parasysh nevojën për të marrë masa adekuate për t'i dhënë fund katastrofës humanitare në mbrojtje të të gjithë civilëve (Naomi, H. 2012:29).

Në bazë të këtyre tri parimeve intervenimi i NATO-s në Kosovë ishte legal e legjitim. Po ashtu, intervenimi i NATO-s legjitimohet edhe përmes doktrinës së Luftës së Drejtë e cila përmbledhet në katër parime kryesore:

1) Matja e drejtë e shkakut (humbje të jetës së njerëzve në shkallë të lartë ose spastrim etnik në shkallë të gjerë);

2) Qëllimi i drejtë, (lufta mjet i fundit, mjetet proporcionale dhe perspektiva të arsyeshme);

3) Autoritet i drejtë;

4) Parimet e operacioneve (objektivat dhe mandati i qartë, qasja e përbashkët ushtarake, rregullat e përshtatshme të angazhimit; pranimi i gradualizimit në aplikimin e forcës, koordinim maksimal me organizata humanitare dhe pranimi se mbrojtja e pushtetit nuk mund të jetë objektiv kryesor (Naomi, H. 2012:29).

Në thellim të analizimit të traditës së Luftës së Drejtë e gjejmë kuadrin më të sofistikuar që korrespondon me intervenimin e NATO-s dhe që shihet se është në përputhshmëri me doktrinën e mbrojtjes së një Luftë të Drejtë. Në bërthamën e traditës së Luftës së Drejtë janë parimet që japin përforcim të qëndrueshëm legalitetit dhe legjitimitetit të intervenimit të NATO-s.

## Plotësimi i parimeve të Luftës së Drejtë

Tradita e Luftës së Drejtë është modeluar dhe ka marrë formë nga konsensusi i gjerë i traditës dhe kulturës perëndimore në justifikim për të frenuar problemet e për të ndërprerë veprimet e dhunshme dhe luftërat kundër njerëzimit. Në pasqyrim për të parë harmonizimin e legjitimitetit të intervenimit të NATO-s në parimet e traditës së Luftës së Drejtë mund të drejtohem te kriteret e dy kategorive të kësaj tradite.

Në kategorinë e parë “*Ius ad Bellum*” (E Drejta për Luftë) mbrohet e drejta për të drejtuar një luftë. Në kategorinë e dytë “*Ius in Bello*” (Ligji në luftë) mbron mundësinë se si lufta mund të bëhet në mënyrë legjitime (Fixdal, M. & Smith, D. 1998:286). Në kategorinë e parë “*Ius ad Bellum*” në tabelën e listuar nga Richard B. Miller (1991:13-15) për Luftën e Drejtë janë 8 kriteret dhe të gjitha elementet e këtyre kriterëve përputhen me intervenimin e NATO-s në Kosovë.

1) Kriteri i parë që përfshin autoritetin e duhur (“right authority”). Ndonëse mungonte autorizimit eksplicit i Këshillit të Sigurimit megjithëkëtë edhe ky kriter është në përputhje me tekstet e Rezolutave për Kosovën që ishin miratuar e u nxorën nga Këshilli i Sigurimit dhe plotëson kushtin e autoritetit të drejtë. Në Rezolutat nr. 1199 ishte definuar që mbetet e hapur përdorimi i masave shtesë i cili ishte përsëritur në Rezolutën 1203. Kriteri për autoritetin e duhur plotësohet edhe kur Këshilli i Sigurimit nuk e kundërshtoi vazhdimësinë e aksioneve të NATO-s dhe refuzoi Projekt-rezolutën e Ruisë për ndërprerjen e intervenimit. Refuzimi i Këshillit të Sigurimit për të ndërprerë intervenimin është tregues i qartë që në mënyrë implicite është plotësuar edhe ky kriter dhe realisht legaliteti dhe legjitimiteti i intervenimit të NATO-s është i pakontestueshëm.

2) Kriteri i dytë është kauza e drejtë (“just cause”) që parasheh lejimin e përdorimit të forcës nëse ekziston kauzë e drejtë. Kriteri është në përputhje me kauzën e drejtë të NATO-s që kishte për qëllim për ta shpëtuar popullin shqiptarë nga ofensiva gjenocidale serbe.

3) Kriteri i tretë është qëllimi i drejtë (“right intention”) në të cilën përveç kauzës përfshihet edhe qëllimi i drejtë. Në këtë kriter kushëzohet që motivi të jetë i drejtë për t’iu përgjigjur kauzës për të arritur

një qëllim të drejtë. Nëse shohim këtë kriter në rastin e Kosovës është e qartë që qëllimi i kauzës ishte për ta shpëtuar popullin shqiptar nga dhuna gjenocidale serbe.

4) Kriteri i katërt është mjet i fundit (“Last resort”) që po ashtu edhe ky kriter është plotësuar në Kosovë. Përpara se të fillohej me intervenimin e NATO-s ishin shpenzuar të gjitha mjetet diplomatike. Intervenimi ishte mjet i fundit edhe për mbrojtjen nga shkelja e të gjitha normativave të OKB-së përfshirë edhe nxjerrjen e Rezolutave që kishin fuqi detyrues për t’i zbatuar por që nuk i zbatonte qeveria në Beograd.

5) Kriteri i pestë është i lidhur me proporcionalitetin (“Proportionality”) dhe në përmbushjen e këtij kriteri kërkohet që nga përdorimi i mjeteve luftarake të jetë i sigurt matja e proporcionalitetit që rezultati i dobive të jetë më i madhe dobia se shkaktimi i dëmit.

Thelbi i këtij kriteri është katërcipërisht i plotësuar dhe nuk ekziston ndonjë dilemë në përmbushjen e këtij kriteri në rastin e intervenimit të NATO-s në Kosovë. Dëshmitë flasin për dobitë të jashtëzakonshme që solli intervenim humanitar i NATO-s duke ndërprerë vazhdimin e veprimeve të gjenocidit serb dhe kthimin e afro një milion shqiptarëve në shtëpitë e tyre. Intervenimi i NATO-s plotësoi edhe përmbushjen e kërkesave të Grave në të Zeza në Serbi të cilat kërkonin nga pushteti në Beograd që të mos i dërgonin djemtë e tyre për të luftuar kundër shqiptarëve në Kosovë. Dobitë nga intervenimi mund të kategorizohen e radhiten në tri dimensione që ndikuan në: a) unifikimin e shteteve demokratike që qëndronin të palëkundura për t’i mbrojtur parimet thelbësore të OKB-së në ruajtën e paqes dhe sigurisë; b) shpëtimi i popullit shqiptar nga dhuna gjenocidale serbe dhe c) plotësimi i apelit të Grave në të Zeza që djemtë e tyre të mos dërgoheshin në luftë.

6) Kriteri i gjashtë është shpresë e arsyeshme (reasonable hope”) që bazohet në parimin fundamental të lirisë që si një vlerë universale mund të arrihej përmes Luftës së Drejtë. Ky kriter ishte shpresa e arsyeshme që intervenimi humanitar të siguronte jetën e shqiptarëve të pambrojtur nga regjimi gjenocidal serb.

7) Kriteri i shtatë parasheh drejtësinë relative (“Relative justice”) e cila e kufizon të drejtën e shtetit për të vepruar në referencë të së drejtës absolute. Sipas këtij kriteri nuk i lejohet asnjë shteti, bazuar në

bazë të sanksionimeve në Sistemin e Drejtësisë Ndërkombëtare, të posedojë të drejtën për të kryer veprime gjenocidale.

Në analizim të kriterit të shtatë gjendet e drejta relative duke e vënë në pikëpyetje çdo sovranitet shtetëror që përdor dhunë gjenocidale. Në këtë kontekst hidhen poshtë të gjitha pretendimet për cenimin e sovranitetit të Jugosllavisë (historikisht e juridikisht sovraniteti i Jugosllavisë nuk kishte legjitimitet e legalitet në trojet shqiptare – shih Konferencën e Bujanit), sepse asnjë shtet nuk ka të drejtë që të vrasë, të masakrojë e të dëbojë shtetasit e vet. Ndonëse Kosova e kishte shpallur pavarësinë në vitin 1990 ende sundonin institucionet e Jugosllavisë. Identifikimi i popullatës shqiptare të Kosovës ishin dokumente të nxjerra prej institucioneve jugosllave që dëshmonin se ishin shtetas të Jugosllavisë, porse nuk gëzonin të drejta si shtetas. Shkelja e të drejtave dhe rrezikimi i jetës së shqiptarëve bëhej pikërisht dhe vetëm pse kishin përkatësi shqiptare. Për të mbrojtur shqiptarët që ishin të rrezikuar nga dhuna gjenocidale serb vetëm nga fakti që i takonin përkatësisë shqiptare. Në këtë bazë sfidohet sovraniteti i Jugosllavisë edhe me nenin 29 pika 1 dhe me nenin 30 të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut dhe legjitimohet e legalizohet intervenimi humanitar i NATO-s.

8) Kriteri i tetë është i lidhur me deklaratimet e hapura (“open declaration”). Sipas këtij kriteri nevojitet të jenë paralajmërime të hapura dhe të njohura para çdo hapi intervenues. Zbatimi i vendimit për intervenim duhet të paralajmërohet nga drejtuesit e intervenimit.

Edhe kriteri për deklarime të hapura përpara intervenimit është plotësuar nga liderë të instancave ndërkombëtare. Qeveria e Millosheviqit ishte paralajmëruar që nëse nuk ndalon dhunën kundër shqiptarëve të Kosovës do të intervenonte NATO-ja ushtarakisht. Këtë paralajmërim e kishin dhënë shumë herë dhe me vite me radhë edhe gjatë fillimit të viteve 1990 duke filluar nga paralajmërimet e presidentit George Bush. Paralajmërimet për intervenim ajrore vazhduan e u intensifikuan kur u përkeqësua jashtëzakonisht gjendja në Kosovë gjatë vitit 1998-1999. Presidenti Clinton e administrata e tij kishte paralajmëruar disa herë Millosheviqi për pasojat nëse nuk ndalon dhunën ushtarake kundër shqiptarëve atëherë do të pasonte intervenimi. Edhe Rezolutat e Këshillit të Sigurimit parashihnin mundësinë për të ndërmarrë masa shtesë për të ndërprerë dhunën e ushtrisë serbe kundër shqiptarëve. Paralajmërimet ishin botërisht të qarta nga NATO-ja duke treguar se qëndronte në gjendje gatishmërie për të marrë urdhër për të intervenuar në Kosovë. Paralajmërimi i fundit ishte urdhri i sekretarit gjeneral të

NATO-s, Javier Solana, që dha urdhër më 23 mars 1999 për të filluar operacionet luftarake kundër forcave ushtarake serbe (Fixdal, M. & Smith, D. 1998:286-7).

Kategoria e dytë është “Ius in Bello” (Ligji i Luftës) si pjesë e Luftës së Drejtë që posedon disa kritere dhe kanë komponentë që e përforcojnë justifikimin për Luftën e Drejtë duke e definuar Ligjin e Luftës, gjegjësisht sjelljen në luftë.

1) Kriteri i parë në këtë kategori është diskriminimi “discrimination”. Në këtë kriter është sanksionuar që me termin *diskriminim* të merren në konsideratë masat pozitive për civilë, pra të përdorej diskriminimi mes palës së forcave ushtarake dhe palës së popullatës civile. Thënë ndryshe, të bëhet dallimi dhe të respektohet imuniteti për njerëz që nuk janë duke luftuar dhe nuk janë luftëtarë apo pjesëtarë të luftës.

Në rastin e Kosovës intervenimi humanitar i NATO-s kishte target vetëm garnizone luftarake dhe pikat e forcave ushtarake që kryenin gjenocid kundër popullatës civile shqiptare në Kosovë. Me këtë kriter të diskriminimit garantohej imuniteti i popullatës civile edhe nga NATO-ja.

2) Në kriterin e dytë është paraparë proporcionaliteti (“Proportionality”). Ky kriter është i ngjashëm me kriterin e pestë të kategorisë së parë “Ius ad Bellum” ku kërkohet që intervenim të jetë i matshëm dhe të sjellë më shumë dobi sesa dëme.

Si më lart, rreth këtij kriteri intervenimi i NATO-s është i matshëm dhe është tejet i suksesshëm, sepse solli dobi shumë të mëdha dhe të mira: a) duke ndërprerë dhunën gjenocidale serbe dhe kthimin e afro një milion shqiptarëve të cilët ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre prej forcave ushtarake serbe; b) duke shpëtuar djemtë e Organizatës së Grave në të Zeza në Serbi që kërkonin që djemtë e tyre të mos shkonin e të rrezikoheshin në luftimet për të vrarë shqiptarë në Kosovë; dhe c) duke mbrojtur parimet universale dhe vlerat e sistemit ndërkombëtar (Fixdal, M. & Smith, D. 1998:287).

Intervenimi i NATO-s ishte në përputhje me përmbajtjen e traditës së Luftës së Drejtë dhe me plotësim të gjithë këtyre kritereve argumentohet se janë respektuar të dy kategoritë përmes të cilave legjitimohet përdorimi i forcës kundër çdo shteti sovran i cili shkel këto kritere, siç ishin shkelur në rastin e Kosovës. Në esencën e dy kategorive qëndron etika nga e cila paraprakisht vlerësohet dhe merren në konsideratë edhe veprimet e pushtetit politik dhe situata reale. Me gjithë

hezitimet e dilemat apo konfrontimet për përkrahjen e Luftës së Drejtë, në thelb, qëndron relevanca e përhershme për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare nga rrezikimi i sigurisë dhe krizave humanitare. Në mbështetje të këtyre argumenteve nga Lufta e Drejtë si pjesë e sanksionuar në kornizën e sistemit ndërkombëtar qëndron në mënyrë të pakontestueshme edhe intervenimi humanitar i NATO-s.

Në sqarim të dilemës rreth zhvillimit të Luftës së Drejtë në mënyrë specifike për dilemat rreth parimit të drejtësisë në rastet e konfrontimit apo të përkrahjes dhe mospërkrahjes së imperativit të luftës mund të kuptohet në përgjigjet e teksteve të filozofisë klasike që mund të përdoret si përgjigje në të gjitha kohërat. Një përgjigje të këtillë e gjejmë të shprehur nga mendimet e filozofit Augustine që imperativin e luftës e lidh me parimin e drejtësisë nga i cili përfshihen obligimi dhe detyrimi. Në këtë kontekst Augustine nënvizon se njerëzit e mençur do të bëjnë luftëra të drejta, por do të ankohen gjithmonë nga fakti që u përballën me domosdoshmërinë e kryerjes së luftës së drejtë, sepse po të mos ekzistonte parimi i drejtësisë nuk do të angazhoheshin në asnjë lloj lufte. Përgjigjja e filozofit Augustin korrespondon saktësisht me imperativin e intervenimit humanitar të NATO-s në Kosovë që ishte veprim i mençur e detyrë dhe obligim për të mbrojtur paqen dhe sigurinë.

Në shqyrtim të mëtejshëm të traditës së Luftës së Drejtë shihet se është sanksionuar forma e zhvillimit të luftës sa i përket mënyrës së sjelljes dhe përdorimit të mjeteve të Luftës së Drejtë. Njëkohësisht, Lufta e Drejtë e përjashton ndarjen në mes relacioneve në nivel rajonal apo ndërkombëtare. Në kornizën e sanksioneve në traditë të Luftës së Drejtë afirmohet paraprirja e motiveve me qëllime të dobishme që mbërthen elementet më të pastra që rrjedhin nga parimet etike. Mbi bazën e parimeve të etikës në lidhshmëri me imperativin e intervenimit afirmohen tri perspektiva etike:

- 1) Deontologjinë (detyrimi dhe obligimi)
- 2) Konsekuencializimin dhe
- 3) Virtytin etikal.

Në lexim të perspektivës etike të deontologjisë (detyrimit dhe obligimit) aty përfshihet kriteri për të përmbushur obligimet dhe detyrat që u detyrohemi të tjerëve. Mjeti matës për të gjykuar rreth obligimit dhe detyrimit ndaj të tjerëve mbështetet në kushtëzime se a janë veprimet konform standardeve të drejtës natyrore. Në thjerrëz të kësaj perspektive për të drejtën natyrore të shqiptarëve të Kosovës për të

jetuar dhe për të mbrojtur jetën e tyre nga dhuna gjenocidale e Serbisë ishte obligim dhe detyrim që është i barasvlershëm me imperativin për të intervenuar. Deontologjia në rastin e Kosovës është plotësuar me intervenim e NATO-s e dhe shtetet që investuan në këtë intervenim e kryen obligimin dhe detyrimin për mbrojtje të drejtave natyrore për sigurimin e jetës së një populli të viktimizuar nga dhuna gjenocidale serbe.

Perspektiva e konsekuencializmit merr parasysh shumë faktorë, por si bazament qëndron prioritizimi i efekteve dhe në listën e kërkesave parashihet promovimi i mirëqenies, lumturisë dhe sjellje të tjera që kanë efekte të mira për jetën e njerëzve. Efektet e intervenimit të NATO-s në Kosovë sollën lumturi dhe mirëqenie të shqiptarëve duke i shpëtuar nga vdekja e forcave të ushtrisë serbe.

Në perspektivën e virtutit etikal koncentrimi i saj është te dhënia e përparësisë për të vepruar në përmbushjen e nevojave, në radhë të parë, ndaj vetvetes për të vazhduar në përmbushjen e detyrave që u kemi borxh të tjerëve. Në këtë dimension detyra dhe efekti bazohen në vlerësimet ndaj individit për të cilin gjykohet se ka karakter dhe qëllime të mira dhe të drejta të cilat kanë rëndësi të posaçme dhe janë pjesë e inkorporuar në filozofinë e traditës së Luftës së Drejtë (Fixdal, M. & Smith, D. 1998:287). Në kuadër të kësaj perspektive ishte mençuria që u tregua në strategjinë e veprimit të intervenimit të NATO-s duke angazhuar trupat e veta përmes aksioneve ajrore e duke rezervuar përdorimin e aksioneve tokësore për të mos rrezikuar trupat ushtarake që kryenin aksion humanitar. Me këtë strategji përmbushej kërkesa për ruajtjen jetës të trupave të NATO-s dhe njëkohësisht kryhej borxh ndaj shpetimit të jetës së njerëzve.

Tradita e Luftës së Drejtë ndonëse përballet me sfida dhe nënshtrim të “tiranisë së parimeve” e kthen vëmendjen drejt gjykimit në përpjekje të baraspeshës për të niveluar bazën në mes të moralit dhe realitetit të situatës aktuale. Gjykimi i lidhshmërisë së luftës së drejtë duken qartazi specifikat dhe ndjeshmëria për të filluar një Luftë të Drejtë.

Ndjeshmëria e luftës kalon nëpër vlerësim të shumë kritereve. Në dy kategoritë e traditës së Luftës së Drejtë kriteri që përsëritet në dy kategoritë është kriteri i proporcionalitetit. Në këtë kriter specifik vlerësohet se në rastet kur një luftë që zhvillohet jashtë përmasave të proporcionalitetit shtron imperativin e pakontestueshëm për të intervenuar për ndërprerje të këtyre luftërave.

Në rastin e Kosovës lufta që zhvillohej nga forcat luftarake serb ishte jashtë çdo proporcionaliteti duke vrarë e masakruar popullatën civile shqiptare dhe duke i dëbuar ata nga shtëpitë e tyre. Në këtë drejtim gjykimi i NATO-s për intervenim humanitar është plotësisht në përputhje me kriteret e traditës së Luftës së Drejtë. Të gjitha kriteret e traditës së Luftës së Drejtë qëndrojnë mbi bazat e humanizmit dhe synon arritjen e ekuilibrit midis argumenteve morale e politike dhe kujdesit të lartë rreth motivit të qëllimit dhe merren paraprakisht në shqyrtim pasojat e tij (Fixdal, M. & Smith, D. 1998:288). Në shqyrtim të këtyre kriterëve plasohet legjitimiteti e legaliteti i intervenimi i NATO-s në Kosovë.

### Doktrina e Clinton-it në linjë me vlerat e humanizimit

***“Nëse nuk veprojmë, lufta do të përhapet. Nëse përhapet, ne nuk do të jemi në gjendje ta frenojmë pa rrezik dhe kosto shumë më të madhe. Unë besoj se sfida e vërtetë e politikës sonë të jashtme sot është të përballemi me problemet para se ato të dëmtojnë përherë interesat tona jetike. Kjo është ajo që ne duhet të bëjmë në Kosovë... Duhet të kujtojmë atë që ndodhi në fshatin Reçak në janar -- burra, gra dhe fëmijë të pafajshëm të çuar nga shtëpitë e tyre në një gropë, të detyruar të gjunjëzohen në baltë, të spërkatur me armë zjarri -- jo për shkak të ndonjë gjëje që kishin bërë, por për shkak të asaj që ishin. ... një pjesë e përgjegjësive sime është të përpiqem t'u lë pasardhësve të mi dhe vendit tonë në shekullin e 21-të, një mjedis në Evropë që është i qëndrueshëm, human dhe i sigurt. Do të jetë një pjesë e madhe e së ardhmes së Amerikës...”***<sup>9</sup>

Imperativi i intervenimit të NATO-s është i lidhur ngushtë me linjën e doktrinës së Clinton-it në të cilën është përcaktuar aspirimi i mbrojtjes së vlerave universale në mbrojtje të jetës së njerëzve të pambrojtur. Doktrina e Clinton-it, në thelb, ishte në mbështetje të intervenimit humanitar të Kosovës për ndërprerjen e gjenocidit serb në Kosovë. Presidenti Clinton gjatë zhvillimit të luftës në Kosovë nënvizoi qartë konsekuencat që pasohen nga politika e një liderit dhe pohoi se nëse ndonjë lider e udhëheq popullin e vet për të bërë krime, duke iu referuar Hilerit që urdhëroi popullin e vet të kryente gjenocid, atëherë

---

<sup>9</sup> <https://edition.cnn.com/ALLPOLITICS/stories/1999/05/13/clinton.kosovo/transcript.html> - - përkthim i citatit nga vetë autorja

njerëz të tjerë që kanë rolin e liderit duhet të marrin vendime për të ndaluar veprime e tyre.

Në analizën krahasuese nga Presidenti Clinton rreth cilësive të liderizmit nxori edhe më tej ngjashmëritë në mes të Hitlerit dhe Millosheviqit duke treguar që ky i fundit prej viteve 1980 në synim për të zgjeruar pushtetin e tij kishte nxitur urrejtje fetare dhe etnike. Millosheviqi në emër të kauzës së Serbisë së Madhe zhvilloi lufta kundër popujve të tjerë të Federatës Jugosllave e këtë luftë e vazhdoi në mënyrë të veçantë kundër myslimanëve boshnjakë dhe shqiptarëve që jetonin kuadër Federatës.

Doktrina e Bill Clinton-it si lider me cilësi demokratike ishte kundër doktrinës gjenocidale të Millosheviqit që ushtronte në Kosovë. Presidenti Clinton tërhoqte paralelizëm në lidhshmërinë e Holokaustit të Hitlerit me veprimet e Millosheviqit kundër shqiptarëve përmes spastrimit etnik, si dhe përdorimit të shtypjes së egër sistematike e të paramenduar duke nxitur urrejtje fetare e etnike me qëllim të mbajtjes së pushtetit dhe krijimit të Serbisë së Madhe. Clinton-i potencoi se luftën që e zhvillonte Millosheviqi në Kosovë për t'i përzënë shqiptarë nga toka e tyre kishte për qëllim për të zhdukur përgjithmonë shqiptarët në Kosovë prandaj konsiderohet që është një luftë jo vetëm kundër shqiptarëve, por edhe kundër vlerave njerëzore. Më tej, presidenti Clinton duke argumentuar për gjendjen në Kosovë dhe ofensivat e Serbisë kundër shqiptarëve nënvizonte se kjo është: “fyerje ndaj njerëzimit dhe sulm jo vetëm ndaj një populli, por ndaj dinjitetit të të gjithë njerëzve”.<sup>10</sup>

Faktet e regjimi gjenocidal të Millosheviqit para një dekade (1989) flasin për zhveshjen e Kosovës nga rregullimi kushtetuese i viti 1974 duke mohuar të drejtën legjitime për drejta elementare të përdorimit të gjuhës amtare, moslejimi të shkonin në shkollat e tyre dhe të japin formë jetës së tyre të përditshme. Presidenti Clinton kërkonte ndryshim të gjendjes në Kosovë dhe ndalimin e dhunës gjenocidale të urdhëruar nga Millosheviqi. Prandaj, në një prononcimin tjetër Clinton-i e cilëson rolin e dy llojeve të liderëve politikë dhe se në çfarë drejti-mesh liderët mund të drejtonin popullin. Në këtë rast, Clinton-i merr shembull Hitlerin dhe nënvizon se gjermanët nuk do të kryenin diçka kundër racave të tjera, por ishte Hitleri që detyroi gjermanët të kryenin Holokaustin. Liderët politikë si Hitleri mund të bëjnë gjëra të ngjashme,

<sup>10</sup> <https://edition.cnn.com/ALLPOLITICS/stories/1999/05/13/clinton.kosovo/transcript.html> me 03-05-2018

por liderët të llojit tjetër duhet të bëjnë diçka që ta ndalonin Millosheviqin.<sup>11</sup> Në këtë situatë vetë Clinton-i në rolin e liderit të SHBA-së ndjente peshën e barrës së rënd që të ndalonte Millosheviqin dhe në vazhdimësi paraqiste argumente faktike për gjendjen në Kosovë.

Presidenti Clinton ishte i drejtpërdrejtë për të paraqitur imperativin për intervenim për të ndaluar vazhdimin e veprimeve gjenocidale të forcave ushtarake serbe pasi ishin shterur të gjitha pritshmëritë që me mjetet të diplomatike do të mund të zgjidhje çështja e Kosovës.

Presidenti Clinton intervenimin e NATO-s e konsideroi imperativ qendror duke plotësuar pohimin e vet se: *“... ne kemi një urdhër vep- rimi të NATO-s që bazohet në zbatimin e procesit të paqes, dhe dështimi për ta bërë atë shkakton reagim, që ne duhet të bëjmë ç’është e mundur për të parandaluar mizoritë e mëtejshme. Nuk besoj se duhet të kemi mijëra njerëz të therur dhe varrosur në fusha të hapura futbolli përpara se të bëjmë diçka. Mendoj se do të ishte për të ardhur keq nëse do të kishim thënë se duhet të kemi shumë më shumë viktimë përpara se të ndalojmë atë që dimë se do të ndodhë”*.<sup>12</sup>

Në përforcimin e doktrinës së tij presidentit Clinton bënte apel duke e vënë theksin për të ndjekur shembullin e gjeneratës së Luftës së Dytë Botërore për të vepruar kundër agresionit dhe urrejtjes dhe kishte bindje të plotë se patjetër në një mënyrë Aleatët e NATO-s do të arrijnë objektivat. Bindja e tij ishte përforcuar meqë dhuna gjenocidale e Millosheviqit kundër popullit shqiptar të Kosovës e kishin forcuar unitetin dhe vendosmërinë e aleatëve.

Në të vërtetë Clinton-i ishte i vetëdijshëm që Kosova gjatë kohës së dezintegritimit të Federatës Jugosllave kishte shpallur sovranitetin e saj, më 1990 dhe ishte përcaktuar për të ardhmen e vet, mirëpo që mbeti pa u njohur nga Bashkësia Ndërkombëtare. Pas shpërthimit të luftërave në Bosnjë e Kroaci çështja e Kosovës mbeti nën hije dhe nuk u mor parasysh as përpara as pas Marrëveshjes së Dejtonit. Gjendja e rëndë dhe shkeljet e vrazhda të drejtave të njeriut në territorin e Kosovës ishin mjaft të njohura për BN-së (Thomahausen, S. 2002:88). BN-ja ishte e fokusuar për zbatimin e Marrëveshjes së Dejtonit dhe Kosova mbeti viktimë e radhës për qeverinë e Serbisë. Duke e parë gjendjen jashtë- zakonisht të rënduar në Kosovë atëherë BN-ja vendosi që të jetë më

---

<sup>11</sup> Po aty

<sup>12</sup> <https://www.washingtonpost.com/wp-srv/politics/daily/april99/clintonquotes.-htm> - përkthim i citatit nga vetë autorja

aktive në parandalimin e regjimit të Millosheviqit dhe vendosi sanksione kundër Serbisë, por nuk dhanë ndonjë efekt pozitiv.

Në fakt, doktrina Clinton-iane në mbrojtje të vlerave humanitare dhe shmangien e luftërave ishte mjaft e njohur në botë. Edhe në rastin e Kosovës doktrina e Clinton-it ishte udhërrëfytes për shmangien e përhapjes së luftës dhe ndërprerjen e veprimeve gjenocidale. Luftërat nuk ishin favorizim në doktrinën e tij prandaj përdori mekanizma për të ndaluar zhvillimin dhe përhapjen e luftës duke paralajmëruar vendosmërinë për të ndërprerë luftën në Kosovë. Në mënyrë brilante doktrinën Clinton-iane e ka paraqitur sekretarja e SHBA-së Madeleine Albright duke e lidhur me rastin e Kosovës e cila prezantoi qëndrimin e presidentit Clinton. Sekretarja Albright potencoi se ishin të gatshëm që të ndërmerren aksion unilateral me qëllim të ndërprerjes së dhunës barbare dhe spastrimit etnik të Millosheviqit ndaj civilëve shqiptarë të Kosovës. Mbështetje doktrinës së Clinton-it i dhanë shumë shtete demokratike evropiane e në mesin e tyre shquhet përkrahja e kryeministrit të Britanisë së Madhe Tony Blair që para se të përshkallëzohej lufta në Kosovë kërkonte ndërhyrje të BN-së në Kosovë. Kryeministri britanik Tony Blair në prononcimet e tij qysh në vitin 1998 nënvizonte se Britania nuk mund të qëndrojë mënjane duke shikuar vuajtje masive njerëzore në Kosovë dhe shtonte se është nevojë e domosdoshme për të vepruar kundër destabilitetit evropian që është kërcënim edhe për Britaninë (P.A. van Hoofft, 2015:236).

Kryeministri britanik, Tony Blair, ishte në rreshtim me linjën e doktrinës Clinton-iane sepse kjo doktrinë ishte në përputhje me të gjitha Kartat e Konventat për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Doktrina Clinton-iane ishte në përballje me regjimin e Millosheviqit i cili vazhdonte të mos i respektonte urdhrat e BN-së, të cilët kërkonin ndërprerjen e ofensivës ushtarake në Kosovë. Edhe Këshilli i Sigurimit i OKB-së kishte aprovuar më 31 mars të vitit 1998 Rezolutën 1160 të cilën Millosheviqi nuk e mori parasysh. Në këtë Rezolutë Këshilli i Sigurimit i kërkonte Serbisë, mes të tjerash, ndërprerjen e ofensivës së forcave ushtarake serbe dhe vazhdimin e negociimit diplomatik për njohjen e një autonomie substanciale për Kosovën. Në këtë Rezolutë ishte miratuar dispozita në të cilën qartësisht ishte dhënë ultimatum që të ndërpriteshin luftime në Kosovë. Mirëpo, dispozitat e Rezolutës nuk i respektoi Serbia e cila jo vetëm që nuk e ndërpreu ofensivën ushtarake, por e intensifikoi edhe më shumë duke vrarë e masakruar civilë shqiptarë. Në mbrojtje të popullatës civile vazhdoi të luftojë Ushtria Çlirimtare e

Kosovës (UÇK ) duke iu kundërpërgjigjur ofensivës serbe (Thomahausen, S. 2002:91). Mungesa e pajisjeve ushtarake të UÇK –së ishte hendek i madh meqë pajisjet e tyre ishin minale në krahasim me pajisjet e ushtrisë serbe, por megjithëkëtë rezistonte me vendosmëri për të luftuar e mbrojtur popullatën nga forcat ushtarake serbe.

Përshkallëzimi i luftës në Kosovë ishte në kundërshtim me Rezolutat e nxjerra nga BN dhe të doktrinës Clinton-iane. Shtimi i numrit të trupave ushtarake të Millosheviqit në Kosovën ishte përlllogaritur diku afër 40-50,000 ushtarë që luftonin kundër shqiptarëve civilë të cilët mbroheshin vetëm nga UÇK -ja. Lufta vazhdonte gjersa BN ishte ende e pavendosur për të nxjerrë ultimatumin për intervenimin e forcave ushtarake të NATO-s për mbrojtje të popullatës shqiptare. BN në shtatorin e vitit 1998 e nxori Rezolutën me numër 1199 e cila në referim të Rezolutës 1160 bënte presion shtesë ndaj Millosheviqit. Në Rezolutën 1199 ishte vlerësuar që gjendja në Kosovë ishte tepër e rrezikshme dhe u definua me termin kërcënim i paqes ndërkombëtare dhe sigurisë regjionale. Gjatë përpilimit të kësaj Rezolute u paraqit propozimi për imperativin e intervenimit të NATO-s, por nuk do të aprovohet, sepse nuk pati mbështetje nga dy anëtarët e përhershëm të KS, të Kinës dhe Rusisë. Megjithëkëtë, në dispozitat e kësaj Rezolute ishte aprovuar që të mbetet i hapur përdorimi i masave shtesë për të mbajtur dhe rikthyer paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon (Thomahausen, S. 2002:93-4).

Miratimi i Rezolutës 1199 dhe 1203 mbante të hapur çështjen e mjeteve shtesë për ndërprerjen e dhunës gjenocidale në Kosovë. Kurse pushteti i Serbisë vazhdonte t'i nënçmojë sanksionimet e Rezolutave dhe nuk i konsideronte si masa suficiente që mund të ofronin ndonjë bazë legale apo mund të referoheshin te kriteret normative ekzistuese në Kartën e OKB-së për përdorim e forcës së NATO-s për të intervenuar në Kosovë. Pas shumë takime diplomatike në këtë periudhë kohore, në mes të muajit tetor 1998, emisari i SHBA-së Richard Holbrooke arriti që të nënshkruan një marrëveshje me Millosheviqin për ndërprerjen e ofensivës si dhe për reduktimin e forcave ushtarake në territorin e Kosovës. Përpos kësaj Marrëveshjeje ishte arritur marrëveshje për lejimin e alokimit të Misionit të Verifikimit me 2000 vëzhgues ndërkombëtarë të paarmatosur, si dhe krijimin e një Misioni për Verifikim Ajror mbi Kosovën.

Në fund tetorit të vitit 1998 (me datën 24 tetor) KS miratoi Rezolutën 1203 me të cilën ripërforcoheshin kërkesat e Rezolutës 1160 dhe 1199 duke ripërsëritur terminologjinë e përdorur në Rezolutën 1199 në tekstin e së cilës gjendja në Kosovë vlerësohej si kërcënim për paqe

ndërkombëtare dhe siguri rajonale (Thomahausen, S. 2002:95-6). Ndërsa, Rezoluta 1203 bënte thirrje për hetim të shpejtë dhe të plotë, duke përfshirë mbikëqyrjen dhe pjesëmarrjen ndërkombëtare, për të gjitha mizoritë e kryera kundër civilëve shqiptarë dhe bashkëpunim të plotë me Tribunalin Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Në këtë Rezolutë ishte përcaktuar edhe afati kohor që deri më 2 nëntor 1998 të nisin negociatat mes palëve për zgjidhje të statusit të Kosovë me mjete paqësore.<sup>13</sup>

Zbatimi i këtyre Rezolutave nuk u respektua dhe u shkelën edhe Marrëveshjet e arritura me emisarin Holbrook duke u intensifikuar edhe më shumë sulmet ushtarake serbe në Kosovës. Rinisja e ofensivës së ushtrisë serbe dhe shkelja e Marrëveshjeve të sipërpërmendura e detyroi NATO-n që të nxjerrë urdhër ndaj Serbisë që brenda 96 orëve të tërhiqte trupat ushtarake, përndryshe do të bombardohej nga NATO-ja.

Pas një tërheqjeje taktike të Millosheviqit për t'iu shmangur kërcënimit që brenda 96 orëve të bombardohej e ndaloi ofensivën për një kohë të shkurtër, por pastaj gjatë periudhës së festave të Krishtlindjeve i rifilloi aksionet ushtarake serbe kundër popullatës civile shqiptare. Forcat ushtarake serbe më 15 janar kryen masakrën e radhës në fshatin Reçak duke i masakruar 45 civilë shqiptarë. Trupat e viktimeve përveç plagëve me armë zjarri kishin edhe plagë nga armët e ftohta. Të gjitha viktimat, që nga më i moshuari deri te foshnja, ishin masakruar në mënyrë barbare. William Walker që ishte kryesues i Misionit të Verifikimit të OSBE-së shkoi në vendin e ngjarjes dhe pa me sytë e vet këtë masakër që më pas dëshmoi para botës se në Reçak ishte kryer një mizori e papërshtueshme, ishte kryer një krim kundër njerëzimit.

Masakra e Reçakut e bëri të qartë qëllimin e Millosheviqit për Kosovën dhe pezmatimi i BN-së kundër tij shpërtheu. Menjëherë u aktivizua diplomacia ndërkombëtare dhe Albright takoi ministrin e Punëve të Jashtme të Rusisë që dënuan ofensivën e re të Millosheviqit kundër shqiptarëve të Kosovës. Pas masakrës së Reçakut më 15 janar 1999 u ripërsërit propozimi se intervenimi i NATO-s ishte imperativ për të ndërprerë gjenocidin serb ndaj shqiptarëve. Por, si zakonisht kundërshtimet e njëpasnjëshme të Rusisë e Kinës ndaj imperativit për të intervenuar NATO-ja ishin një pengesë për përdorimin e forcave ushtarake në mbrojtje të paqes dhe sigurisë.

Kundër këtyre pengesave qëndronte SHBA-ja e udhëhequr nga presidenti Clinton që kishte vendosur për të ndaluar dhunën gjenocidale

<sup>13</sup> <http://unscr.com/en/resolutions/1203> vizituar me 24-06-2023

të serbëve kundër shqiptarëve dhe për të siguruar paqe e siguri. Në këtë situatë ishte obligim i BN-së për të ndërprerë dhunën gjenocidale, por u detyruan që këtë obligim ta fillonin me alternativa të kombinuara me diplomaci më agresive e shoqëruar me kërcënim për të arritur zgjidhje paqësore.

Doktrina e Clinton-it ishte për fuqizimin e NATO-s dhe parashih-te që siguria e shteteve që shtrihen në mes Evropës dhe Ruisë ndikojnë dhe rrezikojnë edhe sigurinë e Amerikës. Qasja e Doktrinës së Cliton-it ishte intervencioniste me bindjen se gjenocidi kudo që të ndodhë, si në Afrikë apo Evropë apo në ndonjë pjesë tjetër të botës mbetet në fuqinë tonë që ta ndalojmë dhe ne duhet që ta ndalojmë. Në këtë drejtim, strategjia e sigurisë së interesave humanitare duhet të jetë ndalimi i krizave që gjeneronin destabilizim dhe flukse të konsiderueshme të refugjatëve (Silver. K. C. 2021:24).

Në deklaratimet e presidentit Clinton shfaqej shqetësimi i tij për të parandaluar luftën dhe për të arritur paqen. Në këtë periudhë doktrina e Clinton-it ishte duke udhëhequr diplomacinë e SHBA-së dhe që kishte vendosur që të gjente mjete diplomatik që të fitonte përkrahjen nga ana e Ruisë. Në mënyrë tejet të matur SHBA-ja për të siguruar mbështetjen e Ruisë nuk e përmend në Grupin e Kontaktit asnjë kërcënim për intervenim e NATO-s. Përkundrazi, SHBA-ja në fokus kishte propozimin që të arrihej një Marrëveshje Paqësore për të dy palët e cila duhet të përmbante një kornizë kohore të përcaktuar. Për arritjen e aprovimit të këtij propozimi kërkohet që të dy palët, pala serbe dhe pala shqiptare, të pranonin një Marrëveshje paqësore. Kornizat e kësaj Marrëveshjeje paqësore u parashtruan në Konferencën e Rambouillet (Thomahausen, S. 2002:97). Me këtë vendim për mbajtjen e Konferencës dhe që pas saj palët të nënshkruanin Marrëveshjen paqësore konsiderohej se ishte vendosur shiriti i kuq nga ana e BN-së. Kushtëzimi për nënshkrimin e Marrëveshjes paqësore ishte paralajmërim se nuk mund të tolerohej vazhdimi i krimeve gjenocidale serbe kundër popullatës shqiptare në Kosovë. BN-ja gjatë mbajtjes së Konferencës me ngulm kërkonte që të nënshkruhej Marrëveshja e Rambouillet nga dy palët, serbe dhe shqiptare.

Në mbështetje të propozimit të lartpërmendur ishte shprehur edhe vetë sekretari i përgjithshëm i NATO-s Javier Solana dhe më 31 janar e paralajmëroi Millosheviqin për herë të fundit që nëse kërkesat e BN-së nuk do të respektoheshin atëherë do të fillonin sulmet ushtarake (Thomahausen, S. 2002:97). Po ashtu Këshilli i NATO-s u paraqit me një deklaratë duke bërë të qartë detyrimin e dy palëve për pranimin e

Marrëveshjes paqësore dhe në rast të refuzimit do ta përdornin forcën ushtarake ajrore. Kjo Deklaratë e Këshillit të NATO-s nuk u mirëprit nga regjimi i Millosheviqit dhe menjëherë kërkoi thirrjen me urgjencë të mbledhjes së Këshillit të Sigurimit që të distancohej nga Deklarata kërcënuese e Këshillit të NATO-s, sepse ky kërcënim, sipas tyre, ishte shkelje e nenit 2 (4) të Kartës së OKB-së.

Kërkesën e Serbisë nuk e aprovoi Këshilli i Sigurimit të OKB-së dhe nuk nxori asnjë Rezolutë për të dënuar kërcënimin e Këshillit të NATO-s. Pretendimet tendencioze të Serbisë kundër intervenimit të NATO-s duke akuzuar se ka shkelur nenin 2 (4), hidhen poshtë nga analizimi më i detajuar i këtij neni. Ne fakt, neni në fjalë në pikën 3, pra 2(3), është sanksionuar që të gjithë anëtarët e OKB-së t'i zgjidhin konfliktet e tyre në mënyrë paqësore që të mos rrezikohet paqja botërore, siguria dhe drejtësia ndërkombëtare. Pastaj, në të vërtetë, edhe te pika 2(4)<sup>14</sup> për të cilën Serbia akuzonte NATO-n është sanksionim i qartë në mbështetje të intervenimit, meqë kërkohet që shtetet të mos bien ndesh me qëllimet e Kombeve të Bashkuara. Prandaj, në lexim dhe interpretim të kuptimit të saktë të nenit 2 (4) shihet se ishte vetë pushteti i Millosheviqit që ra ndesh me dispozitat e OKB-së, sepse sipas Rezolutave të nxjerra nga Këshilli i Sigurimit ishte shpallur gjendja në Kosovë dhe konsiderohej si kërcënim i paqes ndërkombëtare dhe sigurisë rajonale (shih Rezolutat nr. 1160 apo 1199 dhe 1203).

Në kundërshtim të pretendimeve të Millosheviqit ishte përfaqësuesi i Britanisë së Madhe në Këshilli e Sigurimit të OKB-së i cili përjashtoi mundësinë që NATO-ja kishte bërë ndonjë shkelje të nenit 2 (4) të Kartës së OKB-së. Argumentimi i tij ishte në favor të intervenimi, meqë ishte bërë me qëllim të mbrojtjes së parimeve fundamentale të Kartës së OKB-së dhe për të shmangur katastrofën humanitare. Sipas tij, intervenimi ishte mjeti i fundit pasi ishin shterur të gjitha mjetet diplomatike e juridike për të ndërprerë mizoritë e Millosheviqit në Kosovë (Thomahausen, S. 2002:110)

Mbrojtja e përmbajtës së parimeve të Kartës së OKB-së është e detyrueshme për çdo shtet anëtar dhe në përputhje me Kartën obligohen që të angazhohen që çdo mosmarrëveshje të zgjidhet me mjete paqësore. Thelbi kryesor në përmbajtjen e Kartës është obligimi detyrues që të ruhet paqja ndërkombëtare dhe siguria e drejtësia ndërkombëtare. Larg nga respektimi i këtij obligimi ishte Serbia e cila jo vetëm që paraqiste rrezik për paqe ndërkombëtare e siguri regjionale, por as nuk

<sup>14</sup> <https://fn.se/wp-content/uploads/2016/07/FN-stadgan.pdf> vizituar me 23-07-2016

u përpoq fare të respektojë Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së që janë norma detyruese për zbatim.

Pretendimi tjetër akuzues i Serbisë kundër NATO-s ishte akuza për shkeljen e nenit 51 të Kartës së OKB-së. Në demantim të këtij pretendimi akuzues qëndron sanksionimi i veprimeve të çdo shteti ku potencohet se veprimi individual i një shteti në vetëmbrojtje mund të merret apo lejohet derisa të arrijë Këshilli i Sigurimit të marrë masa të nevojshme për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Po ashtu është e sanksionuar që çdo shtet është i detyruar për të paraqitur thirrjen në Këshillin e Sigurimit dhe për të njoftuar për çdo rrezikshmëri. Në këtë drejtim, Serbia nuk mund ta bënte një kërkesë për rrezikshmëri përpara Këshillit të Sigurimit, meqë ishte vetë Serbia që shkaktonte rrezikshmëri të paqes ndërkombëtare dhe të sigurisë regjionale. Kështu që akuza e tyre duke u bazuar në nenin 51 i Kartës së OKB-së ishte e pavlefshme dhe, në fakt, pengesa kryesore me të cilën ballafaqohej regjimi i Millosheviqit.

Në kapitullin VII të Kartës së OKB-së në nenin 39 është sanksionuar se Këshilli i Sigurimit përcakton nëse kemi të bëjmë me një kërcënim apo prishje të paqes dhe jep rekomandim për masa të duhura. Paraqitja e kërcënimit të paqes dhe Sigurisë ishte potencuar në Rezolutat 11 60; 11 99, 12 03 që nuk u zbatuan nga Serbia. Gjithashtu, në neni 42 parashihet që nëse Këshilli i Sigurimit konsideron se masat janë të pamjaftueshme atëherë mund të kërkojë masa të nevojshme deri te lejimi i përdorimit të forcave të armatosura për rivendosjen e paqes dhe sigurisë. Në përputhje me këto nene të kapitullit VII të OKB-së ishin edhe tri Rezolutat e lartpërmendura. Rezoluta 1203 e 24 tetorit 1998 kërkonte zbatimin e plotë dhe të shpejtë të Rezolutave 1160 dhe 1199 dhe respektoheshin të gjitha marrëveshjet e arritura.<sup>15</sup> Në Rezolutën 1203 ishte kërkuar në mënyrë specifike që veprimet e qeverisë së Beogradit të jenë në përputhje me të gjitha Rezolutat e mëparshme. Në këtë Rezolutë ishte miratuar dispozita për asistim të Misionit të Verifikimit të OSBE-së në Kosovë, si dhe mundësinë për të shtuar masat e nevojshme për të siguruar funksionimin e këtij Misioni (Thomahausen, S. 2002:107).

Në janar të vitit 1999 dëshmi për dhunën gjenocidale serbe ishte masakra e Reçakut që ishte referenca më e fundit e situatës në Kosovë. Presidenti Clinton potencoi se *ishte i dhimbshëm lajmi për njerëz civilë që ishin masakruar atje jo pse kishin bërë diçka por vetëm pse ishin ata*

---

<sup>15</sup> <https://digitallibrary.un.org/record/262334?v=pdf>

*që ish-in, do të thotë pse ish-in shqiptarë.. Në nivelin ndërkombëtar kishite reagime të shumta ku kërkohej mbrojtja e popullatës shqiptare të Kosovës, dhe këto kërkesa ishin në përputhje me vlerat fundamentale të Kartës së OKB-së. Në reagimet deklarative dhe të mbështetjes së intervenimit të NATO-s kundër gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës reagimi më i fuqishëm për të ndërprerë gjenocidin ishte i presidentit Bill Clinton që paralajmëronte: “... nëse ne dhe aleatët tanë nuk kemi vullnet për të vepruar, do të ketë më shumë masakra. Në ballafaqimin me agresorët në Ballkan, hezitimi është leje për të vrarë. Por veprimi dhe vendosmëria mund të ndalojnë ushtritë dhe të shpëtojnë jetë”<sup>16</sup>*

Presidenti Clinton pas dështimit të Konferencës së Rambouillet që ofronte alternativën për zgjidhje paqësore mes palëve konstatoi se përpjekjet diplomatike për t’i dhënë fund konfliktit në Kosovë dhe për të ndaluar vrasjet nuk kishin dhënë rezultate. Bisedimet për paqe ishin ndërprerë për shkak se negociatorët serbë nuk kishin pranuar që të diskutojnë rreth planit paqësor. Pas ndërprerjes së bisedimeve, presidenti Clinton e bëri të njohur paralajmërimin që NATO-ja ia kishte dërguar Millosheviqit me urdhër që ose duhet t’i japë fund konfliktit ose do të përballet me aksione ushtarake. Presidenti Clinton në pronociminin e tij rikujtoi tmerrin e luftës së Ruandës dhe Bosnjës dhe vonesën e intervenimit atje deri te vendosmëria e SHBA-së dhe NATO-s për të intervenuar dhe për të arritur paqen në vitin 1995. Përvoja nga këto dy vende nuk duhet të përsëritej në Kosovë.<sup>17</sup>

Ndërprerja e krizës humanitare në Kosovë është e domosdoshme për ruajtjen e besueshmërisë së misionit të NATO-s për ta ruajtur stabilitetin në Evropë. Vendosmëria e Clinton-it ishte burim i themeleve të doktrinës së tij me vizion për shekullin e ardhshëm me përcaktim që të bëhen përpjekje për të ndërtuar një aleancë me Evropën për shekullin e 21-të – i përkushtuar që të shohë një Evropë unike, të fortë e të sigurt, në paqe e mirëqenie.<sup>18</sup>

Presidenti Clinton paralajmërimin e radhës për ndërprerjen e gjenocidit e bëri dy ditë përpara (22 mars 1999) se të fillonte intervenimi ushtarak i NATO-s në Kosovë. Në deklarinin e tij u potencua që po që

<sup>16</sup> [https://1997-2001.state.gov/policy\\_remarks/1999/990319\\_clinton\\_kosovo.html](https://1997-2001.state.gov/policy_remarks/1999/990319_clinton_kosovo.html) vizituar me 30-01-2023

<sup>17</sup> [https://1997-2001.state.gov/policy\\_remarks/1999/990319\\_clinton\\_kosovo.html](https://1997-2001.state.gov/policy_remarks/1999/990319_clinton_kosovo.html) vizituar me 30-01-2023

<sup>18</sup> [https://1997-2001.state.gov/policy\\_remarks/1999/990319\\_clinton\\_kosovo.html](https://1997-2001.state.gov/policy_remarks/1999/990319_clinton_kosovo.html) vizituar me 07-03-2018

se Millosheviqi do të vazhdojë agresionin atëherë planet e NATO-s do të ecin përpara drejt objektivit që në Kosovë të ndalojmë vrasjet dhe të arrijmë një paqe të qëndrueshme. Gjithashtu, presidenti Clinton në përgjigje të situatës në Kosovë në deklarimin e tij nënvizonte se në rrezik ishin vlerat njerëzore dhe interesat e tyre, prandaj duhej të përgatiteshin për të bërë ndryshim të situatës. Në kërkim të ndryshimit u përdorën të gjitha mjetet diplomatike dhe kur u shterën të gjitha shpresat për të bërë ndryshim përmes diplomacisë, atëherë e vetmja alternativë e mundshme për të bërë ndryshim ishte intervenimi i NATO-s.

Po ashtu, një ditë para intervenimit të NATO-s në Kosovë, më 23 mars 1999, presidenti Clinton i brengosur për detyrimin që të fillonin përdorimin e mjeteve ushtarake, paraqiti përmbledhjen e doktrinës së tij se çfarë bote dëshironte ta shihte në të ardhmen dhe tha që dëshironte që ne të jetojmë në një botë ku shkojmë mirë me njëri-tjetrin, me të gjitha dallimet tona dhe të mos shqetësohemi duke parë skena të spastrimit etnik çdo natë në ndonjë pjesë të botës për 40 vjetët e ardhshme.<sup>19</sup>

Presidenti Clinton e argumentoi imperativin e intervenimit të NATO-s me Luftën e Drejtë dhe nënvizonte se "Po të qëndronim mënjane, mizoritë në Kosovë do të vazhdonin. Demokracitë fqinje, siç e shihni, do të pushtoheshin nga refugjatët e përhershëm dhe do të demoralizoheshin nga dështimi i aleancës së demokracisë. Shqiptarët e Kosovës do të bëheshin popull pa atdhe, një barrë për vendet pritëse, një magnet për ideologjitë radikale, një terren pjellor për luftë të pafundme në Ballkan"<sup>20</sup>

Doktrina e presidentit Clinton që ishte zbatuar në rastin e Kosovës për ndërprerjen e veprimeve gjenocidale paraqet zotimet për imperativin e intervenimeve humanitare kudo në botë për një të ardhme paqesore dhe të sigurt për njerëzimin. Doktrina e presidentit Clinton qëndron fuqishëm në plotësimin e kritereve të traditës së Luftës së Drejtë dhe në harmoni me parimet e vlerave humane në sistemin ndërkombëtar të drejtësisë.

## Konkluzionet

Territori i Kosovës ka përjetuar shumë luftëra gjatë historisë, por lufta e fundit ishte një luftë që e tërë bota e kuptoi qëllimin e regjimit të

---

<sup>19</sup> <https://www.washingtonpost.com/wp-srv/politics/daily/april99/clintonquotes.-htm> vizituar me 07--03-2018

<sup>20</sup> <https://www.washingtonpost.com/wp-srv/politics/daily/april99/clintonquotes.htm>

Milloseviqit për të zhdukur shqiptarët nga territori i Kosovës. Në përmbushje të këtij qëllimi gjatë viteve 1998-1999 forcat ushtarake serbe kryenin dhunë gjenocidale transparente kundër shqiptarëve në territorin e Kosovës, duke vrarë e dëbuar shqiptarët dhe duke plaçkitur e djegur shtëpitë e shqiptarëve. Bashkësia ndërkombëtare investoi jashtëzakonisht që përmes labirinteve diplomatike të ndërprisnin dhunën gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve, por të gjitha mjetet diplomatike u shterën dhe dështoi diplomacia ndërkombëtare që të ndërpresë dhunën gjenocidale e cila kishte potencial të rrezikojë sigurinë rajonale dhe paqen ndërkombëtare.

Këshilli i Sigurimit i OKB-së gjatë periudhës kur zhvillohej dhuna gjenociale në Kosovë kishte aprovuar tri rezoluta që ishin dokumente detyruese për t'i zbatuar, por pushteti milloseviqian nuk i mori parasysh dhe i përbuzi. E vetmja alternativë për t'i dhënë fund dhunës gjenocidale ndaj shqiptarëve ishte intervenimi humanitar i NATO-s si imperativ për t'iu përgjigjur situatës katastrofike në Kosovë.

Në bazë të Kartës së OKB-së dhe të gjitha dokumenteve të sistemit ndërkombëtar të drejtësisë, ishte detyrim i BN-së për të reaguuar, por ishte e vështirë që të sigurohej autorizimi i Këshillit të Sigurimit meqë refuzonin dy shtetet permanente, Rusia dhe Kina. Edhe në Rezolutat e Këshillit të Sigurisë ishte sanksionuar se pushteti i Milloseviqit paraqiste kërcënim për paqen ndërkombëtare dhe siguri regjionale. Milloseviqi bënte shkelje kundrejt qëllimit dhe parimeve thelbësore të Kartës së OKB-së në të cilën parashihet që të gjitha shtetet të përmbushin në mirëbesim të gjitha detyrimet që dalin nga Karta.

Situata në Kosovë ishte urgjencë humanitare dhe si rrjedhojë ishte imperativ intervenimi humanitar që me forca ushtarak për të ndërprerë dhunën gjenociale si alternativa e fundit. Intervenimi humanitar i NATO-s për situata të këtilla ishte në përputhje me dokumentet e OKB-se dhe të drejtës zakonore ndërkombëtare për Luftë të Drejtë. Parimet e Luftës së Drejtë bazohen në prizmën që lufta është e keqe dhe duhet të shmanget derisa ka mundësi, por njëkohësisht pranon që detyrohet, pasi në disa raste ekziston justifikimi, për të hyrë në luftë dhe merr njohje si Luftë e Drejtë, siç mori intervenimi 78 ditë i intervenimit të NATO-s në Kosovë.

Këto parime ishin pjesë e doktrinës së Clinton-it që ishte busulla morale e rendit botëror. Vizioni i Clinton-it u realizua në përfundim të shekullit XX në mbrojtjen e popullit shqiptar në Kosovë, si dhe duke i dhënë mbështetje ruajtjes së paqes ndërkombëtare dhe sigurimin e jetës së njerëzve. Realisht rrezikimi i paqes ndërkombëtare dhe i sigurisë

kolektive ishte potencialisht i mundur në shtetet fqinje, si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Greqia. Nëse vendet përreth përfshiheshin në konflikt, rrjedhimisht përhapja e konfliktit do të shkaktonte rrezikshmëri të paqes ndërkombëtare. Rrezikshmëria e paqes dhe sigurisë rajonale u evitua pas ndërprerjes së dhunës gjenocidale serbe në Kosovë përmes aksionin 78 ditësh nga intervenimi humanitar i NATO-s. Intervenimi humanitar i NATO-s në Kosovë dhe doktrina Clinton-iane është pjesë e historisë botërore dhe një parandalim për të mbrojtur vlerat e sistemit ndërkombëtar në të ardhmen. Intervenimi humanitar i NATO-s në Kosovë është pjesë e historisë botërore që mbrojti popullin shqiptar nga shfarosja e dhunës gjenocidale serbe.

## Referenca

- Fixdal, M. & Smith, D. 1998 “Humanitarian Intervention and Just War” in *Mershon International Studies Review* (1998) 42, 283-312.
- Hurd, Ian. 2021. “International organizations: Politics, Law, practice” Cambridge University Press.
- Knotter, L. (2022). Contemporary Humanitarian Intervention: Beyond Rules-Based International Order. In D. Rogers (Ed.), *Human Rights in War* (pp. 81-102). (International Human Rights). Springer. [https://doi.org/10.1007/978-981-16-2116-1\\_5](https://doi.org/10.1007/978-981-16-2116-1_5)
- Krisafi, Ksenofon 2018 ”Lufta e Kosovës në Labirintet Diplomatike”, UMSH Press/Onufri, Tiranë.
- Morton, Jeffrey S. (2002) "The Legality Of NATO's Intervention In Yugoslavia in 1999: Implications For The Progressive Development Of International Law," *ILSA Journal of International & Comparative Law*: Vol. 9: Iss. 1, Article 3.në: <https://nsuworks.nova.edu/ilsajournal/vol-19/iss1/3>
- Naomi, H. 2012 “Justifying violence – Communicative ethics and the use of force in Kosovo” Manchester University Press.
- Newman, Edward “Exploring the UK's Doctrine of Humanitarian Intervention” në: <https://doi.org/10.1080/13533312.2021.1878689> vizituar më 24-03-2022 P.A. van Hooft, 2015 “The future in the past: Victory, defeat, and grand strategy in the US, UK, France and Germany”, University of Amsterdam, the Netherlands.
- Salihu, S. 2000 “Sovereignty and Legitimacy of the State of Kosovo” ISBN 978-9951-27-318-3
- Silver. K. C. 2021 “The Domestic Reality of Foreign Policy: the 1994 Clinton Administration Response to the Crises in Rwanda and Haiti”, Univeristy of South Florida, South Florida.
- Thomahausen, S. 2002 “Humanitarian Intervention in an Evolving World Order: the Case of Iraq, Somalia, Kosovo and East Timor”, African Centry, Publictions Series No. II, South Africa.

## Literaturë online

Den mystiska sjukdomen” në:

<https://bengtsjoberg.blogg.se/2009/march/den-mystiska-sjukdomen-i-kosova.html>

Myter och Dumheter om Kosovo në:

<https://www.fria.nu/artikel/20877>

FÖRENTA NATIONERNAS STADGA och STADGA FÖR DEN INTERNATIONELLA DOMSTOLEN në:

<https://fn.se/wp-content/uploads/2016/07/FN-stadgan.pdf>

Transcript: Clinton justifies U.S. involvement in Kosovo në:

<https://edition.cnn.com/ALLPOLITICS/stories/1999/05/13/clinton.kosovo/transcript.html>

White House Office of the Press Secretary, Washington, DC, March 19, 1999 në:

[https://1997-2001.state.gov/policy\\_remarks/1999/990319\\_clinton\\_kosovo.html](https://1997-2001.state.gov/policy_remarks/1999/990319_clinton_kosovo.html)

Clinton's Statements on Kosovo në:

<https://www.washingtonpost.com/wpsrv/politics/daily/april99/clintonquotes.htm>

Chinkin, M. Christine, 1999 “Kosovo: A “Good” or “Bad” War?” në:

<https://www.jstor.org/stable/2555349?seq=1>

Exploring the UK’s Doctrine of Humanitarian Intervention

<https://doi.org/10.1080/13533312.2021.1878689>

“Text of a letter from the President to the Speaker of the House of Representatives and the President of the Senate” në:

<https://www.clintonlibrary.gov/sites/default/files/documents/kosovo-press-1999.pdf>

Press Release SC/6784

CONFLICTS IN KOSOVO, SIERRA LEONE AND ANGOLA, QUESTION OF EAST TIMOR KEY ELEMENTS OF SECURITY COUNCIL’S WORK FOR 1999 në:

<https://press.un.org/en/2000/20000118.sc6784.doc.html>

U.S. Department of State – Archive në:

<https://1997-2001.state.gov/statements/1998/981027.html>

Resolution 1203 (1998) / adopted by the Security Council at its 3937th meeting, on 24 October 1998 në: <https://digitallibrary.un.org/record/262334?v=pdf>



25-VJETORI I NDËRHRYJES SË NATO-S DHE ÇLIRIMIT TË  
KOSOVËS: NJË ÇEREK SHEKULL SHTETNDËRTIM, ARRITJE DHE  
SFIDA – QASJE MULTIDISIPLINARE

Konferencë shkencore  
10 qershor 2024

2024

*Botues:*  
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

*Lektor:*  
Bahri Koskoviku

*Redaktor teknik:*  
ASHAK

*Madhësia:* 16.5 tabakë shtypi  
*Tirazhi:* 300 copë  
*Formati:* 16x24 cm

*Shtypi:*  
Focus Print  
Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

323.1(=18:496.51)  
061.1(4/9:496.51):355  
341.233(4/9:496.51)

25-vjetori i ndërhryjes së NATO-s dhe çlirimit të Kosovës: një çerek shekull shtetndërtim, arritje dhe sfida – qasje multidisiplinare; këshilli organizues Gjyljeta Mushkolaj, Frashër Demaj, Arsim Bajrami . - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2024. - 263 f. : ilustr. ; 24 cm. - (ASHAK : Seksioni i Shkencave Shoqërore)

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze

1. Mushkolaj, Gjyljeta 2. Demaj, Frashër 3. Bajrami, Arsim

**ISBN 978-9951-26-095-4**